


HALLALLI DHE HARAMI

*E lejuara dhe
e ndaluara*

Dr. Jusuf Kardavi



DR. JUSUF EL-KARDAVI

HALLALLI DHE HARAMI
(E LEJUARA DHE E NDALUARA)
NË ISLAM

Logos-A - Shkup
1998/1418

Titulli i origjinalit:

حلالٌ وحرامٌ في الإسلام

تأليف
الدكتور الشيخ يوسف القرضاوي

Përktheu
Muhammed Mustafa

Copyright © by Logos-A - 1997

Të gjitha mendimet dhe idetë e shprehura nga autori nuk janë
doemos edhe të botuesit

CIP - Katalogizacija vo publikacija Narodna i
univerzitetska biblioteka "Kliment Ohridski" -
Skopje

297.5

El-KARDAVI, Jusuf

Hallalli dhe harami në Islam / Jusuf el-Kardavi:
[përkthyes Muhamed Mustafa] - Shkup: Logos-A,
1997 - 2 izd., - 376 str.: 23 sm.

Fusnoti kon tekstot.

ISBN 9989-601-55-0

a) Islam - Etika

Dr. Jusuf el-Kardavi

Hallalli dhe harami në Islam

NGA KUSHTETUTA HYJNORE

مِّنَ الَّذِينَ يَدْعُونَ إِلَٰهًا لَّا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ
 أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ
 قُلْ مَنْ حَرَّمَ زِينَةَ اللَّهِ الَّتِي أَخْرَجَ لِعِبَادِهِ
 وَالطَّيِّبَاتِ مِنَ الرِّزْقِ قُلْ هِيَ لِلَّذِينَ آمَنُوا
 فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا خَالِصَةٌ يَوْمَ الْقِيَامَةِ كَذَلِكَ
 نَفْصِلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ ﴿٣٣﴾ قُلْ إِنَّمَا حَرَّمَ
 رَبِّي الْفَوَاحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنَ
 وَالْإِثْمَ وَالْبَغْيَ بِغَيْرِ الْحَقِّ وَأَنْ تُشْرِكُوا بِاللَّهِ مَا لَمْ
 يُنَزَّلْ بِهِ سُلْطَانًا وَأَنْ تَقُولُوا عَلَى اللَّهِ مَا لَا تَقُولُونَ ﴿٣٤﴾

الأنعام - ٣٣ - ٣٤

Me ndihmën e All-Ilahut mbrohem prej
dëmit të djallit të mallkuar!

Me emrin e All-Ilahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

“Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-Ilahu i krijoi për robërit e vet?” Thuaj: “Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqarojmë argumentet një populli që kupton”. - Thuaj: “Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, qoftë ato të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t’i mvishni All-Ilahut shok pa patur për këtë kurrfarë argumenti dhe ndaloi të thoni për All-Ilahun atë që nuk e dini se është e vërtetë.”¹

(El-A'râf, 32-33)

¹ Përkthimin e ajeteve nga arabishtja në shqip e huazova prej përkthimit të H. Sherif Ahmetit, që u botua në Prishtinë në vitin 1988 (sh.p.).

Përmbajtja:

NGA KUSHTETUTA HYJNORE.....	iv
Përmbajtja:.....	v
PARATHËNIA E AUTORIT.....	xiii
PARATHËNIA E BOTIMIT TË PARË.....	xv
DEFINICIONET.....	xxii
KAPITULLI I PARË.....	1
PARIMET ISLAME RRETH HALLALLIT DHE HARAMIT....	1
PARIMET E ISLAMIT RRETH HALLALLIT DHE HARAMIT....	2
Në esencë gjërat janë të lejuara.....	3
Lejimi dhe ndalimi janë vetëm e drejtë e Zotit xh.sh.	7
Ndalimi i hallallit dhe lejimi i haramit konsiderohet	
shirk (idhujtari).....	10
Ndalimi - burim i së keqes dhe dëmit.....	13
Zëvendësimi i haramit me hallall.....	15
Ajo që të shpie në haram, konsiderohet haram.....	16
Paraqitja e haramit si hallall është e ndaluar.....	17
Qëllimi i mirë nuk e arsyeton haramin.....	18
Ruajtja nga hamendjet duke iu frikësuar rënies në	
haram.....	21
Harami është haram për të gjithë.....	22
Nevoja lejon përjashtime.....	24
KAPITULLI I DYTË.....	26
HALLALLI DHE HARAMI NË JETËN PERSONALE TË	
MUSLIMANIT.....	26
NË USHQIM E PIJE.....	27
Therja e kafshëve dhe ngrënia e mishit të tyre sipas	
brahmanitëve.....	27
Kafshët e ndaluara tek hebrenjtë dhe të krishterët.	28
Tek arabët para shpalljes së Kur'anit.....	28
Islami e lejon ushqimin e mirë.....	29
Ndalimi i cofëtirës dhe urtësia e kësaj ndalese.....	30
Ndalimi i gjakut të derdhur.....	31
Mishi i derrit.....	31
Prerja që bëhet jo në emër të Zotit.....	32

Llojet e cofëtirave.....	32
Urtësia e ndalimit të këtyre llojeve.....	33
Prerja për idhujt.....	33
Peshqit dhe karkalecat veçohen nga cofëtirat.....	34
Shfrytëzimi i lëkurës, i eshtrave dhe i qimeve të cofëtirave.....	35
Nevoja lejon përjashtime.....	37
Nevoja e shërimit.....	38
Individi nuk është i detyruar (të hajë haram) në qoftë se në shoqëri ka ndonjë që ia largon nevojën e tij	39
PRERJA E KAFSHËVE SIPAS SHERIATIT.....	40
Kafshët e ujit në përgjithësi janë të lejuara.....	40
Kafshët e ndaluara tokësore.....	40
Konditat për lejimin e prerjes së kafshëve shtëpiake	42
Kushtet e prerjes sipas Sheriatit.....	42
Sekreti dhe urtësia e kësaj prerjeje.....	44
Urtësia e përmendjes së emrit të Zotit në prerje.....	46
Therjet e ithtarëve të Librit (hebrenjve dhe të krishterëve).....	46
Prerja për kishën dhe për festat krishtere.....	47
Prerja me mjete elektrike ose forma tjera të ngjashme.....	48
E prera nga zjarrputistët dhe nga të ngjashmit me ata.....	49
Rregull: nuk pyesim për atë që mungon.....	50
Gjahu.....	51
Kushtet e gjahtarit.....	51
Kushtet e gjahut.....	53
Kushtet për mjetet e gjahut.....	53
Gjuetia me mjet vrasës.....	53
Gjuetia me qen ose me diç të ngjashme.....	55
Në rast të ngordhjes së gjahut pas gjuajtjes.....	56
Vera - pijet dehëse (intoksikanët).....	57
Çdo pije dehëse është haram.....	59
Ndalohet edhe pakica e asaj që dehë me shumicë. 60	
Tregtia me alkool.....	60
Muslimani nuk e jep dhuratë alkoolin.....	62
Largimi nga ndejet ku pihet alkooli.....	62
Alkooli është sëmurje e jo shërim.....	63
Narkotikët (droga).....	65
Ngrënia dhe pirja e dëmshme konsiderohet haram. 66	

VESHMBATHJA DHE ZBUKURIMI.....	68
Feja e pastërtisë dhe e bukurisë.....	69
Ari dhe mëndafshi ndalohen për burra.....	71
Urtësia e ndalimit për meshkujt.....	73
Urtësia e lejimit për femra.....	74
Veshja e femrës muslimane.....	74
Imitimi i ndërsjellë midis burrave e grave në veshje	75
Veshja për ekspozim dhe mburrje.....	76
Zbukurimi ekstrem nëpërmjet ndryshimit të konstruktit krijues të Zotit.....	77
Ndalimi i tatuazhit, prerjes së dhëmbëve dhe i operacioneve për zbukurim.....	77
Heqja e vetullave.....	79
Paruka.....	80
Ngjyrosja e flokëve të thinjura.....	82
Rritja e mjekrës.....	84
NË SHTEPI.....	86
Dukuritë e luksit dhe politeizmit.....	87
Enët prej ari e argjendi.....	88
Islami i ndalon statujat.....	90
Urtësia e ndalimit të statujave.....	91
Mendimi islam për madhërimin e personave të mëdhenj pas vdekjes.....	93
Lejimi i lojërave për fëmijë.....	96
Statujat e deformuara.....	97
Pikturat dhe ornamentet njëdimensionale.....	98
Lejimi i figurave të deformuara.....	106
Fotografitë.....	107
Subjekti i fotografisë.....	108
Përmbledhja e rregullave për pikturat dhe piktorët	110
Mbajtja e qenve pa patur nevojë.....	111
Lejohen qentë e gjahut dhe të mbrojtjes.....	112
Mendimi i shkencës moderne mbi ruajtjen e qenve	113
NË FITIM DHE NË ZEJE.....	116
Puna është obligim për të aftin.....	116
Kur lejohet kërkimi i lëmoshës.....	117
Puna e ndershme.....	118
Fitimi nga bujqësia.....	119
Bujqësia e ndaluar.....	121
Industritë dhe profesionet.....	122

Industritë dhe profesionet që i ndalon Islami.....	125
1. Prostitucioni (kurvëria).....	125
2. Vallëzimi dhe artet erotike.....	126
3. Ndërtimi i statujave dhe prodhimi i kryqeve.....	127
4. Prodhimi i pijeve dehëse dhe i narkotikëve.....	127
Fitimi nëpërmjet tregtisë.....	128
Qëndrimi i kishës ndaj tregtisë.....	132
Tregtia e ndaluar.....	132
Puna me pagesë.....	135
Detyrat e ndaluara.....	137
Parimi i përgjithshëm i fitimit.....	138
KAPITULLI I TRETË.....	139
HALLALLI DHE HARAMI NË MARTESE DHE NË JETËN FAMILJARE.....	139
NË ASPEKTIN E INSTINKTIT.....	140
Qëndrimi i njeriut para instinktit seksual.....	140
Mos iu afroni kurvërisë (zinasë).....	141
Ndalohet qëndrimi me femër të huaj në vetmi.....	141
Shikimi i gjinisë tjetër me sy epshi.....	143
Ndalimi i shikimit të pjesëve të turpshme të trupit.....	145
Çka lejohet të shihet në trupin e burrit dhe të gruas.....	146
Cili zbulim i lejohet gruas ta zbulojë e cili jo.....	147
Pjesët e turpshme të gruas.....	150
Hyrja e gruas në banjot publike.....	152
Ndalimi i shfaqjes së bukurisë (teberruxh).....	154
Si duhet të jetë femra muslimane?.....	155
Respekti i bashkëshortes ndaj musafirëve të bashkëshortit.....	158
Homoseksualizmi është mëkat i madh.....	159
Masturbimi (Istimnâ).....	160
NË MARTESE.....	162
S'ka murgëri në Islam.....	162
Shikimi i të fejuarës.....	165
Fejesa e ndaluar.....	167
Pëlqimi i vajzës.....	168
Gratë e ndaluara.....	168
Martesa e ndaluar nga qumështi.....	170
Ndalimet nëpërmjet martesës.....	170
Bashkimi i dy motrave.....	171
Të martuarat.....	172
Gratë idhujtare.....	173
Martesa me gratë që janë ithtare të Librit.....	173

Martesa e muslimanes me jomuslimanin.....	175
Prostitutat.....	176
Martesa e përkohshme (mut'a).....	177
Martesa me më shumë gra.....	179
Drejtësia është kusht për lejimin e martesës me më shumë gra.....	180
Urtësia e lejit të martesës me më shumë gra....	181
MARRËDHËNIET MIDIS BASHKËSHORTËVE.....	183
Marrëdhëniet seksuale.....	183
Marrëdhëniet e ndaluara.....	184
Ruajtja e sekreteve bashkëshortore.....	185
Kontracepcioni.....	187
Shkaqet për kontracepcion.....	188
Aborti.....	191
Të drejtat bashkëshortore.....	191
Toleranca e ndërsjellë bashkëshortore.....	193
Kundërshtimi dhe grindja.....	194
Kur lejohet shkurorëzimi (Talâku).....	196
Shkurorëzimi para Islamit.....	197
Shkurorëzimi sipas Hebraizmit.....	197
Shkurorëzimi sipas Krishterimit.....	198
Mendimet e llojllojshme të krishtere rreth shkurorëzimit.....	199
Pasojat e qëndrimit të Krishterimit ndaj shkurorëzimit.....	200
Krishterimi është shërim i përkohshëm e jo ligj i përgjithshëm.....	200
Përkufizimet e Islamit në rregullat e shkurorëzimit.....	202
Divorci i gruas me të përmuajshmet konsiderohet i ndaluar.....	202
Betimi në shkurorëzim është i ndaluar.....	204
E shkurorëzuara kalon kohën e pritjes në shtëpinë e ish-bashkëshortit të saj.....	204
Shkurorëzimi i përsëritur.....	205
Jetë e njerëzishme ose shkurorëzim me mirëkuptim.....	206
Gruaja e shkurorëzuar s'duhet penguar që të martohet me atë që dëshiron.....	207
E drejta e bashkëshortes të kërkojë shkurorëzim.	207
Ndalohet torturimi i bashkëshortes.....	208
Ndalohet betimi me braktisje (nga bashkëshortja).....	209
FËMIJËT DHE PRINDËRIT.....	211
Islami mbron gjenezën familjare.....	211

Ndalohet mohimi i atësisë.....	211
Adoptimi është i ndaluar në Islam.....	212
Shembulli praktik i anulimit të adoptimit legal.....	214
Adoptimi për rritje dhe kujdes.....	215
Mbarësimi artificial.....	216
Ngarkimi i fëmijës ndokujt tjetër përveç babait konsiderohet mallkim.....	216
Mos i vritni fëmijët tuaj.....	217
Trajtimi i barabartë i fëmijëve.....	218
Respektimi i parimeve të Zotit në trashëgimi.....	220
Mosrespektimi i prindërve është mëkat i madh.....	220
Ofendimi i prindërve është mëkat i madh.....	222
Voluntarizmi për xhihad pa lejen e prindërve nuk lejohet.....	223
Prindërit idhujtarë.....	224
KAPITULLI I KATËRT.....	226
HALLALLI DHE HARAMI NË JETËN E PËRGJITHSHME TË MUSLIMANIT:.....	226
NË BESIME E TRADITA.....	227
Respektimi i ligjeve të Zotit në Gjithësi.....	227
Kundërshtimi i besëtytnive dhe mitologjive.....	228
Besimi në parashikuesit e ardhmërisë është kufër.....	229
Kërkimi i fatit me short.....	229
Magjia (sihri).....	230
Përdorimi i hajmalive.....	232
Parandjenja e fatkeqësisë (pesimizmi).....	235
Lufta kundër traditave të periudhës paraislame.....	237
S'ka shovinizëm në Islam.....	237
Prejardhja dhe ngjyra nuk janë të rëndësishme.....	239
Të mbajturit zi për të vdekurin.....	241
TRANSAKSIONET.....	243
A. Ndalimi i shitjes së gjërave të ndaluara.....	243
B. Ndalohet shitja e pasigurt.....	244
C. Manipulimi me çmimet.....	245
Mallkimi i grumbullimit.....	246
Ndërhyrja në tregun e lirë.....	248
Lejohet ndërmjetësimi tregtar.....	249
Ndalohet eksploatimi dhe mashtrimi tregtar.....	250
Kush na mashtron, s'është prej nesh.....	251
Betimi i shpeshtë.....	252
Mashtrimi në matje e peshim.....	253
Ndalohet blerja e gjërave të vjedhura.....	253
Ndalimi i kamatës.....	254

Urtësia e ndalimit të kamatës.....	255
Dhënësi me kamatë dhe evidentuesi.....	256
Pejgamberi a.s. mbështetet në mbrojtjen e Zotit nga borxhi.....	257
Shitja me pagesë të shtyrë (kredi).....	259
Parapagimi.....	259
Partneriteti ndërmjet kapitalit dhe punës.....	260
Partneriteti i pronarëve të kapitalit.....	262
Kompanitë e sigurimit.....	263
A janë kompanitë e tilla kooperuese.....	264
Modifikimet.....	265
Sistemi islam i sigurimit.....	265
Shfrytëzimi i tokës së kultivuar.....	266
Lloji i ndaluar i veprimtarisë bujqësore.....	269
Analogjia ndalon qiranë me të holla.....	272
Partneriteti në kultivimin e kafshëve.....	275
DËFRIMI DHE REKREIMI.....	277
Kohë për këtë e kohë për atë.....	277
Pejgamberi a.s. si njeri.....	279
Relaksimi i mendjes.....	280
Sportet e lejuara.....	281
Vrapimi.....	281
Mundja.....	282
Harkëtaria.....	283
Gjuajtja me shtiza.....	284
Kalërimi.....	285
Gjuetia.....	287
Tavlla.....	287
Shahu.....	288
Kënga dhe muzika.....	289
Bixhozi është identik me alkoolin.....	293
Lotaria është formë e bixhozit.....	294
Shkuarja në kinema.....	295
NË MARRËDHËNIET SHOQËRORE.....	297
Nuk i lejohet muslimanit të largohet nga muslimani	298
Rregullimi i mosmarrëveshjeve.....	300
Mos të tallet një popull me një popull tjetër.....	301
Mos përgojoni njëri-tjetrin.....	303
Mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape.....	303
Dyshimi.....	303
Spiunimi.....	304
Gibeti, folja pas shpine.....	306

Kur lejohet gibeti.....	308
Thashethemet.....	310
Shenjtëria e nderit.....	312
Shenjtëria e jetës.....	313
Vrasësi dhe i vrari në zjarr (xhehennem).....	315
Shenjtëria e aleatëve dhe e banorëve jomuslimanë	316
Kur anulohet shenjtëria e jetës! (Dënimi me vdekje)	317
Vetëvrasja.....	318
Shenjtëria e pasurisë.....	320
Ndalimi i mitës (ryshfetit).....	321
Dhurata për zyrtarët.....	322
Ryshfeti për largimin e shtypjes (zullumit).....	324
Harxhimi i tepërt ndalohet.....	325
MARRËDHËNIET E MUSLIMANIT ME JOMUSLIMANIN. . .	329
Trajtim i posaçëm ndaj ithtarëve të Librit (ehlul Kitâb)	330
Banorët jomuslimanë në shtetin islam (ehludh- dhimme).....	331
Nocioni i shoqërimit të jomuslimanëve.....	333
Mbështetja në jomuslimanët.....	335
Islami është mëshirë e përgjithshme edhe për kafshët.....	336
PËRFUNDIM.....	339
Shembulli i parë.....	342
Shembulli i dytë.....	343

PARATHËNIA E AUTORIT

Falënderimi i takon All-llahut; Atë e falënderojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë!

Në emër të All-llahut kërkojmë mbrojtje të shpirtave dhe veprave tona dhe veprave tona të këqija!

Atë që e udhëzon Zoti, s'e humbë askush, ndërsa atë që e humbë, s'e udhëzon askush!

Dëshmoj se s'ka zot tjetër përveç All-llahut, është i Vetëm dhe i Pashoq, si dhe dëshmoj se Muhammedi a.s. është i dërguari i Tij (Zoti e mëshiroftë dhe e shpëtoftë atë, familjen e tij, shokët e tij dhe atë që është i udhëzuar me udhëzimin e tij deri në Ditën e gjykimit!).

Ky është botimi i gjashtë¹ i këtij libri, për të cilin lus Zotin që ta shpërblejë autorin, botuesin dhe lexuesin e tij. Ajo që dëshiron zemra e muslimanit është që në këtë kohë ky libër islam të përfitojë lexues, studentë dhe dashamirë nga bijtë e Islamit, të cilët dëshirojnë ta njohin të vërtetën e fesë së tyre dhe t'i harmonizojnë sjelljet e tyre sipas normave fetare, pa u ngarkuar me idetë e huaja dhe shkollat e importuara.

Vlerën e kësaj vepre edhe më shumë e rrit fakti se bëhen përpjekje të mëdha, mblidhet pasuri dhe organizohen fuqi të papërshtatshme nga forcat kundërshtarë të Islamit, me qëllime, metoda, ngjyra dhe emra të ndryshëm, vetëm për ta penguar këtë fe, për ta penguar thirrjen në të, për t'ua ndërprerë rrugën thirrësve të saj, për të mbjellur dyshime e gënjeshtër rreth saj dhe për ta deformuar besimin, sheriatin, qytetërimin dhe historinë e saj. Ata dëshirojnë që popujt muslimanë të largohen nga feja e tyre ashtu siç u larguan shumë udhëheqës të tyre, të cilët e morën Kur'anin për tallje dhe anti-Islamin për program të tyre, e përveç Muhammedit, ndoqën udhërrëfyes tjetër.

¹ Në parathënie të librit *Hallalli dhe Harami në Islam* në origjinal, botuesi thekson se kjo vepër është botuar më herët trembëdhjetë herë.

Nëse dështojnë këto orvatje djallëzore, të planifikuara e të mbështetura për qëllime të caktuara që t'i fusin popujt muslimanë në kufër, atëherë merita i takon librit islam, i cili, sipas statistikës, konsiderohet libër i parë në tregun e botimit dhe distribuimit, ngase hasim në shumë libra, për të cilat shtetet dhe institucionet e mëdha qëllimisht harxhojnë mijëra e qindra mijë dollarë, por nuk e gëzojnë fatin e tregut e as që pranohen, dhe për këtë gëzohemi dhe i falënderohemi Zotit të Madhëruar.

Po, kjo është një begati e Zotit, të cilën obligohemi ta pranojmë me falënderime e nderime, ngase kjo nënkupton se popujt tanë muslimanë vazhdojnë të jenë mirë, ndërsa korruptimi dhe devijimi fshihen në udhëheqjet e imponuara që punojnë për të huajt, fundi i të cilëve është shkatërrimi.

Gjithashtu jam i gëzuar ngase një grup i vëllezërve tanë pakistanezë e turq, ka kërkuar prej meje lejen për ta përkthyer librin në urdisht dhe në turqisht, në të cilën kërkesë u përgjigja pozitivisht, ngase përkthimet e ndryshme nuk duhet të jenë pengesë për këmbime mendimesh midis muslimanëve, që është një ndër hapat e domosdoshëm drejt unitetit islam.

Ky botim dallohet për arsye se shtëpia botuese “El-Mektebul-Islamij” ka shënuar në fusnotë numrat e haditheve, të cilat në margjina të libriti nxori muhaddithi shqiptar Shejh Nasruddin Albani, me qëllim që të ofrojë lehtësim më të madh. Zoti e shpërbleftë Shejh Albanin dhe pronarin e Shtëpisë botuese “El-Mektebul-Islamij” për punën e tyre!

Falënderimi i takon All-llahut i cili na udhëzoi, ngase nuk do të ishim të udhëzuar sikur të mos na udhëzonte Ai!

*“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove,
na dhuro mëshirën Tënde ngaqë vetëm Ti je dhuruesi i
madh!”*

Jusuf el Kardavi

PARATHËNIA E BOTIMIT TË PARË

Instituti i Përgjithshëm i Kulturës Islame në Universitetin e Az'harit më informoi për dëshirën e Pleqësisë së Az'harit që të kontribuojë në një projekt shkencor që përfshin botimin e librave dhe doracakëve të thjeshtë, të cilët përkthehen në gjuhën angleze për t'u dhënë njohuri rreth Islamit muslimanëve dhe jomuslimanëve në Evropë e Amerikë.

Në realitet ky projekt i librave dhe i doracakëve ka qëllim fisnik dhe rëndësi të madhe, dhe njëherit është dashur të realizohet kohë më parë.

Muslimanët e Evropës dhe të Amerikës e njohin shumë pak Islamin. Edhe kjo njohje e kufizuar nuk ka shpëtuar nga konfuzioni dhe deformimi. Para ca kohe më shkroi një shok az'harian i deleguar në SHBA dhe më tha: "Shumica e muslimanëve në SHBA fitojnë nga lokalet e bareve dhe nga tregtia me alkool, pa ndier fare se këto gjëra janë ndër më të ndaluarat në Islam".

Ai gjithashtu shton se meshkujt muslimanë martohen me femrat krishtere e hebreje, bile edhe putistet, ndërsa i braktisin bijat e muslimanëve të cilat mbeten të pamartuara...

Nëse gjendja e muslimanëve është e tillë atëherë si është ajo e jomuslimanëve? Këta kanë një pasqyrë të zbehtë ndaj Islamit, Pejgamberit të Islamit dhe ithtarëve të Islamit. Kryesisht këtë pasqyrim ua afron propaganda misionare kolonialiste, e helmuar dhe e deformuar me të gjitha mundësitë dhe me të gjitha format e mundshme në kohën kur ne jemi në gjumë e agoni.

Kjo është koha më e përshtatshme për ta filluar këtë projekt dhe për ta realizuar këtë shpresëqë na obligon për thirrje në Islam. Ky hap është shumë i bekuar dhe meriton të përshëndeten veprimtarët dhe zbatuesit brenda dhe jashtë Az'harit, duke kërkuar prej tyre që të vazhdojnë me vepra të tilla dhe të kenë sukses.

Instituti i Kulturës kërkoi prej meje që të shkruaj rreth temës së "Hallallit dhe haramit në Islam", duke më rekomanduar që të

shkruaj me stil të rëndomtë, me argumente të kapshme dhe duke bërë krahasime me fetë dhe kulturat tjera.

Tematika e “hallallit dhe haramit” në Islam në fillim duket se është e lehtë, por ajo është shumë e vështirë ngase asnjë autor më herët apo tani vonë, nuk e ka përfshirë këtë temë të gjerë në një libër të posaçëm. Studiuesi mund t’i gjejë pjesët e saj të shpërndara në kapitujt e fikhut islam, tefsir dhe në hadithin e Pejgamberit a.s.

Përveç kësaj, për një temë si kjo autori obligohet të marrë qëndrim të prerë për shumë çështje të cilat ishin diskutabile për dijetarët tanë të hershëm, e në të cilat edhe mendimet e bashkëkohorëve nuk janë definitive.

Vlerësimi i mendimit të drejtë në problemet e hallallit dhe haramit ka nevojë për durim e hulumtime të thella, edhe atë pas përqëndrimit të hulumtuesit në kërkimin e të vërtetës për hir të Zotit.

Kam vërejtur se pjesa dërmuese e hulumtuesve dhe autorëve bashkëkohorë të Islamit ndahen në dy grupe:

Grupi i parë është i mahnitur me shkëlqimin e qytetërimit perëndimor, e adhurojnë këtë put të madh, i ofrojnë viktima, qëndrojnë para tij të përkulur e të nënshtruar. Këta i kanë marrë parimet dhe traditat e Perëndimit si të vërteta aksiomatike. Nëse përputhet diçka me Islamin, e pranojnë dhe e madhërojnë e nëse jo, atëherë kërkojnë ta harmonizojnë e afrojnë, kërkujnë falje ose mbështeten në komentim e deformim, kinse Islami obligohet t’i nënshtrohet qytetërimit, filozofisë dhe traditave të Perëndimit. Këtë e hasim në mendimet e tyre rreth çështjeve që i ka ndaluar Islami, si p.sh. bustat, lotaria, kamata, qëndrimi në vetmi i mashkullit me gruan e huaj, refuzimi i feminitetit nga ana e grave dhe stolisja e meshkujve me ar e mëndafsh... Këtë gjithashtu e vërejmë edhe në atë që e ka lejuar Islami, si p.sh. shkurorëzimi, martesë me më shumë gra... Pra, atë që e lejon Perëndimi, konsiderohet e lejuar, e atë që e ndalon, e ndaluar. Këta harrojnë se Islami është fjalë e Zotit, e fjala e Zotit është gjithmonë më e larta, Ajo ndiqet e nuk ndjek pas, dominon e nuk dominohet!

Si ta ndjek Zoti robin e vet apo si t’u nënshtrohet Krijuesi epsheve të të krijuarve?

“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to”. (El-Mu'minûn, 71)

“Thuaj: “A ka ndokush prej idhujve tuaj që ndonjë të humbur ta drejtojë në rrugën e drejtë?” Thuaj: “Vetëm All-llahu udhëzon në të vërtetën”. Atëherë pra, a është më e drejtë të shkohet pas atij që udhëzon në rrugën e drejtë, apo pas atij që nuk udhëzon (sepse nuk mund ta udhëzojë as vetveten), vetëm nëse prej dikujt tjetër udhëzohet? Ç’është me ju? Si gjykoni?” (Jûnus, 35)

Grupi i dytë mbështetet në disa mendime të posaçme rreth çështjeve të hallallit dhe haramit duke ndjekur ndonjë tekst ose fjali në ndonjë libër, dhe mendon se ai është Islami, nuk e ndien në vete fare, nuk orvatet t’i analizojë argumentet e shkollës ose të mendimit të vet dhe t’i krahasojë me argumentet e të tjerëve për ta nxjerrë të vërtetën nëpërmjet krahasimit dhe dëlirjes.

Nëse pyetet rreth muzikës, këngës, shahut, arsimimit të femrës, zbulimit të fytyrës dhe duarve të femrës, apo diç të ngjashme, menjëherë do të përgjigjet me gojë ose me shkrim se është “haram” (e ndaluar) duke harruar ky grup edukatën e selefit të devotshëm rreth këtyre çështjeve, të cilët ndalonin diçka vetëm nëse kishin njohuri kategorike të ndalimit. Përveç kësaj, ata thonin: “E urrejmë”, “nuk e duam” dhe të ngjashme.

Jam përpjekur që të mos i përkas asnjërit grup ngase nuk pranoj që Perëndimin ta adhuroj si hyjni timen, meqë e kam pranuar All-llahun xh.sh. Zot, Islamin fe dhe Muhammedin a.s. pejgamber. Unë gjithashtu nuk pranoj që mendja ime të imitojë vetëm një medhheb të caktuar për të gjitha çështjet, të sakta apo të gabuara, ngase imituesi, sipas Ibn Xhevizisë, nuk është i sigurt në atë që e imiton, sepse imitimi zhdukë dobinë e intelektit i cili është krijuar për kontemplim e përsiatje, dhe është keq sikur dikujt i jepet qiriri i ndezur e ai e shuan atë dhe ec në errësirë.¹

Po, është e vërtetë se unë nuk u orvata ta përkufizoj veten vetëm në njërin nga medhhebet juridike ekzistuese në botën islame, ngase vetëm një medhheb nuk mund ta përfshijë gjithë të vërtetën. Imamët e këtyre medhhebeve nuk kanë supozuar për veten se janë të pagabueshëm, por kanë qenë muxhtehidë për njohjen e të vërtetës, dhe nëse kanë gabuar, kanë fituar një shpërblim, e nëse e kanë qëlluar, dy shpërblime.

Imam Maliki thotë: “Fjalët e çdonjërit pranohen apo refuzohen, përveç fjalëve të Pejgamberit a.s.”

Imam Shafi'u thotë: “Mendimi im është i saktë me mundësi gabimi ndërsa mendimi i tjetrit është i gabuar me mundësi saktësie”.

¹ *Telbîsu-Iblîs*, f. 81.

Nuk është e udhës për një dijetar musliman që posedon mundësi krahasimi të jetë rob i një medhhebi ose t'i nënshtrohet mendimit të ndonjë fakihi të caktuar, por ai obligohet të jetë rob i argumentit dhe dëshmisë.

Sa më i shëndoshë të jetë argumenti i tij dhe sa më e fortë të jetë dëshmia e tij, aq më tepër ka përparësi për t'u ndjekur, e në qoftë se fakti dhe argumenti i tij janë të dobët, atëherë refuzohet, pa marrë parasysh se kush e thotë atë. Qysh më herët, imam Aliu r.a. ka thënë: "Mos e njih të vërtetën me burrëri, sepse e vërteta i njeh bijtë e saj".

* * *

U mundova që të kem kujdes ndaj kërkesës së Institutit të Kulturës dhe për këtë u mbështeta në argumentime, analizë e krahasime duke u ndihmuar nga mendimet shkencore dhe njohuritë bashkëkohore. Nga e gjithë kjo, u pa se falë Zotit Islami shndritë dhe ndriçon dhe bartë në vete dëshmi të shkëlqyeshme, ngase është fe e përhershme e mbarë njerëzimit.

(Kjo fe jona është) Ngjyrosje e All-llahut, e kush ngjyros (me fe) më mirë se All-llahu? Ne vetëm Atë e adhurojmë." (El-Bekare, 138)

Hallalli dhe harami që prej kohëve të lashta janë të njohur në çdo popull, edhe pse ka patur dallime në sasi dhe lloje si dhe shkaqe të ndryshme. Shumica e tyre ishin të lidhura me besëtytnitë e lashta, me legendat dhe trillimet. Pastaj u shpallën fetë e mëdha qiellore me ligjet dhe porositë e veta mbi hallallin dhe haramin, të cilat e ngritën njeriun prej shkallës së legendave, trillimeve dhe jetës fisnore në shkallën e njeriut fisnik. Disa gjëra të lejuara ose të ndaluara ishin në kornizat e kohës dhe rrethanave, duke u zhvilluar me zhvillimin e njeriut dhe me ndryshimin e kohëve dhe rrethanave. Në Hebraizëm kishte ndalime të përkohshme me të cilat i kishte dënuar Zoti Beni israilët, por nuk kishte karakter të sheriatit të përhershëm. Për këtë Kur'ani e thekson Isain a.s. duke u thënë Beni israilëve:

"Dhe (kam ardhur) që t'ua vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t'ua lejoj disa që u ishin ndaluar juve." (Ali Imrân, 50)

Kur u shpall Islami, njerëzimi përjetonte kulmin e devijimit dhe për këtë shkak Zoti e zbriti shpalljen e Tij të fundit dhe e përfundoi sheriatin e Tij për njerëzimin me sheriatin e përkryer e të përhershëm të Islamit. Rreth kësaj çështjeje, të lexojmë fjalën e Zotit të

Madhëruar pasi i përmendi ushqimet e ndaluara në suren “*El-Mâide*”:

“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe.” (El-Mâide, 3)

Qëndrimi i Islamit ndaj hallallit dhe haramit është i qartë dhe i thjeshtë, si dhe është pjesë e amanetit të madh, të cilin refuzuan ta bartin qiejt, toka dhe kodrat por jo edhe njeriu. Ky është amaneti hyjnor dhe përgjegjësi e hilafetit në tokë. Në bazë të kësaj përgjegjësie njeriu shpërblehet dhe ndëshkohet, për këtë qëllim i është dhuruar intelekti dhe vullneti, i janë dërguar pejgamberë dhe u shpallën librat. Atij pra nuk i takon të pyesë: pse është caktuar hallali dhe harami, apo pse nuk jam i lirë?, ngase një akt i tillë është plotësim i sprovës me të cilën veçohen të ngarkuarit dhe dallohen këto krijesa të Zotit, të cilat nuk kanë shpirtin e pastër të engjëjve e as epshin e kafshëve, është një mesatare me mundësi të ngritjes në shkallën e engjëjve ose më lart apo të zbrësë poshtë e t’u ngjajë kafshëve, bile edhe më poshtë se kafshët.

Nga ana tjetër, hallalli dhe harami qarkullojnë në sferën e sheriatit të përgjithshëm islam që ka për bazë realizimin e mirësisë për njerëzit, mënjanimin e vështirësisë dhe lehtësimin e çështjeve të tyre, mbrojtjen nga korrupsioni, sigurimin e interesit të përgjithshëm, interesin e njeriut në tërësi, atë fizik, shpirtëror dhe mendor; mbrojtjen e interesit të bashkësisë, të të pasurve, të varfërve, udhëheqësve e të udhëhequrve, interesit të burrave e grave, si dhe mbrojtjen e tërë gjinisë njerëzore pa marrë parasysh racën, ngjyrën, vendin, shtetin, moshën apo gjeneratën.

Kjo fe është mëshirë hyjnore për robërit e Zotit në periudhën e fundit të periudhave njerëzore. Në këtë kontekst Zoti i thotë Të dërguarit të Tij:

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (Enbijâ, 107)

Pejgamberi a.s. thotë:

إِنَّمَا أَنَا رَحْمَةٌ مُّهْدَاةٌ.

“Unë u dërgova si mëshirë e dhuruar”.¹

Në bazë të kësaj mëshire, Zoti i ka larguar nga ummeti islam fanatizmin dhe ekstremizmin ashtu siç e ka mënjanuar barrën për të

¹ Transmetim i Hakimit nga Ebu Hurejre ndërsa sahih sipas Dhehebiut. Shiko: *Gâjetul-merâm fî tahrîxi ehâdîthil-halâli vel-harâm*, nga muhaddithi i njohur Shejh Muhammed Nasirud-din Albani.

lejuar apo ndaluar diçka, respektivisht ashtu siç vepruan idhujtarët dhe ithtarët e feve të shpallura të cilët i ndaluan të mirat dhe i lejuan të këqijat. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“E mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (mëshirën) do ta caktoj për ata të cilët ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që argumentet tona i besojnë, që e pranojnë Të dërguarin (Muhammedin a.s.), Pejgamberin arab (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar në virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, ua lejon ushqimet e këndshme dhe ua ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta”. (El-A'râf, 156-157)

Kushtetuta islame rreth hallallit dhe haramit shihet në dy ajetet që i cekëm në fillim të këtij libri:

“Thuaj: “Kush i ndaloj bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet?” (El-A'râf, 32)

“Thuaj: “Zoti im ndaloj vetëm të këqijat e turpshme, qoftë të hapta ose të fshehta, ndaloj mëkatin, ndaloj shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloj t'i mvishni All-llahut shok pa patur për këtë kurrfarë argumenti, dhe ndaloj të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë.” (El-A'râf, 33)

Besoj se, edhe pse ky libër është i vogël, vlera e temës së hallallit dhe haramit e bën që të plotësojë zbrazëtirën në bibliotekën bashkëkohore të muslimanit, të zbërthejë shumë probleme që e kaplojnë muslimanin gjatë jetës së tij personale, familjare e të përgjithshme si dhe t'u përgjigjet pyetjeve të ndryshme si p.sh. çka më lejohet, çka më ndalohet, apo për çka ndalohet kjo e për çka lejohet ajo? Në fund të kësaj parathënieje s'më mbetet tjetër përveç të falënderoj Pleqësinë e Az'harit dhe Institutin e Kulturës Islame për besimin e tyre që ma dhanë për të shkruar rreth kësaj tematike vitale.

Shpresoj se përmes këtij shkrimi e kam arsyetuar besimin dhe e kam realizuar qëllimin.

Lus Zotin e Madhëruar që ky libër të jetë i dobishëm, të jemi të fjalës e të veprës, të na largojë nga devijimi i mendimit dhe i lapsit dhe të na udhëzojë në rrugën e drejtë.

Ai vërtet e dëgjon lutjen!

Safer, 1380 Hixhri

Gusht, 1960

Jusuf el Kardavi

DEFINICIONET

1. HALLALLI (*e lejuara*) nënkupton lejimin që s'ka restriksione ndaluese dhe që e ka lejuar Ligjdhënësi (Zoti) të punohet.
2. HARAMI (*e ndaluara*) nënkupton atë që Ligjdhënësi (Zoti) e ka ndaluar rreptësisht, dhe po qe se veprohet, vepruesi ndëshkohet nga ana e Zotit në Ahiret, e mbase edhe në këtë botë me dënim ligjor nga Sheriati.
3. MEKRUHU (*e papëlqyera*) nënkupton atë që e ndaloi Ligjdhënësi por jo në mënyrë kategorike. Kjo është një shkallë më e ulët se harami dhe vepruesi i mekruh nuk dënohet ashtu siç dënohet vepruesi i haramit. Mirëpo, vazhdimësia në mekruh dhe mospërfillja e tij e çon njeriun deri në haram.

KAPITULLI I PARË

PARIMET ISLAME RRETH HALLALLIT DHE HARAMIT

- Në esencë gjërat janë të lejuara
- Hallalli dhe harami janë e drejtë vetëm e Zotit
- Lejimi i haramit dhe ndalimi i hallallit konsiderohen shirk ndaj Zotit
- Ndalimin e përcjell e keqja dhe dëmi
- Zëvendësimi i haramit me hallall
- Ajo që shpie në haram, konsiderohet haram
- Paraqitja e haramit si hallall është haram
- Qëllimi i mirë nuk e arsyeton haramin
- Largimi nga gjërat e dyshimta
- Harami është i ndaluar për secilin njësoj
- Nevoja lejon përjashtime

PARIMET E ISLAMIT RRETH HALLALLIT DHE HARAMIT

Njerëzit paraislamë ishin të humbur në çështjet e hallallit dhe haramit ashtu siç ishin të humbur edhe në çështjet tjera, bile kishin devijuar aq shumë saqë e kishin lejuar haramin e keq ndërsa e kishin ndaluar hallallin e mirë. Kështu kishin vepruar si idhujtarët ashtu edhe ithtarët e librave të shpallur.

Kjo humbje ka qenë ekstremiste dhe devijuese, e të djathtës apo të majtës ekstreme.

Në të djathtën ekstreme ishin brahmanizmi i vrazhdë indian, murgëria e krishterë dhe doktrinat tjera që mortifikonin trupin, e ndalonin ushqimin e mirë dhe të mirat që i ka krijuar Zoti për roberit e vet. Monasticizmi i krishterë e përjetoi kulmin në Mesjetë ngase mijëra murgj i ndalonin të mirat, bile aq larg kishin shkuar saqë disa prej tyre larjen e këmbëve e kishin konsideruar mëkat kurse hyrjen në banjo, mjerim dhe humbje.

Në të majtën ekstreme ishte doktrina e Mezdekut persian, i cili predikonte lirinë absolute, eventualisht i lejonte njerëzit të marrin çdo gjë, të lejojnë çdo gjë, bile edhe atë që në mënyrë të natyrshme ishte e shenjtë për njerëzit.

Arabët para periudhës islame ishin shembull konkret i destabilizimit kaotik të kriterëve të hallallit dhe haramit. Ata kishin lejuar alkoolin, kamatën e shumëfishtë, torturimin e femrave etj. Kishin shkuar aq larg saqë djajtë e njerëzve dhe xhinëve ua kishin hijeshuar mbytjen e fëmijëve të tyre dhe përkulja para tyre ua ka zhdukur ndjenjat e tyre prindërore. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Kështu, shumicës së idhujtarëve, idhujt ua hijeshuan atyre mbytjen e fëmijëve të vet, për t'i shkatërruar (me mashtrime) dhe për t'ua ngatërruar fenë (që e kishin pasur të Ismailit).” (El-En'âm, 137)

Këta “shoqërues” përdornin mënyra të ndryshme për t'ua hijeshuar vrasjen e fëmijëve prindërve të tyre si p.sh. frika nga varfëria ak-

tuale apo e mundshme, frika nga turpi në rast se fëmija ishte femër, afrimi ndaj zotave nëpërmjet therjes së fëmijëve si kurbanë etj. Është për t'u habitur se ata të cilët e pranonin vrasjen e fëmijëve me therje apo me varrosjen e tyre për së gjalli, këto edhe shumë gjëra të mira ia kishin ndaluar vetes nga kafshët e bimët e ndryshme, bile edhe më interesant është se ata këto vepra i konsideronin si rregulla të fesë dhe ia mvishnin Zotit. Për këtë shkak, Zoti i kundërshtoi dhe u thotë:

“Dhe, sipas bindjes së tyre, ata thoshin: “Këto kafshë dhe këto bimë janë të ndaluara, nuk mund të ushqehet me to, përveç ata të cilëve ne ua lejojmë; këto janë kafshë që është e ndaluar t'u hipet; këto janë kafshë ku gjatë therjes së tyre nuk përmendet emri i All-llahut, duke shpifur ndaj Tij. Ai do t'i ndëshkojë ata për shpifjet e tyre.” (El-En'âm, 138)

Kur'ani e ka sqaruar humbjen e atyre që e lejuan atë që duhet të ndalohet apo që e ndaluan atë që duhet të lejohet, duke thënë:

“S'ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjelehtësia e pa kurrfarë dije dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim.” (El-En'âm, 140)

Kur u shpall Islami, e gjeti këtë konfuzion e devijim në çështjen e hallallit dhe haramit, dhe që në fillim u desht ta përmirësojë këtë aspekt vital të ligjit duke i caktuar parimet legjislative, të cilat do të jenë bazë e hallallit dhe haramit. Kështu i rivlerësoi gjërat, caktoi parime të shëndosha, riktheu drejtësinë dhe caktoi kriteriume. Për këtë shkak, ummeti islam është gjendur në mes të të humburve dhe të devijuarve, qoftë djathtas apo majtas, ishte popull mesatar, dhe ashtu siç e përshkruan Kur'ani, ishte populli më i mirë i njerëzimit.

Në esencë gjërat janë të lejuara

Parimin e parë të cilin e caktoi Islami është që në esencë të gjitha gjërat dhe begatitë që i krijoi Zoti janë të lejuara, ndërsa ndalimi caktohet vetëm në bazë të tekstit ndalues të qartë e konkret nga Ligjdhënësi. Nëse teksti nuk është autentik, siç është rasti me disa hadithe të dobëta, apo nuk është i qartë në argumentimin e tij, atëherë gjërat konsiderohen të lejuara. Dijetarët muslimanë e kanë argumentuar këtë parim me ajetet e qarta nga Kur'ani, si p.sh.:

“Ai (All-llahu) është që për ju krijoi gjithçka në tokë”. (El-Bekare, 29)

“Dhe për ju nënshtroi gjithë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë”. (El-Xhathije, 13)

“A nuk e dini ju se All-llahu nënshtroi për të mirën tuaj ç'ka në qiej e ç'ka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta.” (Llukmân, 20)

Zoti i Madhëruar nuk do t'i krijonte këto gjëra, e as nuk do t'ia nënshtronte njeriut, si dhe nuk do t'i jepte dobi prej tyre e pastaj t'ia ndalonte kur çdo gjë bëri për te por ai ndaloj vetëm disa pjesë të vogla për disa shkaqe të posaçme, që do t'i cekim më vonë.

Kështu, sfera e gjërave të ndaluara në ligjin islam u ngushtua shumë ndërsa sfera e të lejuarave u zgjerua shumë ngase tekstet autentike e të qarta që kanë të bëjnë me ndalimin janë shumë të pakta. Përdërisa nuk ka tekst të lejimit apo ndalimit, në esencë mbizotëron leji-mi dhe falja hyjnore.

Në këtë kontekst, në hadithin vijues thuhet:

مَا أَحَلَّ اللَّهُ فِي كِتَابِهِ فَهُوَ حَلَالٌ، وَمَا حَرَّمَ فَهُوَ حَرَامٌ، وَمَا سَكَتَ عَنْهُ فَهُوَ عَفْوٌ، فَاقْبَلُوا مِنَ اللَّهِ عَافِيَتَهُ، فَإِنَّ اللَّهَ لَمْ يَكُنْ لِيَنْسَى شَيْئًا. وَتَلَا ...

“Atë që e lejoi Zoti në Librin e Tij është hallall dhe atë që e ndaloj është haram, ndërsa për atë që heshti - është falje, pra, pranoni mëshirën prej Zotit ngase All-llahu nuk harron asgjë”,¹ dhe më tej e ka lexuar ajetin:

“Zoti nuk harron gjë...” (Merjem, 64)

Selman Farisiu transmeton se Pejgamberi a.s. është pyetur për tëlyenin, djathin e gëzofin dhe ka thënë:

الْحَلَالُ مَا أَحَلَّ اللَّهُ فِي كِتَابِهِ، وَالْحَرَامُ مَا حَرَّمَ اللَّهُ فِي كِتَابِهِ، وَمَا سَكَتَ عَنْهُ فَهُوَ مِمَّا عَفَا لَكُمْ.

“Hallall është ajo që e ka lejuar Zoti në Librin e Tij e haram është ajo që e ka ndaluar Zoti në Librin e Tij, ndërsa ua ka falur atë për të cilën ka heshtur.”²

Pejgamberi a.s. nuk ka dëshiruar t'u përgjigjet imtësirave por ua ka treguar rregullën me anë të të cilës e njohin të lejuarën dhe të nda-

¹ Transmetimi i Hakimit ndërsa korrigjimi i autenticitetit nga El-Bezari.

² Transmetim i Tirmidhiut dhe i Ibën Maxhes.

luarën. Pra, mjafton ta dijnë atë që Zoti e ka ndaluar, kurse çdo gjë tjetër konsiderohet hallall dhe e mirë.

Pejgamberi a.s. thotë:

إِنَّ اللَّهَ فَرَضَ فَرَائِضَ فَلَا تُضَيِّعُوهَا، وَحَدَّ حُدُودًا فَلَا تَعْتَدُوهَا،
وَحَرَّمَ أَشْيَاءَ فَلَا تَنْتَهِكُوهَا، وَسَكَتَ عَنْ أَشْيَاءَ رَحْمَةً بِكُمْ
غَيْرِ نَسْيَانٍ فَلَا تَبْحَثُوا عَنْهَا.

“Zoti ka obliguar farze, pra, mos i humbni; Zoti ka caktuar kufij, pra, mos i tejkaloni; Zoti ka ndaluar gjëra, pra, mos i aplikoni! E heshtja e Tij ndaj disa gjërave është mëshirë për ju e jo harresë, pra, mos i gjurmoni ato!”¹

Vlen të potencoj këtu se lejimi në esencë nuk përkufizohet në gjëra e objekte por përfshin edhe vepra e sjellje që nuk u përkasin çështjeve të adhurimit, e që i quajmë “zakone (doke) ose punë të përditshme”. Në esencë, këto gjëra janë të lejuara ndërsa ndalimi vlen vetëm për atë që e ka ndaluar Ligjdhënësi i Madhëruar. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Ai ju sqaroi juve se çka është e ndaluar për ju!” (El-En'âm, 119)

Kjo ndryshon nga adhurimi, i cili konsiderohet çështje e mbrojtur e fesë dhe i cili merret vetëm përmes shpalljes (vahjit). Në këtë kontekst, në një hadith autentik thuhet:

مَنْ أَحْدَثَ فِي أَمْرِنَا مَا لَيْسَ مِنْهُ فَهُوَ رَدٌّ.

“Ai që sjell diçka të re në çështjen tonë, diçka që nuk i përket asaj, refuzohet.”²

Kjo bëhet për arsye se e vërteta e fesë pasqyrohet në dy gjëra: të adhurohet vetëm Zoti dhe të adhurohet Zoti vetëm nëpërmjet asaj që e ka caktuar sheriati. Ai që krijon ndonjë adhurim vetvetiu (kushdo qoftë), ajo është humbje dhe refuzohet ngase vetëm Ligjdhënësi ka të drejtë në caktimin e adhurimeve që të afrojnë tek Ai.

Ndërsa Ligjdhënësi, All-llahu xh.sh., nuk i ka caktuar zakonet dhe punët e përditshme, por njerëzit i formojnë dhe i praktikojnë ndërsa Ligjdhënësi vetëm i korrigjon, e në disa raste e konfirmon atë që nuk është e dëmshme dhe kaotike.

¹ Darukutni e ka transmetuar kurse Neveviu e ka trajtuar si hadith hasen.

² Transmetim unanim (muttefekun âlejh).

Shejhul-Islami Ibn Tejmije thotë: “Sjelljet e njerëzve me fjalë e vepra janë dy llojesh: Vepra të adhurimit, me anë të të cilave rregullohet feja e tyre dhe zakone, për të cilat kanë nevojë në jetën e tyre. Në bazë të parimeve të sheriatit dimë se adhurimi, të cilin e obligon ose e dëshiron Zoti, përcaktohet vetëm nëpërmjet sheriatit.

Kurse zakonet janë vepra, me të cilat janë mësuar njerëzit dhe kanë nevojë për to në jetën e tyre, dhe në esencë nuk janë të ndaluara por ndalohen vetëm ato që i ka ndaluar Zoti i Madhëruar, ngase urdhri dhe ndalimi i përkasin vetëm Zotit. Si të ndalohet diçka që nuk është e urdhëruar kur dihet se adhurimi është obligim i urdhëruar?

Për këtë shkak, Ahmed i dhe muhaddithët eminentë theksojnë:

“Në esencë, adhurimet janë çështje *tevkifije* (të ndaluara). Asnjë nga ato nuk bëhet e ligjshme, përveç atyre që All-llahu i ka bërë të ligjshme, përndryshe do të gjendemi në kontekstin e kësaj fjale të All-llahut:

“A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fe, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?” (Esh-Shûrâ, 2)

Sa u përket zakoneve, në esencë mbretëron parimi i faljes, ndërsa haram konsiderohet vetëm ajo që është e ndaluar nga All-llahu, e në të kundërtën ndodh ajo që ceket në ajetin kur'anor:

“Thuaj: “Më thuani atë që All-llahu ua dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar?” (Jûnus, 59)

Meqë ky rregull është i rëndësishëm dhe i dobishëm, atëherë themi se shitblerja, qiradhënia dhe zakonet tjera që janë të nevojshme për jetën e njerëzve, si p.sh. ngrënia, pija dhe veshmbathja janë të rregulluara me norma të mira, gjegjësisht ndalohet ajo që është e keqe, lejohet ajo që është e domosdoshme, urrehet ajo që s' duhet dhe preferohet ajo që është e dobishme.

Nëse është kështu, atëherë njerëzit do të merren me tregti e qiradhënie sipas dëshirës së tyre përderisa nuk e ndalon sheriat si dhe do të hanë e do të pijnë ashtu si të duan përderisa nuk e ndalon sheriat, edhe pse diçka prej tyre preferohet apo urrehet. Përderisa nuk ka ndalesë nga sheriat, atëherë ekziston parimi themelor.”¹

¹ *El-Kavâi 'dun-nûrânijje*, Ibën Tejmije, f. 112-113. Në bazë të këtij parimi, Ibën Tejmije, nxënësi i tij Ibën Kajimi dhe shumica e fukahave hanbelitë thonë: “Në esencën e kontratave dhe kushteve mbizotëron lejimi. Çdo kontratë që nuk është e ndaluar në ndonjë formë, është e lejuar.”

Në kontekst të kësaj, në një transmetim të Xhabir Ibn Abdull-llahut thuhet:

كُنَّا نَعْرِضُ، وَالْقُرْآنُ يَنْزِلُ، فَلَوْ كَانَ شَيْءٌ يَنْهَى
عَنْهُ لَنَهَى عَنْهُ الْقُرْآنُ.

“E praktikonim “*azlin*”^{*} (*coitus interruptus*) gjatë shpalljes së Kur’anit, e sikur të ishte e ndaluar, do ta ndalonte Kur’ani.”

Gjërat të cilat i ka heshtur Shpallja, janë të lejuara dhe të pandaluar, respektivisht lejohen përderisa të ndalohen apo lejohen me tekst të posaçëm.

Ky është perfeksionimi i fikhut të sahabëve r.a., dhe në bazë të tij është caktuar parimi i madhëruar: “Adhurimi bëhet i ligjshëm vetëm me ligjin e Zotit, dhe asnjë zakon nuk ndalohet, përveç me ndalimin e Zotit.”

Lejimi dhe ndalimi janë vetëm e drejtë e Zotit xh.sh.

Parimi i dytë është se Islami e ka përcaktuar autoritetin që ka të drejtë për të lejuar apo për të ndaluar, dhe e ka shkëputur nga kompetenca e krijesave, pa marrë parasysh se çfarë pozite kanë në fenë e Zotit ose në botën e tyre, ngase këtë të drejtë e ka vetëm Zoti i Madhëruar. As monakët, as murgjit, as mbretërit e as sulltanët s’kanë të drejtë që përherë t’u ndalojnë diçka robërve të Zotit. E nëse ndonjëri prej tyre vepron kështu, atëherë ai e kapërcen kufirin dhe kundërshton të drejtën hyjnore në legjislacion për krijesat, kurse ai që e pëlqen veprimin e tyre dhe e përmban, atëherë i bën shokë Zotit ndërsa ithtarët e tillë konsiderohen idhujtarë.

“A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fe, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?” (Esh-Shuara, 21)

Kur’ani i qorton ithtarët e Librit (hebrenjtë dhe të krishterët), të cilët i autorizuan monakët dhe murgjit e tyre për caktimin e hallallit dhe haramit. Në suren “*Tevbe*”, Zoti i Madhëruar thotë:

“Ata i konsideruan “ahbarët” (priftër jehudi) të tyre, “ruhbanët” (murgjit krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes për zota pos All-llahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga peygamberët) pos

* *Azl*, apo *coitus interruptus*, nënkupton derdhjen e spermës jashtë vaginës si një lloj metode kontraceptive.

për adhurimin ndaj All-llahut Një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë (Et-Tevbe, 31)

Adijj Ibn Hatemi erdhi te Pejgamberi a.s. (Adijj para se ta pranonte Islamin besonte në Krishterim) dhe e dëgjoi se e lexonte këtë ajet, e tha:

يَا رَسُولَ اللَّهِ! إِنَّهُمْ لَمْ يَعْبُدُوهُمْ. فَقَالَ: بَلَى،
إِنَّهُمْ حَرَّمُوا عَلَيْهِمُ الْحَلَالَ، وَأَحَلُّوا لَهُمُ الْحَرَامَ
فَاتَّبَعُوهُمْ، فَذَلِكَ عِبَادَتُهُمْ إِيَّاهُمْ.

“O i dërguari i Zotit! Ata nuk i kanë adhuruar ata”. Pejgamberi i përgjigjet: “Gjithsesi, ata ua ndaluan hallallin dhe ua lejuan haramin, e ata i ndjekin. Ky është adhurimi i tyre.”¹

أَمَّا إِنَّهُمْ لَمْ يَكُونُوا يَعْبُدُونَهُمْ، وَلَكِنَّهُمْ كَانُوا إِذَا أَحَلُّوا
لَهُمْ شَيْئًا اسْتَحَلُّوهُ وَإِذَا حَرَّمُوا عَلَيْهِمْ شَيْئًا حَرَّمُوهُ.

Sipas një transmetimi tjetër, Pejgamberi a.s., duke e komentuar këtë ajet, ka thënë:

“Ata edhe pse nuk i adhuronin, e pranonin si hallall atë që ua lejonin dhe si haram atë që ndalonin”.

Krishterët ende supozojnë se Isai a.s. para se të ngrihet në qiell, i ka autorizuar nxënësit e vet që të lejojnë apo të ndalojnë sipas dëshirës së tyre. Në Ungjillin e Mateut 18:18 thuhet: “Unë ua them të vërtetën! Çdo gjë që e ndaloni në tokë, do të jetë e ndaluar edhe në qiell dhe çdo gjë që lejohet në tokë, do të jetë e lejuar edhe në qiell.”

Kur’ani gjithashtu i qorton edhe idhujtarët, të cilët lejonin apo ndalonin pa leje nga Zoti:

“Thuaj: “Më thuani atë që All-llahu ua dha si ushqim (të lejuar), e ju nga ai diçka bëtë të ndaluar e diçka të lejuar?” Thuaj: “A ju lejoi All-llahu ju, ose ju i shpifni All-llahut?” (Jûnus, 59)

“Mos i thuani asaj rrenës së gjuhëve tuaja: “Kjo është hallall e kjo është haram”, e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim”. (Nahl, 116)

Nga këto ajete e hadithe të qarta, juristët e Islamit e dinin kategorikisht se vetëm All-llahu ka të drejtë lejimi apo ndalimi nëpërmjet

¹ Transmetim i Tirmidhiut dhe i të tjerëve.

Kur'anit apo Pejgamberit të Tij, dhe vetëm ata janë të autorizuar ta sqarojnë vendimin e Zotit për të ndaluar dhe lejuar.

“E Ai ju sqaroi juve se çka është e ndaluar për ju!” (El-En'âm, 119)

Nuk është detyrë e tyre të sjellin ligje fetare për njerëzit në atë që u lejohet apo nuk u lejohet.

Edhe pse ishin të njohur si prijës e muxhtehidë, ata largoheshin nga fetvatë dhe mbështeteshin në njëri-tjetrin, nga frika që të mos gabojnë në lejimin e haramit apo në ndalimin e hallallit.

Imam Shafi'u transmeton në librin e tij “El-Umm” se gjykatësi Ebu Jûsuf, shok i Ebu Hanifes,¹ ka thënë:

أَدْرَكْتُ مَشَايخَنَا مِنْ أَهْلِ الْعِلْمِ يَكْرَهُونَ الْفِتْيَا، أَنْ يَقُولُوا:
هَذَا حَلَالٌ وَهَذَا حَرَامٌ إِلَّا مَا كَانَ فِي كِتَابِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ بَيْنًا
بِلَا تَفْسِيرٍ... حَدَّثَنَا ابْنُ السَّائِبِ عَنِ الرَّبِيعِ بْنِ خَيْثَمٍ -
وَكَانَ مِنْ أَفْضَلِ التَّابِعِينَ - إِيَّاكُمْ أَنْ يَقُولَ الرَّجُلُ: إِنَّ اللَّهَ
أَحَلَّ هَذَا أَوْ رَضِيَهُ، فَيَقُولَ اللَّهُ لَهُ: لَمْ أَحِلَّ هَذَا وَكَمْ أَرْضَهُ!
أَوْ يَقُولَ: إِنَّ اللَّهَ حَرَّمَ هَذَا، فَيَقُولَ اللَّهُ: كَذَبْتَ، لَمْ أُحَرِّمْهُ
وَكَمْ أَنَّهُ عَنْهُ.

“Njoh dijetarë tanë të mirëfilltë që me vështirësi japin fetva, gjegjësisht urrejnë të thonë se “kjo është e lejuar e kjo e ndaluar”, përveç asaj që është e qartë në Kur'anin e Zotit dhe që s'ka nevojë për koment.”

Ibn Saibi transmeton nga Rebi'ë Ibn Hajthemi (ka qenë njëri ndër tabiinët më të lëvdëruar) dhe thotë:

“Ruajuni që ndokush prej jush të thotë: “Zoti e ka lejuar këtë apo e ka pëlqyer, e pastaj Zoti ta pyesë se pse e lejove atë që s'e kam pëlqyer?; ose të thotë: “Zoti e ka ndaluar këtë, e Zoti t'i thotë: “Pse gënjen! Une s'e kam bërë haram dhe s'e kam ndaluar!”

وَحَدَّثَنَا بَعْضُ أَصْحَابِنَا عَنْ إِبْرَاهِيمَ النَّخَعِيِّ - مِنْ كِبَارِ
فُقَهَاءِ التَّابِعِينَ بِالْكُوفَةِ - أَنَّهُ حَدَّثَ عَنْ أَصْحَابِهِ أَنَّهُمْ كَانُوا
إِذَا افْتَتَوْا بِشَيْءٍ أَوْ نَهَوْا عَنْهُ قَالُوا: هَذَا مَكْرُوهٌ، وَهَذَا لَا بَأْسَ
بِهِ، فَأَمَّا أَنْ نَقُولَ: هَذَا حَلَالٌ وَهَذَا حَرَامٌ فَمَا أَعْظَمَ هَذَا!

Disa shokë tanë transmetojnë se Ibrâhim Nah'i, jurist i njohur i tabi'inëve në Kufe, kur ka folur për shokët e vet, ka thënë:

¹ El-Umm, 7/317

“Kur jepnin ndonjë fetva, thonin: “Kjo është e urrejtur” apo për këtë tjetrën “s’ka gjë”. Por, sa vështirë është të themi “Kjo është e lejuar dhe kjo e ndaluar”!!!

Ky ishte transmetimi i Ebu Jûsufit, nga selefis-salihi, këtë e transmetoi edhe Shafi’u! Gjithashtu edhe Ibn Muflihi transmeton se Shejhul-Islami Ibn Tejmije ka thënë:

أَنَّ السَّلَفَ لَمْ يُطْلِقُوا الْحَرَامَ إِلَّا عَلَى مَا عَلِمَ
تَحْرِيمُهُ قَطْعًا.

“Selefi ka ndaluar vetëm atë që dihej kategorikisht se është e ndaluar.”¹

Edhe Imam Ahmed ibn Hanbeli kur pyetej për diçka, thoshte: “E urrej, nuk më pëlqen, nuk e dua ose nuk e preferoj.”

Reagime të njëjta transmetohen edhe nga Maliku, Ebu Hanifeja dhe imamët tjerë (r.a.).²

Ndalimi i hallallit dhe lejimi i haramit konsiderohet shirk (idhujtari)

Islami i qorton të gjithë ata që lejojnë apo ndalojnë, posaçërisht ndaluesit ngase ky drejtim paraqet stagnim të njerëzimit dhe ngushtim të horizontit të cilin Zoti ua ka dhënë njerëzve dhe për shkak se disa fetarë ekstremistë e kishin pranuar këtë drejtim. Pejgamberi a.s. me të gjitha fuqitë e luftonte këtë pseudodevotshmëri dhe ekstremizëm, si dhe informonte për shkatërrimin e tyre duke thënë:

أَلَا هَلَكَ الْمُتَنَطِّعُونَ، أَلَا هَلَكَ الْمُتَنَطِّعُونَ، أَلَا هَلَكَ
الْمُتَنَطِّعُونَ.

“Ekstremistët janë shkatërruar, ekstremistët janë shkatërruar, ekstremistët janë shkatërruar.”³

Për mesazhin e vet, Ai thoshte:

¹ Transmetohet se sahabët nuk u larguan krejtësisht nga alkooli pas shpalljes së ajetit kur’anor në suren Bekare: “Të pyesin për verën...” ngase ndalimi nuk ka qenë kategorik deri në shpalljen e ajetit të sures Mâide.

² Le t’i marrin shembull imituesit të cilët nxitojnë të thonë “haram” pa patur kurrfarë argumenti ose diç që i ngjanë argumentit.

³ Transmetim i Muslimit, Ahmedit, Ebu Davudit.

بُعِثْتُ بِالْحَنِفِيَّةِ السَّمْحَةِ.

“Jam dërguar me fenë e pastër e tolerante!”¹ Kjo fe është e pastër në besim e monoteizëm dhe tolerante në vepër e legjislacion ndërsa kundërshton idhujtarinë dhe ndalimin e hallallit. Këto dy gjëra i potencon Muhammedi a.s. duke interpretuar nga Zoti i Madhëruar, i cili ka thënë:

إِنِّي خَلَقْتُ عِبَادِي حُنَفَاءَ وَإِنَّهُمْ أَتَتْهُمْ الشَّيَاطِينُ،
فَاجْتَالَتْهُمْ عَنْ دِينِهِمْ، وَحَرَّمْتُ عَلَيْهِمْ مَا أَحَلَلْتُ
لَهُمْ، وَأَمَرْتُهُمْ أَنْ يُشْرِكُوا بِي مَا لَمْ أَنْزِلْ بِهِ سُلْطَانًا.

“I krijova robërit e mi të pastër. Ju afruan djajtë dhe i larguan nga feja e tyre, dhe ua ndaluan atë që ua lejova si dhe i urdhëruan të Më bëjnë shok atë që nuk ju zbrita për të kurrfarë argumenti.”²

Pra, ndalimi i hallallit konsiderohet shirk dhe për këtë shkak Kur’ani i ka qortuar ashpër idhujtarët arabë për idhujtarinë, putizmin dhe ndalimin e tyre nga të mirat e ndryshme, si nga kafshët ashtu edhe nga bimët, pa lejen e Zotit. Në mesin e kafshëve të ndaluara ishin *behîra*, *sâibe*, *vesîle*, *el-hâm* etj. Në kohën paraislame, nëse deveja kishte pesë lindje dhe lindja e fundit ishte e gjinisë mashkullore, ia prenin veshët, e ndalonin hipjen mbi të, ua linin zotërave të tyre, nuk therej dhe nuk e përdornin për bartje, nuk e përzinin nga uji ose nga kullosa dhe e quanin *behîra* (veshprera). *Sâibe* quhej deveja, të cilën njeriu e lëshonte si *behîra*, kur kthehej shëndoshë prej rruge ose kur shërohej prej ndonjë sëmundjeje. Nëse deveja pjellte femër e pranonin, e nëse pjellte mashkull ua jepnin zotërave të tyre, e nëse i pjellte që të dy thonin: “Lindi vëllai i saj” dhe nuk e prenin mashkullin por ia dhuronin zotërave, dhe këtë ata e quanin *vesîle*. Nëse gjenerata e dytë e deveve mashkull ishte e aftë të mbajë kalorës, thonin: “E mbrojti shpinën e vet”, dhe kështu as nuk hipnin mbi të e as nuk e përdornin për bartje dhe e quanin *el-hâmi*.

Rreth këtyre katër llojeve ekzistojnë gjithashtu edhe komentime tjera.

Kur’ani ua ka mohuar këtë ndalim dhe nuk e ka arsyetuar imitimin e të parëve të tyre në këtë çështje të humbur.

“All-llahu nuk i emëroi (për të shenjta) behîrën, as sâibn, as vesîlen e as hâmen, por ata që nuk besuan trillojnë

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Ahmedit.

rrenë për All-llahun, (duke thënë se All-llahu përcaktoi) dhe shumica e tyre nuk kuptojnë se janë duke shpifur. E kur u thuhet atyre: “Ejani te ajo që e zbriti All-llahu dhe te (çka thotë) i dërguari, ata thonë: “Na mjafton ajo që i gjetëm prindërit tanë”, (a mjafton) edhe nëse prindërit e tyre ishin që nuk dinin asgjë dhe nuk ishin në rrugë të drejtë.” (Mâide, 103-104)

Në suren “*El-En'âm*” shqyrtohet detajisht supozimi i politeistëve rreth ndalimit të disa kafshëve, si p.sh. i deveve, i lopëve, i dhenve dhe i dhive, edhe atë në formë ironike e sarkastike por bindëse:

“Ai krijoi tetë lloje (nga kafshët shtëpiake): prej deleve dy (dash e dele), prej dhive dy (cjap e dhi). Thuaj: “A janë të ndaluar (haram) dy meshkujt apo dy femrat apo çka mbanë (pjell) mitra e dy (llojeve të tyre) femrave?” Më tregoni, pra, me fakte të ditura (e jo me trillime) nëse jeni të sigurtë. Ai (krijoi) edhe nga devet dy (lloje) dhe nga lopët dy (lloje). Thuaj: “A thua dy meshkuj i ka ndaluar (haram), apo dy femrat, ose çka mbanë mitra e dy (llojeve të tyre) femrave?” A mos ishit të pranishëm kur All-llahu ju porositi me këtë (hallall apo haram)?” E kush është më mizor se ai që trillon rrenë për All-llahun dhe ashtu humbë njerëzit në mungesë të dijes. All-llahu nuk i nxjerr në rrugë të drejtë mizorët.” (El-En'âm, 143-144)

Në suren “*A'râf*” gjithashtu Zoti i qorton ndaluesit dhe njëherit i qartëson parimet e ndalesave të përhershme:

“Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet?” Thuaj: “Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqarojmë argumentet një populli që kupton”. Thuaj: “Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, qofshin të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i bashkangjitni All-llahut shok pa patur për këtë kurrfarë argumenti, dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë.” (El-A'râf, 32-33)

Këto diskutime të sureve mekkase, të cilat gjithmonë kanë për qëllim ta konfirmojnë besimin, monoteizmin dhe besimin në botën tjetër, bëjnë të kuptojmë se sipas Kur'anit, këto çështje nuk janë të dorës së dytë dhe të pjesërishtme por janë parësore dhe universale. Meqë në Medinë në mesin e muslimanëve u paraqit një grup ekstremistësh të cilët ua ndalonin vetes të mirat, Zoti i Madhëruar i shpalli ajetet e qarta që na tregojnë përkufizimet e Tij me qëllim që t'i kthejë në rrugën e vërtetë të Islamit.

“O ju që besuat! Mos i ndaloni (mos i bëni haram) të mirat që për ju i lejoi All-llahu (i bëri hallall) dhe mos e teproni, se All-llahu nuk i do ata që teprojnë (i kalojnë kufijtë e dispozitave të Zotit). Hani nga ajo që All-llahu ju furnizoi si hallall të mirë dhe duke qenë se ju All-llahut i besoni, ruanu dënimit të Tij.” (Mâide, 87-88)

Ndalimi - burim i së keqes dhe dëmit

Meqë Zoti i Madhëruar është krijues i njerëzve dhe dhurues i begative të panumërta, atëherë është e drejtë e Tij që t’i lejojë apo ndalojë si dhe t’i obligojë ashtu siç dëshiron Ai. Ata nuk kanë të drejtë të refuzojnë ose kundërshtojnë ngase kjo është e drejtë e Tij hyjnore dhe qëllim i adhurimit të Tij. Nga mëshira e Vet, Zoti i Madhëruar ka caktuar hallalle e haramë ndaj robërve të vet për shkaqe të logjikshme, me qëllim që ta mbrojnë interesin e njerëzve. Zoti i Madhëruar ka lejuar vetëm të mirën dhe ka ndaluar vetëm të keqen. Është e vërtetë se Zoti ua ka ndaluar hebrenjve disa lloje të mirave por me qëllim që t’i dënojë për mëkatën e tyre për mosrespektimin e ndalimeve të Zotit. Në këtë kontekst Zoti thotë:

“E (posaçërisht) ndaj atyre që janë jehudi, Ne ua kemi ndaluar çdo (kafshë) thundrake; nga lopët dhe delet ua kemi ndaluar dhjamine të tyre, pos atij (dhjamine) në shpinën dhe zorrët e tyre dhe pos atij të përzier me ndonjë asht. Këtë (ndalesë) e morëm si ndëshkim për shkak të mëkatit të tyre. S’ka dyshim Ne jemi të vërtetë (në çka ju rrëfejmë). (El-En’âm, 146)

Në një sure tjetër Zoti i thekson format e këtij mosrespektimi dhe thotë:

“Dhe për shkak të mizorisë së tyre, që ishin jehudi dhe për shkak se penguan shumë nga rruga e All-llahut, ne ua ndaluam (ua bëmë haram) disa (lloje ushqimesh) të mira që u ishin të lejuara. Edhe për shkak të marrjes së kamatës, edhe pse e kishin të ndaluar atë, dhe ngrënies së pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë. Ne kemi përgatitur dënim të mundimshëm për ata që nuk besuan prej tyre”. (Nisâ, 160-161)

Kur e dërgoi Zoti peygamberin e fundit me fenë e përgjithshme e të përjetshme, atëherë nga mëshira e Tij ngriti barrën e ndalimit që ishte masë e përkohshme edukative për popullin kundërshtar, edhe pas zhvillimit dhe ardhjes së të vërtetës (ashtu siç i përshkruan Tivrati). Sipas ithtarëve të librit, titullin e kishte “Mesazhi Muhammedan”. Këtë çështje e gjejmë në Kur’an në këtë formë:

“Që pranojnë Të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, ua lejon ushqimet e këndshme dhe ua ndalon ato të pakëndshme dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta”. (El-A'râf, 157)

Zoti ka caktuar forma të tjera në Islam për mbulimin e gabimit përveç ndalimit të të mirave, si p.sh. në Islam ekziston pendimi (Et-Tevbe) i sinqertë i cili e zhduk mëkatin ashtu siç e zhduk uji ndytësirën. Aty ka gjithashtu të mira që i fshijnë të këqijat, kështu është edhe sadakaja, e cila e zhduk mëkatin sikur që e shuan uji zjarrin. Gjithashtu ekzistojnë sprova dhe vështirësi të cilat i fshijnë mëkatet ashtu siç bien gjethet e drurit në dimër.

Nga ky aspekt, në Islam u bë e njohur se harami është burim i së keqes dhe dëmit. Ajo që është e dëmshme, është e ndaluar, e ajo që është e dobishme, është e lejuar. Në qoftë se dëmi është më i madh se dobia, atëherë ajo punë konsiderohet e ndaluar. Në këtë kontekst kur Kur'ani flet për verën dhe bixhozin, thotë:

“Të pyesin për verën dhe bixhozin. Thuaj: “Që të dyja janë mëkat i madh, e ka edhe dobi në to (të pakta) për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre”. (El-Bekare, 219)

Një prej përgjigjeve korrekte rreth hallallit në Islam, është se “janë të mira” ato gjëra që i pranojnë shpirtat e drejtë dhe i vlerësojnë njerëzit si të mira, gjegjësisht të cilët nuk janë nën ndikimin e zakoneve. Zoti i Madhëruar thotë:”

“Të pyesin ty se ç'u është lejuar, e u thuaj: “Ju janë lejuar të mirat!” (Mâide, 4)

Në një vend tjetër, Zoti i Madhëruar thotë:

“Sot ju janë lejuar të mirat.” (Mâide, 5)

Nuk është e domosdoshme që muslimani të ketë njohuri të hollësishme rreth të këqijave dhe dëmeve që janë shkak për ndalimin e gjërave, ngase ndokush di më pak e ndokush më shumë, apo ndoshta e keqja nuk zbulohet në kohën kur jeton (muslimani) por më vonë. Pra, besimtari në këtë rast duhet gjithmonë të thotë:

“Dëgjuam dhe iu nënshtruam!”

A nuk e sheh se Zoti e ka ndaluar mishin e derrit pa e kuptuar muslimani shkakun e ndalimit, përpos asaj se është i fëlliqtë. Me kalimin e kohës, shkenca ka zbuluar parazite e bakterie vdekjepruese që

gjenden në te, dhe sikur të mos i zbulonte shkenca dëmet e mishit të derrit, muslimani do të vazhdonte me bindjen e tij se ai është i fëlliqtë.

Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

اتَّقُوا الْمَلَاعِنَ الثَّلَاثَ (أَيَّ الَّتِي تَجْلُبُ
عَلَى فَاعِلِهَا اللَّعْنَةُ مِنَ اللَّهِ وَالنَّاسِ):
الْبَرَّازُ فِي الْمَوَارِدِ، وَقَارِعَةُ الطَّرِيقِ، وَالظِّلُّ.

*“Ruajuni nga tre mallkime (të cilat përfshijnë mallkimin e Perëndisë dhe të njerëzve): kryerjen e nevojës në ujëra rrjedhës, në rrugë dhe nën hije.”*¹ Gjatë shekujve të hershëm të gjithë mendonin se këto gjëra janë të papastra, se i refuzon arsyeja e shëndoshë dhe kultura e përgjithshme, mirëpo më vonë shkenca zbuloi se këto tri gjëra të mallkuara më së shumti e rrezikojnë shëndetin e përgjithshëm dhe konsiderohen faktorë kryesorë për përhapjen e sëmundjeve të rrezikshme si ankilostomia dhe bilharzia.

Sa më shumë që zgjerohen horizontet e zbulimeve shkencore, aq më shumë ndriçohen karakteristikat e hallallit dhe haramit në Islam dhe në legjislacionin e tij.

Si të mos ndodh kështu kur (Islami) është ligj i urtë, efikas dhe i mëshirshëm për ithtarët e tij!

“All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmi. E sikur të dëshironte All-llahu, do t’ju rëndojë. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti.” (El-Bekare, 220)

Zëvendësimi i haramit me hallall

Nga karakteristikat pozitive të Islamit, e që kishte për qëllim t’ua lehtësojë jetën njerëzve, është fakti se çdo haram e ka zëvendësuar me diçka më të mirë. Këtë e qartëson Ibn Kajjimi (Zoti e mëshiroftë)² si vijon:

حَرَّمَ عَلَيْهِمُ الْإِسْتِقْسَامَ بِالْأَزْلَامِ وَعَوَّضَهُمْ عَنْهُ
دُعَاءَ الْإِسْتِخَارَةِ وَحَرَّمَ عَلَيْهِمُ الرِّبَا،
وَعَوَّضَهُمُ التَّجَارَةَ الرَّابِحَةَ

¹ Transmetim i Ebu Davudit, Ibën Maxhes, Hakemit, Bejhekiut.

² Shiko Ravdatul-muhibbîn, f. 10 dhe A’lamul-mûki’in 2/111

- Ua ndaloi kërkimin e fatit nga shigjetat¹ dhe ua zëvendësoi me duanë e istihares.²
- Ua ndaloi kamatën por ua lejoi tregtinë fitimtare.
- Ua ndaloi bixhozin por ua zëvendësoi me gara të dobishme në fe, si p.sh. garat me kuaj, me deve e me shigjeta.
- Ua ndaloi mëndafshin por ua lejoi llojet e ndryshme luksoze nga leshi, pambuku dhe pëlhura e linjtë.
- Ua ndaloi kurvërinë dhe homoseksualizmin por ua lejoi martesën hallall.
- Ua ndaloi pijet dehëse por ua lejoi pijet e këndshme e të dobishme për trupin dhe shpirtin.
- Ua ndaloi ushqimet e këqija por ua lejoi ato të mirat.

Në qoftë se i përcjellim me vëmendje parimet e Islamit, do të vërejmë se Zoti sa herë që ua ka ngushtuar robve të Tij një pore të jetës, ua ka zgjeruar një tjetër, ngase Zoti nuk dëshiron që t'i ngarkojë robërit e vet me barrë të rëndë, lodhje e vështirësi, por dëshiron t'u ofrojë lehtësim, mirësi, udhëzim e mëshirë. Në këtë kontekst Zoti i Madhëruar thotë:

“All-llahu dëshiron t'ua sqarojë çështjet e t'ju drejtojë në rrugën e atyre që ishin para jush (pejgamberët) dhe t'ua pranojë pendimin. All-llahu e di më së miri gjendjen e robërve dhe është më i urti. All-llahu dëshiron t'ua pranojë pendimin, e ata që ndjekin dëshirat e epsheve, dëshirojnë që t'ju shmangin në tërësi (nga rruga e drejtë). All-llahu dëshiron t'ju lehtësojë (dispozitat), e megjithatë njeriu është i paafte (për t'u përballuar epsheve), (Nisâ, 26-28)

Ajo që të shpie në haram, konsiderohet haram

Në mesin e parimeve që i ka caktuar Islami është edhe ai se kur ndalon diçka, gjithashtu i ndalon edhe mjetet që shpiejnë në haram, për marrjen e masave preventive. Në qoftë se e ndalon kurvërinë, i ndalon edhe të gjitha format që shpiejnë në të ose që e ndjellin atë,

¹ Komentimi vijon më pas.

² Në qoftë se muslimani dëshiron të veprojë diçka, Islami e urdhëron të konsultohet dhe të bëjë istihare. Në këtë kontekst thuhet: “Nuk humb ai që bën istihare dhe nuk pendohet ai që konsultohet. Istihareja nënkupton lutjen Zotit për të zgjedhur njërin prej dy çështjeve përmes duasë dhe namazit.

si p.sh. zbulimin paraislam, lakuriqësinë, përzierjen e grave me burra, pornografinë, nudizmin, këngët e pahijshme etj.

Duke u nisur nga ky aspekt, juristët muslimanë kanë caktuar parimin:

مَا أَدَّى إِلَى الْحَرَامِ فَهُوَ حَرَامٌ

“Ajo që të shpie në haram, konsiderohet haram.”

Në këtë kontekst, sipas Islamit, mëkati i haramit nuk kufizohet vetëm tek vepruesi i drejtpërdrejtë, por ai shtrihet edhe më gjerë, dhe kështu përfshin secilin që ndihmon materialisht apo moralisht. Çdokush ndëshkohet aq sa kontribuon në haram; si shembull konkret, Pejgamberi a.s. e mallkoi atë që pi verë, që e prodhon, që e bartë, atë për të cilin bartet, shfrytëzuesin e të hollave të fituara prej saj... (më gjerësisht do të flasim më vonë)!

Paraqitja e haramit si hallall është e ndaluar

Ashtu siç i ndalon Islami format e dukshme që shpiejnë në haram, po kështu ndalon edhe paraqitjen e haramit si hallall nëpërmjet formave të padukshme dhe intrigave djallëzore. Ai i qortoi hebrenjtë të cilët nëpërmjet intrigave lejuan atë që e ndalonte Zoti. Pejgamberi a.s. thotë:

لَا تَرْتَكِبُوا مَا ارْتَكَبَ الْيَهُودُ وَتَسْتَحِلُّوا
مَحَارِمَ اللَّهِ بِأَدْنَى الْحِيلِ.

“Mos veproni ashtu siç vepruan hebrenjtë e t’i lejoni haramet që i ka caktuar Zoti, duke u mbështetur në intrigat më të poshtra!”¹

Zoti ua ka ndaluar hebrenjve gjahun në ditën e shtunë, dhe kështu, për t’iu shmangur këtij harami, kanë gropuar hendeqe në ditën e premte me qëllim që të bien peshqit në ditën e shtunë, e t’i marrin në ditën e dielë. Këtë gjë e lejojnë intrigantët kurse fukahatë (juristët) islamë e ndalojnë, ngase duhet të ndalet çdo aktivitet gjahu parapërgatitës ose i drejtpërdrejtë.

Intrigë mëkati konsiderohet edhe emërtimi i haramit me emër tjetër: kjo do të thotë ndërrimi i formës por jo edhe i esencës. S’ka dyshin

¹ Shiko Ibën Kajjimin në *Igâthetul-lehefân*, 1/348, dhe thotë se këtë e ka transmetuar Ebu Abdull-llah ibën Betta me sened të mirë. Këtë e ka bërë autentik Tirmidhiu.

se me ndryshime të tilla nuk ndryshohet esenca. Edhe pse njerëzit përdorin forma të ndryshme për ta lejuar kamatën e keqe ose trillojnë emra të rinj për verën me qëllim që ta lejojnë, mëkati përsëri mbetet vazhdimisht në kamatën dhe në verën.

Në hadithin e Pejgamberit thuhet:

لَيَسْتَحِلُّنَّ طَائِفَةً مِنْ أُمَّتِي الْخَمْرَ يُسَمُّونَهَا
بِغَيْرِ اسْمِهَا.

“Një grup i ummetit tim do ta lejojë verën duke e quajtur me emër tjetër.”¹

يَأْتِي عَلَى النَّاسِ زَمَانٌ يَسْتَحِلُّونَ الرِّبَا بِاسْمِ الْبَيْعِ.

“Do të vijë koha kur njerëzit do ta lejojnë kamatën në emër të tregtisë.”²

Është çudi e kohës sonë që vallëzimi lakuriq konsiderohet “art”, pijet alkoolike “pije shpirtërore” ndërsa “kamata” faide etj.

Qëllimi i mirë nuk e arsyeton haramin

Islami i vlerëson faktorët fisnikë, qëllimin e pastër dhe të mirë në të gjitha udhëzimet dhe legjislacionet. Pejgamberi a.s. thotë:

“Veprat janë sipas qëllimeve dhe çdo njeri do të shpërblehet sipas qëllimit të vet.”³

Nëpërmjet qëllimit të mirë, lejohen të lejuarat (*mubahatet*) dhe zakonet të cilat të afrojnë te Zoti. Ai që ushqehet me qëllim që ta mbajë jetën dhe ta forcojë trupin për ta kryer obligimin e vet ndaj Zotit e ummetit të tij, ushqimi i tij konsiderohet adhurim dhe devotshmëri.

Veprimi i atij që fle me bashkëshorten e vet me qëllim të lindjes së fëmijës, ose me qëllim të mbrojtjes së vetes e të familjes, konsiderohet ibadet dhe meriton shpërblim. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Ahmedit.

² E ka theksuar në *Igâthetul-lehefân*, 1/352.

³ Transmetim i Buhariut.

“Kur e plotësoni epshin me gruan tuaj, keni shpërblim”. Në atë rast i thanë: “A shpërblehet ndokush prej nesh kur plotëson epshin e vet, o Pejgamber i Zotit?!” Ai u tha: “A nuk konsiderohet haram nëse e plotësoni epshin me haram? Pra, edhe ai që e plotëson epshin me hallall do të shpërblehet”.¹

“Ai që punon për këtë botë në mënyrë të lejuar duke iu ruajtur zgjatjes së dorës (lypjes), për hir të familjes dhe për t’u kujdesur ndaj fqiu të vet, do ta takojë Zotin me fytyrën që i ngjanë hënës së plotë.”²

Kështu, në çdo vepër të lejuar të besimtarit bën pjesë qëllimi i cili e shndërron veprimin e mirë në ibadet, kurse harami është haram pa marrë parasysh qëllimin e pastër dhe nijetin e mirë dhe fisnik. Islami asnjëherë nuk pranon që harami të shfrytëzohet si mjet për ndonjë qëllim të lavdëruar ngase Islami përkujdeset për nderin e qëllimin dhe pastërtinë e nijetit. Sheriati islam asnjëherë nuk e pranon parimin “qëllimi i arsyeton metodat” ose “përmes thellimit në shumë të këqija të arrihet e vërteta”, por pranon vetëm arritjen e të vërtetës nëpërmjet rrugës së vërtetë. Nëse ndokush grumbullon pasuri nga kamata, harami, bixhozi ose nga ndonjë punë tjetër e ndaluar, me qëllim që të ndërtojë një xhami ose të realizojë ndonjë projekt bamirës, nuk do të pranohet qëllimi i tij i pastër që do ta anulojë barrën e haramit, ngase në Islam harami nuk arsyetohet me qëllime e nijete. Kështu na mësoi Pejgamberi a.s. kur tha:

¹ Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit

² Teksti i hadithit të transmetuar nga Taberani.

“Zoti është i mirë dhe pranon vetëm të mirën. Zoti i ka urdhëruar besimtarët ashtu siç i ka urdhëruar peygamberët e Tij”, dhe shtoi:

“O ju të dërguar, hani prej të mirave dhe bëni vepra të mira ngase Unë di çdo gjë që veproni.” (El-Mu'minûn, 51)

“O ju që keni besuar, hani nga të mirat që ju furnizua.” (El-Bekare, 172)

Pastaj ka theksuar njeriun që e zgjat udhëtimin e është pluhurosuar (për ta kryer haxhë apo umren), dhe i ngre duart nga qielli duke thënë: *“Zoti im, Zoti im, ndërsa ushqimin e ka prej harami, pierjen prej harami, veshjen prej harami dhe është rritur me haram. Pra, si t'i përgjigjet (lutjes) së tij?!”*¹

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

*“Kush tubon pasuri me haram dhe jep sadakë, nuk do të shpërblehet por do të jetë i ngarkuar.”*²

Në këtë kontekst përsëri thotë:

¹ Transmetim i Muslimit dhe Tirmidhiut nga Ebu Hurejre.

² Transmetim i Ibën Huzejmes, Ibën Habbanit dhe Hakemit nga Ebu Hurejre.

“Nuk pranohet sadakaja e robit që e ka fituar nga harami, e as nuk bekohet ai kontribut dhe ai është ushqimi i tij në zjarr. Zoti i Madhëruar nuk e fshinë të keqen me të keqe por e fshinë të keqen me të mirë. Papastërtia nuk fshinë të papastrën.”¹

Ruajtja nga hamendjet duke iu frikësuar rënies në haram

Nga mëshira e Zotit të Madhëruar që ka ndaj njerëzve, është moslënia në huti rreth sqarimit të nocioneve hallall e haram por ato ua ka shpjeguar. Këtë e vërejmë në ajetin:

“Ua ka detajizuar atë që ua ka ndaluar.” (El-En'âm, 119)

Hallalli është i qartë ashtu siç është edhe harami kështu që nuk ekziston mundësia e alternativës.

Ndërmjet hallallit dhe haramit ekziston një zonë që quhet “Zona e dyshimeve” dhe në të mbretëron një kaos për disa njerëz, për shkak të argumenteve të dyshimta ose aplikimit të tekstit në rastin konkret.

Sipas Islamit, devotshmëri konsiderohet largimi i muslimanit nga gjërat e dyshimta me qëllim që të merren masa parandaluese për të mos rënë në haram të vërtetë. Kjo është një metodë preventive për të cilën folëm më parë. Përveç kësaj, kjo mënyrë është një lloj i edukatës afatgjate dhe efikase për realitetin e jetës dhe njeriut. Si parim i kësaj metode konsiderohet hadithi i Pejgamberit a.s.:

¹ Transmetim i Ahmedit dhe i të tjerëve nga Ibën Mes'udi

“Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë ndërsa midis tyre ekzistojnë gjëra të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i njohin se a janë hallall apo haram. Ai që largohet prej tyre, e pastron fenë e dinjitetin dhe shpëton, e kush nuk largohet, mund të fundoset në haram. Kjo i ngjanë depërtimit të ndonjë kafshe në “hima” (vend i caktuar nga sulltani për t’u mbrojtur vetëm kafshët e tij.) Çdo mbret ka “himanë” e vet ndërsa “himaja” e Zotit përmbledh ato që i ka ndaluar.”¹

Harami është haram për të gjithë

Sipas Sheriatit islam, harami i përfshin të gjithë. Nuk ekziston diçka që është haram për të huajin e hallall për arabin, ashtu siç nuk ka diçka të ndaluar për zezakun e të lejuar për të bardhin. Gjithashtu nuk ekziston ndonjë leje speciale për ndonjë elitë apo shtresë të posaçme, qofshin murgjër, monakë, mbretër apo kalorës. Bile, nuk ka diçka specifike që i lejohet muslimanit e i ndalohet jomuslimanit. Nuk ekziston ndonjë gjë e tillë ngase All-llahu është Zot i të gjithëve dhe Sheriati mbizotëron mbi të gjithë. Atë që e lejon Zoti me Sheriat u lejohet të gjithë njerëzve, e atë që e ndalon, u ndalohet të gjithëve deri në Ditën e kijametit. Vjedhja si shembull konkret, konsiderohet haram si për muslimanin ashtu edhe për jomuslimanin, qoftë i vjedhuri musliman apo jomusliman. Ndëshkimi është i

¹ Buhariu dhe Muslimi e transmetojnë nga Nu'man Ibën Beshiri, ndërsa teksti është i Tirmidhiut.

obligueshëm për vjedhësin pa marrë parasysh se cilës shtrese apo cilit post i takon. Kështu ka vepruar Pejgamberi a.s. që mund ta vërtetojmë me deklaratën e tij:

*“Pasha Zotin, sikur të kishte vjedhur Fatimeja, e bija e Muhammedit, do t’ia preja dorën!”*¹ Në kohën e Pejgamberit u bë një vjedhje për të cilën filloi dyshimi në një hebre dhe në një musliman. Disa të afërm të muslimanit ngritën pluhur kundër hebreut me disa fakte, me qëllim që ta arsyetojnë muslimanin (i cili në realitet ishte vjedhësi); dhe kështu Pejgamberi filloi të mendojë se ai (muslimani) është i pastër. Në atë rast i zbriti Shpallja hyjnore, e cila e zbuloi tradhtinë, e pastroi hebreun, e qortoi Pejgamberin dhe e vuri të drejtën në binarët e veta. Në këtë kontekst, Kur’ani thotë:

“Ne ta zbritëm ty (Muhammed) librin (Kur’anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mëson All-llahu. Mos u tradhto për tradhtarët (mos u dil në ndihmë). Kërkoj falje (për këtë) All-llahut. Vërtet, All-llahu falë, mëshiron. Mos polemizo për ata që tradhtojnë vetveten. All-llahu nuk e do atë që është gënjeshtar e mëkatar. Ata fshihen (turpërohen) prej njerëzve, e nuk turpërohen prej All-llahut, e Ai është me ta edhe kur fshehtas planifikojnë thënie me të cilat nuk është i kënaqur Ai. All-llahu nuk mund t’i shpëtojnë veprimet e tyre. Ja, ju jeni ata që i mbrojtët (gënjeshtarët) në jetën e kësaj bote, kush do të polemizojë me All-llahun për ta Ditën e gjykimit, apo kush do t’i marrë në mbrojtje?” (Nisâ, 105-109)

Hebraizmi i devijuar supozonte se kamata nuk lejohet midis hebrejve ndërsa midis hebreut dhe johebreut po. Në Deutoronominë 23/19-20 thuhet: “Mos i jep vëllait tënd argjend, ushqim ose diçka tjetër me kamatë. Të huajt jepi me kamatë por vëllait tënd mos i jep...”

Kur’ani na rrëfen rrymën e tillë që lejon tradhtinë me të tjerët pa ndier kurrfarë mëkati e keqardhje. Në këtë kontekst thuhet:

“Ndër ithtarët e Librit ka asish, që po ia besove një sasi të madhe (ari) ai ta kthen ty atë por ka të tillë që po ia besove një dinar, ai nuk ta kthen ty atë, përveç nëse gjithmonë i rri gati (ia kërkon vazhdimisht). Këtë (e bëjnë) për arsye se thonin: “Ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie ndaj (pasurisë që ua marrim) të të

¹ Transmetim i Buhariut.

paditurve (arabëve analfabetë). Pra, duke e ditur të vërtetën, ata bëjnë gënjeshtëri ndaj All-llahut.” (Âli Imrân, 75)

Po, këta trillojnë gënjeshtër ndaj All-llahut ngase Sheriati i Tij nuk bën diskriminimin e popujve dhe e ndalon tradhtinë nëpërmjet pejgamberëve dhe enbijëve të Tij.

Na vjen keq të themi se kjo rrymë izraelite është rrymë primitive dhe nuk i takon t’i përkasë fesë qiellore. Moral ideal ose moral i vërtetë është ai që karakterizohet me universalitet e komprehensivitet dhe që nuk lejon diçka që e ndalon për të tjerët.

Dallimi midis nesh dhe të prapambeturve qëndron në gjerësinë e tryezës etike e jo në ekzistimin apo në mosekzistimin e saj. Si shembull të përmendim se amaneti për ta ishte kategori e lavdëruar por njëherit ishte edhe e posaçme për anëtarët e fisit, e në qoftë se dillej jashtë fisit, atëherë lejohej tradhtia, bile preferohej dhe obligohej.

Autori i librit *“Rrëfimi i qytetërimit”* thotë:

“Përafërsisht të gjitha shoqëritë njerëzore kanë një bindje se shoqëritë tjera janë më të degraduara; Indianët amerikanë e konsiderojnë veten si popull i zgjedhur i Zotit ngase i ka krijuar “Shpirti i Madh” si shëmbëlltysë për njerëzimin. Një fis prej fiseve indiane e quan veten “Njerëz që s’krahasonen me njerëzit tjerë”, ndërsa një fis tjetër se janë “Njerëzit e njerëzve”. Karibianët thonë “Vetëm ne jemi njerëz”...

Rezultat i gjithë kësaj ishte se njeriu primitiv asnjëherë nuk mendonte t’i nderojë fiset tjera ashtu siç e nderonte fisin e vet, dhe sinqerisht mendonte se roli i moralit është përforsimi i bashkësisë së vet kurse ndaj bashkësive tjera duhej të veprohet ndryshe. Urdhrat etike dhe ndalesat vlejnin vetëm për anëtarët e fisit të vet, kurse kundër të tjerëve lejohej çdo gjë, përveç atyre që ishin musafirë të tyre.¹

Nevoja lejon përjashtime

Islami e ngushton tryezën e të ndaluarave, por njëkohësisht e ashpërsion kategorinë e haramit si dhe mënyrat e pengimit, qofshin të dukshme apo të padukshme. Çdo gjë që shpie në haram konsiderohet haram; çdo gjë që ndihmon haramin, konsiderohet ha-

¹ Vëll. 1, f. 95.

ram dhe çdo gjë që e prezenton haramin si hallall, konsiderohet haram, e kështu me radhë.

Në anën tjetër, Islami nuk i mohon nevojat e jetës dhe dobësinë e njeriut para tyre, kështuqë e vlerëson nevojën e pashmangshme dhe dobësinë njerëzore. Kështu, ai i lejoi muslimanit, që në raste të diktimit të rrethanave, t'i zbatojë të ndaluarat që konsiderohen nevojë elementare dhe që e mbrojnë nga shkatërrimi. Për këtë shkak, pas ndalimit të të ushqyerit me cofëtina, gjak e mish të derrit, Zoti i Madhëruar thotë:

“E kush detyrohet (të hajë nga këto) duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos tepruar në këtë, nuk është mëkat. Vërtet All-llahu falë, është mëshirues.” (El-Bekare, 173)

Të njëjtën gjë e përsërit edhe në katër sure të Kur'anit kur flet për ushqimet e ndaluara. Në bazë të këtyre ajeteve dhe atyre të ngjashme si këto, fukahatë (juristët) e Islamit e formuluan parimin e rëndësishëm: “Nevoja lejon përjashtime”.

Është e qartë se ajetet e kushtëzojnë të obliguarin të hajë, pa pasur për qëllim shijen e as teprimin. Në bazë të këtij kushtëzimi, fukahatë e formuluan parimin: “Nevoja caktohet sipas masës së nevojës.”

Nëpërmjet lejimit të të ndaluarave në raste të nevojës, Islami e mbron shpirtin e vet universal dhe parimet e veta të përgjithshme, gjegjësisht shpirtin e lehtësimit që s'mund ta deformojë vështirësia. Islami gjithashtu e çliron popullin nga prangat dhe zinxhirët që ishin të imponuara nga popujt e mëparshëm.

E vërtetë është thënia e All-llahut të Madhëruar:

“Zoti ua dëshiron lehtësimin e jo vështirësimin”. (El-Bekare, 185)

“All-llahu nuk dëshiron (me obligim për abdest e larje) t'ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t'ju pastrojë (prej mëkateve), t'ju plotësojë të mirën e Tij ndaj jush e që t'i falënderoheni”. (Mâide, 6)

“All-llahu dëshiron t'ua lehtësojë (dispozitat) e megjithatë njeriu është i paaftë (për t'u përballuar epsheve.).” (Nisâ, 28)

KAPITULLI I DYTË

HALLALLI DHE HARAMI NË JETËN PERSONALE TË MUSLIMANIT

- Në ushqim e pije
- Në veshje e stolisje
- Në shtëpi
- Në fitim e zeje (në punë)

NË USHQIM E PIJE

Qysh në kohët e lashta, popujt kanë patur qëndrime të ndryshme ndaj ushqimeve dhe pijeve, ndaj asaj që u lejohet dhe që u ndalohet, veçanërisht ndaj ushqimeve nga kafshët.

Sa u përket ushqimeve e pijeve vegjetative, popujt nuk kanë patur shumë qëndrime të ndryshme ndaj tyre. Islami e ka ndaluar vetëm verën, qoftë e prodhuar nga rrushi, hurma, elbi ose nga ndonjë substancë tjetër. Ai gjithashtu ka ndaluar atë që dehtë dhe defunksionon trupin, ashtu siç do të cekim më vonë.

Pra, popujt dhe fetë e ndryshme kanë pasur qëndrime të llojllojshme më së shumti ndaj ushqimeve nga kafshët.

Therja e kafshëve dhe ngrënia e mishit të tyre sipas brahmanitëve

Disa shoqëri, e në mesin e tyre edhe brahmanitët e disa filozofë, ia kanë ndaluar vetes therjen e kafshëve dhe ngrënien e mishit të tyre, kështu që janë mbështetur në ushqimet bimore duke thënë: “Në therjen e kafshës manifestohet vrazhdësia e njeriut ndaj gjallesës së gjallë sikur ai, dhe për këtë, ai s’ka të drejtë t’ia ndalojë të drejtën e jetës”.

Nga meditari i thellë, ne kuptojmë se këto kafshë nuk u krijuan si qëllim më vete ngase nuk posedojnë intelekt e vullnet. Gjithashtu nga pozita e tyre natyrore kuptojmë se ato i nënshtrohen shërbimit të njeriut, dhe për këtë arsye nuk është për t’u habitur se njeriu e shfrytëzon mishin e kafshës së prerë ashtu siç e shfrytëzon me nënshttrim.

Nga ligji i Zotit për krijesat, gjithashtu kuptojmë se lloji më i ulët sakrifikohet për llojin më të lartë, p.sh. bima e gjelbër kositet për ta ushqyer kafshën kurse kafsha theret për ta ushqyer njeriun, bile edhe njeriu si individ, lufton e vritet për hir të shumicës... Nëse njeriu nuk i therë kafshët, nuk do t’i shpëtojë nga ngordhja e shkatë-

rrimi. Në qoftë se nuk mbyten në mes vete, ato do të ngordhin në mënyrë natyrore, e në këtë rast kjo gjë nuk është më e dhembshme se prerja me teh të mprehtë.

Kafshët e ndaluara tek hebrenjtë dhe të krishterët

Në fetë e shpallura, Zoti ua ka ndaluar hebrenjve shumë kafshë tokësore e detare. Kjo çështje më konkretisht zbërthehet në kaptinën e njëmbëdhjetë të Levitikusit nga Tevrati.

Kur'anî ka theksuar disa ndalime të Zotit ndaj hebrenjve dhe shkakun e ndalimit (ashtu siç u cek më parë), gjegjësisht Zoti ua ka ndaluar për shkak të mëkateve dhe tiranisë së tyre.

“E (posaçërisht) ndaj atyre që janë jehudi. Ne ua kemi ndaluar çdo (kafshë) thundrake: nga lopët dhe delet ua kemi ndaluar dhjamin e tyre, pos atij në shpinën dhe në zorrët e tyre dhe pos atij të përzier me ndonjë asht. Këtë (masëndalesë) e morëm si ndëshkim për shkak të mëkatit të tyre.” (El-En'âm, 146)

E tillë është gjendja e hebrenjve dhe do të ishte e udhës që edhe me të krishterët të ndodhte e njëjta gjë, ngase në Bibël thuhet se Mesihi (Isa a.s.) nuk ka ardhur për ta anuluar Ligjin e Musait por për ta plotësuar, mirëpo në realitet, këta e kundërshtuan dhe e lejuan atë që ndalohej në Tevrat (po qe se nuk e ka abroguar Inxhili), eventualisht ndoqën Palin, i cili ua lejoi të gjitha ushqimet e pijet, përpos asaj që është prerë për hir të idhujve dhe i është thënë të krishterit: “Kjo është prerë për idhuj.” Pali e arsyetonte qëndrimin e vet me pretekst se çdo gjë është e pastër për të pastërtit dhe se çdo gjë që hyn në gojë nuk e fëlliq gojën, por e fëlliq ajo që del prej saj (prej gojës).

Edhe pse deri sot Tevrati e ndalon mishin e derrit, ata (të krishterët) e lejojnë ngrënien e tij.

Tek arabët para shpalljes së Kur'anit

Arabët e periudhës paraislame ndaluan disa kafshë për shkak të papastërtisë, adhurimit, afrimit ndaj idhujve ose ndjekjes së iluzioneve, si p.sh. *behîrën*, *saîben*, *vesîlen* dhe *hâmin* (i sqaruam më parë) në një anë, kurse në anën tjetër lejuan shumë ushqime të pa-pastra, si p.sh. mishin e cofëtirave dhe gjakun e derdhur.

Islami e lejon ushqimin e mirë

Kur u shpall Islami, populli ishte në këtë gjendje me ushqimin nga mishi i kafshëve, eventualisht disa ishin teprues e disa as që e përdornin fare, dhe për këtë u bëri apel të gjithë njerëzve:

“O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaj.” (El-Bekare, 168)

Ai i thirri “*njerëzit*” që të ushqehen nga të mirat e sofrës së madhe që ua ka përgatitur (sofra është toka e gjerë me të gjitha begatitë), dhe të mos e ndjekin djallin dhe rrugën e tij, i cili ua zbukuroi vetëm disa njerëzve ndalesën nga ajo që ua lejoi Zoti. Pra, (djalli) i largoi nga të mirat dhe i humbi.

Gjithashtu Islami u bëri apel besimtarëve duke thënë:

“O ju që besuat, hani nga të mirat që ua kemi dhënë dhe falënderoni All-llahun, nëse jeni që vetëm Atë e adhuron. (All-llahu) Ua ndaloj juve cofëtirat, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret (ngrihet zëri me të) jo në emër të All-llahut. E kush shtrëngohet (të hajë nga këto), duke mos patur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtet All-llahu falë, është mëshirues.” (El-Bekare, 172-173)

Në këtë apel të posaçëm për besimtarët, Zoti i Madhëruar i urdhëron të hanë nga të mirat me të cilat i furnizoi dhe t'i falënderohen Zotit të Madhëruar. Në të gjithashtu vërehet se Zoti ua ka ndaluar vetëm këto katër lloje të caktuara në ajet. Edhe në ajetet tjera theksohen ndalimet që mund të rrumbullakohen në këto katër. Zoti i Madhëruar në suren “*En'âm*” thotë:

“Thuaj: “Në atë që më është shpallur mua (në Kur'an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai (ushqim) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish i derrit, ai është i ndytë, dhe në qoftë se është therur jo në emër të All-llahut (por të ndonjë idhulli) e që është mëkat. E kush detyrohet (t'i hajë këto të ndaluara), por duke mos patur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar; Zoti yt është që falë e mëshiron shumë.” (El-En'âm, 145)

Në suren “*Mâide*”, Kur'ani edhe më shumë i detajizon këto ndalime:

“Juve u janë ndaluar (t'i hani): ngordhësitat, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emër të All-llahut, e ngulfatura, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që

arrini ta thorni (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhuj dhe (u është ndaluar) të kërkonte me short fatin. Kjo është mëkat ndaj All-llahut.” (Mâide, 3)

Nuk ka kurrfarë kundërshtimi mes këtij ajeti që numëron dhjetë ndalime dhe ajeteve të para që numërojnë katër, por këtu ka detajizim të ajeteve tjera. E ngulfatura, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara dhe ajo që e ka ngrënë egërsira janë të mbytura.

Ajo që është therur për hir të ndonjë idhulli ka trajtim të njëjtë sikur ajo që është therë nëpërmjet kërimit të fatit.

Pra, në përgjithësi të ndaluarat janë katër kurse në detajizim, janë dhjetë.

Ndalimi i cofëtirës dhe urtësia e kësaj ndalese

1. Që në fillim ajetet ndalojnë cofëtirën që ka ngordhur vetvetiu, nga ndonjë kafshë ose shpezë, kryesisht cofëtirën që nuk e ka prerë njeriu qëllimisht ose nuk e ka gjuajtur.

Nëse mendja bashkëkohore pyet për urtësinë e ndalimit të cofëtirës për njeriun dhe hedhjen e mishit të saj pa e shfrytëzuar, atëherë përgjigjemi se ka arsye të urta dhe të qarta si:

A. Natyra e shëndoshë e urren dhe e konsideron të fëlliqtë ndërsa të mençurit në përgjithësi e konsiderojnë si nënçmim të dinjitetit të njeriut, dhe për këtë vërejmë se të gjitha fetë e shpallura e ndalojnë mishin e cofëtirës dhe e lejojnë vetëm atë të prerë, pa marrë parasysh mënyrat e prerjes.

B. Muslimani duhet të mbështetet në qëllimin dhe vullnetin e vet. Ai fiton dhe ndëshkohet vetëm pas caktimit të qëllimit dhe përpjekjes. Qëllimi i prerjes së kafshës është marrja e shpirtit të kafshës për ta ngrënë. Zoti i Madhëruar nuk pranon për njeriun që ta hajë atë që theret pa qëllim (ashtu siç është rasti me cofëtirën), kurse e prera dhe e gjuajtura bëhen vetëm me qëllim e nijet të destinuar.

C. Ajo që ka ngordhur vetvetiu, mund të ketë ngordhur nga shkak i kohës, nga faktori i papritur, nga njeriu e ndonjë bimë helmuese etj. Në këtë rast, ngrënia e mishit të saj mund të shkaktojë dëme. Status të njëjtë ka edhe ajo që ka ngordhur nga mosha ose nga uria.

Ç. Zoti ua ka ndaluar (njerëzve) cofëtirën nga mëshira e Tij ndaj kafshëve e shpezëve ngase edhe ato janë një botë sikurse ne, ashtu

siç theksohen edhe në Kur'an. E vërteta e kësaj vërehet te kafshët e ngordhura nëpër vende të hapura.

D. Ky ndalim inkurajon njeriun që të ketë kujdes ndaj kafshëve që i posedon dhe të mos lejojë që të bëhen viktimë e sëmurjes dhe dobësisë e më në fund të ngordhin, por të shpejtojnë e t'i shërojnë ose t'i therë.

Ndalimi i gjakut të derdhur

2. Ndalimi i dytë është gjaku i derdhur, kryesisht ai që rrjedh. Kur është pyetur Ibn Abbasi për shpnetkën, është përgjigjur: "Hajeni!" Kur i kanë replikuar se është gjak, ai është përgjigjur: "Ju është ndaluar vetëm gjaku që rrjedh". Shkaku i ndalimit qëndron në faktin se është i papastër dhe se natyra e pastër e njeriut nuk e pranon. Gjithashtu ky gjak shkakton dëme ashtu siç shkakton cofëtira. Kur paraislamët kishin uri, merrnin diçka si p.sh. ndonjë asht ose diçka të ngjashme, e shponin kafshën dhe ia pinin gjakun. Lidhur me këtë, poeti E'asha thotë: Cofëtirave mos ju afroni, ruajuni, mos përdorni eshtra, hekura, gjakun t'ua pini. Meqë kjo shpuarje thithëse e dëmton dhe e dobëson kafshën, Zoti e ndaloj.

Mishi i dërrit

3. Ndalimi i tretë është mishi i dërrit. Natyra e shëndoshë e konsideron të fëlliqtë dhe largohet prej tij, ngase derri më së shumti e pëlqen ushqimin e fëlliqtë e të papastër. Mjekësia bashkëkohore vërteton se ngrënia e tij është e dëmshme në të gjitha viset, posaçërisht në ato tropike. Gjithashtu eksperimentet mjekësore vërtetojnë se ngrënia e mishit të tij shkakton parazitin vdekjeprurës (trihina sprialis) ashtu siç shkakton edhe shumë parazite të tjera. Kush e di, ndoshta shkenca nesër do të zbulojë edhe fshehtësi tjera të këtij ndalimi. E vërtetë është fjala e Zotit, i cili e përshkruan Pejgamberin e Tij me këto fjalë:

"Ua ndalon të këqijat."

Disa hulumtues thonë: "Ngrënia e vazhdueshme e mishit të dërrit dobëson ndjenjën e turpit nga e pahijshmja".

Prerja që bëhet jo në emër të Zotit

4. Ndalimi i katërt është prerja që i dedikohet ndokujt tjetër përveç Zotit, eventualisht ajo që gjatë prerjes së saj përmendet emri i ndokujt tjetër përveç Zotit, si p.sh. emri i idhujve. Kur idhujtarët therrnin diçka, theksonin emrat e idhujve të tyre, si p.sh. emrat e Latit dhe Uza'it. Me këtë bëhet afrim ndaj ndokujt tjetër përveç Zotit dhe adhurohet me emër tjetër përveç emrit të Tij të Madhëruar.

Shkaku i ndalimit këtu ka karakter të pastër fetar për ta mbrojtur monoteizmin, për ta pastruar besimin, për ta luftuar idhujtarinë dhe dukuritë e idhujtarisë në çdo mënyrë.

Zoti i cili krijoi njeriun, ia nënshtroi çdo gjë që është në tokë dhe ia përkuli kafshët, i lejoi ta therë në interes të tij në qoftë se e përmendë emrin e Tij të Madhëruar gjatë therjes. Kur e përmend emrin e Zotit, vërteton se atë që e bën me kafshën e gjallë, e bën me lejen dhe pëlqimin e Zotit, e në qoftë se e therë në emër të ndokujt tjetër e jo në emër të Zotit, atëherë e abstrahon lejen dhe me plot të drejtë i ndalohej kafsha e prerë.

Llojet e cofëtirave

Në përgjithësi, këto ishin katër llojet e ndalesave, ndërsa ajeti i sures “*Mâide*” i detajizon deri në dhjetë:

5. E ngulfatura është ajo që cofë nga ngulfatja, respektivisht nga litari në qafë, nga futja e kokës në ndonjë ngushticë etj.

6. E mbytura është ajo që mbytet me shkop ose me diçka tjetër deri në ngordhje.

7. E rrëzuara është ajo që rrëzohet nga ndonjë vend i lartë ose ajo që rrëzohet në pus.

8. E shpuara është ajo që shpohet nga ndonjë kafshë tjetër dhe ngordh.

9. Ajo që e kanë ngrënë egërsirat dhe ka ngordhur.

Pas këtyre pesë llojeve përjashton vetëm (“atë që e keni prerë”), kryesisht kafshën që e keni gjetur të gjallë dhe e keni prerë. (Sqarimi pason.) Kuptimi më korrekt i kësaj forme është që kafsha të jetë sadopak e gjallë. Ali Ibn Ebi Talibi thotë: “Nëse therni ndonjë të ngulfatur, të rrëzuar ose të shpuar që ende lëvizë ndonjë këmbë apo krah, hajeni.”

Dahhaki rrëfen se njerëzit e kohës paraislame e hanin këtë lloj, mirëpo kur ua shpalli Zoti Islamin, ua ndaloi.

Kështu, çdo gjë që lëvizë këmbën, bishtin ose syrin, theret dhe konsiderohet hallall.¹

Urtësia e ndalimit të këtyre llojeve

Urtësinë e ndalimit të këtyre llojeve e theksuam në ndalimin e mishit të cofëtirave. Urtësia e fundit është ajo se Ligjdhënësi i Gjithëditur di interesimin e njerëzve ndaj kafshëve, mirësjelljen dhe mbrojtjen e tyre. Pra, nuk duhet të lejohet që të ngulfaten, të mbyten ose të shpohen kafshët në mes vete deri në mbytje. Gjithashtu nuk duhet të lejohet që kafsha të maltretohet me rrahje deri në mbytje ashtu siç vepronin disa barinj zemërgurë, të cilët i nxitnin kafshët si p.sh., dy mëzatë ose dy desh të dalin në dyluftim e të mbyten me brirët e tyre.

Për këtë shkak dijetarët përqëndrohen në ndalimin e mishit të të shpuarës, që është plagosur e që i rrjedh gjaku nga therja ngase qëllimi i ndalimin trajtohet si ndëshkim kundër kësaj forme që i lë kafshët të shpohen deri në mbytje.

Ndalimi i mishit të kafshës që e kanë ngrënë egërsirat është respektim ndaj njeriut ngase njeriut nuk i lejohet të hajë fundërrinat e egërsirave. Njerëzit e periudhës paraislame e hanin atë që e braktisnin egërsirat, si p.sh. delet, devet ose lopët, mirëpo Zoti i Madhëruar ua ndaloi besimtarëve.

Prerja për idhujt

10. Ndalimi i dhjetë i detajizuar është prerja për idhujt, gjegjësisht duke kërkuar fatin nga idhujt ose nga altarët, të cilët adhuroheshin përveç Zotit. Këta (idhuj e altarë) ishin rreth Qabes dhe njerëzit e periudhës paraislame thernin për ta ose para tyre, me qëllim të afërimit ndaj zotërave e idhujve të tyre.

Kjo prerje i takon llojit të prerjes në emër të ndokujt tjetër e jo në emër të Zotit, ngase në të dy rastet glorifikohet hyjnia e falsifikuar. Dallimi midis këtyre dy formave është aty se prerja që i dedikohet ndokujt jetër përveç All-llahut bëhet për ndonjë idhull, eventualisht

¹ Sipas disa juristëve, duhet të jetë e gjallë saqë gjaku t'i shpërthejë e të ketë lëvizje të rënda.

larg tij dhe përmendet emri i idhullit, ndërsa prerja për kërkimin e fatit patjetër duhet të realizohet në altar ose jashtë altarit dhe nuk obligohet përmendja e ndonjë emri tjetër përveç atij të Zotit.

Meqë këta altarë ishin rreth Qabes ndokush mund të mendojë se përmes prerjes së tillë madhërohet Shtëpia e Shenjtë, mirëpo Kur'ani e anuloi këtë iluzion dhe qartësisht e ndalon, edhe pse nënkuptohet se i takon grupit të prerjes që i dedikohet ndokujt tjetër përveç Zotit.

Peshqit dhe karkalecat veçohen nga cofëtirat

Sheriati islam i veçon peshqit, balenat dhe krijesat tjera ujore nga kategoria e cofëtirave.

Kur pyetet Pejgamberi a.s. për ujin e detit, përgjigjet: *“Ai është i pastër dhe cofëtirat në të janë të lejuara.”*¹

Zoti i Madhëruar thotë:

“U lejohet juve gjahu në det dhe ushqimi i tij.” (Mâide, 96)

Umeri r.a. thotë:

“Gjahu (në det) nënkupton atë që gjuhet ndërsa ushqimi i tij, ajo që është gjuajtur.”

Gjithashtu Ibn Abbasi thotë: “Ushqimi i tij nënkupton cofëtirat”.

¹ Transmetim i Ahmedit dhe i autorëve të suneneve.

Në *Sahihajn* (Buhariu dhe Muslimi), transmetohet nga Xhabiri (r.a.)

që Pejgamberi a.s. i ka dërguar sahabët e vet në ekspeditë. Ata kanë gjetur një balenë të madhe jashtë detit (të cofur), dhe prej saj kanë ngrënë njëzet e ca ditë, pastaj janë kthyer në Medine dhe e kanë informuar Pejgamberin a.s., ndërsa Ai u ka thënë: *“Hani furnizimin (rizkun) që e ka nxjerrur Zoti për ju, dhe na ushqeni edhe neve me të në qoftë se keni.”* Disa prej tyre i dhanë pak dhe e hëngri.¹ Trajtim të njëjtë kanë edhe karkalecat e ngordhur ngase Pejgamberi e ka lejuar ngrënien e tyre, për shkak se nuk mund të theren. Ibn Ebi Eufa thotë:

*“Luftuam me Pejgamberin e Zotit në shtatë beteja duke ngrënë së bashku me të karkaleca.”*²

Shfrytëzimi i lëkurës, i eshtrave dhe i qimeve të cofëtirave

Ndalimi i cofëtirës nënkupton ndalimin e ngrënies së saj, mirëpo mund të shfrytëzohen lëkura, brirët, eshtrat ose qimet e saj, bile shfrytëzimi i tillë është i kërkuar ngase prej tij mund të fitohet dhe një fitim i tillë nuk duhet humbur.

Ibn Abbasi thotë:

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim unanim përveç Ibën Maxhes.

“I është dhënë sadaka guvernantes¹ së Mejmunes (nëna e besimtarëve) një dele, dhe kur i ngordh, kaloi aty afër Pejgamberi a.s. dhe tha: *“A nuk e merrni lëkurën e saj që ta përpunoni dhe ta shfrytëzoni?”* Ajo i thotë se ajo kishte ngordhur, mirëpo Pejgamberi i përgjigjet: *“Ndalohet vetëm ngrënia e saj”*.² Pejgamberi a.s. e ka sqaruar mënyrën e përpunimit të lëkurës duke kërkuar që ajo të regjet, sepse ai ka thënë:

“Pastrimi nga regjja trajtohet si prerje për lejimin e deles.” Në një transmetim tjetër thuhet:

“Regjja e saj zhduk fëlliqësinë e saj”.³

Në *Sahihun* e Muslimit dhe të tjerëve thuhet se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Çdo lëkurë që regjet ajo pastrohet”.

Nxënësi i Ebu Hanifes, Ebu Jûsufi (e ka preferuar Shevkani) transmeton se:

¹ Guvernantja ka qenë robëreshë e liruar.

² Transmetim unanim përveç Ibën Maxhes.

³ Transmetim i Ebu Davudit dhe Nesaiut.

Sevda, Ummul-Mu'minin, ka thënë: “Na ngordhi një dele, e regjëm lëkurën e saj dhe e bëmë kacek (në të hedhnim hurma për ta ëmbëltuar ujin)”.¹

Nevoja lejon përjashtime

Të gjitha këto ndalime vlejnë në rastet kur ekzistojnë alternativat, ndërsa rasti i nevojës ka trajtim të posaçëm, ashtu siç cekëm më parë. Zoti i Madhëruar thotë:

“Ua ka detajizuar atë që ua ka ndaluar përpos asaj në të cilën obligoheni.” (El-En'âm, 119)

Meqë Zoti përmendi ndalimin e cofëtirave dhe të gjakut, thotë:

“E kush shtrëngohet (të hajë nga këto) duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar, për të nuk është mëkat. Vërtet All-llahu falë, është mëshirues.” (El-Bekare, 173)

Të gjithë janë të një mendimi se nevoja nënkupton të ushqyerit në rast urie (sipas disa fukahave, duhet të kalojë një ditë e një natë urie), kryesisht në rast se nuk gjen diçka tjetër përveç këtyre ushqimeve të ndaluara. Në këtë rast ai detyrohet të hajë aq sa ta mënjanojë urinë e të shpëtojë nga shkatërrimi. Imam Maliki thotë: “Ushqimi dhe furnizimi i tillë vazhdojnë derisa të gjejë diçka tjetër.”

Disa të tjerë thonë: “Prej (ushqimit të tillë) han vetëm ai që i rrezikohet jeta...”. Ndoshta kjo është ajo që kuptohet nga fjala e Zotit të Madhëruar:

“Duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar.”

Këtu nënkuptohet se nevoja kufizohet me mosshijen dhe mostepimin.

Kur'ani qartësisht e thekson nevojën nga uria dhe thotë:

¹ Transmetim i Buhariut.

“E kush detyrohet nga uria (të hajë nga të ndaluarat), duke mos anuar dhe duke mos pasur për qëllim mëkatin, All-llahu falë shumë dhe është mëshirues”. (Mâide, 3)

Nevoja e shërimit

Nevoja e shërimit nënkupton shërimin nga njëra prej të ndaluarave. Rreth kësaj çështjeje mendimet e dijetarëve janë të ndryshme; disa prej tyre nuk e konsiderojnë shërimin nevojë të ngutshme si ushqimin duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s.:

*“Zoti nuk e ka caktuar shërimin tuaj nga ajo që e ka ndaluar.”*¹

Disa prej tyre e trajtojnë në mënyrë të barabartë shërimin dhe ushqimin ngase të dyja janë të nevojshme për jetë. Ky grup është mbështetur në lejimin e ndalesave për shkak të shërimit. Kështu Pejgamberi a.s. edhe pse e kishte ndaluar veshjen e mëndafshit, ua kishte lejuar Abdurrahman Ibn Aufit dhe Zubejr Ibn Avamit (r.a.) për shkak të nevojës së domosdoshme (ishin të sëmurë nga zgjebja).²

Ndoshta ky mendim është më afër shpirtit islam i cili përmes legjislacioneve dhe porosive e mbron jetën njerëzore.

Lejimi i përdorimit të medikamenteve nga të ndaluarat kushtëzohet me këto kushte.

1. Nëse nuk përdoret medikamenti i tillë rrezikohet realisht shëndeti i njeriut.

2. Në qoftë se nuk ekziston medikament tjetër hallall që mund ta zëvendësojë atë.

3. Atë ta caktojë mjeku musliman që është i besuar dhe fetar.

Nga realiteti objektiv ne themi se, sipas raporteve të mjekëve të besueshëm, nuk ka ndonjë nevojë obligative që të detyron të konsumosh diçka nga të ndaluarat si medikament shërues, mirëpo, do të konstatojmë parimin rezerv si mundësi që i ofrohet muslimanit, i cili jeton në një rreth ku ekzistojnë vetëm të ndaluarat.

¹ Transmetim i Buhariut nga Ibën Mes’udi.

² Shiko më gjerësisht në kreun *Veshmbathja dhe zbukurimi*.

Individi nuk është i detyruar (të hajë haram) në qoftë se në shoqëri ka ndonjë që ia largon nevojën e tij

Nevoja nuk kushtëzohet vetëm me mosgjetjen e ushqimit nga prona e vet. Ai nuk obligohet t'i përdorë ushqimet e ndaluara në qoftë se në shoqërinë e tij (qoftë islame apo dhimmite) ka ndonjë që posedon ushqim të lejuar. Shoqëria islame është e plotë dhe unike si një trup ose sikur tullat e shtëpisë që forcojnë njëra-tjetrën.

Koncepcioni i solidaritetit shoqëror më së miri përshkruhet nga Imam Ibn Hazmi. Në këtë kontekst ai thotë: “Muslimanit nuk i lejohet të hajë cofëtira ose mish derri në qoftë gjen ushqim të lejuar nga muslimani ose dhimmu, ngase pronari i ushqimit obligohet ta ushqejë njeriun e uritur. Pra, në raste të tilla nuk detyrohet të hajë cofëtira e mish derri. Nëse ai që jeton në begati refuzon që ta plotësojë obligimin e vet, i urituri ka të drejtë që ta luftojë. Në qoftë se i urituri vritet, vrasësi është fajtor dhe meriton të vritet. Por, nëse ndodh që të vritet ai që ka penguar që të ushqehet i urituri, ai gjithsesi meriton mallkimin e All-llahut xh.sh. për atë se e ka penguar të drejtën e tjetërkujt, dhe për të lirisht mund të thuhet se është mizor dhe dhunues.

Të shohim se ç'thotë All-llahu xh.sh. për zullumqarët:

“Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftone atë grup që vërsulet pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të All-llahut.” (Huxhurât, 9)

Ai i cili vëllait të vet ia pengon të drejtën, ai ngrihet kundër All-llahut xh.sh.

Për këtë shkak Ebu Bekri r.a. i luftoi refuzuesit e zeqatit, e të cilët pohonin për vete se janë muslimanë.¹

¹ *El-Muhal-la*, Ibën Hazm, 6/159.

PRERJA E KAFSHËVE SIPAS SHERIATIT

Kafshët e ujit në përgjithësi janë të lejuara

Kafshët sipas vendbanimit dhe vendqëndrimit, ndahen në dy lloje: në ujore dhe tokësore.

Kafshët e ujit jetojnë në ujë dhe të gjitha janë të lejuara, pa marrë parasysh a janë të gjalla apo të ngordhura. Ky parim i përmbledh peshqit, balenat, peshkaqenin, derrin e detit etj., qofshin të peshkuara nga muslimani apo jomuslimani.

Zoti ua ka lejuar robërve të vet çdo gjë që jeton në ujë, pa e ndaluar asnjë lloj të tyre dhe pa e kushtëzuar prerjen. Ai ia ka lënë përgjegjësinë njeriut për mënyrat e gjuatjes së tyre, por me kusht që t'i shmanget mundimit të tyre.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Pastaj, Ai është që nënshtroi detin, që prej tij të hani mish të freskët”. (Nahl, 14)

“Gjahu dhe ushqimi në det u është lejuar si përjetim për ju dhe për udhëtarët.” (Mâide, 96)

Pra, këtu Zoti flet në përgjithësi pa kurrfarë përjashtimi. (Zoti nuk harron!)

Kafshët e ndaluara tokësore

Prej kafshëve tokësore, Kur'ani qartësisht ndalon vetëm mishin e derrit në mënyrë të veçantë, mishin e çfarëdo qoftë kafshe të ngordhur apo të therur në emër të dikujt tjetër e jo në emër të Zotit xh.sh., si dhe gjakun e derdhur, ashtu siç u theksua në ajetet të cilat në përgjithësi ndalonin katër lloje ndërsa në detajizim, dhjetë sosh.

Kur'ani i Madhëruar për Pejgamberin Muhammed a.s. thotë:

“Ua lejon të mirat (të dobishmet) dhe ua ndalon të këqijat.” (El-A'râf, 157)

Të këqija janë ato që i konsideron të këqija shija e përgjithshme e njerëzve në tërësi, pa marrë parasysh individët.

Pejgamberi a.s. ka ndaluar ngrënien e mishit të gomarit shtëpiak në Betejën e Hajberit.¹

Në *Sahihajn* transmetohet se Pejgamberi a.s. ua ka ndaluar ngrënien e çdo egërsire që ka dhëmbë shqyes dhe të çdo shpeze me kthetra. Egërsira janë ato kafshë që i sulmojnë kafshët tjera dhe i shqyejnë, si p.sh. luani, tigri, ujku etj. Në grupin e shtazëve me kthetra bëjnë pjesë ato që kanë kthetra shqyese, si shqiponja, sokoli etj. Sipas mendimit të Ibn Abbasit (r.a.) ndalohen vetëm katër llojet e përmendura në Kur'an, dhe me sa duket, ai mendon se hadithet që ndalojnë kafshët shqyese kanë të bëjnë me shkallën e papëlqyeshmërisë (mekruh) e jo me haramin.

Në periudhën paraislame njerëzit hanin dhe braktisnin ushqimin për shkak të papastërtisë. Kështu, Zoti e dërgoi Pejgamberin a.s. dhe shpalli Kur'anin, me të cilin lejoi atë që duhet lejuar dhe ndaloi atë që duhet ndaluar. Atë që e lejoi konsiderohet hallall dhe atë që e ndaloi konsiderohet haram, kurse për atë që ka heshtur, mbizotëron falja.²

Pastaj e lexoi ajetin:

¹ Transmetohet se ndalimi ka qenë i përkohshëm për shkak të nevojës së tyre për të. Disa qeveri ndalojnë prerjen e kafshëve të vogla për shkak të nevojës për mishin e tyre kur të rriten.

“Thuaj: “Në atë që më është shpallur mua (në Kur’an) nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi...” (El-En’âm 145)

Në bazë të këtij ajeti, Ibn Abbasi mendonte se mishi i gomarëve shtëpiakë është i lejuar.

Mendimin e Ibn Abbasit e mbështette edhe Imam Maliku, i cili nuk e ndalonte mishin e egërsirave por vetëm mendonte se i takojnë shkallës së papëlqyeshmërisë (*mekruh*).

Është konstatuar se prerja e ligjshme nuk ka të bëjë me kafshët e ndaluara në relacion të lejimit të ngrënies por vetëm në pastrimin e lëkurës pa kushtëzuar regjien e saj.

Konditat për lejimin e prerjes së kafshëve shtëpiake

Kafshët e lejuara tokësore janë dy llojesh: lloji i kafshëve të buta shtëpiake si devet, lopët e dhentë dhe të tjera që rriten nëpër ferma e shtëpi dhe në llojin e dytë bëjnë pjesë kafshët e pazbutura e të egra. Për llojin e parë Islami kushtëzon që të theren sipas sheriatit.

Kushtet e prerjes sipas Sheriatit

Kushtet e kërkuara për prerjen sipas Sheriatit janë këto:

1. Të theret kafsha me mjet të mprehtë në mënyrë që të rrjedhë gjaku prej dejve të saj, qoftë mjete prej guri apo druri.

Adij Ibn Hatim Ta’i transmeton se i ka thënë Pejgamberit a.s.: “O i dërguari i Zotit, ne gjuajmë por s’mund të gjejmë thikë përveç gurit të mprehtë e drurit të gdhendur”, ndërsa ai i është përgjigjur: “Derdh gjak me çka të duash dhe përmende emrin e Zotit.”¹

² Këtë hadith e transmeton Ebu Davudi nga Ibën Abbasi por në formë të “mevkufit”.

2. Të prehet gryka ose të shpohet zgavra e grykës duke shkaktuar daljen e shpirtit të kafshës. Mënyra më e mirë është të prehet fyti i frymëmarrjes, gabzherri dhe dy damarët e qafës.¹

Ky kusht hedhet poshtë në qoftë se është vështirë të theret në vendin e duhur. Si shembull konkret, nëse bie kafsha në pus me kokë teposhtë dhe nuk mund të arrihet gryka ose gabzherri, ose nëse kundërshton natyrën e vet shtëpiake, në këtë rast trajtohet si kafshë që gjuhet dhe mjafton të shpohet në ndonjë vend të mundshëm.

Në *Sahihajn* transmetohet se

Rafi Ibn Hadixhi ka thënë: “Ishim me Pejgamberin a.s. në një udhëtim dhe (papritmas) një deve u largua e iku. Meqë nuk kishim kuaj, njëri e gjuajti me shigjetë dhe e ndaloi. Në atë rast, Pejgamberi a.s. tha: *“Disa prej këtyre kafshëve u ngjajnë egërsirave, dhe nëse ndonjëra prej tyre vepron kështu, silluni në këtë mënyrë.”*²

3. Të përmendet vetëm emri i Zotit - këtë parim e pranojnë të gjithë ngase njerëzit në periudhën paraislame i adhuronin idhujt e tyre me prerjen e kurbanit për ta, edhe atë duke i përmendur emrat e tyre ose duke i prerë gjatë kërimit të fatit. Këto forma Kur’ani i ka ndaluar ashtu siç cekëm më parë: *“Ajo që prehet për dikë tjetër e jo për Zotin dhe ajo (që prehet) për ta kërkuar fatin.”*

4. Nga tekstet është e qartë se duhet të përmendet emri i Zotit gjatë prerjes. Kur’ani thotë:

“Ju (besimtarë) hani nga ajo që (është therur dhe) është përmendur emri i All-llahut...” (El-En’âm, 118)

¹ Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit, Nesaiut, Ibën Maxhes, Hakemit dhe Ibën Habbanit.

¹ Disa juristë muslimanë kanë caktuar edhe kushte të tjera për procesin e prerjes ngase nuk ka tekst të qartë e të posaçëm dhe se prerja dihet sipas formës instinktive e tradicionale. Për shkak të vështirësive dhe qëndrimeve strikte të tyre që nuk përputhen me natyrën e lehtë të Islamit, nuk do t’i përmendim.

² Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit.

“Dhe mos hani nga ajo që (para therjes së saj) nuk është përmendur emri i All-llahut, vërtet ajo (ngrënia) është mëkat.” (El-En'âm, 121)

Pejgamberi a.s. thotë:

“Hani atë prej së cilës rrjedh gjaku dhe në të cilën përmendet emri i Zotit!”¹

Më vonë do t'i cekim hadithet të cilat obligojnë përmendjen e emrit në gjah, gjatë gjuajtjes së shigjetës ose dërgimit të qenit të stërvitur. Disa dijetarë mendojnë se përmendja e emrit është e detyrueshme por nuk është e detyrueshme në rastin e prerjes ngase mjafton të përmendet gjatë ngrënies. Ai që përmend emrin në haje nuk han diçka për të cilën nuk është përmendur emri i Zotit. Në *Sahihun* e Buhariut transmetohet se

Aisha r.a. thotë: “Një grup njerëzish që posa kishin hyrë në Islam, i thanë Pejgamberit a.s.: Njerëzit na sjellin mish për të cilin nuk dimë se a e kanë përmendur emrin e Zotit ose jo, pra a ta hamë apo jo? Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Përmendni emrin e Zoti dhe hani!”*

Sekreti dhe urtësia e kësaj prerjeje

Sekreti i kësaj prerjeje, sipas mendimit tonë, qëndron në faktin se duhet t'i dalë shpirti kafshës në një formë më të shpejtë dhe pa mundime. Për këtë shkak është kushtëzuar mjeti i posaçëm dhe vendprerja në grykë ngase kjo është mënyra më e përshtatshme për ta ndarë nga jeta me lehtësim. Ndalohet prerja përmes dhëmbëve dhe thonjve ngase në këtë mënyrë maltretohet kafsha, dhe si zakonisht, kështu kafsha mbytet. Pejgamberi a.s. ka urdhëruar mprehjen e tehut dhe vënien e kafshës në një pozitë të përshtatshme duke thënë:

¹ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

“Zoti ka urdhëruar mirësjelljen ndaj çdo gjëje, pra, nëse vritni atëherë vritni me mirësjellje, nëse therni, therni me mirësjellje. Le ta mprehë ndonjëri prej jush thikën dhe le ta vejë kafshën në një pozitë të përshtatshme.”¹

Këtë mirësjellje gjithashtu e transmeton edhe Ibn Umeri nga Pejgamberi a.s., i cili urdhëron të mprehet thika dhe thotë:

“Nëse ndonjëri prej jush pret, atëherë le të përgatitet!”²

Ibn Abbasi transmeton se një njeri e ka shtrirë delen e pastaj e ka mprehur thikën. Në atë moment Pejgamberi a.s. i thotë:

“A do ta therësh dy herë? Pse nuk e përgatite thikën para shtrirjes së saj?”³

Kur e ka parë Umeri një njeri duke tërhequr një dele për ta prerë, i ka thënë:

“Mjerë për ty! Çoje në therje me mirësi!”⁴

Sipas këtij mendimi të përgjithshëm të këtij kreu, nënkuptojmë mirësjelljen ndaj kafshëve të huaja, sigurimin e qetësisë së tyre sipas mundësisë. Në periudhën paraislame njerëzit e prenin gungën e deves së gjallë dhe bishtin e deles, dhe meqë në këtë mënyrë maltretoheshin kafshët, Pejgamberi a.s. ndaloi ngrënien e çdo pjese prej tyre, duke thënë:

¹ Transmetim i Muslimit nga Sheddad ibën Evsi.

² Transmetim i Ibën Maxhes.

³ Transmetim i Hakemit i cili e bën autentik sipas kushtit të Buhariut.

⁴ Transmetim i Abdur-rez-zakut

“Nëse prehet diçka duke qenë kafsha e gjallë, ajo konsiderohet e ngordhur.”¹

Urtësia e përmendjes së emrit të Zotit në prerje

Përmendja e emrit në prerjen (e kafshës) ka një urtësi të këndshme, të cilës duhet kushtuar vëmendje të veçantë. Ky akt është në kundërshtim me veprimet e idhujtarëve dhe njerëzve të periudhës së injorancës ngase ata i përmendnin emrat e zotave të tyre të trilluar. Pra, meqë idhujtari përmend emrin e idhullit të vet, atëherë si të mos e përmend besimtari emrin e Zotit të vet?!

Në anën tjetër, kafshët dhe njerëzit janë krijesa të Zotit dhe gjallesa me shpirt. Pse njeriu t’i mbizotërojë e t’ua merr shpirtin (t’i therë) pa lejen e Zotit, i cili krijoi për të çdo gjë në tokë. Përmendja e emrit të Zotit në këtë rast konfirmon lejen hyjnore dhe njeriu sikur thotë:

“Unë nuk veproj kështu nga armiqësia dhe dobësia kundër këtyre krijesave, por në emër të Zotit theri, në emër të Zotit gjuaj, dhe në emër të Zotit ha.”

Therjet e ithtarëve të Librit (hebrenjve dhe të krishterëve)

Pamë se Islami ka qëndrim të ashpër ndaj prerjes, ngase idhujtarët arabë dhe ithtarët e feve tjera i konsideronin kurbanet si çështje të adhurimit, bile si çështje të besimit e bazave të fesë, dhe për këtë filluan të therin për hir të zotave të tyre, ose filluan të therin për kërkimin e fatit (para altarit) dhe i përmendnin emrat e tyre në ceremoninë e prerjes. Kur u shpall Islami, i anuloi të gjitha këto çështje dhe obligoi që të përmendet vetëm emri i Zotit gjatë prerjes, ndaloi prerjen para altarit të fatit ashtu siç ndaloi prerjen që i dedikohet ndokujt tjetër përveç Zotit.

Meqë ithtarët e Librit në parim janë ithtarë të monoteizmit, mirëpo më vonë depërtuan te ata idetë idhujtare të cilat i kishin trashëguar nga idhujtaria e vjetër, dhe për këtë shkak disa muslimanë

¹ Transmetim i Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Hakemit.

mendojnë se ithtarët e Librit duhet të trajtohen si idhujtarë. Zoti ka lejuar ushqimin me ithtarët e Librit dhe martesën (me femrat e tyre). Në këtë kontekst, Zoti në suren “*Mâide*”, që u shpall në fund të shpalljes së Kur’anit, thotë:

“Sot i lejuam për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therurat) e ithtarëve të Librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar).” (*Mâide*, 5)

Nga ky ajet nënkuptojmë se “sot ua lejuam ushqimet (e mira), pra nuk ka më *behîre*, as *sâibe*, as *vesîle* as *hâm*. Ushqimi i itharëve të Librit, gjegjësisht i hebrenjve dhe të krishterëve, parimisht ju lejohet dhe asnjëherë Zoti nuk ua ka ndaluar, si dhe ushqimi juaj lejohet për ata. Hani prej mishrave të cilat i kanë prerë ose i kanë gjuajtur, dhe ushqeni ata nga ajo që e preni ose e gjuani.

Islami është më rigoroz me idhujtarët arabë por jo edhe me ithtarët e Librit ngase këta janë më afër besimtarëve për shkak se pranojnë shpalljen, pejgamberinë dhe bazat e fesë. Na lejohet të ushqyerit me ta, martesa me femrat e tyre dhe mirësjellja ndaj tyre si dhe në qoftë se bashkëjetojnë me ne dhe e njohin Islamin, rrethin islam dhe pjesëtarët e tij në esencë, si nga aspekti i diturisë, i punës dhe moralit, mund të ndodhë që ata ta kuptojnë se feja jonë është e ngjashme me fenë e tyre por se Islami është në një shkallë më të lartë, me një pasqyrë më të plotë dhe me faqe më të pastra nga risitë, konceptet e gabuara dhe idhujtaria.

Thënia “Ushqimi i ithtarëve të Librit” ka karakter të përgjithshëm dhe nënkupton të gjitha ushqimet e tyre, si p.sh. mishin, prodhimet e ndryshme etj., dhe përgjithësisht na lejohet neve, përveç ushqimit që është i ndaluar, si p.sh. cofëtirat, gjaku që rrjedh dhe mishi i derrit.

Të gjithë kanë mendim unanim se ushqimi i ndaluar nuk lejohet, pa marrë parasysh se a i takon ithtarit të Librit ose muslimanit.

Në vazhdim na mbetën për t’i sqaruar disa çështje për të cilat muslimanët shprehin dëshirë për t’i njohur.

Prerja për kishën dhe për festat krishtere

1. Nëse nuk dëgjohet prej ithtarit të Librit se e përmend emrin e Isait ose Uzejrit përveç Zotit, atëherë kafsha e prerë është hallall, e nëse ndodh e kundërta, atëherë disa fukaha (juristë) e ndalojnë ngase i dedikohet ndokujt tjetër përveç All-llahut, ndërsa disa fukaha të

tjerë thonë se Zoti na ka lejuar ushqimin e tyre (Zoti është më i dituri!).

Është pyetur Ebu Derdaja (r.a.) për një qengj të prerë për kishën e quajtur Xhorxhis, se a duhet të hahet? Ai është përgjigjur:

“O Zot, kërkoj mëshirë! Ata janë ithtarë të Librit, ushqimi i tyre lejohet për ne ashtu siç lejohet i yni për ta.” Pastaj ka urdhëruar që të hahet.¹

Kur është pyetur Imam Maliku rreth kafshës së prerë nga ithtarët e Librit për festat dhe kishat e tyre, është përgjigjur:

“Nuk e pëlqej por nuk e ndaloj. Nuk e pëlqej nga devotshmëria se mos i përket grupit të prerjes që i dedikohet ndokujt tjetër përveç Zotit. Ai nuk e ka ndaluar për shkak se ajo që theret për dikë tjetër nënkupton prerjen për zotat e tyre, me të cilën i adhurojnë por nuk e hanë, ndërsa atë që e presin dhe e hanë, konsiderohet ushqim i tyre. Zoti i Madhëruar thotë:

“Ushqimi i ithtarëve të Librit ju lejohet!”²

Prerja me mjete elektrike ose forma tjera të ngjashme

2. Çështja e dytë ka të bëjë me kushtëzimin që prerja e tyre t’i ngjajë prerjes sonë, gjegjësisht asaj në fyt?

Shumica e dijetarëve e kushtëzojnë këtë mënyrë, ndërsa një grup i medhhebit malikit nuk e pranon si kusht.

Kur Kâdi Ibn Arabiu e komentoi ajetin e sures “*Mâide*”, tha: “Ky është argument i prerë se gjahu dhe ushqimi i ithtarëve të Librit u përkasin ushqimeve të mira që i ka lejuar Zoti. Ky ushqim është hallall i vërtetë, ndërsa Zoti e ka përsëritur me qëllim që ta largojë dyshimin dhe kundërshtimet nga rreziqet shkatërrimtare, të cilat dëshirojnë t’i refuzojnë e t’i prolongojnë diskutimet. Më kanë pyetur

¹ Transmetim i Taberit.

² Kjo fetva pasqyron devotshmërinë, fikhun dhe bindjen fetare të Imam Malikut, ngase nuk ka shpejtuar në ndalim ashtu siç veprojnë disa të tjerë sot, por ka shprehur vetëm urrejtje (me mekruh).

për një të krishter i cili e ka këputur kokën e pulës dhe e ka zier se a hahet pula, dhe unë jam përgjigjur: Hahet, ngase ajo konsiderohet ushqim i tyre, i monakëve dhe i murgjve të tyre, edhe pse këtë mënyrë të prerjes ne nuk e pranojmë. Meqë Zoti në përgjithësi na ka lejuar ushqimin e tyre dhe atë që ua lejon feja, atëherë edhe për ne është i lejuar përveç asaj me të cilën përgënjeshtrohet Zoti. Dijetarët tanë kanë thënë: Meqë martohemi me gratë e tyre dhe kemi marrëdhënie seksuale me to, atëherë pse mos t'i hamë kafshët e prera të tyre”.

Në një vend tjetër Ibn Arabiu gjithashtu thotë: “Ajo që e hanë e që nuk është prerë, si p.sh. është ngulfatur ose ia kanë thyer kokën, konsiderohet haram.”

Këtu nuk ka kundërshtim mendimesh, por ka për qëllim atë se çka konsiderohet e prerë për ata, na lejohet edhe neve, pa marrë parasysh se për ne nuk është e drejtë. Gjithashtu ajo që nuk e pranojnë ata si të prerë, nuk lejohet edhe për ne.

Të kuptuarit e përbashkët të prerjes është kjo: “Qëllimi i prerjes së kafshës është lejimi i ngrënies së saj”. Ky është mendimi i një grupi medhhebit malikij.

Në bazë të kësaj që cekëm, mund të gjykojmë ndaj mishrave të importuar nga ithtarët e Librit, si p.sh. mishi i pulave dhe mishi i konservuar i lopëve, gjegjësisht mishi që mund të jetë i kafshës së prerë me mjete elektrike ose me metoda tjera të ngjashme. Përderisa ata e pranojnë këtë si të prerë të lejuar, atëherë lejohet edhe për ne, në bazë të konceptit të përgjithshëm të ajetit.

Sa i përket mishit të importuar nga shtetet komuniste, themi se nuk lejohet ngase nuk janë ithtarë të Librit, i refuzojnë të gjitha fetë dhe e mohojnë Zotin e të gjitha mesazhet e Tij.

E prera nga zjarrputistët dhe nga të ngjashmit me ata

Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth këtij qëndrimi. Pjesa dërrmuese e ndalojnë ngrënien e saj ngase i konsiderojnë idhujtarë, ndërsa disa të tjerë e lejojnë ngase Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Trajtoni ata ashtu siç i trajtoni ithtarët e Librit!”¹ Ai merrte xhizjen prej zjarrputistit të emigruar.² Kur flet për prerjen, Ibn Hazmi në librin e vet *El-Muhal-la*, thotë:³

Ata janë ithtarë të Librit dhe trajtimi i tyre i ngjanë trajtimit të ithtarëve të Librit në çdo gjë.”⁴

وَالصَّابِغُونَ عِنْدَ أَبِي حَنِيفَةَ أَهْلُ كِتَابٍ أَيْضًا.

Sipas Ebu Hanifes, edhe sabejët konsiderohen ithtarë të Librit.⁵

Rregull: nuk pyesim për atë që mungon

Muslimani nuk duhet të pyetë për atë që mungon, gjegjësisht të pyesë se si është bërë prerja, a janë plotësuar kushtet apo a është përmendur emri i Zotit gjatë prerjes apo jo!

Çdo gjë që mungon nga ne, pa marrë parasysh se a e ka prerë muslimani (qofë injorant ose fasik) ose ithtari i Librit, konsiderohet hallall për ne.

إِنَّ قَوْمًا يَأْتُونَنَا بِاللَّحْمِ لَا نَدْرِي أَذَكَّرُوا اسْمَ اللَّهِ عَلَيْهَا
أَمْ لَا؟ فَقَالَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: سَمُّوا اللَّهَ عَلَيْهِ أَنْتُمْ وَكُلُّوا.

¹ Transmetim i Shafiut dhe i Malikit. Pjesën tjetër që thotë: “Mos i martoni gratë e tyre dhe mos hani mishin e prerë nga ata”, muhaddithët nuk e pranojnë si autentike.

² Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

³ S’ka dyshim se fjala e Ibën Hazmit ka peshë, dhe është njohës më i mirë i teksteve dhe i historisë së popujve e feve të tyre. Në librin *El-Ferk bejnel-fireki*, Bagdadi thotë se zjarrputistët pranojnë profecinë e Zaratustrës. Këtë mendim e kanë pranuar edhe disa dijetarë bashkëkohorë të cilët i njohin kulturat antike, si p.sh. Mevlana Ebu Kelam Azadi.

⁴ Disa hulumtues bashkëkohorë orvaten t’i trajtojnë edhe brahmanitët e budistët si zjarrputistë dhe ithtarë të Librit, por në këtë aspekt ata e teprojnë.

⁵ Shiko tefsirin *El-Menar*, vëllimi VI, kreu për ushqimin e putistëve dhe mbi martesën me gratë e tyre, ajetin për ushqimin e ithtarëve të Librit.

Më parë theksuam se në një transmetim të Buhariut rrëfëhet se një grup njerëzish e kanë pyetur Pejgamberin a.s. për një grup që kanë sjellur mish por nuk e kanë ditur se a e kanë përmendur emrin e Zotit apo jo, e ai u është përgjigjur: *“Përmendni emrin e Zotit dhe hani atë!”*

Kur flasin dijetarët për këtë hadith, thonë: “Ky është argument se veprat dhe sjelljet pranohen të vërteta e autentike përderisa nuk ka argument tjetër për ta shtrembëruar.”

Gjahu

Shumica e arabëve dhe e popujve tjerë jetonin nga gjahu dhe për këtë shkak Kur’ani e Sunneti u interesuan për këtë çështje, kështujuristët i kushtuan kapituj të posaçëm kësaj pjese, e detajizuan atë që lejohet dhe atë që ndalohet, atë që obligohet dhe atë që preferohet. E gjithë kjo ndodh për shkak se ekzistojnë kafshë e shpezë që kanë mish të mirë por njeriu s’mund t’i kapë ose t’i përfitojë ngase nuk janë shtëpiake. Islami për këtë lloj nuk ka caktuar kushte të prerjes ashtu siç ka caktuar për kafshët shtëpiake, por ka mjaftuar vetëm me mënyrat e mundshme me qëllim që njeriut t’i ofrojë më shumë lehtësime. Për këtë shkak, njerëzit u mbështetën në instinktin dhe në nevojën e tyre, por me kushte e organizime që i përkasin besimit islam dhe parimit të tij. Disa nga këto kushte kanë të bëjnë me gjuetarin, disa me gjahun dhe disa se me çfarë bëhet gjuetia.

E gjithë kjo ka të bëjë me gjahun tokësor, ndërsa për gjahun detar u cek më parë se Zoti e ka lejuar në përgjithësi:

“Zoti ua ka lejuar gjahun e detit dhe ushqimin e tij.”(Mâide, 96)

Kushtet e gjahtarit

1. Për gjahtarin kushtëzohen kushtet e njëjta që kushtëzohen edhe për prerësin (e kafshës), gjegjësisht të jetë musliman ose ithtar i Librit, ose që trajtohet si ithtar i Librit, si p.sh. zjarrputistët dhe sabejët.

Islami ka caktuar edhe këto udhëzime për gjahtarin: të mos gjuajë pa qëllim dhe kot t’ia marrë shpirtin kafshës në qoftë se nuk ka për

qëllim ta hajë ose ta shfrytëzojë mishin e saj. Në një hadith të Pejgamberit thuhet:

“Nëse ndokush vret ndonjë zog për kot (pa qëllim të definuar), zogu do të vajtojë (do t’i ankohet Zotit) deri në Ditën e Kijametit duke thënë: “O Zot, filani më vrau pa kurrfarë qëllimi e pa ndonjë dobi prej meje.”¹

Në një hadith tjetër thuhet:

“Zoti do t’i kërkojë çdokujt llogari Ditën e Kijametit në qoftë se vret ndonjë zog pa kurrfarë qëllimi.” E kanë pyetur Pejgamberin se për çfarë llogarie bëhet fjalë, e ai u është përgjigjur: *“Është dashur ta therë e ta hajë e jo t’ia këpusë kokën dhe ta gjuajë!”²*

Gjahtari gjithashtu kushtëzohet që të mos jetë i veshur me *ihram*, si p.sh. në haxh apo në umre, ngase periudha e *ihramit* përfaqëson periudhën e paqes së plotë dhe të sigurisë së përgjithshme që i përfshin edhe kafshët në tokë e shpezët në qiell, bile edhe në qoftë se janë aq afër saqë njeriu mund t’i kapë me dorë apo t’i gjuajë me shigjetë.

Në këtë mënyrë sprovohet dhe edukohet besimtari i fuqishëm dhe i durueshëm. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, All-llahu do t’ju sprovtojë me diçka nga gjahu që e arrijnë duart ose shigjetat tuaja për t’u dalluar te All-llahu ai që i frikësohet Atij në heshtje (në bazë besimi). E kush i shkelë (dispozitat) pas këtij (sqarimi), ai ka dënim të dhembshëm”. (Mâide, 94)

*“Gjahu tokësor u është ndaluar sa të jeni në *ihram*.”* (Mâide, 96)

¹ Transmetim i Nesaiut dhe Ibën Habbanit në *Sahih*.

² Transmetim i Nesaiut dhe Hakemit; ka transmetim autentik.

“Dhe përveç gjuetisë, që nuk është e lejuar derisa jeni në ihram.” (Mâide, 1)

Kushtet e gjahut

Në mesin e këtyre kushteve bën pjesë edheai që kafsha e cila duhet gjuajtur, të mos mund të theret në grykë, e në rast se therja është e mundshme, atëherë shfrytëzohet vetëm forma e therjes e jo ndonjë formë tjetër, ngase ky është kusht parimor.

Në qoftë se kafsha gjuhet me shigjetë ose e kap qeni, por ajo është ende e gjallë, atëherë duhet të prehet në grykë e nëse nuk lëviz, atëherë therja e saj, është më e mirë, e nëse e lëmë t’i dalë shpirti vetvetiu, gjithashtu pranohet. Në një hadith të *Sahihajnit*, thuhet:

“Kur ta lëshosh qenin, përmende emrin e Zotit, dhe nëse e bie (gjahun) të gjallë atëherë there.”

Kushtet për mjetet e gjahut

Mjetet e gjahut janë dy llojesh:

1. Mjetet vrasëse si p.sh. shigjeta, shpata, shtiza, ashtu siç thuhet në ajetin kur’anor:

“E mbërrijnë duart dhe shigjetat tuaja!” (Mâide, 94)

2. Shtazët gjuajtëse që stërviten për gjah, si p.sh. qeni e leopardi nga bota e egërsirave dhe shqiponja e petriti nga shpezët shqyese. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Thuaj: “U janë lejuar të gjitha ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të stërvitur që i mësoni ashtu siç ju ka mësuar juve All-llahu.” (Mâide, 4)

Gjuetia me mjet vrasës

Në këtë lloj të gjuetisë kushtëzohen dy gjëra:

1. Arma duhet ta shpojë trupin e kafshës e jo ta shtypë atë.

Adij Ibn Hatimi e ka pyetur Pejgamberin a.s.: “Unë e gjuaj kafshën me (mi’rad) armë dhe e godas”, e në atë rast Pejgamberi a.s. i është përgjigjur: *“Nëse e gjuan me armë dhe e shpon (kafshën) haje, e nëse vetëm e shtypë, mos e ha.”*¹

Nga ky hadith nënkuptojmë se kusht është shpuarja, pa marrë parasysh se a vritet me shtypje (përplasje). Në bazë të këtij fakti lejohet gjahu me plumbin e pushkës, revoles etj., ngase këto armë shpojnë më shumë se shtizat, shigjetat e shpata.

Transmetimi i Ahmedit në hadithin që thotë:

“Mos hani atë që vritet me “bunduka - plumb” por vetëm atë që pritët”, dhe transmetimi i Buhariut nga Ibn Umeri kanë të bëjnë me gjylen prej argjile e jo me pushkën moderne. Pejgamberi a.s. gjithashtu ka ndaluar gjahun me gjuajtje gurësh dhe ka thënë:

*“Në këtë mënyrë nuk gjuhet gjahu e as që vritet armiku, në këtë mënyrë vetëm ia then dhëmbin ose e qorron.”*²

2. Të përmendet emri i Zotit kur të gjuhet me armë, ashtu siç e ka mësuar Pejgamberi a.s. Adij Ibn Hatemin, dhe hadithet e tij konsiderohen parime themelore në këtë çështje.

¹ Hadith autentik.

² Transmetim i Buhariut dhe Muslimit.

Gjuetia me qen ose me diç të ngjashme

Nëse gjuhet me qen ose falkon, kërkohet që:

1. Të jetë i stërvitur.
2. Të gjuajë për pronarin e vet, ose sipas Kur'anit, ta kapë për pronarin e vet e jo për vete.
3. Të përmendet emri i Zotit me rastin e lëshimit.

Si bazë e këtyre kushteve është ajeti kur'anor:

“Të pyesin ty (Muhammed), çka u është lejuar atyre? Thuaj: “U janë të lejuara të gjitha ushqimet e mira dhe ai (gjahu) i gjahtarëve (shtazëve) të stërvitur që i mësoni ashtu siç ju ka mësuar juve All-llahu. Hani pra atë që gjuajtën për ju dhe më parë përmendni emrin e All-llahut. Kini frikë nga All-llahu sepse All-llahu shpejt ndërmerr masa.” (Mâide, 4)

1. Definicioni i stërvitjes së tyre është i njohur, gjegjësisht të jetë nën kontrollin e pronarit dhe pronari i qenit mund të konstatojë se kur është qeni i gatshëm për gjueti. Kur ta thërrasë t'i përgjigjet dhe ta ndjekë gjatë gjahut, qoftë i lidhur apo jo (mendimet e dijetarëve rreth kësaj çështjeje janë të ndryshme).

Sidoqoftë, qeni duhet të jetë i stërvitur, ndërsa stërvitja i tij kuptohet sipas gjykimit të rëndomtë.

2. Definicioni “të mos hajë qeni diçka prej gjahut”. Pejgamberi a.s. thotë:

“Nëse e dërgoni qenin e ai e ha kafshën e gjuajtur, mos e hani, ngase ai e ka gjuajtur për vete. Nëse e dërgoni qenin dhe ai e mbyt kafshën pa e ngrënë fare, atëherë hane atë ngase e ka kapur për pronarin e vet.”¹

Disa fukaha bëjnë dallimin midis shtazëve shqyese si qentë dhe shpezëve si falkoni, dhe kështu lejohet ajo që e ka ngrënë shpeza ndërsa ndalohet ajo që ka ngrënë qeni.

Urtësia e këtyre dy kushteve, gjegjësisht stërvitja e qenit pastaj përcjellja e gjahut para pronarit të vet lartëson dinjitetin e njeriut dhe pastërtinë e tij nga ngrënia e mbeturinave të qenve dhe

¹ Transmetim i Ahmedit, Buhariut dhe Muslimit.

egërsirave tjera, para të cilave mund të tregohet i dobët ai që ka shpirt të dobët. Në rast se qeni është i stërvitur dhe ia dërgon gjahun pronarit të vet, atëherë ai i ngjan mjetit të cilin e përdor gjahtari si p.sh. shigjetën e shtizën.

3. Përmendja e emrit të Zotit me rastin e dërgimit të qenit i ngjan përmendjes në gjuajtjen e shigjetës, shtizës apo goditjes me shpatë. Në këtë kontekst, ajeti kur'anor thotë:

"Dhe përmendni emrin e Zotit..." (Mâide, 4)

Kështu na urdhërojnë edhe shumë hadithe autentike si p.sh. hadithi i Adij Ibn Hatemit.

Këtë kusht e konfirmon edhe fakti se po që se qenin (e stërvitur) e shoqëron edhe ndonjë qen tjetër (i rëndomtë), atëherë mishi i gjahut nuk lejohet.

Kur Adij e ka pyetur Pejgamberin a.s.: "Kur e dërgoj qenin tim gjej me të edhe një qen tjetër dhe s'di se cili prej tyre e ka marrë". Pejgamberi a.s. i është përgjigjur:

"Mos e ha, ngase e ke përmendur emrin e Zotit në qenin tënd e jo në ndonjë qen tjetër!"

Në qoftë se harrohet përmendja e emrit të Zotit gjatë gjuajtjes ose dërgimit (të qenve), atëherë Zoti falë ngase nuk llogarit në rast të harresës e gabimit, dhe në këtë rast duhet ta rikujtojmë gjatë ngrënies, ashtu siç përmendëm në çështjen e prerjes.

Mjafton të thuhet ajo që u tha për urtësinë e përmendjes së emrit të Zotit me rastin e prerjes.

Në rast të ngordhjes së gjahut pas gjuajtjes

Ndonjëherë ndodh që gjuetari ta gjuajë shigjetën e ta godasë gjahun, mirëpo pas një kohë e humbë dhe më vonë e gjen të ngordhur, bile ndoshta e gjen pas disa ditëve. Në këtë rast lejohet ngrënia e gjahut por me këto kushte:

1) Të mos bie në ujë. Pejgamberi a.s. thotë:

“Nëse gjuan me shigjetë dhe e mbytë, haje, e nëse e gjenë në ujë atëherë mos e ha, sepse nuk dihet se a thua shigjeta yte apo uji e ka mbytur?! ”¹

2. Të mos gjendet ndonjë gjurmë tjetër që e ka mbytur përveç shigjetës.

Adij Ibn Hatemi transmeton se i ka thënë Pejgamberit: “O i dërguari i Zotit! Nëse e gjuaj gjahun dhe e gjej të nesërmen me shigjetën time?”, Pejgamberi a.s. i ka thënë: *“Nëse e di se shigjeta yte e ka mbytur dhe nuk gjenë gjurmë të egërsirave, atëherë haje!”*²

3. Në qoftë se mishi i gjahut nuk është i prishur (i kalbur) ngase natyra e shëndoshë refuzon kalbësirën dhe rrëqethet prej saj, si dhe ajo shkakton dëm.

Në *Sahihun* e Muslimit, transmetohet se Pejgamberi a.s. i ka thënë Ebu Tha’lebe El-Hasheniut:

“Në qoftë se gjuan gjahun e pastaj të humbet tri ditë dhe e gjenë, haje në qoftë se nuk është kalbur.”

Vera - pijet dehëse (intoksikanët)

Me këtë nënkuptojmë pijet alkoolike që dehin. Është shumë e qartë se s’duhet të përmendim dëmin e tyre psikik dhe fizik ndaj individit, në fenë dhe në botën e tij, apo të potencojmë rrezikun që i kërcënohet familjes dhe përgjegjësisë familjare ndaj gruas dhe

¹ Transmetim i Buhariut dhe Muslimit.

² Transmetim i Tirmidhiut.

fëmijëve. Gjithashtu s'ka nevojë të cekim rrezikun për shoqërinë dhe popujt, gjegjësisht për mirëqenien e tyre shpirtërore, materiale e morale.

Ka të drejtë një hulumtues që thotë: "Fatkeqësia më e madhe për njeriun është ajo e alkoolit. Në qoftë se bëhet një statistikë e përgjithshme vjetore për numrin e të sëmurëve në botë nga sëmundjet psikike e fizike, për numrin e vetëvrasjeve ose vrasjeve, për numrin e atyre që vuajnë nga sëmundjet nervore e digjesteve, për numrin e bankrotëve dhe shitësve të shtëpive personale për shkak të konsumimit të pijeve alkoolike, do të fitohet një numër shumë i madh. Këshillat kundër këtyre pijeve, në krahasim me këto statistika, janë shumë të kufizuara."

Arabët e periudhës paraislame e kanë konsumuar alkoolin me të madhe dhe këtë fakt e vërteton ekzistimi i afër njëqind emrave për të. Në poezitë e tyre ata e kanë përshkruar alkoolin, gotat e tij, ndejtet dhe llojet e tij.

Kur u shpall Islami, filloi ta ndalojë në mënyrë të urtë e edukative dhe gradualisht e bëri haram. Në fillim ndaloi faljen e namazit në gjendje të dehur pastaj tregoi se dëmi i tij është më i madh se dobia, e më vonë, Zoti i Madhëruar shpalli ndalimin kategorik në suren "*Mâide*":

"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta të shejtanit. Pra largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të shkaktojë armiqësi midis jush, t'ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?" (Mâide, 90-91)

Shumë qartë Zoti i ndalon verën dhe bixhozin në këto dy ajete, i krahason me idhujt dhe me hedhjen e shigjetës për fall dhe i konsideron të ndyta. (Në Kur'an ky term përdoret vetëm për gjërat shumë të këqija e amorale). Ai i konsideron si vepra të djallit, të pamoralshme e të këqija. Largimin prej tyre e konsideron shpëtim. Prej dëmeve shoqërore thekson ndërprerjen e lidhjeve, nxitjen e armiqësisë dhe urrejtjes, kurse prej dëmeve shpirtërore, pengimin e obligimeve fetare, gjegjësisht pengimin e përmendjes së Zotit dhe faljes së namazit. Pastaj, në një mënyrë shumë paralajmëruese thotë:

"Pra, a po i jepni fund (verës e bixhozit)?"

Përgjigjja e besimtarëve ndaj këtij paralajmërimi kategorik ishte: “O Zot! Ne i dhamë fund, o Zot!”

Pas zbritjes së këtij ajeti, besimtarët bënë çudira. Nëse ndokush mbante gotën në dorë dhe ishte duke pirë, kur e dëgjonte këtë ajet e hedhte dhe e derdhte në tokë.

Shumë qeveri janë të bindura për dëmet që ua shkakton alkooli individëve, familjeve dhe vataneve. Disa prej tyre u orvatën t’i pengojnë me ligj e fuqi (si Amerika) por dështuan, kurse Islami korri sukses në eliminimin e tij.

Klerikët krishterë kanë mendime të ndryshme rreth qëndrimit të Krishterimit ndaj alkoolit. Disa mbështeten në tekstin biblik: “Pak verë ndihmon digjestionin (tretjen).” Sikur të ishte kjo e vërtetë dhe sikur të ndihmonte sasia e vogël e verës në tretje, atëherë do të duhej të largohemi nga kjo sasi e vogël ngase sasia e vogël ndjell sasinë e madhe dhe gota e vogël, gotën e madhe, e kështu deri në dehje.

Në anën tjetër, Islami kishte qëndrim kategorik e të prerë ndaj alkoolit dhe ndaj çdo gjëje që shpie në konsumimin e tij.

Çdo pije dehëse është haram

Deklarata e parë e Pejgamberit a.s. nuk kishte të bëjë me materien nga e cila përfitohet vera, por për pasojat që i linte, gjegjësisht dehjen. Çdo gjë që dehë konsiderohet alkool, pa i marrë parasysh emrat e titujt e tij që i shpikin njerëzit dhe substancën që e prodhon. Në bazë të kësaj edhe birra e të ngjashmet me të janë të ndaluara.

Kur Pejgamberi a.s. është pyetur për fermentimin e pijeve nga mjalti, misri e elbi derisa të shndërrohen në pije alkoolike, shkurtimisht është përgjigjur: “*Çdo pije dehëse është “hamër” (alkool) dhe çdo “hamër” është haram.*”¹

Umeri r.a. është drejtuar para njerëzve nga minberi i Pejgamberit a.s. dhe ka thënë:

¹ Transmetim i Muslimit.

“Hamër konsiderohet çdo gjë që dehë mendjen.”¹

Ndalohet edhe pakica e asaj që dehë me shumicë

Islami ka qëndrim të prerë ndaj çdo pije dehëse, qoftë me pakicë ose shumicë, ngase njeriut mjafton t’i lejohet të rrëshqasë vetëm një këmbë në këtë rrugë, pastaj ai vazhdon edhe me hapa të tjerë, njëherë fillon me hapa të ngadalshëm e pastaj me të shpejtë dhe kështu nuk ndalet në asnjë shkallë. Për këtë, Pejgamberi a.s. thotë:

“*Ndalohet edhe pakica e asaj që dehë me shumicë,*”² ose në një hadith tjetër:

“*Çka të dehë me kovë, edhe një grusht prej saj është i ndaluar.*”³

Tregtia me alkool

Pejgamberi nuk ka ndaluar vetëm konsumimin e alkoolit me shumicë apo me pakicë, por e ka ndaluar edhe tregtinë me të, qoftë edhe me jomuslimanin. Muslimanit nuk i lejohet importimi ose eksportimi i alkoolit, ose të jetë pronar i shitores me alkool, apo të punojë në shitoren e tillë.

Për këtë çështje Pejgamberi a.s. i ka mallkuar dhjetë persona: “prodhuesin, kërkuesin për prodhimin e alkoolit, konsumuesin, bartësin,

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

³ Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

shitësin, shfrytëzuesin e fitimit prej tij, blerësin dhe atë për të cilin është blerë.”¹

Kur u shpall ajeti i lartpërmendur në suren “*Mâide*”, Pejgamberi a.s. tha:

“Zoti e ka ndaluar alkoolin me këtë ajet, pra nëse ndokush prej jush ka diçka prej tij, le të mos e pijë dhe të mos e shesë”.

Transmetuesi i hadithit rrëfen se njerëzit i janë përgjigjur pozitivisht dhe e kanë derdhur nëpër rrugët e Medines.²

Duke u mbështetur në parimin e Islamit për mbrojtjen nga harami me anë të masave preventive, muslimanit nuk i lejohet t’ia shesë rrushin atij që e di se do ta shndërrojë në alkool. Në një hadith thuhet:

*“Ai që e rezervon rrushin në kohën e vjeljes për t’ia shitur ndonjë hebreu, ndonjë të krishteri ose dikujt tjetër që do ta përdorë për alkool, do të hyjë syçelë në zjarr.”*³

¹ Transmetim i Ibën Maxhes.

² Transmetim i Muslimit.

³ Transmetim i Taberaniut në *El-Evsat*. Hafidhi e konsideron si hadith “hasen” në *Bulugul-meram*.

Muslimani nuk e jep dhuratë alkoolin

Meqë shitja dhe shfrytëzimi i fitimit nga alkooli janë të ndaluara për muslimanin, atëherë dhënia e tij si dhuratë ndonjë hebreu, të krishteri ose ndonjë tjetri konsiderohet haram. Muslimani nuk duhet të lejojë që ndonjë dhuratë e tillë të dalë prej tij e as atij t'i dhurohet, ngase muslimani është i mirë, dhuron vetëm të mirën dhe e pranon vetëm të mirën.

Transmetohet se një njeri ka dëshiruar t'i dhurojë Pejgamberit a.s. një fuçi me verë, por Pejgamberi e ka informuar se Zoti e ka ndaluar atë. Në atë rast i ka thënë:

“E as ta shes?” Pejgamberi i është përgjigjur: *“Ai që ka ndaluar pirjen e saj, ka ndaluar edhe shitjen e saj”*. Pastaj njeriu i ka thënë: “E as të mos ia dhuroj ndonjë hebreu?” Pejgamberi a.s. i është përgjigjur: *“Ai që e ka ndaluar atë, ka ndaluar edhe t'u jepet si dhuratë hebreujve.”* Në atë rast ai e ka pyetur: “Atëherë, ç'të bëj me të?” Pejgamberi a.s. i është përgjigjur: *“Derdhe në tokë!”*¹

Largimi nga ndejet ku pihet alkooli

Sipas kësaj, muslimani urdhërohet që të largohet nga ndejet ku konsumohet alkooli. Umeri r.a. transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë.

¹ Transmetim i Hamîdît në Musnedin e tij.

“Ai që beson në Zotin dhe në Ditën e Ahiretit, të mos ulet në tavolinën ku konsumohet alkooli.”¹

Muslimani urdhërohet që ta ndalojë të keqen kur e sheh, e nëse nuk mund ta ndalojë, atëherë le të largohet vetë ai.

Transmetohet se halifi i drejtë Umer Ibn Abdulazizi, i ka rrahur me kamxhik konsumuesit e alkoolit dhe ata që ishin ulur në tavolinën e tyre, edhe pse nuk e konsumonin.

Transmetohet se një grup është paditur tek ai për konsumimin e alkoolit, dhe ai ka urdhëruar që të rrahen me kamxhik, por në atë rast i është thënë: “Në mesin e tyre është edhe filani i cili agjëron” e ai ka reaguar dhe ka thënë: “Prej tij filloni, a nuk e keni dëgjuar fjalën e Zotit të Madhëruar.”

“Juve u është shpallur në librin (Kur’anin) që kur të dëgjoni se po mohohet Kur’ani i All-llahut dhe po bëhet tallje me të, të mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. All-llahu do t’i tubojë tradhtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehennem.” (Nisâ, 140)

Alkooli është sëmurje e jo shërim

Të gjitha këto tekste në mënyrë të qartë vërtetojnë se Islami kategorikisht e lufton alkoolin dhe e largon muslimanin prej tij. Ai ka vënë barriera ndërmjet muslimanit e alkoolit pa lënë kurrfarë shtegu të ngushtë apo të gjerë për ta lejuar përdorimin e tij.

Muslimanit nuk i lejohet aspak ta pijë, ta shesë, ta blejë, ta dhurojë, ta prodhojë, ta fusë në shitoren apo në shtëpinë e vet, ta shtrojë në solemnitetet e në rastet tjera që festohen me alkool, t’ia ofrojë musafirrit jomusliman, e as ta përdorë në ndonjë ushqim ose pije.

Disa njerëz mund të pyesin edhe për një aspekt tjetër, gjegjësisht për përdorimin e alkoolit si barë shërimi. Për këtë aspekt, cekim hadithin e Pejgamberit, i cili njëherë ia ka ndaluar një njeriu alkoolin por ai i është përgjigjur se e prodhon për shërim,

¹ Transmetim i Ahmedit. Edhe Tirmidhiu transmeton diçka të ngjashme me këtë.

e Pejgamberi në atë çast i ka thënë: *“Ai nuk është shërim por sëmurje.”*¹

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Zoti e ka zbritur sëmurjen dhe shërimin, dhe për çdo sëmurje ka edhe bar. Pra, shërohuni, por jo me haram!”*²

Kur flet Ibn Mes’udi r.a. për pijet dehëse, thotë:

*“Zoti nuk e ka caktuar shërimin tuaj nga ajo që e ka ndaluar.”*³

Nuk është çudi pse Islami e ndalon shërimin me alkool dhe me ndalesat tjera, ngase, sipas Ibn Kajjimit,⁴ harami nënkupton largimin prej tij në të gjitha mënyrat, e nëse përdoret si shërues, atëherë nxit kureshtjen për ta përdorur e kjo formë kundërshton edhe qëllimin e Ligdhënësit.

Ibn Kajjimi gjithashtu thotë se lejimi i përdorimit të alkoolit për shërim, posaçërisht në qoftë se shpirtrat anojnë nga ai, atëherë ekziston mundësia që të përdoret edhe për kënaqësi e dëfrim, veçanërisht nëse njerëzit e dinë se është i dobishëm dhe se ka efekt shërimi.

Ai gjithashtu thotë se medikamenti i ndaluar shton bindjen në efektin shërues të tij. Ibn Kajjimi vë në pah një aspekt psikik të rëndësishëm dhe thotë: “Kushti i shërimit me medikament është pranimi i medikamentit, bindja në dobinë e tij dhe në atë që Zoti e ka bërë shërues. Bindja e muslimanit ndalon (përdorimin e të ndaluarës si medikament, qëndrimin pozitiv ndaj tij dhe pranimin e tij, bile sa më i fortë të jetë imani i robit (njeriut), aq më i urrejtur është

¹ Transmetim i Muslimit, Ahmedit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

² Transmetim i Ebu Davudit.

³ Transmetim i Buhariut.

⁴ Shiko *Zadul-Me’âd*, 3/115-116.

(medikamenti) i ndaluar dhe më i refuzuar. Nëse e pranon në këtë gjendje, atëherë (alkooli) konsiderohet sëmurje e jo shërim”.¹

Sheriati gjithashtu trajton edhe rastin e nevojës së obligueshme, eventualisht nëse mendohet se alkooli apo diçka e ngjashme me të mund të jetë shërim për ndonjërin, jeta e të cilit është e rrezikuar dhe s’ka medikament tjetër, (nuk besoj se mund të ndodhë diç e tillë), atëherë dispozitat e Sheriatit që kanë për qëllim lehtësimin dhe mënjanimin e vështirësisë, e lejojnë por me kusht që ta propozojë mjeku musliman që është specialist dhe i devotshëm, si dhe të jetë përdorimi vetëm aq sa duhet.

“E kush detyrohet (t’i hajë këto të ndaluara), por duke mos pasur për qëllim shijen dhe duke mos e tepruar; Zoti yt është që falë e mëshiron shumë.” (El-En’âm, 145)

Narkotikët (droga)

(Dehëse nënkupton atë që dehë mendjen). Këto ishin fjalët e Umer Ibn Hattabit nga minberi i Pejgamberit a.s., kur u orvat ta definojë alkoolin, me qëllim që të mos ketë shumë pyetës e as dyshime në ata që dyshojnë. Çdo gjë që e mbulon mendjen dhe e nxjerr nga natyra karakteristike perceptuese e gjykuese quhet “hamër” (verë) dhe konsiderohet haram nga Zoti e Pejgamberi i Tij deri në Ditën e Kijametit.

Dihet se narkotikët si hashashi, kokaina, opiumi etj., ndikojnë në mendjen e atyre që i përdorin, gjegjësisht në gjykimin e gjërave dhe ngjarjeve, dhe kështu, të largëtën e shohin të afërt, ndërsa të afërtën të largët, kanë halucinacione e iluzione dhe zhyten në botën e ëndrrave e fantazive. Ata e bëjnë këtë me qëllim që të largohen nga vetvetja, nga feja e tyre, nga bota e tyre dhe të jetojnë në botën e imagjinatës.

Përveç kësaj, narkotikët ndikojnë në trup, në mpirjen e nervave, në shkatërrimin e shëndetit, e posaçërisht ndikojnë në dobësimin psikik, në shkatërrimin e moralit, në dobësimin e vullnetit dhe në zhdukjen e përgjegjësisë, dhe kështu konsumuesit e helmeve të këntilla shndërrohen në anëtarë të pavlefshëm të shoqërisë.

¹ Po aty.

Përveç kësaj, narkotikët ndikojnë në humbjen e pasurisë dhe shkatërrimin e shtëpive ngase konsumuesit e tyre harxhojnë shumë të holla, shpeshherë harxhojnë kafshatën e vetme të fëmijëve të tyre, bile devijojnë dhe nëpërmjet rrugëve jo të ndershme sigurojnë mjete për të.

Nëse e theksojmë rregullën: “Të këqijat dhe dëmet shkaktojnë ndalimin (haramin)”, atëherë do të vërejmë se këto të këqija ndalohen për shkak të dëmtimeve shëndetësore, psikike, morale, shoqërore e ekonomike.

Të gjithë fukahatë muslimanë kanë patur qëndrim unanim kundër të këqijave që përhapeshin në kohën e tyre, e në ballë qëndron Shejh-ul-Islami Ibn Tejmije, i cili thotë: “Ky hashash i dukshëm është i ndaluar, qoftë dehës apo jo... Të këqijtë e përdorin për shkak se në të gjejnë shashtisje e kënaqësi dhe i ngjanë alkoolit dehës. Alkooli nxiste urrejtje e armiqësi kurse ky nxit turbullirë e letargji; bile edhe më tepër, konsumimi i tij shkatërron temperamentin dhe mendjen, hapë derën e epsheve dhe zhduk turpin. E keqja e tij është më e rrezikshme se konsumimi i pijeve dehëse (alkoolit). Njerëzit filluan ta përdorin (hashashin) pas ardhjes së tatarëve. Ndëshkimi për përdorimin e tij përmbanë 40 ose 80 shkopinj.

Ai që e konsumon hashashin krahasohet me atë që e konsumon alkoolin, bile edhe më keq, dhe që të dy kanë ndëshkim të njëjtë.”

Rregulla e Sheriatit konstaton: “Ndëshkohet çdo përdorim i të ndaluarave, si ato që t’i do shpirti, p.sh. kurvëria e alkooli, ndërsa ato që s’i do shpirti, si cofëtirat, ekziston dënimi i paraparë me ligj. Ndërsa hashashi është ndër ato pije që e do shpirti dhe me vështirësi braktiset. Burimet e Kur’anit dhe hadithit për ndalimin e gjërave të tjera (të verës), vlejnë edhe për këtë.”¹

Ngrënia dhe pirja e dëmshme konsiderohet haram

Këtu ekziston një rregull i përgjithshëm i Sheriatit islam, i cili ndalon që muslimani të hajë apo të pijë diçka që e mbytë në mënyrë të shpejtë apo ngadalë (si p.sh. helmi i të gjitha llojeve), ose që e dëmton. Gjithashtu nuk i lejohet të hajë shumë ose të pijë diçka që ndikon në sëmurjen e shumicës. Muslimani nuk e posedon vetëm veten, por posedon fenë dhe shoqërinë e vet. Jeta, shëndeti dhe

¹ Ibën Tejmije, *Fetavâ*, vëll. IV, f. 262.

pasuria e tij janë dhunti nga Zoti, dhe për këtë atij nuk i lejohet t'i shkatërrojë. Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos e mbytni veten tuaj; Zoti është shumë i mëshirshëm ndaj jush!” (Nisâ, 29)

“Mos shkatërroni veten tuaj me duart tuaja!” (El-Bekare, 195)

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Mos e dëmto veten e as të tjerët!”*¹

Në bazë të këtij parimi, themi se përdorimi i duhanit, meqë është vërtetuar se dëmton, është haram posaçërisht në qoftë se mjeku specialist porositë dikë për këtë çështje.

Në qoftë se nuk ndikon në shëndet, ndikon në pasuri, ngase nuk harxhohet në dobi të fesë ose të kësaj bote.

Pejgamberi a.s. ka ndaluar humbjen e pasurisë.²

Gjithashtu duhani ndalohet nëse vërtetohet se vetë duhanxhiu dhe familja e tij kanë nevojë për të holla.

¹ Transmetim i Ahmedit dhe Ibën Maxhes.

² Transmetim i Buhariut.

VESHMBATHJA DHE ZBUKURIMI

Islami e urdhëron muslimanin që të ketë pamje të bukur, veshje të bukur dhe të jetë dinjitoz, si dhe të kënaqet me zbukurimet, veshjen dhe mbathjen që i ka krijuar Zoti për të.

Sipas Islamit, veshmbathja nënkupton dy gjëra: të mbulohet trupi dhe të zbukurohet. Kështu, Zoti ua ka mundësuar njerëzve këto begati duke u thënë:

“O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk që ua mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues.” (El-A'râf, 26)

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos e teproni sepse All-llahu nuk i do ata që e teprojnë.” (El-A'râf, 31)

Islami na obligon t'i mbulojmë vendet të cilat në mënyrë të natyrshme janë të turpshme, për t'u dalluar nga kafsha lakuriqe. Ai e fton njeriun të mbulohet edhe në qoftë se jeton i vetmuar larg shoqërisë me qëllim që ta mbrojmë përkryerjen në moral enë fe.

Nga Behz Ibn Hakimi, nga i ati i tij dhe nga gjyshi i tij transmetohet se i ka thënë Pejgamberit a.s.:

O i dërguari i Zotit, çka mund të fshehim e çka mund të tregojmë prej pjesëve tona?” Ai është përgjigjur: “*Ruaje aurretin tënd prej të*

gjithëve, e nga këto përjashtohet bashkëshortja dhe robëresha.” Pastaj përsëri e ka pyetur: “Ç’duhet bërë nëse njerëzit jetojnë bashkërisht (p.sh. në udhëtim ose në kampim)? Atëherë ai i përgjigjet. “*Mundohu që sipas mundësive të mos t’i shohin të tjerët!*” Përsëri e ka pyetur: “Por në qoftë se s’ka asnjë njeri?” Pejgamberi i është përgjigjur: “*Më së tepërmi (njeriu) duhet të turpërohet prej Zotit të Madhëruar.*”¹

Feja e pastërtisë dhe e bukurisë

Para se të përqëndrohej Islami në zbukurimin e në pamjen e jashtme, më së tepërmi tregoi interesim ndaj pastërtisë, ngase ajo është esenca e çdo zbukurimi e pamjeje të jashtme të bukur.

Pejgamberi a.s.thotë:

*“Pastrohuni sepse Islami është i pastër.”*²

(Në një hadith tjetër thotë):

*“Pastërtia shpie drejt besimit ndërsa besimi me pronarin e vet (hyjnë) në xhennet.”*³

Pejgamberi a.s. urdhëron pastrimin e rrobave, të trupit, të shtëpisë, të rrugëve, veçanërisht rekomandon pastrimin e dhëmbëve, të duarve e të kokës.

Kjo nuk duhet të na habis ngase kemi të bëjmë me një fe që e trajton pastërtinë si çelës për hyrje në namaz. Nuk pranohet namazi i muslimanit që nuk ka trup, veshje e vend të pastër.

Përveç këtyre llojeve të pastërtisë, Islami kërkon edhe pastërtinë që njihet me emrin gusul e abdest.

Meqë mjedisi arab ka qenë beduin dhe shkretinor, atëherë ka mund të ndodhë që shumica e tyre ta lënë pasdore pastrimin dhe zbukurimin, mirëpo Pejgamberi a.s. gjithmonë i ka udhëzuar dhe i

¹ Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit, Tirmidhiut, Ibën Maxhes, Hakemit, Bejhakiut etj.

² Transmetim i Ibën Habbanit

³ Transmetim i Taberaniut.

ka këshilluar në mënyrë të urtë e të përpiktë gjersa i ka ngritur nga jeta beduine në qytetërim, dhe ua ka mësuar virtytet e qytetërimit. Kur ka ardhur një njeri me kokë e mjekër të pluhurosur te Pejgamberi a.s., Pejgamberi e ka urdhëruar që të pastrohet e pastaj të kthehet. Në atë rast, Pejgamberi a.s. ka thënë:

“A s’është kështu më bukur se të vijë ndonjëri prej jush me kokë të pluhurosur sikur djalli?! ”¹

Kur e ka parë Pejgamberi një njeri me flokë të pakrehura, ka thënë:
“A s’ka ky me çka t’i krehë flokët?”

Kur e ka parë një tjetër me rroba të zhytura, ka thënë:

“A s’ka ky me çka t’i lajë rrobat?”²

Kur i ka ardhur Pejgamberit një njeri me rroba të përlyera, i ka thënë: *“A ke pasuri?”* Kur i është përgjigjur se ka, atëherë e ka pyetur se çfarë pasurie ka, ndërsa aii është përgjigjur se Zoti ia ka dhënë të gjitha llojet e pasurisë. Në këtë rast, Pejgamberi a.s. i ka

thënë: *“Meqë të ka dhuruar Zoti pasuri atëherë le të shihen begatia dhe fisnikëria e Zotit në (trupin) tënd!”³*

¹ Transmetim i Malikit në *El-Muvat’u*.

² Transmetim i Ebu Davudit.

³ Transmetim i Nesaiut.

Ai e ka urdhëruar pastrimin dhe zbulurimin në vendtubime, si p.sh në Ditën e xhumasë dhe në kohën e dy bajrameve. Në këtë kontekst, ai thotë:

“Jeni të obliguar që (sipas mundësisë) të vishni tesha tjera përveç atyre të punës në Ditën e xhumasë.”¹

Ari dhe mëndafshi ndalohen për burra

Islami e lejon dhe e rekomandon zbulurimin dhe e refuzon ndalimin e tij.

Thuaj: “Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet?” (El-A'râf, 32).

Mirëpo vërejmë se burrave ua ndaloi dy lloje të veshjes kurse grave

jo.

1. Ornamentet prej ari dhe

2. Veshjen e rrobave të mëndafshita.

Aliu r.a. transmeton se Pejgamberi a.s. e ka marrë mëndafshin me dorën e djathtë dhe arin në dorën e majtë dhe ka thënë: *“Këto janë të ndaluara për meshkujt e ummetit tim.”²*

Umeri transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *“Mos e veshni mëndafshin ngase ai që e veshë në këtë botë, nuk do ta veshë në botën tjetër.”³*

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit, Nesaiut, Ibën Habbanit dhe Ibën Maxhes. Ibën Maxhe i shton edhe fjalët: *“U lejohet grave të tyre!”*

³ Transmetim i Buhariut dhe Muslimit nga Enesi.

Në një rast tjetër ka parë tesha prej mëndafshi dhe ka thënë:

*“Kjo veshje është për atë që s’ka karakter.”*¹

Kur e ka parë unazën e arit në gishtin e një njeriu, ia ka nxjerrur, ia ka gjuajtur dhe i ka thënë:

“A e merr ndokush gacën prej zjarri dhe e vë në dorën e vet?”

Pas shkuarjes së Pejgamberit, i është thënë njeriut: “Merre unazën tënde dhe shfrytëzoje atë!”, mirëpo ka reaguar duke thënë. “Pasha Zotin jo, nuk e marr pasi e hodhi Pejgamberi a.s.”²

E njëjta gjë vlenë edhe për ata që zbukurohen me lapsa prej ari, orë prej ari, shkrepsë prej ari, kuti cigaresh prej ari etj...

Pejgamberi a.s. e ka lejuar unazën prej argjendi.

Buhariu transmeton se Ibn Umeri ka thënë: “Pejgamberi a.s. ka patur unazë prej argjendi, pas tij e ka mbajtur Ebu Bekri, pastaj Umeri e (më në fund) në dorën e Uthmanit derisa ka rënë në pusin Eris.”³

Nuk ka tekst të qartë që i ndalon metalet tjera si p.sh. hekurin, por përkundrazi, gjejmë në *Sahihun* e Buhariut se Pejgamberi a.s. e ka këshilluar një njeri që dëshironte të martohej, duke i thënë:

¹ Transmetim i Buhariut dhe Muslimit.

² Transmetim i Muslimit.

³ Transmetim i Buhariut.

“Dhuroi asaj një dhuratë, qoftë edhe një unazë prej hekuri.” Këtë hadith e mbështet Buhariu dhe e lejon unazën prej hekuri.

Veshja e mëndafshit lejohet vetëm në rast të nevojës shëndetësore. Pejgamberi a.s. ua ka lejuar Abdurrahman Ibn Avfit dhe Zubejr Ibn Avvomit ngase kanë qenë të sëmurë prej zgjebes.⁴

Urtësia e ndalimit për meshkujt

Qëllimi i Islamit për ndalimin e këtyre dy gjërave ka karakter edukativ, moral e fisnik, ngase Islami është fe e xhihadit dhe fuqisë, për këtë shkak dëshiron ta mbrojë burrërinë e njeriut nga format e dobësimit, pasivizimit e devijimit.

Zoti e dallon konstruktin trupor të mashkullit nga ai i femrës, andaj atij nuk i takon të veshet si ajo.

Gjithashtu ekziston edhe qëllimi shoqëror. Ndalimi i arit dhe i mëndafshit është pjesë e programit të Islamit për luftimin e luksit, ngase, sipas Kur’anit, luksi ka qenë faktor i shkatërrimit të popujve dhe i padrejtësisë shoqërore sepse pakica pasurohet në kurriz të shumicës së mjeruar.

Në këtë kontekst, Kur’ani famëlart thotë:

“Kur duam të shkatërrojmë ndonjë vend (popull), i urdhërojmë pasanikët (përinë) e atjeshëm (të jenë në rrugë) e ata kundërshtojnë; atëherë zbatohet dënimi i merituar kundër tyre dhe i shkatërrojmë krejtësisht.” (Isrâ, 16)

“Ne nuk dërguam në asnjë vend ndonjë nga pejgamberët e që pasanikët e tij të mos i thonin: “Ne nuk i besojmë asaj me çka jeni dërguar.” (Sebe’ë, 34)

Duke e praktikuar frymën e Kur’anit, Pejgamberi a.s. ndaloi të gjitha dukuritë luksoze në jetën e muslimanit; ashtu siç ndaloi arin e mëndafshin për burrat po ashtu ndaloi përdorimin e enëve nga ari e argjendi për burrat dhe gratë.

Përveç kësaj, këtu ekziston edhe faktori ekonomik që është me peshë. Ari konsiderohet si bazë e nderimit në mediumet ndërkombëtare, dhe për këtë shkak s’duhet të përdoret në gjësendet siç janë enët shtëpiake apo ornamentet për burra.

⁴ Transmetim i Buhariut.

Urtësia e lejimit për femra

Islami i përjashton gratë nga këto dy ndalime ngase e nderon gruan, natyrën e saj femërore dhe dashurinë e saj të natyrshme ndaj zbukurimit, por me kusht që zbukurimi i saj të mos i provokojë meshkujt, respektivisht epshet e tyre. Në një hadith thuhet:

*“Çdo grua që parfumoset dhe kalon afër burrave tjerë për ta ndier erën e saj, konsiderohet lavire; dhe çdokush që e shikon atë, konsiderohet pusht.”*¹

Zoti i Madhëruar ua tërheq vërejtjen grave e thotë:

“Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre.” (Nûr, 31)

Veshja e femrës muslimane

Islami ndalon femrën që të veshë tesha të cilat janë të tejdukshme për trupin dhe për pjesët e posaçme trupore, posaçërisht për pjesët vitale, si p.sh. gjoksi, beli etj.

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: صِنْفَانِ مِنَ أَهْلِ النَّارِ لَمْ أَرَهُمَا:
قَوْمٌ مَعَهُمْ سِيَاطٌ كَأَذْنَابِ الْبَقَرِ يَضْرِبُونَ بِهَا
النَّاسَ (إِشَارَةً إِلَى الْحُكَّامِ الظَّالِمَةِ أَعْدَاءِ الشُّعُوبِ)،
وَنِسَاءٌ كَاسِيَاتٌ عَارِيَاتٌ مُمِيلَاتٌ مَائِلَاتٌ رُؤُوسُهُنَّ
كَأَسْنِمَةِ الْبُخْتِ الْمَائِلَةِ، لَا يَدْخُلْنَ الْجَنَّةَ،
وَلَا يَجِدْنَ رِيحَهَا، وَإِنْ رِيحَهَا لَيُوجَدُ
مِنْ مَسِيرَةٍ كَذَا وَكَذَا.

Në *Sahih* transmetohet nga Ebu Hurejra që rrëfen se:

¹ Transmetim i Nesaiut; Ibën Hazime dhe Ibën Habbani e transmetojnë në dy sahihet e tyre.

Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Nuk shoh (nuk do të jem dëshmitar) për dy grupe njerëzish që janë të caktuar për në zjarr: një grup me kamxhik (të trashë) si bishtat e lopëve, me të cilin i rrahin njerëzit (aludon në qeveritarët tiranë e armiqtë e popullit) dhe një grup grash të veshura por të zhveshura, joshin e joshen dhe me flokë si gunga e pjerrët e deveve. Këto grupe nuk hyjnë në xhennet dhe nuk e shijojnë erën e tij edhe pse era e tij depërton në largësi të mëdha.”*¹

Gratë e tilla janë të veshura por në të njëjtën kohë janë lakurique ngase teshat e tyre janë të tejdukshme e të holla dhe zbulojnë çdo gjë që është nën to, ashtu siç janë teshat e shumicës së grave të kësaj kohe. Kokat e tyre krahasohen me gungat e pjerrëta të deveve për shkak të fryerjes së flokëve, dhe si duket, Pejgamberi e ka parapare këtë kohë, në të cilën hapen sallone ondulimi ku më së shumti punojnë meshkujt dhe marrin para të majme. Përveç kësaj, gratë nuk kënaqen me flokët natyrore që ua ka dhuruar Zoti, por blejnë flokë artificiale me qëllim që të duken më të këndshme e më të bukura, më tërheqëse e më atraktive. Është për t'u habitur se ky hadith ndërlihdh tiraninë politike me devijimin moral, gjë që është realitet ngase tiranët i preokupojnë popujt me atë që nxitë epshet e tyre dhe i dëfrejnë njerëzit me kënaqësi individuale, me qëllim që t'i largojnë nga përcjellja e çështjeve të përgjithshme.

Imitimi i ndërsjellë midis burrave e grave në veshje

Pejgamberi a.s. ka deklaruar se i ndalohet femrës t'i veshë rrobat e burrit dhe anasjelltas.² Ai i ka mallkuar burrat që u ngjajnë grave dhe gratë që u ngjajnë burrave.³ Imitimi këtu nënkupton ngjashmërinë në fjalë, në lëvizje, në ecje, në veshje etj.

Fatkeqësia më e madhe në jetë e në shoqëri është largimi nga krijimi natyror, ngase në natyrë ka meshkuj e femra që kanë karakteristika të posaçme. Në qoftë se burri e imiton gruan e gruaja burrin, atëherë shkaktohet devijim dhe tronditje.

Pejgamberi tregon se melaqet e mallkojnë dhe është i mallkuar në këtë e në botën tjetër, ai që Zoti e ka krijuar mashkull por feminizo-

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Ebu Davudit, Nesaiut, Ibën Maxhes, Ibën Habbanit në Sahihun e tij dhe Hakimit.

³ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

het dhe i imiton gratë, si dhe atë që e ka krijuar femër por mashku-llizohet dhe i imiton burrat.¹

Për këtë shkak Pejgamberi ua ka ndaluar burrave të veshin teshat e turpshme. Në *Sahihun* e Muslimit, Aliu r.a. thotë:

“Pejgamberi i Zotit më ka ndaluar të vë unazë prej ari, të veshë tesha prej mëndafshi... e të turpshme.”

Gjithashtu transmetohen se Ibn Amri ka thënë:

“Pejgamberi a.s. i ka parë Umerit dy palë rroba të turpshme dhe i ka thënë: “Këto janë rroba të pabesimtarëve, pra, mos i vish!”

Veshja për ekspozim dhe mburrje

Parimi i përgjithshëm për kënaqësinë me të mirat në ushqim, pije e veshje është ky: “Të mos ketë harxhim të tepruar dhe ekspozim.”

Teprimi nënkupton kapërcimin e kufirit në të kënaqurit me të lejuarën (hallallin) kurse ekspozimi ka të bëjë shumë me qëllimin sesa me gjërat e dukshme, sepse këtu nënkuptohet lavdërimi, krenaria dhe ekspozimi para njerëzve:

“All-llahu nuk e do asnjë arrogant që u lëvdërohet të tjerëve.” (Hadîd, 23)

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Ai që vishet me qëllim ekspozimi, Zoti nuk do t’ia hedhë sytë Ditën e Kijametit”.*²

Që të largohet muslimani nga dyshimi i ekspozimit, Pejgamberi a.s. i ka ndaluar teshat e “famës”, të cilat nxisin krenarinë, mburrjen dhe lavdërimin midis njerëzve me forma të jashtme e të zbrazëta. Në një hadith, Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Taberanit.

² Transmetim Unanim.

مَنْ لَبَسَ ثَوْبَ شُهْرَةِ الْبَسَةِ اللَّهُ ثَوْبَ مَذَلَّةٍ
يَوْمَ الْقِيَامَةِ.

“Kush i veshë teshat “e famës”, Zoti do t’ia veshë teshat e nënçmimit Ditën e Kijametit.”¹

وَقَدْ سَأَلَ رَجُلٌ ابْنَ عُمَرَ: مَاذَا أَلْبَسُ مِنَ الثِّيَابِ؟ فَقَالَ:
مَا لَا يَزِدُّ رِيكَ فِيهِ السُّفَهَاءُ – يَعْنِي لِتَفَاهَتِهِ
وَسُوءِ مَنْظَرِهِ – وَلَا يَعْيِبُكَ بِهِ الْحُكَمَاءُ –
يَعْنِي لِتَجَاوُزِهِ حَدَّ الْإِعْتِدَالِ.

Një njeri e ka pyetur Ibn Umerin çfarë të veshë e ai i është përgjigjur: “Atë që nuk i nxitë mendjelehtët dhe për të cilat nuk të turpërojnë të mençurit.”²

Zbukurimi ekstrem nëpërmjet ndryshimit të konstruktit krijues të Zotit

Islami refuzon zbukurimin që e kapërcen kufirin dhe ndryshon krijesën e Zotit e që Kur’ani e konsideron si inspirim të djallit, i cili për ithtarët e vet thotë:

“Do t’i urdhëroj dhe ata do t’i shëmtojnë krijesat e Zotit.” (Nisâ, 119)

Ndalimi i tatuazhit, prerjes së dhëmbëve dhe i operacioneve për zbukurim

Në mesin e çështjeve të ndaluara bëjnë pjesë edhe tatuazhi i trupit dhe prerja e dhëmbëve.

¹ Transmetim i Ebu Davudit, Nesaiut, Ibën Maxhes.

² Transmetim i Taberaniut.

Pejgamberi a.s. e ka mallkuar atë që bën tatuazh dhe njeriun të cilit i bëhet si dhe prerësin e dhëmbëve dhe atë që i prehen.¹

Tatuazhi deformon fytyrën dhe duart me ngjyrën e kaltër dhe vizatimet repulsive. Disa arabë, veçanërisht gratë, e kanë tepruar aq tepër saqë kanë bërë tatuazh nëpër tërë trupin, ndërsa disa sekte i vizatonin në trupat e tyre objektet e tyre të adhuruara dhe simbolet fetare. Gjithashtu vërejmë se të krishterët e vizatojnë kryqin në duart dhe në gjokset e tyre. Përveç kësaj, mund t'i shtojmë edhe dhembjet e vuajtjet që i përjeton trupi nga gjilpëra. E gjithë kjo shkakton mallkimin e atij që bën tatuazh dhe atij që i bëhet tatuazhi. Prerja e dhëmbëve nënkupton shkurtimin e tyre.

Pejgamberi a.s. e ka mallkuar gruan që i pret dhe atë që kërkon t'i prehen. Nëse mashkulli kërkon një gjë të tillë, gjithashtu edhe ai mallkohet.

Po ashtu mallkohet edhe ajo që e zgjeron zbrazëtirën mes dhëmbëve ose kërkon një gjë të tillë. Disa gra i kanë të zgjeruara dhëmbët ashtu siç ua ka krijuar Zoti, mirëpo ato që s'i kanë dhëmbët e tilla, atëherë i mprehin dhëmbët e ngjitura me qëllim që artificialisht t'i ndajnë. Këtë mashtrim të njerëzve dhe teprim në zbukurim Islami e refuzon.

Me këto hadithe autentike gjithashtu kuptojmë vendimin fetar për atë që sot njihet me emrin "operacion zbukurimi", të cilin e ka inicuar qytetërimi i trupit dhe i epsheve (kam për qëllim qytetërimin perëndimor materialist bashkëkohor). Disa njerëz shpenzojnë sasi të mëdha të parave për ta ndryshuar formën e hundës, të gjinjve apo të tjera. E gjithë kjo përfshihet në sferën e mallkimit nga Zoti e Pejgamberi a.s. për shkak të dhembjes që ushtrohet mbi njeriun dhe ndryshimittë formës së krijuar nga ana e Zotit. Në këtë mënyrë bëhen harxhime të panevojshme por vetëm me qëllim që t'i kushtohet kujdes anës së dukshme (për formalitete), formës e jo esencës, trupit e jo shpirtit.

Në qoftë se njeriu ka ndonjë shenjë të posaçme e të turpshme (të metë fizike), që ndikon fizikisht e psikikisht në mesin e njerëzve

¹ Transmetim i Muslimit.

ose në një vend publik, atëherë nuk është keq ta shërojnë, ngase dëshiron ta evitojë këtë të metë që e përjeton. Zoti nuk e ngarkon përmes fesë me vështirësi!¹

Nga hadithi që i mallkon ato të cilat bëjnë zbrazëtira mes dhëmbëve për zbulurim, nënkuptohet se qortohet vetëm ajo që vepron kështu për hir të zbulurimit dhe bukurisë së rrejshme, e në qoftë se detyrohet të bëjë një gjë të tillë për të evituar dhimbjen ose dëmin, atëherë i lejohet. (Zoti është më i dituri).

Heqja e vetullave

Edhe një teprim tjetër zbulurimi, të cilin e ndalon Islami është “en-nemsi”, që nënkupton heqjen e vetullave për t’i holluar ose formësuar.

Pejgamberi a.s. e ka mallkuar holluesen e vetullave dhe atë që i hollon. Praktikimi i tillë ndalohet për shkak se është gjest i lavireve. Disa dijetarë hanbelistë lejojnë këputjeve e qimeve nga fytyra, përdorimin e podrës, kremave dhe gjërave tjera për zbulurimin e grave, por me lejen e burrit.

Imam Neveviu është më rigoroz dhe nuk lejon këputjen e qimeve por këtë punë e konsideron të ndaluar si “nemsi.”

Kundër kësaj mund të përdoret ajo që e thotë Ebu Davudi: “Namisë” konsiderohet ajo që i heq vetullat, dhe siç duket, këtu nuk bën pjesë shkulja e qimeve të fytyrës.

Taberiu transmeton se gruaja e Ebu Is-hakut ka shkuar te Aisheja dhe pasi që ishte e re dhe e admironte bukurinë, i ka thënë:

¹ *El-Mer’etu bejnel-bejti vel-muxhteme’i*, prof. Behi Huli, botimi i dytë, f. 105.

“Ç’ndodh nëse gruaja i këput qimet e fytyrës për ta kënaqur burrin e saj? Aisheja i ka thënë: “Hiqe të dëmshmen sipas mundësisë.”¹

Paruka

Ndalohet zbukurimi i femrës përmes vazhdimet të flokëve natyrale me flokë të tjera, qofshin ato natyrale apo artificiale. Ky zbukurim i gruas sot quhet “parukë”.

عَنْ عَائِشَةَ وَأُخْتِهَا أَسْمَاءَ وَابْنِ مَسْعُودٍ وَابْنِ عُمَرَ وَأَبِي
هُرَيْرَةَ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ لَعَنَ الْوَاصِلَةَ وَالْمُسْتَوْصِلَةَ
وَالْوَاصِلَةُ هِيَ الَّتِي تَقُومُ بِوَصْلِ الشَّعْرِ بِنَفْسِهَا أَوْ بِغَيْرِهَا،
وَالْمُسْتَوْصِلَةُ الَّتِي تَطْلُبُ ذَلِكَ.

Buhariu dhe të tjerët transmetojnë nga Aisheja dhe motra e saj Esma, nga Ibn Mes’udi, nga ibn Umeri dhe nga Ebu Hurejre se Pejgamberi a.s. e ka mallkuar atë që e vë parukën për vete ose për të tjerët dhe atë që kërkon një gjë të tillë.

Më së pari mashkulli bën pjesë në kategorinë e kësaj ndalese, qoftë ekspert i kësaj veprimtarie, si në sallonin e ondulimit, apo individ i cili kërkon që t’i vazhdohen-zgjaten flokët si “bitëllsat”.

Pejgamberi a.s. ishte rigoroz dhe e luftonte këtë formë zbukurimi, saqë nuk i lejonte të vërë flokë të huaja edhe asaj të cilës i kishin rënë flokët nga ndonjë sëmundje, qoftë kjo edhe nuse që përgatitej për t’u martuar.

Buhariu transmeton nga Aisheja se një guvernante prej ensarëve ishte martuar dhe pas martesës ishte sëmurë dhe i kishin rënë flokët. Kur kanë shprehur dëshirë që t’i ngjesin flokë tjera, e kanë pyetur Pejgamberin a.s., e ai është përgjigjur:

“Zoti e ka mallkuar atë që i ngjet dhe atë që kërkon t’i ngjiten.”²

¹ *Fet-hul-bârî*, komentim i Ibën Mes’udit në kapitullin *El-mutenemmisât*.

² Këto hadithe i transmeton Buhariu në Sahihun e vet.

Transmetohet se Esma ka thënë: “E ka pyetur një grua Pejgamberin a.s. dhe i ka thënë: “O i dërguari i Zotit, bija ime është sëmurë nga fruthi dhe i kanë rënë flokët. Meqë është e martuar, a t’ia shtoj (flokët me parukë)?” Pejgamberi a.s. i është përgjigjur: “*Zoti mallkon ngjitësen dhe atë që kërkon t’i ngjitet (paruka).*”¹

Transmetohet nga Seid Ibnul Musejjeb se ka thënë:

“Kur erdhi Muavija për herë të fundit në Medine, ligjëroi para nesh dhe nxori një bisht flokësh e tha: “Këtë e praktikonin vetëm hebrejtë, ndërsa Pejgamberi a.s. këtë e quante “falsifikim”, që nënkupton ngjitësen e flokëve artificiale”.

Sipas një transmetimit tjetër, ai u ka thënë medinasve:

“Ku janë dijetarët tuaj? Kam dëgjuar se Pejgamberi a.s. i ndalonte këto gjëra duke thënë: “*Fisi israelit është shkatërruar kur gratë e tyre filluan të veprojnë kështu*”.

Emërtimi i Pejgamberit a.s. të kësaj vepre me titullin “falsifikim”, i referohet urtësisë së ndalimit, ngase këtu ka një lloj mashtrimi e tri-

¹ Transmetim i Buhariut.

llimi. Islami urren mashtrimin dhe largohet prej mashtruesit në çdo gjë, qoftë mashtrim materialist apo moral.

*“Ai që na mashtron, s’është prej nesh.”*¹

Hitabiu referon se dënimet ndaj këtyre gjërave janë të mëdha ngase këtu ka mashtrim dhe sikur të lejohej ky mashtrim, atëherë do të duhej të lejoheshin edhe llojet tjera të mashtrimit me të cilat ndryshohet krijesa e Zotit. Në këtë gjë aludon hadithi i transmetuar nga Ibni Mes’udi në *“Ndryshimet e krijesës së Zotit.”*²

Nga hadithet nënkuptohet lidhja e flokëve me flokë, qofshin natyrore apo artificiale, dhe pikërisht kjo nënkuptohet me termet “falsifikim e mashtrim”. Në qoftë se shtohen flokët me diçka tjetër, si p.sh. me ndonjë copë lëkure apo me pe, atëherë kjo konsiderohet e lejuar. Në këtë kontekst, Seid Ibn Xhubejri transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“S’është keq nëse përdoret “tevamili”,³ që nënkupton fije prej mëndafshi apo leshi për të bërë bishta, me të cilat gruaja i zgjatë flokët. Këtë gjithashtu e lejon edhe Imam Ahmedi.⁴

Ngjyrosja e flokëve të thinjura

Në sferën e zbukurimit bën pjesë edhe ngjyrosja e flokëve të kokës apo e mjekrës. Transmetohet se hebrenjtë dhe të krishterët, që janë ithtarë të Librit, e ndalojnë ngjyrosjen dhe ndryshimin e flokëve duke menduar se një gjë e tillë kundërshton adhurimin dhe devotshmërinë. Kështu vepronin edhe murgjit dhe asketët ekstremistë fetarë.

Meqë Pejgamberi a.s. ndalon imitimin e të tjerëve dhe ndjekjen e rrugës së tyre, dhe për t’u dalluar përherë muslimanët me personalitetin e vet të pavarur në format e dukshme e të padukshme, në *Sahihun* e Buhariut, Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

¹ Transmetim i një grupi të sahabëve.

² *Fet-hul-bârî*.

³ Në *El-Fethu* thuhet: Transmetim i Ebu Davudit me sened.

⁴ *Fet-hul-bârî*.

“Hebrenjtë dhe të krishterët nuk i ngjyrosin flokët, pra, ju dallohuni prej tyre.” (d.m.th. ngjyrosni).

Nga sjelljet e sahabëve vërehet se kjo çështje rekomandohet, ngase disa i kanë ngjyrosur si Ebu Bekri e Umeri, kurse disa jo, si Aliu, Ubejje Ibn Ka’b, Enesi etj.¹

Me çka të ngjyrosen flokët, me ngjyrë të zezë ose me ngjyra tjera apo të mënjanohet ngjyra e zezë? Plakut të shtyer në moshë nuk i ka hije ta ngjyrosë kokën dhe mjekrën me ngjyrë të zezë.

Kur e solli Ebu Bekri babanë e vet Ebu Kuhafë para Pejgamberit a.s. në ditën e çlirimit të Mekkes, Pejgamberi a.s. e ka vërejtur kokën e tij (flokët e tij) të bardhë si bora dhe ka thënë:

*“T’ia ndërroni këtë ngjyrë por largohuni nga e zeza!”*²

Ai që nuk është në gjendjen dhe në moshën e Ebu Kuhafes, mund t’i ngjyrosë flokët me ngjyrë të zezë. Në këtë kontekst, Zuhriu thotë:

“E përdornim ngjyrën e zezë derisa ishim të rinj, mirëpo kur u plakëm, u larguam prej saj!”³

Një grup i sahabëve e lejonte ngjyrën e zezë, e prej tyre janë Sa’d Ibn Ebi Vekkasi, Ukbe Ibn Amir, Hasani, Husejni, Xheriri etj., ndërsa një grup tjetër nuk e lejonte përpos në rastin e xhihadit për ta frikësuar armikun nga ushtria e muslimanëve si dhe të duken më të rinj.⁴

Në hadithin e transmetuar nga Ebu Dherre thuhet:

*“Mënyra më e mirë për ta larguar ngjyrën e thinjur është përdorimi i “henna-s” dhe “ketmit”. (Ketmi është bimë jemenase e cila përmban ngjyrë të zezë në të kuqe, ndërsa henna përmban ngjyrë të kuqe.)”*⁵

¹ *Fet-hul-bârî.*

² Transmetim i Muslimit.

³ Transmetim i Ibën Ebi Asimit në librin *El-hudâb.*

⁴ Kjo theksohet në *El-Fethu.*

⁵ Transmetim i Tirmidhiut dhe i të gjithë autorëve të suneneve.

Sipas hadithit të Enesit,
Ebu Bekri ngjyrosej me “henna dhe ketëm” kurse Umeri gjithmonë
me henna (kanë).

Rritja e mjekrës

Këtu do ta shqyrtojmë edhe tematikën e rritjes së mjekrës. Buhariu transmeton nga Ibn Umeri se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Dallohuni prej idhujtarëve, rritni mjekrën dhe shkurtoni mustaqet!” Sipas një transmetimi tjetër thuhet që ta lënë e ta rrisin. Nga vetë hadithi kuptohet se shkaku i rritjes së mjekrës është dallimi nga idhujtarët, gjegjësisht nga zjarrputistët, të cilët e shkurtonin apo e rruanin mjekrën.

Pejgamberi a.s. ka urdhëruar të dallohen prej tyre me qëllim që muslimanët të formojnë personalitetin e vet të pavarur, të dallohen psikikisht e fizikisht në aspektin e dukshëm dhe të padukshëm. Përveç kësaj, rruarja e mjekrës është kundër natyrës së mashkullit dhe orvatje për t’i imituar gratë. Pra, mjekra konsiderohet pjesë e burrërisë dhe karakteristikë e tij e posaçme.

Rritja e mjekrës nuk nënkupton që të mos shkurtohet fare, ngase në këtë mënyrë ajo shumë do të zgjatej saqë do ta pengonte vetë pronarin e saj. Përkundrazi, ajo duhet të shkurtohet për së gjati e për së gjeri, ashtu siç transmetohet nga Tirmidhiu dhe ashtu siç vepronte selefi. Ajjâdi thotë: “Urrehet rruarja e mjekrës, mirëpo lejohet shkurtimi në rastin e zgjatjes së saj.”

Ebu Shameja thotë: “Një popull i rruanin mjekrat, e ndër më të njohurit ishin mexhusët (zjarrputistët).”¹

Them se pjesa më e madhe e muslimanëve tash e rruajnë mjekrën duke i imituar armiqtë e fesë së tyre dhe kolonialistët e krishterë e hebrej, ashtu siç ndodh me të dështuarin, i cili gjithmonë e imiton ngadhënjimtarin. Këta harrojnë urdhrin e Pejgamberit për t’u dalluar nga pabesimtarët dhe nga imitimi i tyre. *“Ai që i përngjan një populli, bëhet prej tyre!”*²

Shumë juristë ndalojnë rruarjen e mjekrës duke u mbështetur në urdhrin e Pejgamberit a.s. për ta rritur atë.

¹ Fet’hul-Bari.

² Transmetim i Ebu Davudit nga Ibën Umeri.

Në esencë, rritja e mjekrës është vaxhib, posaçërisht kur bëhet fjalë për dallimin nga pabesimtarët. Dallimi prej tyre është vaxhib dhe asnjëherë nuk është transmetuar se ndonjë anëtar i selefit e ka lënë anash këtë vaxhib.

Disa dijetarë bashkëkohorë lejojnë rruarjen e saj për shkak të ndikimit të realitetit dhe largimit nga mashtrimet, dhe thonë se rritja e mjekrës u takon veprave të rëndomta të Pejgamberit a.s. e jo sheri-atit me të cilin urdhërohet.

Në të vërtetë, rritja e mjekrës nuk është konfirmuar vetëm me vep-rën e Pejgamberit a.s. por me urdhrin e tij të qartë që ka për qëllim dallimin nga pabesimtarët. Ka të drejtë Ibn Tejmijje kur thotë se dallimi prej (pabesimtarëve) është qëllimi i Ligdhënësit, ndërsa ngjashmëria (imitimi) në aspektet e dukshme ndikon në dashurinë, në shoqërimin dhe në afinitetin e ndjenjave në brendi. Dashuria e brendshme rezulton imitimin e jashtëm, gjë që vërehet me sy e me përvojë. Ai thotë se Kur'ani, Sunneti e Ixhma'i urdhërojnë dallimin nga pabesimtarët dhe mosimitimin e tyre në përgjithësi. Gjithashtu çdo gjë që shkakton shkatërrim në sjelljet e brendshme e të jashtme, ka trajtim të njëjtë dhe gjithashtu ndalohet. Imitimi i çështjeve të dukshme të pabesimtarëve do të shkaktojë imitimin e sjelljeve të tyre të pamoralshme dhe cilësitë e këqija, - bile edhe imitimin e be-simeve të tyre. Ndikimet e tilla as që mund të kontrollohen e as të zbulohen, dhe gradualisht bëhet shumë vështirë ose e pamundshme që të çrrënjosen. Sipas kësaj, çdo gjë që shkakton shkatërrim, nda-lohet nga Ligdhënësi.

(Shiko më gjerësisht librin e tij *Iktidâus-sirâtil-mustekîm*).

Nga e gjithë kjo konkludojmë se rreth rruarjes së mjekrës ekzistojnë tre mendime:

1. Ndalimi i rruarjes, si p.sh. Ibn Tejmijje etj.
2. Papëlqyeshmëria e rruarjes (mekruh), i cili theksohet në *El-Fet-h* vetëm nga Ajjâdi.
3. Mendimi që e lejon si p.sh. ai i dijetarëve të kohës bashkëkohore. Ndoshta mendimi më i pranuar, më i drejtë dhe më i qëlluar është ai i papëlqyeshmërisë, ngase nuk referohet ndonjë obligim (vaxhib) i prerë, edhe pse argumentohet me dallimin nga pabesimtarët. Gjithashtu më i afërt është edhe mendimi për ngjyrosjen e flokëve të thinjura me qëllim të dallimit nga hebrenjtë dhe të krishterët. Meqë disa sahabe nuk i kanë ngjyrosur, atëherë ngjyrosja pranohet si mustehab.

Është e vërtetë se asnjëri prej selefit nuk e ka rruar mjekrën, por ndoshta nuk kanë ndier nevojë për rruarjen e saj dhe ndoshta kjo ka qenë traditë e tyre.

NË SHTËPI

Shtëpia ose vendbanimi është vendi ku njeriu mbron veten dhe ku gjenë lirinë e vet nga kufizimet shoqërore. Aty ai pushon trupin dhe e relakson trurin. Për këtë shkak, kur Zoti shpreh mëshirën ndaj robërve të vet, thotë:

“All-llahu ua bëri shtëpitë tuaja vendbanim të qetë...”
(En-Nahl, 80)

Pejgamberi a.s. e donte gjerësinë e shtëpisë dhe e konsideronte ndër burimet e lumturisë së kësaj bote. Ai thoshte:

“Katër gjëra sjellin lumturinë: gruaja e mirë, vendbanimi i gjerë, fqiu i mirë dhe bartja komfore (e kafshës).”¹
Ai shpeshherë lutej me këto fjalë:

“O Zoti ynë, m’i fal mëkatet, ma zgjero shtëpinë dhe bekoma furnizimin tim”. Kur e kanë pyetur pse e përsërit shumëherë këtë duâ, ai është përgjigjur: “A kam lëshuar diçka?”²

¹ Transmetim i Ibën Habbanit në Sahihun e vet.

² Transmetim i Nesaiut dhe Ibën Sunnîut me sened autentik.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Zoti është i mirë dhe e do të mirën, është i pastër dhe e do pastërtinë, është fisnik dhe e do fisnikërinë, është bujar dhe e do bujarinë. Pastroni shtëpitë tuaja dhe mos u ngjani hebrenjve.”¹
(Pejgamberi ka për qëllim brendinë dhe oborrin e shtëpisë).

Dukuritë e luksit dhe politeizmit

Muslimani mund ta zbukurojë shtëpinë e vet me lule të ndryshme e dekorime të llojllojshme por të lejuara.

“Thuaj: “Kush i ndaloj bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet...” (El-A'râf, 32)

Po, muslimani mund ta dëshirojë bukurinë në shtëpinë e vet, në veshmbathjen e vet dhe në çdo gjë të ngjashme me to. Pejgamberi a.s. thotë:

“Nuk hyn në xhennet ai që në zemrën e vet ka një sasi sa thërrmija të mendjemadhësisë”. Në atë rast, një njeri e pyeti: “Po ai që dëshiron të ketë veshmbathje të bukur?” Pejgamberi i përgjigjet: “All-llahu është i bukur, e do bukurinë.”²

Sipas një transmetimi, një njeri i bukur ka shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë:

¹ Transmetim i Tirmidhiut.

² Transmetim i Muslimit.

“Unë e dua bukurinë, dhe siç sheh, ajo më është dhënë, por aq shumë e dua sa që nuk dua të më tejkalojë dikush, bile as në nallë. O Pejgamber i Zotit, a konsiderohet kjo mendjemadhësi?” Pejgamberi i është përgjigjur: *“Jo, ngase mendjemadhësia nënkupton refuzimin e të vërtetës dhe përbuzjen e njerëzve.”*¹

Meqë Islami refuzon teprimin në çdo gjë, atëherë nënkuptohet se Pejgamberi a.s. nuk ka pëlqyer që muslimani ta rregullojë shtëpinë në mënyrë luksoze e të shkapërderdhur të cilën e qorton Kur’ani ose me elemente të paganizmit, të cilat i lufton feja e monoteizmit në çdo mënyrë.

Enët prej ari e argjendi

Islami ia ndalon muslimanit që të mbajë në shtëpi enë prej ari e argjendi dhe shtroje mëndafshi të pastër. Pejgamberi a.s. i kërcënohet ashpër atij që devijon nga kjo rrugë. Në *Sahihun* e Muslimit transmetohet nga Umme Selemeja r.a.:

*“Në barkun e atij që han prej enëve të arit e të argjendit grafallon zjarri i xhehennemit.”*²

Buhariu transmeton nga Hudhejfe se ka thënë:

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Muslimit.

“Pejgamberi a.s. na ka ndaluar të pijmë e të hamë prej enëve të arit e argjendit, si dhe të veshim apo të ulemi mbi mëndafsh. Pejgamberi a.s. thoshte: “*Kjo u takon (pabesimtarëve) në këtë botë e neve në botën tjetër.*”¹

Nëse ndalohet përdorimi, atëherë ndalohet edhe dekorimi dhe zbukurimi me to.

Ndalimi i enëve dhe i shtrojeve është i njëjtë si për meshkujt ashtu edhe për femrat, ngase në këtë rast sheriatu dëshiron ta pastrojë shtëpinë prej elementeve të shkapërderdhjes së urrejtur. Sa të urta janë fjalët e Ibn Kudames: “Në këtë çështje si meshkujt ashtu edhe femrat kanë trajtim të njëjtë sipas përgjithshmërisë së hadithit. Shkaqet e ndalimit të tyre janë teprimi, shkapërderdhja dhe thyerja e zemrave të të varfërve, dhe për këtë shkak përfshihen të dy gjinitë. Në rast të nevojës grave u lejohet ky zbukurim për t’i zbukuruar në martesë por edhe në raste tjera. Në qoftë se shtrohet pyetja pse nuk ndalohet ena prej margaritari ose prej gurëve tjerë të çmueshëm, e cila është më e shtrenjtë se ena prej ari e argjendi, atëherë përgjigjemi se këto gjëra nuk i njohin të varfërit dhe nuk demoralizohen në qoftë se i përdorin të pasurit. Pastaj rrallësia e tyre pengon përdorimin e tyre, dhe për këtë shkak s’ka nevojë të ndalohen.”

Kur shqyrtoam urtësinë e ndalimit të arit për meshkujt, theksuam faktorin ekonomik që është më evident në këtë rast. Ari e argjendi janë standarde monetare ndërkombëtare për të caktuar vlerën e çmimeve dhe transaksioneve midis popujve. Zoti i ka udhëzuar njerëzit t’i përdorin si begati për t’i shfrytëzuar e jo për t’i mbyllur në shtëpitë e tyre si monedha, ose edhe më keq, t’i mbyllin në artikujt shtëpiakë e në ornamente.

Sa të bukura janë fjalët e Imam Gazaliut në kapitullin *Esh-shukru* të librit *El-ihjau*: “Çdokush që blenë enë prej ari e argjendi me dinarë e derhemë, bën kufër në begatinë (e Zotit), bile edhe më keq se ai

¹ Transmetim i Buhariut.

që i grumbullon. Kjo i ngjanë angazhimit të guvernatorit të qytetit për t'i pastruar rrugët e qytetit, për të qepur rrobatë leckosura ose për punët që i kryen shtresa më e ulët e njerëzve. Burgosja e tij është më pak fyese. Sot materialet nga porcelani, hekuri, plumbi dhe bakri mund t'i zëvendësojnë arin e argjendin për prodhimin e vazove dhe enëve të ndryshme por nuk mund t'i zëvendësojnë si monedha ose si standarde këmbimi. Ai që s'kupton në këtë mënyrë, atëherë le të kuptojë nga komenti hyjnor:

“Kush pi nga ena e arit ose argjendit, barku i tij do të mbushet me zjarrin e xhehennemit.”¹

Le të mos mendojë askush se në këtë mënyrë muslimanit i ngushtohet liria në shtëpinë e vet, ngase në mesin e gjërave të lejuara ka variante të llojllojshme. Sa vazo e enë të bukura mund të prodhohen nga qelqi, porcelani, bakri e materiale tjera! Gjithashtu edhe mbulesa, jastëkë e mësalla të bukura prodhohen nga pambuku, linji e materiale tjera të ndryshme.

Islami i ndalon statujat

Islami ndalon që në shtëpinë islame të ketë statuja, gjegjësisht statuja me figura të plota që nuk janë të shfrytëzuara. Ekzistimi i tyre në shtëpi shkakton largimin e engjëjve, të cilët përfaqësojnë mëshirën dhe pëlqimin e Zotit të Madhëruar. Pejgamberi a.s. thotë:

*“Engjëjt nuk hyjnë në një shtëpi ku ka statuja (ose figura).”*²

Dijetarët thonë se engjëjt nuk hyjnë në shtëpinë ku ka figura ngase pronari (i shtëpisë) në këtë rast u ngjanë pabesimtarëve, të cilët i vënë statujat në shtëpitë e tyre dhe i adhurojnë, prandaj engjëjt e urrejnë një vepër të tillë dhe nuk hyjnë në shtëpinë e tillë.

Islami ndalon muslimanin të merret me prodhimin e statujave, bile edhe në qoftë se i prodhon për jomuslimanët. Pejgamberi a.s. thotë:

¹ *Ihljâu ulumid-dîn*, Imam Gazali, botimi i Mustafa Halebiut, vëll. IV, f. 79.

² Transmetim unanim kurse shqiptimi është i Muslimit.

إِنَّ مِنْ أَشَدِّ النَّاسِ عَذَابًا يَوْمَ الْقِيَامَةِ الَّذِينَ يُصَوِّرُونَ هَذِهِ
الصُّورَ. وَفِي رِوَايَةٍ: الَّذِينَ يُضَاهَوْنَ بِخَلْقِ اللَّهِ.

“Më së shumti do të dënohen në Ditën e Kijametit ata njerëz që i prodhojnë figurat (statujat).” Sipas një transmetimi tjetër: “Ata të cilët imitojnë krijimin e Zotit.”¹

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

“Në Ditën e gjykimit do të kërkohet prej atij që bën figura t’u japë shpirt atyre, por nuk do të mund ta bëjë këtë asnjëherë.”² Këtu nënkuptohet se do të kërkohet prej tij t’u japë jetë të realtë. Ky obligim vërteton paaftësinë dhe nënçmimin e tij.

Urtësia e ndalimit të statujave

1. Qëllimi kryesor i ndalimit të statujave nuk është mbrojtja e monoteizmit ashtu siç mendojnë disa njerëz, ose largimi nga imitimi i idhujtarëve të cilët prodhojnë me duart e veta figurat dhe idhujt, e pastaj i shenjtërojnë dhe përkulen para tyre. Islami e ka arritur kulmin e mbrojtjes nga të gjitha dyshimet e idhujtarisë. Islami ka patur plotësisht të drejtë kur parandaloi një gjë të tillë, mirëpo tash ka përfunduar koha kur njerëzit në fillim i ngrenin statujat e të vdekurve dhe të devotshëmve të tyre për t’i rikujtuar, e të cilët pas një kohe të gjatë fillonin gradualisht t’i shenjtëronin derisa i shndërronin në zotëra që i adhuronin përveç All-llahut, prej tyre frikohehin dhe prej tyre kërkonin begatitë. Kështu ndodhi me fiset Vûd, Suva', Jegûth, Ja'uk e Nasra.

Kjo nuk është për t’u habitur ngase sipas rregullave të sheriatit, kjo fe ka ndërmarrë masa parandaluese për të mbrojtur nga shkatërrimi, eventualisht i ka mbyllur të gjitha zbrazëtirat, prej të cilave mund të depërtonin në mendjet e në zemrat e njerëzve e të shkaktojnë “shirk” të hapur e të fshehur apo imitim të idhujtarëve dhe të ekstremistëve nga fetë tjera. Islami nuk ofron dispozita për një ose dy gjenerata por për mbarë njerëzimin deri në Ditën e gjykimit. Ajo

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

që refuzohet në një shoqëri mund të pranohet në një tjetër, dhe ajo që konsiderohet e pamundshme në një kohë mund të jetë realitet objektiv në ardhmërinë e afërt ose të largët.

2. Shkaku tjetër i ndalimit që ka të bëjë me punuesin ose skulptorin, i cili e gdhend skulpturën asisoj që duket sikur është përmbushur plot krenari apo të mendojë skulptori se ka krijuar prej asgjësë një krijesë. Transmetohet se një njeri paska bërë një skulpturë brenda një kohe të gjatë, dhe kur e paska përfunduar, nën ndikimin e mburrjes e krenarisë nga përpikëria e saj, iu paska drejtuar me fjalët: “Fol! Fol!”

Për këtë shkak Pejgamberi fisnik a.s. ka thënë:

“Ata të cilët i punojnë këto figura do të dënohen në Ditën e Kijametit dhe do t’u thuhet: “Ngjallni atë që e krijuat!”¹

Në një hadith kudsî, Zoti thotë:

“Kush është më gabimtar se ai që tenton të krijojë si krijesa ime? Le të krijojnë një atom ose le të krijojnë një kokërr elbi!”²

3. Ata që e ushtrojnë këtë art nuk njohin kufij, por bëjnë figura të grave lakuriqe ose gjysëmlakuriqe dhe figura me forma e simbole të idhujtarisë së feve tjera, si p.sh. kryqa e idhuj tjerë të cilat nuk i pranon muslimani.

4. Përveç kësaj, statujat kanë qenë dhe do të jenë dukuri të jetës aristokrate e luksoze. Elita e lartë i mbushë pallatet, sallonet dhe dhomat me statuja nga materiale të ndryshme. Nuk është për t’u habitur se feja që lufton jetën luksoze me të gjitha manifestimet e saj, ndalon muslimanin të mbajë statuja në shtëpinë e vet.

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

Mendimi islam për madhërimin e personave të mëdhenj pas vdekjes

Ndoshta ndokush parashton pyetjen: “A nuk është sinqeritet nëse populli tregon lojalitetin e vet ndaj përkujtimit të heronjve të vet, të cilët me veprat e tyre u shënuan në histori, si dhe nëpërmjet ngritjes së statujave gjeneratat e ardhshme t’i kujtojnë veprat e tyre madhështore? Kujtesa e popullit është e shkurtë dhe me kalimin e kohës gjërat harrohen!”

Përgjigjja është se Islami e urren glorifikimin e tepërt të personave (pa marrë parasysh se çfarë grade kanë arritur), të gjallë apo të vdekur. Pejgamberi a.s. thotë:

“Mos më glorifikoni ashtu siç glorifikuan të krishterët Isain, të birin e Merjemes, por thoni: “Robi i Zotit dhe Pejgamberi i Tij.”¹

Njerëzit dëshironin të ngrihen në këmbë kur e shihnin Pejgamberin a.s. nga respekti ndaj tij, por ai ua ndaloi këtë dhe u tha:

“Mos u ngrini ashtu siç ngrihen të huajt nga glorifikimi ndaj njëritjetrit.”² Ai ua ka tërhequr vërejtjen që të mos e teprojnë në respektimin e tij pas vdekjes duke u thënë:

“Mos e shndërroni varrin tim në vend manifestimi”,³ dhe iu lut Zotit: “O Zot, mos e shndërro varrin tim në idhull që adhurohet!”⁴

¹ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

² Transmetim i Ebu Davudit dhe ibën Maxhes.

³ Transmetim i Ebu Davudit.

⁴ Transmetim i Malikut në *El-Muvat'at* 'u.

I kanë ardhur disa njerëz dhe e kanë pyetur: “O i dërguari i Zotit, o më i miri prej nesh, i biri i më të mirit prej nesh, zotëriu ynë dhe i biri i zotëriut tonë!” Në atë rast Pejgamberi a.s. thotë: *“O njerëz, thoni atë që thoni plotësisht ose pjesërisht, por mos t’ju mashtrojnë djalli! Unë jam Muhammedi, robi i Zotit dhe Pejgamberi i Tij. Nuk dëshiroj të më lartësoni mbi pozitën time, në të cilën më dërgoi Zoti i Madhëruar.”*¹

Feja e tillë nuk dëshiron që disa njerëz të glorifikohen e të shndërrohen në idhuj, për të cilët shpenzohen mjete të shumta me qëllim që njerëzit t’i madhërojnë e t’i admirojnë.

Sa i madh është numri i atyre që glorifikohen dhe që falsifikojnë historinë nëpërmjet derës së hapur për çdokënd që ka mundësi vetë të bëjë një gjë të tillë ose për aderuesit e tij, të cilët do t’i ndërtojnë monument të falsifikuar, ndërsa në anën tjetër, të mëdhenjtë e vërtetë populli i harron!

Pavdekshmëria e vërtetë për besimtarët është pavdekshmëri te Zoti, i cili i di edhe gjërat më të fshehta, nuk humb dhe nuk harron! Sa është i madh numri i të mëdhenjve të cilët janë regjistruar në imortalitetin e Tij, e për krijesat e Tij, ata janë të panjohur! Kështu ndodh pasi që Zoti i Madhëruar i do të mirët, të devotshmit e të fshehurit të cilët nëse prezentojnë, nuk njihen e nëse mungojnë nuk humbin.

Në qoftë se pavdekshmëria është e domosdoshme tek njerëzit, atëherë ajo nuk fitohet me ngritjen e statujave për atë që dëshirohet të madhërohet. Islami e pranon pavdekshmërinë e tyre në zemër, në mendime e në gjuhë për punët dhe për gjurmët e mira.

Pejgamberi a.s., halifët e tij, udhëheqësit e Islamit dhe imamët e njohur nuk janë glorifikuar me statuja prej guri dhe me forma mate-

¹ Transmetim i Nesaiut me sened të mirë.

riale, por biografitë dhe të arriturat e tyre transmetohen prej gjenerate në gjenerate. Fëmijët i transmetojnë prej etërve të tyre nëpërmjet kujtesës së ngulitur në zemër e të regjistruar në gjuhë. Kështu zbukurohen mexhliset e takimet dhe në këtë mënyrë mbushen mendjet e zemrat pa kurrfarë pikturash e statujash.¹

Islami i bën të pavdekshëm njerëzit me veprat e tyre të mira e të dobishme, i bën të pavdekshëm në zemrat e të gjithë njerëzve. I madh e i vogël e kanë njohur drejtësinë e Umerit, si dhe urtësinë dhe vendosmërinë e Ebu Bekrit, modestinë dhe trimërinë e Aliut, por asnjëri prej tyre s'ka patur nevojë për statujë formale që t'i njohin njerëzit ngase veprat dhe morali i tyre i kanë bërë të pavdekshëm.

Metoda e imortalizimit me anë të statujave është regresive e dekadente. Këtë formë e kanë përdorur romakët, grekët dhe pas tyre edhe evropianët ngase të gjithë kanë natyrë idhujtare dhe nuk i vlerësojnë virtytet e moralit. Meqë nuk e kanë njohur vlerën më të lartë të trimërisë, këta i kanë shndërruar hyjnitë në trima e trimat në hyjni.

Rezultati i fundit është se ne nuk duhet t'i nënshtrohemi mendimit të huaj rreth kësaj çështjeje ngase nuk përputhet me mendimin tonë,

¹ Për një sqarim më të gjerë përsëris fjalën e urtë të prof. Muhamed Mubarekut, dekan i Fakultetit të Sheriatit në Universitetin e Damaskut, të cilën e ligjëroi në Universitetin Az'har me titull: *"Nga vetëdija e re islame!"* Ai thotë: "Në jetën tonë ndeshemi me grupacione, sisteme e tradita të reja... Disa prej tyre nuk përputhen me besimin tonë të vërtetë dhe me parimet tona të fuqishme morale. Një prej tyre është edhe metoda e evropianëve dhe amerikanëve për imortalitetin e heronjve të tyre dhe ngritjen e statujave për ta. Nëse këtë çështje e studiojmë në mënyrë të pavarur nga qytetërimi i Perëndimit dhe nëse studiojmë filozofinë e kësaj metode për imortalitetin e gjurmëve dhe virtyteve, do të vërejmë se arabët i kanë imortalizuar vetëm virtytet dhe veprat e lavdëruara të heronjve të tyre si p.sh. sinqeritetin, bujarinë dhe trimërinë. Metoda e tyre (arabëve) shtrohej nëpërmjet përcjelljes së tregimeve për heroizmin e tyre prej gjenerate në gjenerate, ose nëpërmjet krijimit të panegjerve. Në këtë mënyrë është imortalizuar (është bërë e pavdekshme) bujaria e Hatemit dhe trimëria e Anteres para Islamit.

Me paraqitjen e tij Islami e konfirmoi këtë parim dhe njeriu u bë krijesa më e nderuar e Zotit dhe Pejgamberi i fundit tha: *"Unë jam njeri si ju dhe inspirohem!"* Islami e vlerësoi njeriun sipas veprave e jo sipas trupit dhe e bëri Pejgamberin a.s. shëmbëlltyrë për njerëzit, ndaloj shenjtërimin e njerëzve dhe madhërimin e tyre deri në adhurim. Prandaj, kur vdiq Pejgamberi, halifi i parë tha: "Kush e adhuronte Muhammedin, Muhammedi ka vdekur dhe kush e adhuron Zotin, Zoti është i gjallë dhe nuk vdes", pastaj lexoi fjalën e Zotit të Madhëruar: *"Muhammedi është vetëm I Dërguar..!"*

dhe nuk duhet ta ndryshojmë parimin islam për ndalimin e statujave për shkak të dëmeve të tyre në shpirt e moral.”

Lejimi i lojërave për fëmijë

Në qoftë se ekzistojnë statuja që nuk adhurohen, nuk përdoren për luks dhe nuk bëjnë pjesë në të ndaluarat e theksuara më parë, atëherë Islami nuk tregohet zemërngushtë por i lejon, si p.sh. lojërat për fëmijë që kanë formë kukullash, egërsirash e të kafshëve tjera, me të cilat fëmijët luajnë dhe dëfrehen.

Nëna e besimtarëve, Aisheja r.a. thotë: “Luaja me kukullat kur më vinin shoqet, dhe kur vinte Pejgamberi a.s. i fshihnim nga frika prej tij, mirëpo ai gëzohej për vizitën që ma bënë e që luanin me mua.”¹ Sipas një transmetimi tjetër, Pejgamberi a.s. e pyeti njëherë se ç’janë ato (lojëra), e ajo i përgjigjet se janë kukulla. Kur e pyeti se ç’është ai në mes, ajo i thotë se është kalë. Pastaj e pyeti se çka mbi të, e ajo i përgjigjet se janë dy krahë, dhe në atë rast ai habitet dhe i thotë: “*Kalë me dy krahë?*” Ajo i thotë: “A nuk ke dëgjuar se Sulejman ibn Davudi ka patur kalë me krahë?” Në atë rast

¹ Transmetim unanim.

Pejgamberi a.s. fillon të qeshet derisa i janë vërejtur edhe dhëmballët e tij.¹

Kukullat e lartpërmendura në hadith janë kukulla me të cilat luanin fëmijët, dhe me to luante edhe Aisheja r.a. ngase ishte në moshë të re kur u martua me Pejgamberin dhe luante me to.

Shevkani thotë se ky hadith është argument se fëmijëve u lejohet të luajnë me kukulla e lojëra tjera.

Transmetohet se Maliki një njeriu nuk i ka lejuar t'i blejë vajzës së vet (kukull), ndërsa gjykatësi Ajjad ka thënë: "Vajzave të vogla u lejohet të luajnë me kukulla."

Trajtim të njëjtë kanë statujat për fëmijë nga ëmbëlsirat, që shiten gjatë festave e më në fund përdoren për ushqim.

Statujat e deformuara

Në një hadith transmetohet se Xhibrili a.s. nuk ka hyrë në shtëpinë e Pejgamberit a.s. sepse para derës ka patur një statujë. Gjithashtu edhe të nesërmen nuk ka hyrë derisa i ka thënë:

*"Shko te statuja dhe preja kokën ashtu që t'i ngjajë trungut të drurit."*²

Dijetarët e përdorin këtë hadith si argument se fotografitë (figurat) e plota nuk lejohen, e në rast se u hiqet ndonjë pjesë që e dëmton tërësinë, atëherë lejohet. Një shpjegim i vërtetë dhe i sinqertë i kërkesës së Xhibrilit për prerjen e kokës së statujës, na bën të kuptojmë se qëllimi i tij ishte që statuja të mos jetë në nivelin e madhërimit pas këputjes së një pjese të saj, e jo të ndikojë në jetën apo vdekjen e saj.

S'ka dyshim se statujat e përgjysmuara të cilat ngrihen nëpër sheshe për t'i imortalizuar mbretërit e të mëdhenjtë janë më shumë të ndaluara se figurat (statujat) e vogla e të plota, të cilat përdoren për dekorim nëpër shtëpia.

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Ebu Davudit, Tirmidhiut e Ibën Habbanit.

Pikturat dhe ornamentet njëdimensionale

Ky ishte qëndrimi i Islamit ndaj figurave tridimensionale, por çfarë qëndrimi ka ndaj pikturave dhe ornamenteve njëdimensionale që vizatohen në letër, në rroba, në perde, në mure, në monedha e në bankënota? Përgjigjja është se parimin islam mund ta kuptojmë në qoftë se e kuptojmë qëllimin e pikturave, vendin ku vëndohen, si përdoren dhe cili është qëllimi i piktorit kur pikturon!

Nëse piktura artistike përdoret për t'u adhuruar diçka përveç Zotit si p.sh. Isai tek të krishterët, lopa tek indusët etj., atëherë piktori i saj konsiderohet pabesimtar dhe agjikator i kufrit e i humbjes. Pikërisht këtij njeriu Pejgamberi a.s. i kërcënohet me dënim të ashpër:

“Në mesin e njerëzve më së tepërmi do të dënohen piktorët në Ditën e Kijametit!”¹

Taberiu thotë se këtu nënkuptohet pikturimi i asaj që adhurohet përveç Zotit me vetëdije e qëllim. Piktori i tillë bën kufër e nëse ka për qëllim diçka tjetër, atëherë do të përgjigjet vetëm për mëkatin e pikturimit.

Përveç kësaj, muslimani nuk pranon që të shenjtërohen pikturat, përveç në rast se e ndërron fenë.

Trajtim të njëjtë ka edhe ai që pikturon diçka që nuk adhurohet me qëllim që ta imitojë Zotin në krijim, gjegjësisht me pretendim se krijon ashtu siç ka krijuar Zoti i Madhëruar. Në këtë rast, piktori i tillë del nga feja e monoteizmit. Në këtë kontekst hadithi i Pejgamberit thotë:

“Më së shumti do të dënohen ata të cilët e imitojnë Zotin në krijim.”

Pra, kjo çështje ka lidhje me qëllimin e piktorit. Këtë e përforcon edhe më shumë hadithi kuds:

¹ Transmetim i Muslimit.

“Cili është më tiran se ai që mendon të krijojë si krijesa ime! Le të krijojnë një kokërrzë ose një grimcë!” Fjalët *“Krijon si krijesa ime”* tregojnë qëllimin e imitimit në krijim, që konsiderohet karakteristikë hyjnore, mirëpo po aty Zoti i Madhëruar kërkon prej tyre, të krijojnë ndonjë kokërrzë ose grimcën. Duke u mbështetur në qëllimin e tillë të tyre, Zoti publikisht do t’ju thotë në Ditën e gjykimit:

“Jepni jetë asaj që e krijuat!” Piktori obligohet t’i japë shpirt por asnjëherë nuk do të ketë sukses.

Gjithashtu ndalohen portretet e njerëzve që fetarisht shenjtërohen ose konsiderohen në këtë botë si të mëdhenj, si p.sh. portreti i pejgamberëve, i engjëjve, i të devotshëmve, portreti i Ibrahimit, i Is’hakut, i Musait, i Merjemes, i Xhibrilit etj. Kjo është traditë e të krishterëve, mirëpo për fat të keq, disa muslimanë “kureshtarë” i imitojnë kështu që pikturojnë Fatimenë, Aliun etj. Trajtim të tillë kanë edhe portretet e mbretërve, të udhëheqësve dhe të artistëve të kohës sonë. Në këtë kategori mëkati është më i vogël, por do të jetë mëkat i madh në qoftë se janë persona pabesimtarë, tiranë e mëkatarë, si p.sh. qeveritarët që qeverisin me diçka tjetër e jo me Shpalljen e Zotit, që thërrasin në diçka tjetër e jo në Mesazhin e Zotit dhe artistët që glorifikojnë të pavërtetën dhe propagandojnë amoralitetin e të pandershmen në popull.

Me sa duket, shumë portrete nga koha e Pejgamberit dhe më vonë janë shenjtëruar e glorifikuar, dhe në përgjithësi ishin punime të romakëve e persianëve (të krishterëve e zjarrputistëve). Ata ishin nën ndikimin e besimit dhe shenjtërimit të tyre të prijësve fetarë e shtetërorë.

Muslimi transmeton nga Ebu Duha se ai ka thënë: “Isha me Mesrukin në një shtëpi me statuja dhe Mesruki më tha: “A janë këto statuja të Kisraut?” I thashë: “Jo, por të Merjemes!” Mesruki mendonte se ishin punime të zjarrputistëve, të cilët i pikturonin portretet e mbretërve të tyre edhe në enë, mirëpo u kuptua se punimet ishin të një krishteri. Me këtë rast Mesruki thotë: Dëgjova Abdull-llahun

(Ibn Mes'udin) duke thënë: “Kam dëgjuar se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Më së shumti Zoti do t'i dënojë piktorët.”*

Pikturat dhe vizatimet e qenieve të pashpirt (të botës së vdekur), si p.sh. të bimëve, drunjve, deteve, anijeve, kodrave, diellit, hënës, yjeve dhe të dukurive tjera natyrore, janë të lejuara. Në qoftë se piktori pikturon diçka me shpirt dhe nuk ka në të diçka nga ndalimet e përmendura më parë, kryesisht nuk ka shenjtërim, glorifikim ose imitim të Zotit në krijim, atëherë mendoj se një gjë e tillë lejohet, duke u mbështetur në shumë hadithe të vërteta.

Transmetohet në *Sahihun* e Muslimit:

nga Busr Ibn Seid, nga Zejd Ibn Halidi, shok i Pejgamberit a.s. se Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Engjëjt nuk hyjnë në atë shtëpi ku ka figura (piktura, statuja).”* Basri vazhdon e thotë: “Pastaj u ankua Zejdi dhe e kthye pas, mirëpo në derën e tij pamë një pikturë. Iu drejtova Ubejdull-llah Haulanit i cili i shërbente gruas së Pejgamberit a.s. Mejmunes dhe i thashë: “A nuk na informoi dje Zejdi për pikturat?” Abdull-llahu i përgjigjet: “A nuk dëgjove kur tha: “Përveç asaj në tesha!”

Tirmidhiu transmeton nga Utbeja se ka shkuar ta vizitojë Talha Ensariun dhe aty e ka gjetur Sehl Ibn Hanifiun (sahab) i cili ka thënë: “Ebu Talhaja ka thirrur një njeri dhe ka shqyer një teshë (ose pëlhurë me piktura).

لَمْ تَنْزَعُهُ؟ قَالَ: لَأَنَّ فِيهِ تَصَاوِيرَ، وَقَالَ فِيهِ النَّبِيُّ ﷺ
مَا قَدْ عَلِمْتَ. قَالَ سَهْلٌ: أَوَلَمْ يَقُلْ: إِلَّا مَا كَانَ
رَقْمًا فِي ثَوْبٍ؟ فَقَالَ أَبُو طَلْحَةَ: بَلَى وَلَكِنَّهُ أَطْيَبُ
لِنَفْسِي.

Kur e pyeti Sehli pse e shqyen, ai i përgjigjet se në të ka piktura, dhe ia përsëritë fjalët e Pejgamberit që i dinte. Sehli thotë: “A nuk ka thënë përveç asaj në tesha?”, ndërsa Ebu Talha përgjigjet: “Po, por kështu jam më i kënaqur?” Tirmidhiu thotë se ky hadith është “hasen” dhe “sahih.”

A nuk argumentojnë këto dy hadithe se ndalohen figurat që i quajmë “statuja”, ndërsa pikturat që pikturohen në dru, tesha, mure e të ngjashme me to, nuk ndalohen me tekst autentik të qartë e të shëndoshë.

Ekzistojnë hadithe autentike, në të cilat Pejgamberi a.s. tregon urrejtjen e tij ndaj kësaj kategorie pikturash për shkak se u takojnë atyre që jetojnë jetë luksoze dhe që i duan gjërat e pavlera.

رَوَى مُسْلِمٌ عَنْ زَيْدِ بْنِ خَالِدٍ الْجُهَنِيِّ عَنْ أَبِي
طَلْحَةَ الْأَنْصَارِيِّ قَالَ: سَمِعْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ
يَقُولُ: لَا تَدْخُلُ الْمَلَائِكَةُ بَيْتًا فِيهِ كَلْبٌ وَلَا تَمَائِيلٌ.
قَالَ: فَأَتَيْتُ عَائِشَةَ فَقُلْتُ: إِنَّ هَذَا يُخْبِرُنِي أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ
قَالَ: لَا تَدْخُلُ الْمَلَائِكَةُ بَيْتًا فِيهِ كَلْبٌ وَلَا تَمَائِيلٌ،
فَهَلْ سَمِعْتَ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ ذَكَرَ ذَلِكَ؟ فَقَالَتْ:

لَا... وَلَكِنْ سَأُحَدِّثُكُمْ مَا رَأَيْتُهُ فَعَلَ: رَأَيْتُهُ خَرَجَ فِي
عَزَاتِهِ، فَأَخَذَتْ نَمَطًا، فَسَتَرَتْهُ عَلَى الْبَابِ،
فَلَمَّا قَدِمَ فَرَأَى النَّمَطَ عَرَفَتْ الْكَرَاهِيَةَ فِي وَجْهِهِ،
فَجَذَبَهُ (النَّمَطَ)، حَتَّى هَتَكَهُ أَوْ قَطَعَهُ وَقَالَ:
إِنَّ اللَّهَ لَمْ يَأْمُرْنَا أَنْ نَكْسُو الْحَجَارَةَ وَالطِّينَ!! قَالَتْ:
فَقَطَعْنَا مِنْهُ وَسَادَتَيْنِ وَحَشَوْنَهُمَا لِيَفَا،
فَلَمْ يَعِْبْ ذَلِكَ عَلَيَّ.

Muslimi transmeton nga Zejd ibn Halid El-Xhuheni e ai nga Ebu Talha El-Ensariu, i cili thotë: “Dëgjova Pejgamberin a.s. duke thënë: “Nuk hyjnë engjëjt në shtëpinë ku ka qen dhe statuja”. Shkova te Aisheja r.a. dhe i thashë: “Ky më lajmëron se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Nuk hyjnë engjëjt në shtëpinë ku ka qen dhe statuja”, po ti, a e ke dëgjuar Pejgamberin a.s. se ka thënë kështu? Ajo tha: “Jo, por do t’ju rrëfej sjelljen e tij që e kam parë: “Njëherë shkoi Pejgamberi a.s. në një ekspeditë e unë vura në derë një pëlhurë me piktura. Kur u kthye dhe e pa, vërejtta në fytyrën e tij mospëlqim, pastaj e hodhi poshtë dhe e grisi një copë duke thënë: “Zoti nuk na ka urdhëruar t’i mbulojmë gurin e argjilën.” Më vonë e preva pëlhurën dhe bëra dy jastëkë të mbushur me fije palme, kurse ai nuk më qortoi.”

Nga ky hadith kuptohet se mbulimi i mureve dhe lëshimi i perdeve me fotografi konsiderohet gjë e urrejtur. Imam Neveviu thotë se në këtë hadith nuk ka diçka që ndalohet, ngase nga fjalët “Zoti nuk ju ka urdhëruar kështu” nënkuptohet se një gjë e tillë nuk është vaxhib, as mendub e as haram.

عَنْ عَائِشَةَ قَالَتْ: كَانَ لَنَا سِتْرٌ فِيهِ تِمْنَالُ طَائِرٍ،
وَكَانَ الدَّخِلُ إِذَا دَخَلَ اسْتَقْبَلَهُ، فَقَالَ لِي رَسُولُ اللَّهِ
ﷺ: حَوْلِي هَذَا، فَإِنِّي كُلَّمَا دَخَلْتُ فَرَأَيْتُهُ ذَكَرْتُ الدُّنْيَا.

Me kontekst të njëjtë Muslimi transmeton nga Aisheja se ka thënë:

“Kishim një perde me fotografi të zogut, dhe çdoherë që hynte e shihte atë. Pejgamberi a.s. më tha: *“Hiqe prej aty, ngase sa herë që e shoh, ma rikujton këtë botë!”*”¹

Pejgamberi a.s. nuk e ka urdhëruar që ta grisë por që t’ia ndërrojë vendin, nga urrejtja që kishte ndaj gjërave që zakonisht rikujtojnë këtë botë dhe atraksionet e saj, posaçërisht kur dihet se Pejgamberi a.s. i falte sunnetet dhe nafilet në shtëpi. Fotografitë dhe statujat e tilla e largojnë zemrën nga devotshmëria dhe përqëndrimi i plotë në lutjet e drejtuara nga Zoti i Madhëruar.

Buhariu transmeton nga Enesi se ka thënë: “Aisheja kishte një perde me të cilën kishte mbuluar një anë të shtëpisë së saj, mirëpo Muhammedi a.s. i thotë: *“Largoje prej syve të mi ngase figurat e saj më paraqiten në namaz.”*”²

Nga kjo nënkuptojmë se Pejgamberi a.s. ka lejuar në shtëpinë e tij perde me fotografi të zogut e me diçka të ngjashme me të.

Për shkak të haditheve të tilla, disa nga selefi thonë:

“Ndalohet vetëm ajo që ka hije (trupore), e ajo që s’ka, lejohet.”³

Këtë e vërteton edhe hadithi kuds, në të cilin Zoti i Madhëruar thotë:

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Buhariut.

³ E ka cekur Neveviu në *Komentimin e Muslimit* dhe e ka kontestuar duke thënë se ky qëndrim është i pavlefshëm. Hafidhi transmeton në *El-Fet’h* se hadithi është i vërtetë dhe transmetohet nga Kasim Ibën Muhamedi, i cili njihet si jurist nga Medineja dhe si dijetar më i çmuar në kohën e vet. Shejh Behiti transmeton fjalët e Hattabit: “Ai që i pikturon kafshët dhe drunjtë, shpresoj se nuk hyn në këtë qortim, edhe pse e gjithë kjo është e urrejtur dhe angazhon zemrën me çështje të kota”. Shejh Bahiti i komenton këto fjalë dhe thotë. “Piktori i kafshës nuk krijon formën e kafshës por vetëm e vizaton, dhe në këtë mënyrë figura humb shumë organe pa të cilat kafsha nuk mund të jetojë. Nuk kërkohet në Ditën e Kijametit prej piktorit të tillë ta ngjallë pikturën e vet, ngase një gjë e tillë kërkohet prej fotografisë që ka hije (statuja) e që s’ka humbë asnjë organ, pa të cilin nuk mund të jetojë. Në rastin e kërkimit të ringjalljes, vërtetohet paaftësia e skulptorit për t’i dhënë jetë...”

“Cili është më i keq (më tiran) se ai që përpiqet të krijojë si krijesa ime! (Nëse munden), le të krijojnë një grimcë ose një kokërr elbi!” (Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit).

Siç nënkuptohet prej këtui, krijesa e Zotit nuk paraqet vizatimin por krijimin e figurave tredimensionale. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Ai është që ua krijon (formën) juve në mitra ashtu si të dojë..” (Âli Imrân, 6)

Këtë çështje e vështirëson vetëm një hadith i transmetuar nga Aisheja r.a. (Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit).

Ajo tregon se e ka blerë një jastëk me fotografi, dhe kur e ka parë Pejgamberi a.s., është ndalur te dera dhe nuk ka hyrë brenda. Kur e ka parë dëshpërimin në fytyrën e tij i ka thënë: “O i dërguari i Zotit, i pendohem Zotit dhe Pejgamberit të Tij! Çfarë mëkati kam bërë?” Pejgamberi u përgjigj: “Ç’është ky jastëk?” Ajo i ka thënë se e ka blerë për Pejgamberin që të ulet e të mbështetet mbi të, ndërsa Pejgamberi a.s. i ka thënë: “Piktorët e pikturave të tilla do të

dënohen dhe do t'u thuhet: "Ngjallni atë që krijuat!" Pastaj ka vazhduar dhe ka thënë: *"Në shtëpitë ku ka piktura, nuk hyjnë engjëjt."* Muslimi shton se Aisheja ka thënë: *"Pastaj e mora dhe bëra dy jastëqe për t'u mbështetur."*

Sidoqoftë, ky hadith refuzohet në shumë aspekte:

1. Transmetimi ka versione të ndryshme e të kundërt njëri me tjetrin. Disa transmetime vërtetojnë se Pejgamberi a.s. ka përdorur perde me vizatime (piktura) dhe pas copëtimit prej tyre ka bërë jastëkë, kurse sipas disa transmetimeve të tjera, ai nuk i ka përdorur fare.
2. Disa transmetime vërtetojnë vetëm urrejtjen e tij ndaj tyre, posaçërisht kur bëhet fjalë për perdet e murit me fotografi ngase perdet e tilla prezantojnë një formë të luksit të cilin nuk e pranonte. Këtë e vërejmë edhe në hadithin e Pejgamberit të cilin e transmetuam pak më parë ku thuhet:

"Zoti nuk na ka urdhëruar t'i mbulojmë gurin e baltën."

3. Në hadithin e transmetuar nga Aisheja, që ka të bëjë me perden në të cilën është i vizatuar zogu, Pejgamberi thotë:

"Ndërroja vendin, ngase sa herë që e shoh, ma rikujton këtë botë!"

Këto fjalë nuk konfirmojnë ndalesën e prerë.

4. Ky hadith kundërshton hadithin që kishte të bëjë me perden në shtëpinë e Aishes r.a., kur Pejgamberi a.s. e urdhëron ta largojë për shkak se i pengonte në namaz. Këtu vërehet se Pejgamberi a.s. e ka urdhëruar Aishen ta largojë perden ngase i ka penguar në namaz e jo për shkak të fotografisë.

Hafidhi thotë se vështirë është të pajtohet ky hadith me hadithin e Aishesë rreth perdes, mirëpo vazhdon e thotë se i pari ka të bëjë me fotografi me shpirt ndërsa i dyti ka të bëjë me gjëra jo të gjalla. Çështjen e tillë e vështirëson hadithi i perdes me pikturë të zogut.

5. Ky hadith e kundërshton hadithin e Ebu Talha El-Ensariut, i cili përjashton figurat e vizatuara në tesha. Kurtubiu thotë se të dy hadithet mund të përputhen ashtu që hadithi i Aishes i referohet urrejtjes kurse i Ebu Talhas lejimit absolut, dhe kështu nuk kundërshton urrejtjen. Këtë qëndrim e ka pranuar edhe Hafidh ibn Haxheri.

6. Transmetuesi i hadithit të Aishes rreth perdes (transmetuesi është i biri i vëllait të saj Kasim Ibn Muhamed ibn Ebi Bekër), i cili lejonte fotografitë pa hije. Ibn Avni thotë se ka hyrë në shtëpinë e

Kasimit, që jetonte në pjesën më të lartë të Mekkes, dhe ka parë në të një mbulesë të vizatuar me figurat e kastorit dhe feniksit. Hafithi thotë se fjala e tij mund të pranohet në tërësi

(*“përveç vizatimeve në tesha”*), dhe siç duket Pejgamberi a.s. ia ndalonte Aishes vënien e perdes së theksuar me të cilën e mbulonte murin ngase ishte me fotografi. Këtë e mbështet transmetimi:

“Zoti nuk na ka urdhëruar t’i mbulojmë gurin dhe baltën”, pastaj, Kasim Ibn Muhamedi, njëri ndër shtatë fukahatë e Medines, dijetar i çmuar në kohën e vet dhe transmetues i hadithit mbi perden. Sikur të mos e kuptonte lejimin që ceket në hadithin rreth “huxhle-s”, nuk do ta lejonte përdorimin e saj.

Gjithashtu ekziston edhe një mënyrë tjetër e komentimit të haditheve mbi pikturat dhe piktorët. Pejgamberi a.s. në fillim ka patur qëndrim të prerë ndaj ndalimit të pikturave të tilla për shkak se populli ka qenë shumë afër kohës së shirkut, adhurimit të idhujve dhe shenjtërimit të figurave e statujave. Pas besimit monoteist Pejgamberi a.s. ka lejuar fotografitë dydimensionale, respektivisht pikturimin dhe gravimin. Sa i përket vetë atij (a.s.), ai nuk lejonte të ketë perde e gjëra të tjera me figura e vizatime brenda shtëpisë së vet, bile as vizatimet e figurat që ishin në tesha, në letër ose në mur. Tahaviu, imami hanefit, thotë: “Në fillim, Ligdhënësi i ka ndaluar të gjitha llojet e figurave, qofshin edhe dydimensionale, për shkak se muslimanët ishin shumë afër kohës kur i adhuronin pikturat. Ky ishte shkaku që i ndaloi në përgjithësi të gjitha figurat. Më vonë (kur u përforcua besimi), i ka lejuar fotografitë në tesha për shkak të nevojës për veshje. Pastaj ai gjithashtu i ka lejuar figurat e deformuara ngase në këtë mënyrë e ka bindur të paditurin në adhurimin e të deformuarës.”

Ndalimi i figurave të padeformuara mbetet i pakontestuar.¹

Lejimi i figurave të deformuara

Çdo ndryshim i figurës që e largon atë nga glorifikimi dhe e deformon e bartë atë nga sfera e urrejtjes në sferën e lejimit.

¹ Transmetim i Shejh Bahitit në *El-Xhevabush-shafi*.

Sipas një hadithi, Xhibrili ka kërkuar leje prej Pejgamberit a.s. të hyjë në shtëpinë e tij, dhe kur e ka lejuar, Xhibrili i ka thënë: *“Si të hyj në shtëpinë tënde kur brenda ke perde me figura!” Nëse janë të domosdoshme atëherë prejti ato, shndërroji në jastëk ose në shtroje!”*¹

Kur e ka parë Aisheja dëshpërimin në fytyrën e Pejgamberit a.s. jastëkun e vizatuar e ka shndërruar në dy mbështetëse me qëllim që ta deformatojë dhe ta zhdukë edhe mundësinë më të vogël për adhurimin e saj.

Të parët (selefë) e kanë lejuar figurën e deformuar. Transmetohet se Urveja mbështetej mbi statujat që kishin forma njerëzish dhe shpezësh. Ikrimeja thotë se urreheshin statujat që përdoreshin si idhuj por jo edhe ato që shkeleshin me këmbë, me pretekst se me shkeljen e figurave që ishin të vizatuara në qilim e hasër, ata i nënçmonin ato.

Fotografitë

Duhet të cekim se çdo gjë që u theksua deri tash për pikturat e fotografitë, kishte për qëllim pikturat që vizatohen, pikturohen e fiksohen në sipërfaqe të rrafshtë.

Fotografia që përdoret sot nuk ishte zbuluar në kohën e Pejgamberit a.s. e as në kohën e selefit të muslimanëve. Meqë është kështu, atëherë a aplikohen të njëjtat parime që i theksuam deri tash rreth pikturave dhe piktorëve?

Ata të cilët e kufizojnë ndalimin vetëm për statujat, i lejojnë fotografitë, veçanërisht ato që nuk janë të plota (tredimensionale).

Të tjerët pyesin se a krahasohen fotografitë me ato të cilat i krijojnë pena e artistit? A realizohet edhe këtu shkaku i dënimit që ceket në hadithet për artistët (piktorët e skulptorët), të cilët imitojnë krijimin e Zotit?

¹ Transmetim i Nesaiut dhe i Ibën Habbanit në Sahihun e tij.

Parimi i usulistëve është ky: “Nëse nuk ka shkak, nuk ka edhe pasojë!”

Shejhu i ndjerë Muhamed Behit, mufti i Egjiptit, thotë se fotografia e cila nënkupton fotografimin e objektit të realtë me anë të foto-aparateve, nuk u përket pikturave të ndaluara. Piktura të ndaluara konsiderohen ato të cilat nuk i kanë objektet e pranishme por i krijon artisti që ka për qëllim të imitojë Zotin në krijimin e kafshëve. Pra, ky përkufizim nuk vlen për fotografimin me aparat.

Edhe pse disa njerëz janë shumë rigorozë dhe ndiejnë urrejtje ndaj të gjitha llojeve të figurave bile edhe ndaj fotografisë, përsëri e lejojnë atë që është e nevojshme, si p.sh. fotografitë personale për letërnjoftim, për pasaportë, për të mbajtur dosjet e të dyshimtëve dhe kriminelëve ose për qëllime të ndryshme e kështu me radhë, por me kusht që ato të mos shenjtërohen e të bien në kundërshtim me besimin (islam).

Nevoja për fotografitë e tilla është më e madhe se pikturimi i teshave, të cilin e përjashtoi Pejgamberi a.s.

Subjekti i fotografisë

Subjekti i fotografisë ndikon në vendimin për ndalim ose lejim. Muslimani ndalon fotografinë që ka subjekt të kundërt me parimet e besimit islam dhe shariatit.

S’ka dyshim se ndalohen fotografitë e femrave lakuriqe, gjysëm lakuriqe, ato të organeve gjenitale, të pozitave që nxisin epshet ashtu siç është rasti me disa revista e gazeta. Gjithashtu edhe roli i tillë i kinemasë ndalohet.

Pra, ndalohet në përgjithësi punimi i fotografive të këtilla, shpërndarja e tyre në mesin e njerëzve, marrja e tyre në shtëpi, zyra e shitore, si dhe ngjitja në mure dhe shikimi i tyre.

Të gjitha këto gjëra i fotografojnë pabesimtarët, tiranët e mëkatarët, ndërsa muslimani obligohet t’u kundërvihet për hir të Zotit. Nuk i lejohet muslimanit të fotografojë dhe ta ruajë fotografinë e ndonjë udhëheqësi ateist që refuzon ekzistimin e Zotit, të ndonjë idhujtari që ia shoqëron Zotit lopën, zjarrin etj., apo të ndonjë hebreu e të krishteri që refuzon pejgamberinë e Muhammedit a.s., ose të atij që fshehet pas Islamit dhe vepron në kundërshtim me parimet e tij; apo të atyre që përhapin amoralitet dhe korrupsion në shoqëri, si aktorët e aktoreset, këngëtarët e këngëtareset etj.

Gjithashtu ndalohen fotografitë që kanë si subjekt paganizmin ose simbolet e feve të cilat nuk i pranon Islami, si p.sh. idhujt, kryqat etj. Shumë shtroje, perde e jastëqe kanë patur piktura të tilla në kohën e Pejgamberit a.s.

Buhariu transmeton se Pejgamberi a.s. nuk ka pranuar në shtëpinë e vet asgjë që ka patur formën e kryqit.¹

Ibn Abbasi transmeton se Pejgamberi a.s. nuk ka hyrë në Qabe në ditën e çlirimit të Mekkes derisa brenda saj nuk janë shkatërruar edhe piktura dhe statuja e fundit.² Sigurisht këto piktura e statuja kanë prezentuar paganizmin e idhujtarëve të Mekkes dhe rrugën e tyre të humbur.

Ali Ibn Talibi transmeton se njëherë Pejgamberi a.s. ishte në një rast vdekjeje dhe tha: *“Cili prej jush shkon në Medinë dhe i then idhujt, i rrafshon varret dhe i shkatërron të gjitha pikturat?”* Një njeri i

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Buhariut.

tha: “Unë, O Pejgamber i Zotit”, dhe kështu shkoi e pas një kohe u kthye e raportoi: “O Pejgamber i Zotit, të gjithë idhujt i theva, të gjitha varret i rrafshova dhe të gjitha pikturat i shkatërrova.” Pastaj Pejgamberi a.s. tha: “*Çdokush që ripërsërit një vepër të tillë konsiderohet pabesimtar i asaj që iu shpall Muhammedit a.s.*”¹

Pejgamberi a.s. me siguri urdhëroi të shkatërrohen pikturat që kishin subjekt pagan injorant me qëllim që ta pastrojë qytetin prej gjurmëve të tyre. Për këtë shkak, ai gjithashtu tha se kush kthehet përsëri në të parën, refuzon atë që e ka shpallur Zoti!!

Përmbledhja e rregullave për pikturat dhe piktorët

Në këtë përmbledhje mund t’i përkufizojmë rregullat për pikturat dhe piktorët:

1. Piktura më të ndaluara janë ato të cilat pikturohen për t’u adhuruar dikush tjetër përveç Zotit, si p.sh. Isai tek të krishterët. Piktura e tillë e shpie piktorin në kufër nëse qëllimisht dhe me vetëdije vepëron ashtu. Kësaj kategorie gjithashtu i përkasin edhe statujat. Secili që merr pjesë në propagimin ose në madhërimin e tyre, do të jetë mëkatar aq sa kontribuan në këtë.
2. Gjithashtu ka mëkat edhe për pikturat që nuk pikturohen për t’u adhuruar, por për ta imituar Zotin në krijim, gjegjësisht nëse piktori pretendon se krijon ashtu siç krijon edhe Zoti, dhe në këtë mënyrë bën kufër. Kjo çështje ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me qëllimin e piktorit.
3. Përveç kësaj kategorie në këtë grup radhiten edhe statujat që glorifikohen, si p.sh. statujat e mbretërve, të udhëheqësve e të liderëve për t’i bërë të pavdekshëm duke i vënë nëpër sheshe apo në vende tjera. Pa marrë parasysh se a është statuja e plotë apo e përgjysmuar, trajtimin e ka të njëjtë.
4. Statujat e qenieve të gjalla, të cilat nuk shenjtërohen e as nuk madhërohen, në përgjithësi janë të ndaluara me përjashtim të atyre të deformuarave (të parespektuara), si p.sh. lojërat e fëmijëve dhe ëmbëlsirat që hahen.

¹ Transmetim i Ahmedit. Mundhiri thotë se transmetimi i këtij hadithi është i mirë. Hajjan Ibën Huseini transmeton se edhe Ali Ibën Talibi r.a. ka kërkuar prej tij atë që kërkoi Pejgamberi a.s. të bëhet në Medine.

5. Portretet e njerëzve të mëdhenj, si p.sh. të udhëheqësve, liderëve etj. Ndalimi është edhe më i rigoroz kur ka të bëjë me njerëzit tiranë, mëkatarë e ateistë. Respekti ndaj tyre e degradon Islamin.
6. Pikturat e qenieve të gjalla që nuk madhërohen por konsiderohen si manifestim i jetës luksoze e të lartë, si p.sh. mbulimi i mureve me to. Kjo kategori konsiderohet e urrejtur.
7. Lejohet vizatimi i natyrës, si p.sh. vizatimi i drurit, palmës, deteve, anijeve, kodrave dhe peizazheve tjera natyrore por me kusht që të mos pengojnë në adhurim ose të arrijnë shkallën e luksit e të urrehen.
8. Në esencë fotografitë lejohen përderisa si subjekt nuk kanë diçka që ndalohet, si p.sh. shenjtërimin fetar të personit të fotografuar, ose glorifikimin e tij në këtë botë, posaçërisht nëse bëhet fjalë për pabesimtarët, mëkatarët, paganët, ateistët dhe artistët e devijuar.
9. Nëse statujat dhe pikturat e ndaluara deformohen ose asgjësohen, atëherë kalojnë nga sfera e ndalimit në sferën e lejimit, si p.sh. figurat që janë vizatuar në shtresën mbi të cilën shkelin këmbët, nallet etj.

Mbajtja e qenve pa patur nevojë

Pejgamberi a.s. gjithashtu ka ndaluar mbajtjen e qenve në shtëpi pa patur nevojë.

Disa njerëz bëjnë jetë luksoze dhe harxhojnë për qentë e tyre ndërsa i përbuzin njerëzit. Disa prej tyre nuk kënaqen vetëm me harxhimet për qentë e tyre por ua përkushtojnë edhe ndjenjat e tyre sentimentale duke e harruar të afërmin, vëllain dhe fqin.

Qeni në shtëpinë e muslimanit shkakton papastërti. Pejgamberi a.s. thotë:

“Nëse qeni lëpin enën e ndonjërit prej jush atëherë le ta lajë shtatë herë, e një herë edhe me dhé.”¹

Disa dijetarë e arsyetojnë mosruajtjen e qenit në shtëpi ngase e sulmon musafirin, frikëson lypësin dhe e dëmton kalimtarin. Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Buhariut.

“Më erdhi Xhibrili dhe më tha: “Erdha dje por nuk munda të hyjë ngase para derës kishte statuja, në shtëpi kishte perde me piktura, kurse brenda shtëpisë kishte qen. Heqja kokën statujës që t’i ngajë trungut të drurit, grise perden dhe bëri dy jastëkë mbështetës dhe genin nxirre jasht.”¹

Ky ndalim vlen për qentë që mbahen në shtëpi pa patur kurrfarë nevojë.

Lejohen qentë e gjahut dhe të mbrojtjes

Qentë që ruhen për nevojë, si p.sh. qentë për gjah apo për mbrojtjen e fushës dhe të dhenve, përjashtohen nga ndalimi. Në një hadith që transmetohet unanimisht Pejgamberi a.s. thotë:

“Kush ruan qen përveç qenve të gjahut, të fushës e të gjedheve, do t’i pakësohet një sasi e madhe nga shpërblimi për çdo ditë”.²

Disa fukahë mbështeten në këtë hadith dhe thonë se ruajtja e qenve është mekruh e jo haram, ngase harami nënkupton pa përjashtime, qoftë mungesa e shpërblimit ose jo.

Ndalimi i ruajtjes së qenve në shtëpi nuk nënkupton të sillemi keq ndaj tyre ose t’i zhdukim. Pejgamberi a.s. thotë:

“Sikur të mos ishin qentë qenie sikur qeniet tjera, do të urdhëroja të vriten.”³

(Sqarim: Pejgamberi a.s. këtë e tha pos vërejtjes së Xhibrilit engjëjt nuk hyjnë në shtëpinë ku ka qen).

Pejgamberi a.s. tregon një të vërtetë të pakontestueshme. Gjithashtu edhe në Kur’an ceket një e vërtetë e tillë.

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë e as shpezë që fluturojnë me dy krahë e që nuk janë të ndarë në dy grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi, i pajisi si juve).” (El-En’âm, 38)

¹ Transmetim i Ebu Davudit, Nesaiut, Tirmidhiut dhe Ibën Habbanit në Sahihun e tij.

² Transmetim i Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

³ Transmetim unanim.

Pejgamberi a.s. ua rrëfente sahabëve ngjarjen e njeriut, i cili kishte gjetur një qen të molisur në shkretëtirë nga etja, e pastaj kishte shkuar te pusi, e kishte mbushur këpucën, i kishte dhënë ujë qenit dhe e kishte shpëtuar nga ngordhja. Pastaj vazhdon Pejgamberi e thotë:

فَشَكَرَ اللَّهُ لَهُ، فَغَفَرَ لَهُ.

“Zoti e ka falënderuar dhe e ka mëshiruar (bartësin e ujit).”¹

Mendimi i shkencës moderne mbi ruajtjen e qenve

Në rrethin tonë mund të gjejmë njerëz që e simpatizojnë Perëndimin dhe pretendojnë se posedojnë dashuri, respekt e humanitet të lartë ndaj çdo gjallese dhe e kritikojnë Islamin me pretekst se sulmon “shokun më të mirë” të njeriut. Këtyre ua paraqes artikullin shkencor, të cilin e ka shkruar një shkencëtar gjerman në një revistë², ku i thekson të gjitha rreziqet që kanosen nga ruajtja e qenve ose nga afrimi me ta:

- Dëshira e njerëzve që është në rritje e sipër gjatë viteve të fundit për ruajtjen e qenve, na obligon të shkruajmë për rreziqet që na kanosen prej tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë jo vetëm për ruajtjen e tyre por edhe për përkëdheljen e puthjen e tyre, lëpirjen e duarve të fëmijëve dhe të të mëdhenjve, bile shpeshherë u lejohet që të hanë në enët, në të cilat han e pi edhe njeriu. Përveç refuzimit të ushqimit të shëndoshë dhe mospranimi të parimeve të etikës, një vepër e tillë nuk përputhet edhe me parimet e shëndetit dhe të pastërtisë. Këto çështje do t’ua lëmë të tjerëve t’i gjykojnë, kurse neve këtu na intereson aspekti dhe qëndrimi mjekësor ndaj këtyre rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut e jetës së tij nga ruajtja dhe përkëdhelja e qenve. Disa njerëz e kanë paguar shtrenjtë injorancën e tyre ngase shiriti i qenve u ka shkaktuar sëmurje kronike, bile disa herë edhe i ka mbytur. Nga kjo sëmundje sëmurën njerëzit, thundrakët dhe derrat por paraziti i tillë zhvillohet më së shumti te qentë, te ujqit dhe më pak te macet. Ai dallohet nga shiritat tjerë për nga forma ngase është aq i vogël saqë vështirë mund të shihet edhe me sy. Ky shirit ka qenë i panjohur deri në vitet e fundit.

¹ Transmetim i Buhariut.

² Studimi i prof. dr. Xherard Ventsemer është marrë nga revista gjermane *Kosinos*, që është përkthyer dhe botuar në revistën *Nur-ul-Islam*.

Pastaj vazhdon profesori dhe thotë:

- Procesi i zhvillimit biologjik të këtij shiriti ka karakteristika të posaçme. Nga plaga e shkaktuar prej tyre, formohen shirita të ri të ngjashëm apo krejtësisht me formë të re. Kokat e formuara shndërrohen në shirita të plotë në bajamet e qenit, ndërsa tek njeriu dhe kafshët tjera ato paraqiten në formë të dregëzave dhe çibanëve në formë krejtësisht të ndryshme. Ky shirit rritet te kafshët dhe bëhet sa një mollë, kurse shpnetka e kafshës së infektuar rritet prej 5 deri më 10 herë më shumë se forma normale. Tek njeriu rritet sa një grusht ose sa koka e fëmijës së vogël, ka lëng të verdhë dhe peshon prej 10 deri 20 ritla¹.

Brenda trupit të njeriut më së shumti formohet në mushkëri, në muskulaturë, shpnetkë e në tru dhe vështirë është për specialistët ta gjejnë shiritin e tillë ngase merr forma të ndryshme. Kudo që gjendet ky parazit e rrezikon shëndetin e pacientit të infektuar, bile më e keqja qëndron në faktin se njihet jeta, historia, origjina dhe zhvillimi i tij por nuk dihet ilaçi, përveç në disa raste kur shkatërrohet nga antitruptat që i prodhon vetë trupi i njeriut. Për fat të keq, zhdukja pa pasoja e parazitëve të tillë është shumë e rrallë. Përveç kësaj, kemoterapia ende nuk ka arritur ndonjë sukses të dukshëm, kurse operacioni është mënyra e vetme për mënjanimin e pjesëve trupore që janë të infektuara nga ky parazit.

Këto shkaqe na obligojnë t'i ndërmarrim të gjitha masat për ta luftuar këtë sëmundje të tmerrshme dhe për ta mbrojtur njeriun nga rreziku që i kanoset prej këtij shiriti.

Prof. dr. Noelleri i ka analizuar kufomat e infektuara nga shiriti i qenit në Gjermani dhe ka ardhur në përfundim se numri i tyre është 1 për qind ndërsa vendet më të rrezikuara janë Dalmacia, Islanda, Australia Juglindore dhe Holanda, aty ku ruhen qentë që përdoren për tërheqjen e sajave, gjegjësisht 12 për qind të qenve e posedojnë këtë parazit.

Në Islandë 43 për qind të njerëzve janë të infektuar nga ky shirit.

Nëse i marrim parasysh humbjet e njeriut, të cilat përfshijnë ushqimin e njeriut duke hedhur mishin e kafshëve të infektuara dhe rrezikun e vazhdueshëm që i kanoset shëndetit të njeriut nga ky shirit, atëherë duhet të jemi të shqetësuar për këtë problem.

¹ *Ritl*, masë për matjen e peshës. Ritli shpeshherë ka të bëjë edhe me sasinë e vlerës së monedhës.

Mënyra më e përshtatshme për ta luftuar këtë parazit është që ta kufizojmë brenda qenve e mos ta përhapim ndër njerëz, edhe pse në kohë të sotme nuk mund ta pengojmë ruajtjen e qenve.

Nuk duhet të harrohet edhe fakti se obligohemi t'i shërojmë qentë që e kanë këtë parazit në bajamet e tyre, dhe kohë pas kohe preferohet përsëritja e këtij procesi të qentë e stanit dhe qentë për mbrojtje. Njeriu mund ta shpëtojë jetën dhe shëndetin e vet nëse largohet nga qentë e nuk u afrohet. Gjithashtu edhe fëmijët duhet të largohen nga qentë, të mos lejohet që qentë t'ua lëpijnë duart dhe të mos lejohet qëndrimi i qenve në vendet ku zbaviten e luajnë fëmijët. Për fat të keq ne vërejmë një numër të madh të qenve në kopshtet e fëmijëve, ku edhe fëlliqësirat e tyre janë të shpërndara në çdo anë. Gjithashtu duhet të caktohen enë të posaçme për ushqimin e qenve dhe të mos lejohen që t'i lëpijnë enët prej të cilave ushqehet njeriu. Nuk duhet t'u lejohet hyrja në shitoret e artikujve ushqimorë, në tregjet publike dhe në restorante...”

Në përgjithësi, qentë duhet të largohen plotësisht nga çdo vend ku han ose pin njeriu.

Ne e pamë se si Pejgamberi a.s. ndalonte shoqërimin me qentë, ngrënien prej enëve të ushqimit e të pierjes të cilat i kanë lëpirë qentë dhe ruajtjen e tyre pa nevojë. Pra, si përputhen mësimet e Muhammedit ummi e të pashkolluar me zbulimet më të reja të shkencës moderne dhe të mjekësisë bashkëkohore?

Ne mund vetëm t'i përsërisim fjalët e Zotit:

“Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet.” (Nexhm, 3-4)

NË FITIM DHE NË ZEJE

“Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj ecni nëpër pjesët e saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij.”
(Mulk, 15)

Ky është parimi i Islamit!

Zoti e ka bërë të përshtatshme tokën për ta shfrytëzuar njeriu. Pra, ai obligohet të ecë nëpër tokë e t’i shfrytëzojë begatitë e saj të dhuruara nga Zoti!

Puna është obligim për të aftin

Nuk i lejohet muslimanit të përtojë në kërkimin e furnizimit të vet për shkak të përqendrimit në ibadet (adhurim), ose në emër të mbështetjes në Zotin xh.sh., ngase qielli nuk lëshon as ar e as argjend.

Gjithashtu njeriut nuk i lejohet të kërkojë lëmoshë nëse është i aftë për punë, gjegjësisht nëse është i aftë ta furnizojë veten dhe familjen. Në këtë kontekst Pejgamberi i Islamit thotë:

“Sadakaja nuk i lejohet të pasurit e as të aftit (për punë)”.¹

Pejgamberi ka qenë më rigoroz dhe e ka ndaluar muslimanin që të kërkojë lëmoshë prej njerëzve, ta humbë nderin, fytyrën e respektin pa nevojë. Pejgamberi a.s. thotë:

*“Kush kërkon lëmoshë pa nevojë i ngjanë atij që mban zjarr në dorë.”*²

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

¹ Transmetim i Tirmidhiut.

² Transmetim i Bejhakiut dhe Ibën Huzejmes në Sahihun e tij.

“Kush kërkon lëmoshë prej njerëzve për t’u pasuruar, do të ketë fytyrë të gërvishtur deri në Ditën e Kijametit dhe do të hajë gurë zjarri nga xhehennemi; pra, kush dëshiron le ta pakësojë ose le ta shtojë!”¹

Ai gjithashtu thotë:

“Njeriu vazhdon të kërkojë lëmoshë derisa ta takojë Zotin me fytyrë të zhveshur nga mishi”.²

Me këshilla e qortime të tilla Pejgamberi a.s. e mbronte nderin e muslimanit, ta përforcojë mbështetjen në vete dhe të largohet nga varësia prej njerëzve tjerë.

Kur lejohet kërkitimi i lëmoshës

Pejgamberi a.s. e kupton nevojën dhe obligimin, dhe kështu kush detyrohet i shtyrë nga nevoja të lypë prej shtetit ose prej individëve, këtu s’ka asgjë të keqe. Në këtë kontekst ai thotë:

“Lypja është e barabartë me zhveshjen e mishit nga fytyra yte, dhe në qoftë se njeriu dëshiron ta mbrojë fytyrën e vet, atëherë le të largohet; (Lypja) lejohet prej pushtetit ose në rast nevojë.”³

Në *Sahihun* e Muslimit transmetohet se Ebu Beshir Kubejsa Ibn Mehârik r.a. ka thënë:

¹ Transmetim i Tirmidhiut.

² Transmetim unanim.

³ Transmetim i Ebu Davudit dhe Nesaiut.

“Vendosa të paguaj kompensim dhe shkova te Pejgamberi a.s. të kërkoj ndihmë prej tij, e ai më tha: *“Prit derisa të vijë sadakaja e pastaj do të të japim prej saj.”* Pastaj vazhdon dhe i thotë: *“O Kubejse, lypja lejohet vetëm në tre raste: për njeriun që punon punë të rënda (hamall), dhe kështu i lejohet të lypë derisa ta tubojë shumën e duhur e pastaj të ndalet; për njeriun që i ndodh ndonjë fatkeqësi dhe e humbë pasurinë lejohet lypja derisa të ngrihet në këmbët e veta; për njeriun që është i uritur derisa tre njerëz të besueshëm nga shoqëria e tij thonë: ‘Filani është i uritur’, dhe i lejohet të lypë derisa të ngrihet në këmbë. O Kubejse, lypja në përjashtim të këtyre rasteve konsiderohet zjarr, gjegjësisht lypësi ha zjarr.”*¹

Puna e ndershme

Pejgamberi a.s. nuk lejon urrejtjen e disa njerëzve ndaj disa profesioneve dhe punëve. Ai i mësonte sahabët e vet të jenë të ndershëm në çdo punë, dhe se është nënçmim dhe zhvlerësim i plotë nëse mbështeten në ndihmën e të tjerëve. Në këtë kontekst, ai thotë:

¹ Transmetim i Muslimit, Ebu Davudit dhe Nesaiut.

“Më mirë është që njeriu të mbledhë një krah me dru, t’i mbajë mbi shpinë e t’i shesë sesa të kërkojë lëmoshë. Në këtë mënyrë Zoti ia mbron dinjitetin, e në rast se lypë, njerëzit mund t’i japin ose mos t’i japin.”¹

Muslimani duhet të fitojë nëpërmjet bujqësisë, tregtisë, industrisë ose cilido profesioni tjetër përderisa nuk i takon haramit, nuk ndihmon haramin ose nuk i afrohet haramit.

Fitimi nga bujqësia

Zoti i Madhëruar i cekë në Kur’anin Famëlart parimet e obligueshme për bujqësinë: Zoti e ka përgatitur tokën për bimë e prodhim, ia ka nënshtuar njeriut dhe e ka bërë të plleshme me qëllim që t’ua afrojë krijesave begatitë e saj. Pra, krijesat duhet t’i përmendin dhe të falënderohen për begatitë e tilla!

“All-llahu juve ua bëri tokën të sheshtë që nëpër të të ecni rrugëve të gjera.” (Nûh, 19-20)

“Ai edhe tokën e bëri të shtrirë për krijesat. Në të ka pemë të llojllojshme, ka edhe hurma me shporta të mbështjella. Edhe drithin me kashtën e tij edhe bimët aromatike (ose ushqyese). E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?! (Er-Rahmân, 10-13)

Zoti gjithashtu ka mundësuar edhe ujin nëpërmjet shiut ose lumënve, dhe me të e ringjallë tokën pas thatësisë së saj!

“Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxori bimën e çdo gjëje dhe prej bimës gjelbërimin dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura me kallinj.” (El-En’âm, 99)

“Njeriu le të shikojë ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës. Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra dhe rrush e perime.” (Abese, 24-28)

Zoti i dërgon erërat me lajme të mira, i drejtojnë retë dhe i polenizojnë bimët:

¹ Transmetim unanim.

“E tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vërë kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve. Dhe ne ua krijuam juve në të jetesën (mjetet për jetë) e edhe atyre për të cilët ju nuk jeni furnizues. E nuk ka asnjë send që mos ta ketë burimin te Ne, por Ne nuk e japim atë ndryshe vetëm sipas një mase të caktuar (të nevojshme). Ne i lëshojmë erërat mbarësuese, e nga qielli (retë) lëshojmë shi dhe atë ua japim ta pini, e ju nuk mund ta ruani atë.” (Hixhr, 19-22)

Në të gjitha këto ajete ka udhëzim hyjnor për njeriun që t’i shfrytëzojë begatitë e bujqësisë dhe mjetet e saj lehtësuese për të.

Pejgamberi a.s. thotë:

“Muslimani fiton sadaka për çdo pemë që e mbjell dhe për çdo farë që e mbjell dhe që është ushqyese e shpezës dhe njeriut.”¹

Pejgamberi a.s. përsëri thotë:

“Muslimani fiton sadaka prej çdo gjëje që mbillet e që hahet prej asaj që i vilet. Çdokush që mbjell, fiton prej saj sadaka deri në Ditën e Kijametit.”²

Hadithi konfirmon se shpërblimi është i vazhdueshëm derisa bima apo pema është ushqyese apo e dobishme, qoftë mbjellësi i gjallë apo i vdekur, dhe pa marrë parasysh se a është transferuar pasuria e tij në ndonjë person tjetër apo ende është e tij. Dijetarët thonë se bujaria e Zotit shpërblen edhe pas jetës ashtu siç shpërblen gjatë jetës për gjashtë gjëra: për sadakanë e përhershme, për diturinë e dobishme, për fëmijën e mirë, për mbjelljen, për farën për mbjelljen e pemëve dhe për mbrojtjen e kufijve territorialë nga pabesimtarët. Transmetohet se një njeri ka kaluar afër Ebu Derdasë r.a., i cili ishte duke mbjellur një fidan arre dhe e ka pyetur: “Pse e mbjell kur je plak! Kjo do ta japë frytin e vet pas shumë viteve.” Ebu Derdaja i

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Muslimit.

përgjigjet: “Për mua është me rëndësi se unë për këtë punë do të shpërblehem, ndërsa frutat le t’i vjelë kush të dojë.”

Një sahab i Pejgamberit a.s. thotë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:

*“Zoti do ta konsiderojë sadaka çdo ushqim që del prej mbjellësit që mbjell një dru dhe kujdeset për të derisa ta japë frytin e tij!”*¹

Në bazë të këtyre haditheve disa dijetarë mendojnë se fitimi më i lëvdëruar është ai prej bujqësisë; sipas disa të tjerëve industria dhe puna e dorës; ndërsa sipas disa të tjerëve tregtia.

Sipas disa hulumtuesve kjo gjë varet nga ndryshimi i situatës: ku ka nevojë për ushqim bujqësia është më e preferuar, ku ka nevojë për mallra, tregtia është më e preferuar dhe ku ka nevojë për prodhime të fabrikuara, industria është më e preferuar.²

Kjo analizë e fundit në përgjithësi përputhet me rezultatet më të reja të ekonomisë moderne.

Bujqësia e ndaluar

Islami ndalon mbjelljen e të gjitha bimëve që janë të dëmshme si p.sh. hashashi etj.

Në qoftë se themi se duhani është i ndaluar, atëherë edhe mbjellja e tij është haram, e nëse e konsiderojmë të urrejtur, atëherë edhe mbjellja është e urrejtur.

Islami nuk lejon që të mbillet gjëja e ndaluar e pastaj t’u shitet jo-muslimanëve. Islami asnjëherë nuk e lejon haramin. Gjithashtu nuk lejon që muslimani të ruajë derra për t’ua shitur të krishterëve. U tha më parë se Islami ndalon shitjen e rrushit të lejuar personit, për të cilin dihet se do ta përdorë për prodhim të alkoolit.

¹ Transmetim i Ahmedit.

² Shiko komentimin e Kastalanit mbi Buhariun.

Industritë dhe profesionet

Islami i angazhon njerëzit të merrem me bujqësi me qëllim që t'i shfrytëzojnë dobitë e saj në këtë botë e të shpërblehen në botën tjetër. Islami gjithashtu urren që muslimanët të angazhohen vetëm në bujqësi e të mbyllën ashtu siç është mbyllur guaska. Ai po ashtu ndalon që muslimanët të mjaftojnë vetëm me lopët ngase në këtë mënyrë ummetit i kërcënohet rreziku. Duke u nisur nga ky fakt, Pejgamberi a.s. proklamoi se përqëndrimi i tillë konsiderohet burim i së keqes, i sprovimit negativ dhe i nënçmimit të ummetit dhe këtë parim e ka vërtetuar edhe koha. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Nëse punoni me kamatë, nëse i kapni vetëm bishtat e lopëve dhe nëse merreni vetëm me kultivimin e tokës dhe e lini anash xhihadin, Zoti do t’ju nënçmojë derisa t’i riktheheni fesë tuaj!”¹

Pra, përveç bujqësisë, ndihet nevoja edhe për industri e profesione tjera, me të cilat plotësohen bazat e jetës së këndshme, elementet e ummetit të lirë dhe të shtetit të fortë e të pasur. Sheriati islam jo vetëm që i lejon profesionet dhe industritë tjera, por gjithashtu i konsideron farz të përbashkët në fenë islame. E gjithë kjo nënkupton se grupet islame duhet t’i posedojnë të gjitha njohuritë, profesionet e industritë e nevojshme. Në qoftë se stagnon vetëm një aspekt nga aspektet e shkencës ose të industrisë, atëherë e tërë shoqëria islame fajësohet, posaçërisht njerëzit me post dhe autoritet.

Imam Gazaliu thotë: *“Fardu kifaje* konsiderohet çdo shkencë që është e domosdoshme në këtë botë, si p.sh. mjekësia e cila është e nevojshme për mjekimin e organizmit njerëzor; matematika e cila është e domosdoshme për transaksionet e përditshme dhe për ndarjen e vasijetit e të trashëgimisë etj. Nëse nuk ekzistojnë shkencat e tilla, atëherë përgjegjësia u takon të gjithë anëtarëve të shoqërisë, e nëse vetëm ndonjëri merret me to, atëherë përgjegjësia kolektive anulohet. Nuk konsiderohen vetëm mjekësia e matematika si fardi

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

kifaje, por në të njëjtën mënyrë trajtohen edhe bazat e industrisë, si bujqësia, tjerria, politika, bile edhe hedhja e kupave dhe qepja e rrobave. Nëse humbet hedhja e kupave, populli do të shkatërrohet. Ai i cili e ka zbritur sëmundjen, e ka caktuar edhe ilaçin, ka dhënë udhëzime për përdorimin e tij dhe i ka përgatitur shkaqet për administrimin e tij. Pra, nuk lejohet shkatërrimi për shkak të lënies së tyre pasdore!”²

Kur’ani numëron shumë industri dhe i konsideron si begati të dhëna nga Zoti i Madhëruar.

“Ne i patëm dhënë Davudit dhuratë të madhe nga ana jonë: “O male dhe shpezë, lartësonu (me tespih) së bashku me të!” Ne ia zbutim atij edhe hekurin (si brum). (I thamë) Puno këmisha të plota (nga hekuri) dhe thuri me precizitet ato. Dhe bëni vepra të mira (o familje e Davudit), se Unë vëzhgoj atë që punoni.” (Sebe’, 10-11)

“Ne i mësuam atij (Davudit) punimin e petkave (të hekurta) për ju, që t’ju mbrojnë në rast lufte. A jeni pra mirënjohës ju për këtë” (Enbijâ, 80)

Për Sulejmanin thotë:

“Edhe Sulejmanit ia nënshtroam erën që paraditja (udhëtimi me të duke shkuar) ishte sa një muaj dhe pasdita e saj (në të kthyer) sa një muaj (udhëtimi). Bëmë që atij t’i rrjedhë burim i remit dhe me urdhrin e Zotit të tij ia nënshtroam xhinët që punonin sipas dëshirës së tij, e kush largohet prej tyre nga urdhri jonë, atij do t’ia shijojmë zjarrin e fortë. I punonin atij çka ai dëshironte: pallate të fortifikuara, skulptura, pjata (të drunjtë) sikurse rezervoare, enë (kazane) të palëvizshme. Veproni duke falënderuar o familje e Sulejmanit, e nga robërit e Mi pak janë mirënjohës.” (Sebe’ë, 12-13)

Për Dhulkarnejnin dhe pendën e tij thotë:

“Ai (Dhulkarnejni) tha: “Atë që mua ma mundësoi Zoti im është shumë më e mirë (nga ajo që më afroni ju), po ju më ndihmoni me fuqi punëtore të bëj një pendë të fortë mes jush dhe mes atyre! Më sillni copa të hekurit! E kur e nivelizoi ai me dy anët e kodrave, tha: “Ndizni!”, e kur e bëri atë (hekurin) zjarr (si zjarr nga të ndezurit) tha: “Më sillni bakër të shkrirë t’ia hedhë atij! E ata as nuk arritën ta kapërcenin atë e as ta shponin.” (Kehf, 95-97)

Për Nûhin dhe mjeshttrinë e tij në ndërtimin e anijeve të mëdha thotë:

² *Ihjaw ulûmid-dîn*, vëll. 1, f. 15.

“Dhe nga argumentet e Tij (që dokumentojnë fuqinë), janë anijet lundruese nëpër det si të ishin kodra.” (Esh-Shûrâ, 32)

Në shumë sure theksohet industria e peshkimit me të gjitha llojet e saj si peshkimi i peshqve, i kafshëve të detit, i kafshëve të tokës; pastaj mjeshtria e zhytjes në det për nxjerrjen e margaritarëve etj. Kur’ani në veçanti potencoi vlerën e hekurit në atë formë që nuk mund të krahasohet me ndonjë libër të fesë ose të kësaj bote. Pas përmendjes së dërgimit të Pejgamberëve për krijesat dhe shpalljes së librave për ta, Zoti i Madhëruar thotë:

“Ne e kemi zbritur edhe hekurin, që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz.” (Hadîd, 25)

Për këtë shkak edhe vet sureja titullohet me emrin *Hadîd* (hekur).

Çdo industri ose profesion që plotëson nevojat e shoqërisë dhe realisht është i dobishëm për të, konsiderohet vepër e mirë, në qoftë se aplikohet sipas urdhrave të Islamit.

Islami gjithashtu i çmon edhe ato profesione të cilat njerëzit i nënçmonin, p.sh. njerëzit nuk e preferojnë shumë profesionin e bariut. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Çdo Pejgamber që e ka dërguar Zoti, ka qenë bari”. Kur e kanë pyetur Pejgamberin: “Po ti, o Pejgamber i Zotit?”, ai u është përgjigjur: “Po, i kam ruajtur me pagesë dhentë e mekkasve.”¹

Muhammedi a.s., Pejgamberi i fundit, ka qenë bari i dhenve, edhe atë jo i dhenve të veta por i të tjerëve, dhe i ruante me pagesë. Ai ua bën të ditur këtë ithtarëve të vet me qëllim që t’ju tregojë se punëtorët duhet të krenohen e jo përtacët e të papunët.

Kur’ani na rrëfen tregimin e zotëriut tonë Musait (a.s.), i cili punoi me rrogë te një plak plot tetë vjet. Ai gjithashtu u martua edhe me vajzën e plakut. Plaku e kishte punëtorin dhe të paguarin më të mirë. E vërtetë ishte fjala e të bijës së plakut kur i thotë babait të vet:

“Njëra prej atyre dyjave tha: “O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku.” (Kasas, 25)

¹ Transmetim i Buhariut.

Ibn Abbasi transmeton se Davudi a.s. ka qenë mjeshtër i mburojave dhe i teshave prej hekuri, Ademi a.s. ka qenë bujk, Nûhi a.s. ka qenë zdrukthëtar, Idrisi ka qenë rrobaqepës, ndërsa Musai a.s. ka qenë barí.¹

Pra, muslimani duhet të kënaqet me profesionin e vet, ngase çdo pejgamber ka patur edhe profesionin e vet.

Në *Sahih* thuhet:

*“Asnjëri nuk mund të hajë ushqim më të mirë se nga duart e veta. Pejgamberi i Zotit, Davudi a.s. ka ngrënë nga puna e vet.”*²

Industritë dhe profesionet që i ndalon Islami

Ekzistojnë industri e profesione të cilat i ndalon Islami për shkak se dëmtojnë besimin, moralin, nderin dhe parimet etike të shoqërisë.

1. Prostitucioni (kurvëria)

Prostitucionin si profesion e lejojnë shumë shtete të Perëndimit, japin leje të posaçme dhe femrën që merret me këtë profesion e trajtojnë si profesionalistët tjerë që i kanë të drejtat e veta. Islami e ndalon profesionin e tillë në mënyrë kategorike dhe nuk e lejon as femrën e lirë e as robëreshën të fitojë në këtë mënyrë.

Disa njerëz të periudhës paraislame e obligonin robëreshën me tatim ditor ndaj zotëriut të vet, dhe ajo shpeshherë merrej me prostitucion për ta paguar tatimin e tillë. Disa të tjerë i obligonin pa dëshirën e tyre për të fituar qoftë edhe diçka simbolike.

Kur u shpall Islami, i largoi bijtë e bijat nga ky imoralitet. Këtë e vërejmë në fjalën e Zotit të Madhëruar:

¹ Transmetim i Hakimit.

² Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

“Mos i detyroni robërshat tuaja të bëjnë imoralitet, për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra. E kush i detyron me dhunë ta bëjnë atë, All-llahu i falë ato pas atij detyrimi. All-llahu falë dhe është mëshirues.” (Nûr, 33)

Ibn Abbasi transmeton se prijësi i njerëzve të dyfytirshëm Abdull-llah ibn Ubejj ka shkuar te Pejgamberi a.s. me një robërshë të bukur që quhej Mu’adha, dhe i ka thënë:

“O Pejgamber i Zotit. Kjo u përket jetimëve të filanit. A nuk e lejon të merret me prostitucion për dobinë e tyre?” Pejgamberi a.s. i përgjigjet: “Jo!”¹

Kështu Pejgamberi a.s. e ndaloj këtë profesion të fëlliqtë, pa marrë parasysh faktorin obligues, qoftë nevoja, detyrimi ose qëllimi i pastër, me qëllim që shoqëria islame të jetë e pastër prej të këqijave të tilla të urrejtura.

2. Vallëzimi dhe artet erotike

Islami gjithashtu nuk lejon vallen erotike provokative ashtu siç nuk lejon çdo vepër tjetër që nxitë epshin, si p.sh. këndimi i lakuriqes, drama provokative dhe çdo lloj të fëlliqtë të cilin sot disa njerëz e quajnë “art” dhe “përparim”.

Islami ndalon të gjitha lidhjet seksuale jashtë martesës dhe çdo fjalë apo vepër që mundëson lidhjen e tillë të ndaluar. Kjo është edhe urtësia e Kur’anit kur thotë në këtë kontekst:

“Dhe mos iu afroni amoralitetit (zināsë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe!” (Isrâ, 32)

Pra, Islami jo vetëm që ndalon këtë amoralitet, por ndalon edhe afrimin.

Të gjitha këto që i cekëm dhe ato provokimet që i njohin njerëzit, shpiejnë drejt këtij amoraliteti, ndjellin dhe nxisin epshet, por kjo rrugë është shumë e keqe.

¹ *Tefsiri* i Fahrud-din Raziut, vëll. 23, f. 220.

3. Ndërtimi i statujave dhe prodhimi i kryqeve

Siç pamë më parë, Islami ndalon përdorimin e statujave, bile edhe më tepër prodhimin e tyre.

Buhariu transmeton se Seid ibn Ebu El-Hasan ka thënë: Isha te Ibn Abbasi dhe papritmas i erdhi një njeri e i tha: "O Ibn Abbas. Unë jetoj nga fitimi prej duarve të mia dhe i prodhoj këto figura!" Ibn Abbasi i thotë: Të tregoj se e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:

"Zoti do ta dënojë atë që bën piktura derisa t'u japë shpirt, mirëpo nuk do të mund t'u japë asnjëherë!" Kur vërejti Ibn Abbasi se ky njeri u hutua, vazhdoi e tha:

"Nëse je i detyruar, atëherë bëri prej këtij druri dhe prej çdo gjësendi që s'ka shpirt!"¹

Në këtë kontekst bën pjesë edhe prodhimi e putave, i kryqeve dhe i gjësendeve të ngjashme.

Sa i përket vizatimit dhe fotografisë, thamë më parë se më afër esencës islame është lejimi (ose mekruh), mirëpo këtu përjashtohet vizatimi i gjërave të ndaluara në Islam, si p.sh. eksponimi i pjesëve provokative të trupit të femrës, paraqitja e mashkullit duke e puthur gruan etj. Në kategorinë e gjërave të ndaluara bëjnë pjesë edhe figurat që glorifikohen e shenjtërohen, si p.sh. figurat e engjëjve, të pejgamberëve, etj.

4. Prodhimi i pijeve dehëse dhe i narkotikëve

Më parë theksuam se Islami ndalon çdo pjesëmarrje në prodhimin, përgatitjen, shpërndarjen dhe në përdorimin e alkoolit. Pejgamberi

¹ Transmetim i Buhariut.

a.s. mallkon çdonjërin që merret me këto punë. Në këtë kontekst bën pjesë edhe ndalimi i materieve narkotike, si p.sh. i heroinës, opiumit etj.

Pra, Islami ndalon muslimanin të punojë në çdo prodhim ose profesion që ka të bëjë me haramin ose me përgatitjen e haramit.

Fitimi nëpërmjet tregtisë

Në tekstet kur'anore dhe në hadithet e Pejgamberit vërehet se Islami ka përqendrim të fortë në tregti, nxit angazhimin dhe udhëtimin për të, dhe e quan "Kërkim i begative të Zotit". Zoti i Madhëruar i krahason tregtarët që udhëtojnë mbi sipërfaqen e tokës për tregti me muxhahedinët që luftojnë në rrugën e Tij. Në këtë kontekst, Ai thotë:

"Dhe të tjerët që gjallërojnë nëpër tokë duke kërkuar nga begatitë e All-llahut, e edhe të tjerët që luftojnë në rrugën e All-llahut." (Muzemmil, 20)

Në Kur'an potencohen rrugët tregtare që ua ka mundësuar Zoti njerëzve, edhe atë për tregtinë e brendshme e të jashtme nëpërmjet lidhjeve detare, të cilat janë më të njohura në transportin e tregtisë botërore. Rreth nënshtimit të detit dhe lundrimit të anijeve tregtare, Zoti i Madhëruar thotë:

"E i sheh anijet se si çajnë ujin për të kërkuar të mirat e Tij..." (Fâtir, 12)

E ndonjëherë e përmendë fryerjen e erërave:

"Nga argumentet e Tij është edhe: që Ai t'i lëshojë erërat myzhdexhinj dhe t'u shijojë juve nga mëshira e vet (shiun); dhe të lundrojnë anijet me vullnetin e Tij, dhe që të përfitoni nga të mirat e Tij, dhe ashtu, ju të jeni mirënjohës." (Er-Rrûm, 46)

Kur'ani përsërit termin "begati" me qëllim të shfrytëzimit të saj. Ai përmend edhe gjithësinë si argument për ekzistimin, fuqinë dhe urtësinë e Zotit:

"Të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve." (El-Bekare, 164)

"Dhe nga argumentet e Tij (që dokumentojnë fuqinë e Tij), janë anijet lundruese nëpër det si të ishin kodra." (Esh-Shûrâ, 32)

Në Kur'an ceket gjithashtu se Zoti ua ka mundësuar mekkasve që Mekka të jetë qendër tregtare e shkëlqyeshme në Siujdhesën e Arabisë:

“Po a nuk u siguruam Ne atyre një vend të shenjtë e të sigurt që aty sillen frytat e çdo sendi si furnizim nga ana jonë.” (Kasas, 57)

Në këtë mënyrë është realizuar lutja e Ibrâhimit a.s.:

“Zoti ynë! Unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, e pranë Shtëpisë së Shenjtë. Zoti ynë! (I vendosa aty) që të falin namazin, pra bëre që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata, dhe, për të të falënderuar me mirënjohje, furnizoi ata me fruta.” (Ibrâhim, 37)

Zoti thekson se kurejshitëve u ka mundësuar dy udhëtime tregtare në çdo vit, një udhëtim dimëror deri në Jemen, e tjetrin veror deri në Sham. Ata udhëtojnë të sigurt për hir të Mekkes. Pra, le t'i falënderohen Zotit për këto begati me adhurimin e Zotit të vetëm, Zotit të Shtëpisë dhe me adhurimin e Atij që është i meritueshëm për dhurimin e begative të tilla:

“Për hir të garantimit që e gëzojnë kurejshitët! Garantimin e udhëtimit të tyre të lirë dimrit dhe verës! Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie, i cili i ushqen pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike.” (Kurejsh, 1-4)

Islami ka mundësuar këmbimin tregtar ndërmjet muslimanëve të gjitha vendeve dhe viseve të botës edhe atë në sezonin vjetor islam botëror, gjegjësisht në sezonin e haxhxit në Shtëpinë e Shenjtë të Zotit:

“Dhe thirr ndër njerëz për haxhxin, se të vijnë ty këmbësorë, e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta.” (Vijnë) Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin All-lahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe për atë se i ka furnizuar me kafshë.” (Haxh, 27-28)

Prej dobive të tilla, pa dyshim është edhe tregtia. Buhariu transmeton se muslimanët ngurrenin të merreshin me tregti në kohë të haxhxit nga frika se mos po ndikonte kjo në nijetin e tyre të sinkertë dhe mos po njollosej pastërtia e adhurimit të tyre. Për këtë shkak, Kur'ani u thotë në mënyrë të qartë e të prerë:

“Nuk është mëkat për ju të kërkonit begati nga Zoti juaj (të bëni ndonjë tregti gjatë haxhxit).” (El-Bekare, 198)

Kur'ani i lëvdëron ata të cilët shkojnë shpesh në xhami dhe e madhërojnë Zotin e tyre në mëngjes e në mbrëmje:

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur All-llahun, për të falur namazin dhe për të dhënë zeqatin...” (Nûr, 37)

Sipas Islamit, besimtarët nuk janë ata që rrijnë nëpër xhamia, as dervishët e teqeve e as murgjit e manastireve por janë njerëz të punës. Karakteristikë e tyre është se punët e kësaj bote nuk i largojnë nga obligimet e tyre fetare.

Këto ishin disa mësimet e Kur'anit rreth tregtisë.

Gjithashtu edhe Sunneti, gjegjësisht edhe Pejgamberi i Islamit i nxiste njerëzit në tregti, kishte kujdes ndaj saj dhe orvatej t'i formonte bazat e saj me fjalë, vepra e pëlqime.

Prej haditheve të tij të urta janë këto:

“Tregtari i drejtë dhe i sinqertë do të jetë me dëshmorët në Ditën e Kijametit.”¹

“Tregtari i drejtë dhe i sinqertë do të jetë me pejgamberët, me të sinqertët dhe me dëshmorët.”²

Të mos habitemi pse Pejgamberi a.s. e krahason tregtarin e sinqertë me shkallën e muxhahidit. Pra edhe pse shehidi bie dëshmor në rrugë të Zotit, përvoja e jetës na mëson se xhihadi nuk zhvillohet vetëm në fushat e luftës por edhe në fushën e ekonomisë.

Zoti ua premtoi tregtarëve këtë pozitë të lartë dhe këtë shpërblim të madh në botën tjetër ngase tregtia, në përgjithësi nxit ambiciet dhe fitimin në çdo mënyrë. Kështu, pasuria lind pasurinë dhe fitimi nxit fitimin më të madh, dhe ai që qëndron brenda kufirit të sinqeritetit e besnikërisë, konsiderohet muxhahid i suksesshëm kundër epshit. Në këtë mënyrë ai meriton shkallën e muxhahidinëve. Pastaj tregtia i zhytë tregtarët në shifrat e veta dhe në kalkulimin e kapitalit e fitimeve. Në kohën e Pejgamberit a.s. erdhi një karvan i tregtisë përderisa Pejgamberi ligjëronte në hytbe, dhe pasi që populli dëgjoi për ardhjen e tij, u angazhuan me të dhe u larguan prej Pejgamberit duke u drejtuar nga karvani. Në atë rast, Zoti i Madhëruar shpalli ajetin me të cilin qorton:

¹ Transmetim i Ibën Maxhes.

² Transmetim i Hakimit dhe i Tirmidhiut me sened hasen.

“Po, kur ata shohin ndonjë tregti ose ndonjë aheng ia mësyjnë atje, kurse ty të lënë në këmbë. Thuaju: “Ajo që është tek All-llahu, është shumë më e mirë se dëfrimi dhe tregtia, e All-llahu është furnizuesi më i mirë.” (Xhumu'a, 11)

Ai që mund të mbetet në këtë proces me bindje të fortë, me zemër përplot frikë nga Zoti dhe me përmendjen e Zotit, atëherë meriton të jetë në një shkallë me ata të cilët i gradoi Zoti, kryesisht me pejgamberët, me të sinqertët dhe me dëshmorët.

Mjafton të shohim qëndrimin e Pejgamberit a.s. ndaj tregtisë dhe ndaj aspektit shpirtëror. Ai në Medinë ndërtoi xhaminë nga devotshmëria ndaj Zotit, që të jetë qendër për ibadet, çerdhe e diturisë, shtëpi e thirrjes dhe qendër e shtetit. (Përveç aspektit shpirtëror), ai tregoi interesim edhe për aspektin ekonomik, p.sh. ngriti treg të pastër islam ku nuk dominonin hebrenjtë ashtu siç ishte më parë me fisin Kajnuka. Vetë Pejgamberi a.s. e bëri sistematizimin e punës, gjithmonë jepte këshilla e udhëzime, nuk kishte mashtrim, nuk kishte padrejtësi në matjet me kandar, pa pasuri të vënë në një anë dhe pa çmime më të ulta se të tjerët...

Më gjerësisht do të flasim në kapitullin rreth hallallit dhe haramit në jetën e përditshme të muslimanit.

Nga biografitë e sahabëve shohim se prej tyre ka patur tregtarë të shkathët, zejtarë, bujq dhe profesionalistë e zejtarë të tjerë.

Në mesin e tyre ishte Pejgamberi i Zotit, të cilit i shpallehin ajetet nga Zoti, i thirrte me fjalën nga qielli, kishte shpirt besnik dhe fliste me Shpalljen e Zotit. Të gjithë e donin këtë pejgamber me sinqeritet e besnikëri dhe çdonjëri prej tyre nuk dëshironte të largohej prej tij asnjë çast. Edhe pse mbretëronte një situatë e tillë, përsëri vërejmë se të gjithë sahabët e tij punonin punët e tyre, disa në tregti, disa në bujqësi e disa të tjerë në profesionet e zejjet tjera. Ai që nuk prezentonte në disa nga mësimet e Pejgamberit, u drejtohej shokëve dhe i pyeste ata sipas mundësisë. Ata ishin të detyruar që ta informojnë atë që kishte munguar.

Ensarët në përgjithësi ishin bujq ndërsa muhaxhirët tregtarë.

S'ad Ibn Rebi El-Ensariu i ofroi ndihmë vëllait të vet në fe, muhaxhirit Abdurahman ibn Afit, duke i propozuar që t'ia dhurojë pasurinë dhe shtëpinë e vet. Kur ia ofroi këto gjëra, i tha Sa'dit: “Zoti të bekoftë ty, pasurinë tënde dhe familjen, unë nuk kam nevojë, por a ka ndonjë treg këtu?” Kur i thotë se është tregu i fisit Kajnuka, shkon me një sasi të vogël djathi e tëlyeni dhe kështu fillon të shesë

e të blejë derisa u bë prej muslimanëve më të pasur. Vdiq si pronar i një pasurie të madhe.

Ebu Bekri merrej me tregti dhe shkante në treg deri kur muslimanët e zgjodhën halif të tyre.

Umeri thotë për vetveten: “Shkuarja nëpër tregje më largonte nga dëgjimi i hadithit të Pejgamberit a.s”.

I këtij rangu ishte edhe Uthmani dhe shumë të tjerë.

Qëndrimi i kishës ndaj tregtisë

Kështu shoqëria islame lëvizte në botë brenda parimeve të fesë, merrej me shitblerje pa preokupim e largim nga përmendja e Zotit. Gjendja ishte krejtësisht ndryshe me popujt e Mesjetës dhe me mbretëritë e shtetet e krishtera evropiane të cilat endeshin në mënyrë të paqartë mes idesë së shpëtimit të shpirtit nga gabimi dhe singeriteti. Këto teori, gjegjësisht Teoria e Klerosit, ndihmuan zhvillimin e zejeve dhe të tregtisë në një anë dhe mallkimin e njerëzve, të cilët i refuzonin mësimet e priftërinjve në anën tjetër, dhe u qaseshin zejeve, profesioneve dhe tregtisë. Gabimi nuk krahasohej me sasinë e mëkatit, por, siç thonin disa njerëz, ishte i përhershëm në qiell e në tokë dhe në këtë botë e në botën tjetër.

Shën Augustini thotë: “Biznesi, në të vërtetë, është gabim, ngase e largon shpirtin nga e vërteta, që është Zoti”.

Njëklerik tjetër thotë: “Një njeri që merret me shitblerje, i takon elitës së shitblerësve të larguar nga mëshira e faltores dhe nga shenjtëria e saj”.

Të gjitha këto fjalë e mendime, logjikisht janë vazhdim i mësimave të Shën Palit, i cili thotë se i krishteri nuk duhet ta ndjekë vëllain e vet të krishter në mënyrë gjyqësore. Duhet që të mos ketë tregti aktive ndërmjet të krishterëve.¹

Tregtia e ndaluar

Islami ndalon vetëm tregtinë që ka në vete padrejtësi, mashtrim, shfrytëzim ose diçka tjetër që ndalohet nga Islami.

Tregtia me pije alkoolike, me mjete narkotike, me derra, me idhuj, statuja ose me diçka të ngjashme konsiderohet tregti e ndaluar dhe

¹ Ligjëratë e prof. Isa Abduh Ibrâhim me titull: *Pozita e kamatës në konstruksionin e ekonomisë kombëtare*, f. 20.

çdo fitim nëpërmjet kësaj tregtie konsiderohet i pavlefshëm. Çdo ushqimi prej tregtisë së tillë i pason zjarri. Ai që merret me tregti të tillë nuk është i singertë dhe besnik. Këtë tregti Islami e lufton që në esencë dhe në asnjë mënyrë nuk e pranon.

Tregtia me ar e argjend është e lejuar ngase lejohet për gratë, përveç tregtisë me diçka që përdoret vetëm për burra.

Në qoftë se tregtia me diçka është e lejuar, atëherë tregtari duhet të ketë kujdes ndaj disa gjërave, sepse në të kundërtën mund të ringjallet në Ditën e Kijametit në mesin e njerëzve të pandershëm, e njerëzit e pandershëm e kanë vendin në xhehennem.

Kur shkoi Pejgamberi a.s. njëherë në xhami, i pa njerëzit duke u marrë me tregti dhe u tha: *“O tregtarë!”* Ata iu përgjigjën, i ngrenë kokat dhe i drejtuan sytë nga ai. Pastaj vazhdoi e u tha: *“Tregtarët do të ringjallen Ditën e Kijametit të pamoralshëm, përveç atyre që i frikohen Zotit, bëjnë mirë dhe janë të singertë.”*¹

Transmetohet se Vathile ibn Aska ka thënë: “Kur vinte Pejgamberi a.s. tek ne tregtarët, thoshte:

*“O tregtarë, kini kujdes e mos gënjeni!”*²

Tregtari duhet të ketë kujdes nga mashtrimi, ngase mashtrimi është dobësia e tregtarëve. Mashtrimi shkakton amoralitet dhe amoraliteti shpie në zjarr. Gjithashtu duhet të ketë kujdes në betimin ndaj masës posaçërisht në betimin e rrejshëm. Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Tirmidhiut, Ibën Habbanit, Ibën Maxhes dhe Hakemit. Tirmidhiu thotë se është hadith hasen sahih.

² Transmetim i Taberanit.

“Zoti nuk do t’i shikojë Ditën e Kijametit tre persona, nuk do t’i pastrojë (nga mëkatet) dhe do t’u japë dënim të hidhur: njëri prej tyre është ai që shet me betim të rrejshëm!”¹

Ebu Se’idi transmeton se një fshatar ka kaluar afër tij me një dele dhe ky e ka pyetur: “A e shet për tre derhemë?, e ai i është përgjigjur: “Jo, për Zotin!”, e pastaj e ka shitur. Kur ia ka rrëfyer këtë Pejgamberit a.s., ai i ka thënë: *“E ka shitur botën tjetër për këtë botë.”*²

Tregtari duhet të ketë kujdes nga mashtrimi, se mashtruesi nuk i takon ummetit islam.

Ai gjithashtu duhet të ketë kujdes nga mashtrimi në matje. (Mjerë për mashtruesit në kandar!)

Ai duhet të ketë kujdes nga zbritja e çmimeve përderisa nuk dëshiron të largohen prej tij as Zoti e as Pejgamberi.

Ai duhet të ketë kujdes nga kamata ngase Zoti e urren. Në një hadith thuhet:

“Njeriu që ha një dirhem nga kamata, është sikur të bënte zina (kurvëri) 36 herë!”³

Këtë çështje do ta detajizojmë në kapitullin rreth *Marrëdhënieve të ndërsjella njerëzore*.

¹ Transmetim i Muslimit dhe i të tjerëve.

² Transmetim i Ibën Habbanit në Sahihun e tij.

³ Transmetim i Ahmedit dhe i të tjerëve.

Puna me pagesë

Muslimani është i lirë të fitojë edhe nëpërmjet ndonjë funksioni me rrogë, qoftë i shtetit, i ndonjë organizate shtetërore ose private, përdërisa është i aftë dhe ka mundësi t'i kryejë obligimet e veta. Nuk i lejohet muslimanit të kandidohet në ndonjë punë për të cilën nuk është i aftë, posaçërisht nëse bëhet fjala për ndonjë pozitë në qeveri ose në jurisprudence.

وَيْلٌ لِلْمُرَاءِ . وَيْلٌ لِلْعُرَقَاءِ (الرُّؤَسَاءِ) وَيْلٌ لِلْأُمَنَاءِ
(الْحَفَظَةُ عَلَى الْأَمْوَالِ) لَيَتَمَنَّيْنَ أَقْوَامٌ يَوْمَ الْقِيَامَةِ أَنَّ
ذَوَائِبَهُمْ مُعَلَّقَةٌ بِالْثُرَيَّا، يُدْكُونُ بَيْنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ، وَأَنَّهُمْ
لَمْ يَلَوْا عَمَلًا.

Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Mjerë për udhëheqësit, mjerë për liderët dhe mjerë për kujdestarët! Në Ditën e gjykimit disa njerëz do të dëshirojnë që më mirë të ishin të varur për yllin polar sesa të kishin qenë përgjegjës të punëve të tyre!”¹

وَعَنْ أَبِي ذَرٍّ: قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ! أَلَا تَسْتَعْمِلُنِي؟ (أَيُّ
فِي مَنْصِبٍ) قَالَ: فَضْرَبَ بِيَدِهِ عَلَى مَنْكِبِي، ثُمَّ قَالَ: يَا أَبَا
ذَرٍّ، إِنَّكَ ضَعِيفٌ، وَإِنَّهَا أَمَانَةٌ، وَإِنَّهَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ خِزْيٌ
وَنَدَامَةٌ، إِلَّا مَنْ أَخَذَهَا بِحَقِّهَا وَأَدَّى الَّذِي عَلَيْهِ فِيهَا.

Ebu Dherri i ka thënë Pejgamberit a.s. “O i dërguari i Zotit! A nuk më cakton (në ndonjë detyrë?)”. Pejgamberi i ka ra në shpatull dhe i ka thënë: “O Ebu Dherre! Ti je i dobët, obligimi është përgjegjësi; në Ditën e Kijametit do të të shkaktojë turpërim dhe pendim; përveç atij që punon dhe i përgjigjet përgjegjësisë së (obligimit)!”²

Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Ibën Habbanit dhe Hakemit.

² Transmetim i Muslimit.

وَقَالَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: الْقُضَاةُ ثَلَاثَةٌ: وَاحِدٌ فِي الْجَنَّةِ،
وَاِثْنَانِ فِي النَّارِ. فَأَمَّا الَّذِي فِي الْجَنَّةِ فَرَجُلٌ عَرَفَ الْحَقَّ
فَقَضَى بِهِ، وَرَجُلٌ عَرَفَ الْحَقَّ فَجَارَ فَهُوَ فِي النَّارِ، وَرَجُلٌ
قَضَى لِلنَّاسِ عَلَى جَهْلٍ فَهُوَ فِي النَّارِ.

“Gjykatësit ndahen në tre grupe: një grup në xhennet dhe dy në xhehennem. Në xhennet do të hyjë ai që e ka ditur të vërtetën dhe ka gjykuar me drejtësi, kurse në xhehennem do të hyjë ai që e di të vërtetën por ka gjykuar në mënyrë të padrejtë dhe ai që i gjykon njerëzit me injorancë (padituri).”¹

Muslimanit më tepër i preferohet që të mos ketë aspirata për pozita të larta, edhe në qoftë se i meriton. Çdokush që e konsideron pozitën si mjet mbizotërimi ndaj të tjerëve, shndërrohet në rob. Kush përqëndrohet përgjithësisht në formalitetet e tokës, nuk do të ketë udhëzim nga qielli.

Abdurrahman Ibn Semra thotë se Pejgamberi a.s. i ka thënë:

“O Abdurrahman! Mos kërko postin udhëheqës; nëse caktohesh pa e kërkuar do të ndihmohesh, e nëse e kërkon, atëherë, vetë do të jeshë përgjegjës!”²

Enesi transmeton se Pejgamberi a.s. i ka thënë:

“Kush e kërkon postin e gjykatësit duke mbledhur rekomandime, do t’i mbështetet vetëm vetvetes, e kush obligohet që ta pranojë, Zoti do t’i dërgojë një engjell që do ta udhëzojë.”³

Në qoftë se dikush e di se askush nuk mund ta zëvendësojë në ndonjë detyrë, dhe në qoftë se nuk e pranon dhe e shkatërron interesin,

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

³ Transmetim i Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

atëherë duhet ta pranojë. Në këtë kontekst Kur'ani na rrëfen ngjarjen e Jûsufit me mbretin:

“Ai (Jûsufi) tha: “Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm!” (Jûsuf, 55)

Këto ishin mësimet e Islamit në ushtrimin e funksioneve politike dhe të ngjashme.

Detyrat e ndaluara

Atë që e thamë rreth punësimit të lejuar, kushtëzohet që të mos i dëmtojë muslimanët. Nuk i lejohet muslimanit të punojë si epror ose si ushtar në ushtrinë që lufton kundër muslimanëve; nuk i lejohet të punojë në fabrikë ku prodhohen armë për t'i luftuar muslimanët, si dhe nuk i lejohet të punojë në ndonjë organizatë që kundërshton Islamin dhe i lufton muslimanët.

Gjithashtu ndalohet punësimi në ndonjë funksion që ndihmon tiraninë ose të ndaluarën, puna me kamatë, puna në vendin e alkoolit, në klube të natës, në ndonjë sallë vallëzimi, etj.

Ata që punojnë në këto vende të punës konsiderohen mëkatarë nga se e ndihmojnë haramin. Thamë më parë se sipas parimeve të Islamit, ndihma e mëkatit konsiderohet mëkat, dhe për këtë shkak Pejgamberi a.s. e mallkon regjistruarin e kamatës, dy dëshmitarët dhe shfrytëzuesin e saj. Ai gjithashtu mallkon prodhuesin e alkoolit, pjesëmarrësin në prodhimin e tij dhe atë që e konsumon.

Në qoftë se mbizotëron nevoja e obligueshme, atëherë muslimani mbështetet në punët e atilla dhe arsyetohen por ai duhet të urrejë një punë të tillë, dhe të vazhdojë të kërkojë derisa të gjejë punë të lejuar dhe larg haramit.

Muslimani i vërtetë gjithmonë largohet nga vendet e dyshimta ku dobësohet feja dhe e vërteta, pa marrë parasysh se sa fiton. Pejgamberi a.s. thotë:

“Braktise të dyshimtën dhe merre të padyshimtën!”¹

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

¹ Transmetim i Ahmedit, Tirmidhiut, Nesaiut, Ibën Habbanit në Sahihun e tij dhe i Hakimit. Tirmidhiu thotë se është hadith hasen sahih.

“Robi e fiton gradën e të devotshëmve kur të largohet prej të dyshimtës dhe ta marrë të padyshimtën.”¹

Parimi i përgjithshëm i fitimit

Parimi i përgjithshëm i fitimit është se Islami nuk u lejon ithtarëve të vet të fitojnë ashtu siç dëshirojnë dhe në çfarëdo mënyre, por ua cakton rrugët e lejuara dhe të palejuara sipas sheriatit për përfitimin e tyre, duke u mbështetur në interesin e përgjithshëm. Ky dallim mbështetet në parimin e përgjithshëm se të gjitha mënyrat e fitimit të pasurisë që janë në dëm të të tjerëve konsiderohen të ndaluara, kurse të gjitha mënyrat për fitimin e individëve që konsultohen njëri me tjetrin dhe janë në pajtim, konsiderohen të lejuara.

Këtë parim e thekson edhe Zoti i Madhëruar:

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete dhe mos e mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, All-llahu është i mëshirshëm për ju. Kush bën këtë (që ndaloj Zoti) qëllimisht dhe i kapërcen kufijtë, Ne do ta hedhim atë në një zjarr të fortë. Dhe kjo është lehtë për All-llahun.” (Nisâ, 29-30)

Ky ajet e kushtëzon tregtinë me dy kushte:

1. Të jetë tregti me pëlqim të ndërsjellë, dhe
2. Të mos ndikojë fitimi i njërit në humbjen e tjetrit.

Këtë e sqaron pjesa e ajetit:

“... mos e mbytni veten tuaj!”

Komentuesit këtë e komentojnë në dy mënyra: mënyra e parë nënkupton që të mos e vrasin njëri-tjetrin, kurse e dyta nënkupton që të mos vriten me duart e veta. Sidoqoftë, këtu nënkuptohet se ka të bëjë me atë që dëmton tjetrin për interes të vetin personal dhe në fund e shkatërron vetveten. Vjedhja, ryshfeti, bixhozi, tradhtia, mashtrimi, keqinterpretimi e kamata dhe shumë punë të tjera, për shkak të këtyre dy shkaqeve konsiderohen të ndaluara. Në qoftë se në ndonjërin prej tyre ekziston kushti i pëlqimit të ndërsjellë, gjithashtu nevojitet edhe kushti që përmendet në fjalën e Zotit të Madhëruar:

“Mos e mbytni veten tuaj!”²

¹ Transmetim i Tirmidhiut.

² Prof. Ebu Ala El-Meududi, *Ususul-iktisâd*, f. 152.

KAPITULLI I TRETË

HALLALLI DHE HARAMI NË MARTESË DHE NË JETËN FAMILJARE

- Aspekti i instinktit
- Martesa
- Marrëdhëniet ndërmjet dy të martuarve
(ndërmjet burrit dhe gruas)
- Kontracepcioni
- Shkurorëzimi
- Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

NË ASPEKTIN E INSTINKTIT

Zoti xh.sh. e krijoi njeriun si mëkëmbës të vetin në tokë duke ia mundësuar jetën në të. Kjo gjini mund të mbijetojë në tokë vetëm nëse mbjell e punon, ngrit e ndërton, si dhe i kryen obligimet ndaj Zotit xh.sh.. Për t'u plotësuar të gjitha këto gjëra, Zoti ka krijuar një sasi të instinkteve dhe faktorin psikik, të cilat garantojnë vazhdimësinë e njeriut si individ dhe si gjini njerëzore.

Një prej instinkteve të tilla është instinkti për ushqim, me të cilin garanton vazhdimin e llojit të vet si individ, kurse nëpërmjet instinktit seksual vazhdon gjininë e vet. Ky instinkt është i thelluar brenda njeriut dhe kërkon kënaqësitë dhe nevojat e veta. Njerëzit i janë përgjegjës instinktit seksual në tri mënyra të ndryshme:

Qëndrimi i njeriut para instinktit seksual

1. Plotësimi i instinktit seksual në mënyrë plotësisht të lirë e të pakufizuar nga feja, morali ose tradita. Ky është parimi i doktrinëve për lirinë seksuale, të cilat nuk pranojnë as fenë e as virtytin. Me këtë qëndrim njeriu degradohet në nivelin e kafshës dhe shkatërrohet individi, familja dhe mbarë shoqëria.

2. Përpjekja për të bërë presion dhe shtypje mbi instinktin e tillë ashtu siç veprojnë doktrinat e asketizmit, monasticizmit dhe pesimizmit, si psh. maoizmi dhe filozofitë tjera vetëmohuese.

Ky qëndrim ngulfatë instinktin, ndalë funksionin e tij, kundërshton urtësinë e Atij që e ka gërrshetur në strukturën e njeriut dhe ballafaqohet me parimin e jetës që i shfrytëzon instinktet e tilla për të vazhduar.

3. Ose të përcaktohen rregulla e kufij, të cilët as nuk do ta shtypin e as nuk ofrojnë liri të pakufizuar, ashtu siç veproun të gjitha fetë qiellore, që institucionalizuan martesën dhe ndaluan shkeljen e kurorës; në veçanti duhet të theksohet Islami, i cili e pranoi këtë

instinkt, e lehtësoi me hallall dhe ndaloi largimin prej grave ashtu siç ndaloi kurvërinë dhe mënyrat e faktorët që shpiejnë në kurvëri. Ky qëndrim është mesatar dhe i drejtë. Sikur të mos ishte legalizimi i martesës, instinkti nuk do ta luante rolin e vet për vazhdimin e jetës së njeriut. Sikur të mos ndalohej lidhja seksuale e pakufizuar dhe sikur të mos përcaktohej njeriu për një grua (të lejuar), atëherë nuk do të ekzistonte familja, e cila konsiderohet faktor kryesor i formimit të ndjenjave të larta shoqërore, të dashurisë, të mëshirës dhe të sakrifikimit. Sikur të mos ishte familja, nuk do të formohej shoqëria e as nuk do ta arrinte zhvillimin dhe përkryerjen e saj.

Mos iu afroni kurvërisë (zinasë)

S'duhet habitur se të gjitha fetë qiellore e ndalojnë dhe e luftojnë kurvërinë (zinanë), posaçërisht Islami i cili rreptësisht e ndalon dhe tërheq vërejtjen se në këtë mënyrë mund të shkaktohen rrjedha kaotike, krime të lindjes, devijime familjare, shkatërime të lidhjeve, përhapje të sëmundjeve të pashërueshme, mbizotërime të epshëve dhe rrënime të moralit. E vërtetë është fjala e Zotit kur thotë:

“Dhe mos iu afroni amoralitetit (zinasë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe”. (Isrâ, 32).

Siç e dimë, kur Islami ndalon diçka, së pari i ndërmerr masat parandaluese për t'i penguar të gjitha mënyrat dhe format që shpiejnë në haram. Ai nuk i ka konsultuar instinktet e tilla që t'i hapë të gjitha dyert e dritaret për mashkullin apo femrën dhe të paraqitet amoraliteti. Islami, pra, ndalon çdo gjë që nxitë epshet duke ndërmarrë masa parandaluese.

Ndalohet qëndrimi me femër të huaj në vetmi

Islami ndalon burrin të qëndrojë në vetmi me ndonjë grua të huaj, gjegjësisht me atë që nuk e ka të martuar por vetëm nëse e ka të afërt e me të cilën s'mund asnjëherë të martohet, si p.sh. motra, halla, tezja etj...

Kjo nuk nënkupton mosbesimin ndërmjet tyre ose në njërin prej tyre, por e konsideron si masë parandaluese ndaj cytjeve të këqija

dhe pëshpëritjeve të të keqes, të cilat mund të lindin gjatë takimit të mashkullit me femrën pa të tretin tyre. Në këtë kontekst,

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Le të mos qëndrojnë mashkulli në vetmi me ndonjë grua që nuk është e ndaluar për të në qoftë se beson Zotin dhe Ditën e gjykimit, ngase i treti i tyre është djalli.”*¹

Në ajetin kur'anor rreth grave të Pejgamberit, Zoti i Madhëruar thotë:

“E kur të kërkonit prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkonë pas perdes, kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre.” (Ah'zâb, 53).

Imam Kurtubiu e komenton këtë ajet dhe thotë: “Ka për qëllim mendimet e rrezikshme që mund të lindin në mendjen e burrave ndaj grave dhe anasjelltas.

Kjo formë më së miri e largon dyshimin e akuzimin dhe është më e fuqishme për mbrojtje.

Kjo tregon se askush nuk duhet të mbështetet në vetveten në rast të qëndrimit në vetmi me të pandaluarën për të, por më mirë do të ishte sikur të largohej e ta mbronte plotësisht vetveten.”²

Këtu Pejgamberi a.s. tërheq vërejtjen e pasaçme ndaj vetmisë së femrës me të afërmit e burrit të vet si p.sh. me vëllain ose kushëririn e tij ngase mund të ndodhë gjithçka në raste të tilla. E njëjta gjë aplikohet edhe me të afërmit e saj, si p.sh. kushërirën e saj. Pejgamberi a.s. thotë:

“Kini kujdes dhe mos hyni te gratë”. Një ensar e pyeti Pejgamberin: “O Pejgamber i Zotit, po me të afërmit (e burrit)?” e ai i përgjigjet:

¹ Transmetim i Ahmedit nga Amir ibën Rebia, kurse në *Sihahajnin* e Abdull-llah ibën Abbasit thuhet: “Mos të mbetet në vetmi ndokush prej jush përveç me atë që ju ndalohet”.

² Tefsiri i Kurtubiut, vëll. 14, f. 228.

“*Aty qëndron vdekja*”.¹ (Termi “*hamv*” nënkupton të afërmit e burrit).²

Ai do të thotë se qëndrimi në vetmi paraqet rrezik dhe shkatërrim. Shkatërrohet feja nëse ndodh mëkati, shkatërrohet gruaja në qoftë se ndodh diçka e pamoralshme dhe shkatërrohen lidhjet shoqërore nëse përhapet mendimi i keq ndërmjet të afërmeve ndaj njëri-tjetrit. Këtu nuk i kërcënohet rreziku vetëm instinktit njerëzor por vihet në pyetje edhe familja dhe jeta e burrit dhe e gruas nga fjalët e atyre që flasin tepër, janë kureshtarë dhe dëshirojnë t’i shkatërrojnë familjet (shtëpitë). Në këtë kontekst, Ibn Ethiri thotë: “Arabët si zakonisht e përdorin termin ‘*El-hamvu el-mevtu*’ sikur që i përdorin frazat ‘Luani është vdekje’ dhe ‘Mbreti është zjarr’, gjegjësisht takimi të këta është i barabartë me vdekjen dhe zjarrin. Fraza: “Vetmia me të afërmit (e burrit) është vdekje, është më e keqe se me të huajt ngase mund të ndodhë diçka e papritur dhe e vështirë për burrin, e bashkëshortët nuk kanë dëshirë që të afërmit t’i dijnë fshehtësitë e tyre.”

Shikimi i gjinisë tjetër me sy epshi

Në sferën e instinktit seksual, Islami gjithashtu ndalon shikimin që ia hedh burri gruas dhe anasjelltas, ngase syri është çelësi i zemrës, shikimi është zëdhënës i epshit dhe bartës i mesazhit të amoralitetit. Një poet antik thotë:

*Çdo gjë me shikimin fillon,
Zjarrin e madh xixa e përfundon!*

Një poet bashkëkohor thotë:

*Një shikim, një buzëqeshje e përshëndetje
pastaj lidhje, biseda e takime.*

Për këtë shkak, Zoti i Madhëruar i urdhëron të gjitha besimtarët dhe besimtarët që t’i ruajnë shikimet, e pastaj menjëherë i urdhëron t’i ruajnë edhe organet e tyre:

“Thuaju besimtarëve t’i ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është hollësisht i njohur për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtareve të ndalin

¹ Transmetim unanim.

² Imam Neveviu thotë se në këtë hadith nënkuptohet vetmia me të afërmit e burrit përveç prindit dhe fëmijëve të tij. Mâzîrî mendon se ky term nënkupton edhe prindin e burrit. (Shiko *Fet-hul-bârî*, vëll. 11/344).

shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharonin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robërshave të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë për fëmijë e për femra ose fëmijëve që nuk kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësitë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim”. (Nûr, 30-31).

Në këto dy ajete ka disa udhëzime hyjnore: dy prej tyre janë të njëjta për burrat e gratë dhe kanë të bëjnë me ndaljen e syve dhe me ruajtjen e pjesëve të turpshme, ndërsa udhëzimet tjera u referohen vetëm grave.

Në këto dy ajete vërehet dallimi mes shprehjeve: *“t’i ndalin sytë”* dhe *“t’i mbrojnë organet seksuale”*, ngase organet seksuale duhet krejtësisht të jenë të mbrojtura pa kurrfarë përjashtimi, përderisa *“ndalimi i syve”* është i pjesërishëm, sepse nevoja dhe interesi i përgjithshëm i popullit mund të lejojnë shikimin.

“Mbyllja e syve” nuk do të thotë mbyllje e syrit e as ulje e kokës për tokë. Një gjë e tillë jo që nuk kërkohet por as që është e mundshme.

Të shprehurit e njëjtë e kemi edhe në fjalën e Zotit:

“Ule zërin tënd!” (Llukmân, 19)

Këtu nuk nënkuptohet mbyllja e plotë e gojës.

Mbyllja e syve aludon uljen e shikimit nga fytyrat e kalimtarëve dhe të mos përcillen tiparet atraktive të gjinisë femërore, të mos i shikojnë gjatë dhe të mos e përqëndrojnë vëmendjen në to!

Për këtë, Pejgamberi a.s. i ka thënë Ali ibn Ebi Talibit:

*“O Ali! Mos lejo të ta pasojë shikimi i dytë të parin! Shikimi i parë lejohet por jo edhe i dyti!”*¹

¹ Transmetim i Ebu Davudit dhe i Tirmidhiut.

Pejgamberi a.s. pohon se shikimi me sy epshi, qoftë për burra apo për gra, konsiderohet amoralitet i syrit e në këtë kontekst, ai thotë:

*“Dy sytë bëjnë amoralitet! Amoraliteti i tyre është shikimi!”*¹ Ai e quan amoralitet ngase shikohet me sy epshi dhe kënaqësie të instinktit seksual në mënyrë të palejuar.

Kjo përputhet me atë që theksohet në Inxhil rreth Isait a.s.:

“Ata para jush thonin: “Mos bëni amoralitet”, e unë ju them: “Ai që shikon me syrin e tij, bën amoralitet”. (Mateu, 5:27-28).

Shikimet e tilla plot uri dhe epsh nuk rrezikojnë vetëm dëlirësinë por rezultojnë edhe me shqetësimin e mendjes dhe përzierjen e mendimeve. Një poet thotë:

*Nëse lejon që shikimet tua të enden,
ato një ditë zemrën do ta ndezin!
Atë që e sheh, nuk mund ta keshë në tërësi,
e as pjesë-pjesë kënaqesh të paktën lehtësi!*

Ndalimi i shikimit të pjesëve të turpshme të trupit

Ndalohet shikimi i pjesëve të turpshme të trupit. Pejgamberi a.s. e ka ndaluar shikimin e tillë ndërmjet burrave ose grave, qoftë shikimi epsharak ose joepsharak:

*“Le të mos shikojë mashkulli pjesët e turpshme të mashkullit tjetër e as gruaja të gruas tjetër! Le të mos mbulohet mashkulli me mashkullin e as femra me femrën me një mbulesë!”*²

¹ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

² Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

Vendet e turpshme të mashkullit apo të femrës përcaktohen prej kërthizës e deri në gjunj. Ky kuptim ceket në hadith, kurse sipas disa imamëve, si Ibn Hazmi dhe disa malikitë, gjunji përjashtohet.

Si pjesë e turpshme e gruas për njeriun e huaj konsiderohet i tërë trupi përveç fytyrës dhe duarve, ndërsa për ata të cilët janë “mahrem”, gjegjësisht për të jatin dhe vëllain e saj, do të flasim në kapitullin rreth zbulimit të zbulurimit.

Ato pjesë që nuk lejohen për t’u shikuar, gjithashtu nuk lejohen as të preken me dorë ose me ndonjë pjesë të trupit.

Të gjitha këto ndalime, me prekje ose me shikim, vlejné në qoftë se nuk paraqitet ndonjë nevojë e domosdoshme si p.sh. ndonjë gjendje urgjente ose shërimi. Në atë rast ndalimi përjashtohet.

Lejimi i shikimit kushtëzohet me sigurimin nga amoraliteti dhe epshi, e nëse nuk mund të sigurohet nga amoraliteti e epshi, atëherë lejimi ndalohet si masë parandaluese.

Çka lejohet të shihet në trupin e burrit dhe të gruas

Nga ajo që cekëm më parë, vërejtëm se lejohet të shikojë gruaja atë që është jashtë pjesëve të ndaluara (auretit) tek burri (mbi kërthizë dhe nën gjunj), po që se nuk provokohen epshet as nuk ka frikë nga fitneja. Pejgamberi a.s. e ka lejuar Aishenë t’i shikojë abisinët, të cilët luanin me shtiza në Xhaminë e Pejgamberit, dhe kështu, ajo i ka shikuar derisa është lodhur e pastaj është larguar.¹

E njëjta gjë vlen edhe për burrin ndaj gruas (vetëm fytyrën dhe duart), por kushtëzohet gjithashtu mosprovokimi i epsheve dhe të mos ketë frikë nga fitneja.

Nga Aisheja transmetohet se Esma, e bija e Ebu Bekrit (motra e saj) ka hyrë e veshur me një veshje të hollë kur ka qenë i pranishëm edhe Pejgamberi a.s., mirëpo ai e ka kthyer fytyrën në anën tjetër dhe ka thënë:

يَا أَسْمَاءُ إِنَّ الْمَرْأَةَ إِذَا بَلَغَتِ الْمَحِيضَ لَا يَصْلَحُ أَنْ يُرَى
مِنْهَا إِلَّا هَذَا وَهَذَا – وَأَشَارَ إِلَى وَجْهِهِ وَكَفَّيْهِ.

“Oj Esma! Kur fillojnë të përmuajshmet e femrës, i lejohet t’i shihen vetëm kjo dhe kjo (vetëm fytyra dhe duart).”²

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Ebu Davudit.

Ky hadith është i dobët mirëpo e përforcojnë hadithet tjera autentike të cilat lejojnë vetëm shikimin e fytyrës dhe të duarve për t'u mbrojtur nga fitneja.

Në përgjithësi lejohet shikimi i pastër i pjesëve që janë jashtë "auretit", si për burrin ashtu edhe për gruan, por me kusht nëse nuk ripërsëritet dhe nuk provokohen epshtet.

Islami toleron shikimin e shpejtë që ndodh befasisht. Xherir ibn Abdull-llahu thotë:

عَنْ جَرِيرِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ قَالَ: سَأَلْتُ رَسُولَ اللَّهِ ﷺ عَنْ نَظَرِ
الْفُجَاءَةِ فَقَالَ: اصْرِفْ بَصْرَكَ.

se e ka pyetur Pejgamberin a.s. për shikimin e shpejtë, e ai i ka thënë: "*Largoi sytë!*",¹ që nënkupton: Mos e përsërit shikimin edhe një herë.

Cili zbukurim i lejohet gruas ta zbulojë e cili jo

Kjo ka të bëjë me ndalimin e shikimit, të theksuar në dy ajetet kur'anore për meshkujt dhe për femrat. Prej udhëzimeve hyjnore për femrat, në ajetin e dytë është edhe ky:

a. "Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre". (Nûr, 31).

Në stolitë e femrës bën pjesë çdo gjë që e zbukuron, qoftë zbukurimi natyror, si fytyra, flokët dhe trupi, apo artificial, si veshmbathja, stolitë dhe grimimi. Në këtë ajet Zoti i detyron gratë t'i fshehin stolitë e tyre. Ai ua ndalon atë vetëm me një përjashtim:

"Përveç atyre që janë të dukshme".

Mendimet e dijetarëve rreth ajetit "*Përveç atyre që janë të dukshme*" janë të ndryshme, si p.sh. ajo që duket në rast të paqëllimtë, konkretisht atë që e zbulon era, ose ajo që tradicionalisht dhe instinktivisht shihet!

Pjesa dërrmuese e fukahave të selefit e pranojnë mendimin e dytë. Është i njohur komentimi i Ibn Abasit në ajetin "*Përveç atyre që janë të dukshme*", i cili thotë se kjo ka të bëjë me "kohlin"² dhe unazën. Një komentim i tillë transmetohet edhe nga Enesi.

¹ Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

² Zbukurimi i syve me ngjyrë të zezë.

Lejimi i “kohlit” dhe i unazës krahasohet me lejimin e fytyrës dhe të duarve. Këtë mendim eksplicit e kanë mbështetur Said ibn Xhubejri, Atai, el-Evzai etj. Aisheja dhe Katadeja lejojnë edhe zbulimin e byzylykëve, dhe kjo nënkupton përjashtimin e një pjese të krahut. Mendimet janë të ndryshme rreth pjesës së lejuar duke filluar prej katër inçave deri në gjysmën e krahut.

Kundër këtij zgjerimi ishin Abdull-llah ibn Mes’udi dhe Nah’i, duke e komentuar ajetin “*vetëm ato që duken*”, se ka të bëjë me teshat e jashtme që s’mund të mbulohen.

Një grup prej sahabëve dhe tabi’inëve mendojnë se ky ajet “*Përveç atyre që janë të dukshme*”, ka të bëjë me fytyrën, duart dhe me stolitë e rëndomta e të patepruara, si p.sh. unaza e dorës, kohli i syve, të cilin mendim e përkrah edhe unë.¹

Lejimi këtu nuk e përfshin kozmetikën që e përdorin gratë sot për faqet, buzët e thonjtë e tyre, ngase ky lloj i zbukurimit konsiderohet teprim i urrejtur dhe lejohet vetëm brenda shtëpisë. Ndalohet kozmetika e grave që e përdorin sot jashtë shtëpisë për të tërhequr vëmendjen e meshkujve.

Komentimi i ajetit “*Përveç atyre që janë të dukshme*” që ka të bëjë me teshat e jashtme refuzohet, ngase nuk mund të përjashtohet diçka nga ajo që s’mund të ndalohet. Të njëjtin trajtim e ka edhe zbulimi i paqëllimtë, si p.sh. zbulimi nga era, ngase s’ka kontroll qoftë me përjashtim apo pa përjashtim.

Nga “përjashtimi” mund të nënkuptojmë lehtësimin për femrën besimtare që të zbulojë diçka që mund të mbulohet, dhe mund të kup-tohet se përjashtimi ka të bëjë me fytyrën dhe duart.

Lejohet zbulimi i fytyrës dhe i duarve ngase mbulimi i tyre është i vështirë për gruan, posaçërisht kur ka nevojë të dalë e të kryejë ndonjë punë të lejuar, si p.sh. përpjekja e vejanes për t’i rritur fëmijët jetima, ose puna e të varfërës për t’i ndihmuar burrit të saj. Siç shihet, obligimi i saj për t’i mbuluar duart dhe fytyrën do të shkaktojë pengesë dhe vështirësi për të.

Kurtubiu thotë: “Meqë fytyra dhe duart janë tradicionalisht të pambuluara dhe meqë duhet të jenë të pambuluara gjatë adhurimit, si p.sh. në namaz dhe në haxh, atëherë mendoj se përjashtimi ka të bëjë me to.” Ky konkludim mbështetet edhe me transmetimin e Ebu Davudit nga Aisheja r.a. Ajo thotë se Esmâ, bija e Ebu Bekrit

¹ Ky është mendimi i Taberit, Kurtubiut, Zamahsheriut, Raziut dhe i komentuesve tjerë. (Shiko më gjerësisht në tiparet e tyre!).

njëherë ka shkuar te Pejgamberi a.s. me tesha të holla, e ai e ka kthyer fytyrën anash dhe i ka thënë:

“Oj, Esma! Kur t’i fillojnë të përmuajshmet femrës, i lejohet ta zbulojë vetëm këtë dhe këtë (fytyrën dhe duart)”.

Në fjalën e Zotit:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit)”,

nënkuptohet se fytyrat e grave nuk kanë qenë të mbuluara, dhe sikur t’i kishin të mbuluara trupin dhe fytyrën, nuk do të kishte nevojë për t’i ndalur shikimet, ngase s’ka ç’të shihet.

Sidoqoftë, më e preferuar është që gruaja muslimane t’i mbulojë stolitë e saj, bile sipas mundësisë edhe të fytyrës për ta penguar amoralitetin e përhapur në kohën tonë, e posaçërisht kur bëhet fjalë për femrën e bukur.

b. “Le t’i vënë shamitë mbi kraharorin e tyre”. (Nûr, 31).

Obligohet gruaja muslimane ta mbulojë kokën, gjoksin e fytyrës ashtu që shikuesit të mos kenë mundësi të shohin asgjë.

c. “Të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet...” (Nûr, 31).

Ky udhëzim ndalon muslimanen t’i zbulojë stolitë e saj të brendshme, si p.sh. stolitë e veshëve, flokëve, fytyrës, gjoksit dhe nyjeve të këmbëve, para burrave të huaj, kryesisht para të cilëve i lejohet vetëm zbulimi i fytyrës dhe i duarve.

Nga ky ndalim përjashtohen dymbëdhjetë kategori njerëzish:

1. Bashkëshortët e tyre - burrit i lejohet të shohë çka të dëshirojë nga e shoqja e vet dhe anasjelltas. Në një hadith thuhet:

“Ruaji pjesët e turpshme të trupit tënd përveç nga gruaja jote!”

2. Baballarët e tyre - këtu bëjnë pjesë edhe gjyshërit si nga ana e nënës ashtu edhe nga ana e babait.

3. Baballarët e burrave - ngase trajtohen si prindër të tyre.

4. Djemtë e tyre - gjithashtu edhe nipat nga bijtë e bijat.

5. Djemtë e burrave të tyre - për shkak të jetës së përbashkët dhe trajtimit të tyre si nëna.

6. Vëllezërit e tyre - qofshin edhe vëllezër vetëm nga nëna ose nga babai.

7. Djemtë e vëllezërve të tyre - ngase ndalohet përgjithmonë martesa mes nipit dhe hallës së tij.
 8. Djemtë e motrave të tyre - për shkak të ndalimit të përhershëm të martesës mes nipit dhe tezes së tij.
 9. Gratë e tyre - gratë që kanë lidhje nga gjeneza ose nga feja. Gruas jomuslimane nuk i lejohet t'i shohë stolitë e gruas muslimane përveç atyre që i lejohen mashkullit.
 10. Robërshat të cilat i kanë në pronësinë e tyre - ngase Islami i konsideron si anëtare të familjes. Disa fukaha i lejojnë vetëm robërshat e jo edhe robërit.
 11. Meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat - ngase nuk anojnë nga gratë për shkaqe fizike apo psikike. Këtu është me rëndësi të ekzistojnë dy kushte: të jenë shërbëtorë të tyre në shtëpi dhe të mos kenë epsh seksual.
 12. Fëmijët që nuk kanë arritur pjekurinë për gra - këtu nënkuptohet fëmija që nuk ka ndjenja seksuale. Kur të vërehen simptomat e ndjenjave të tilla, atëherë u ndalohet grave t'i zbulojnë stolitë e fshehura para tyre, - edhe në qoftë se ende nuk kanë hyrë në periudhën e adoleshencës.
- Ajeti nuk i cekë xhaxhain dhe dajën ngase tradicionalisht kanë statusin e babait. Në një hadith thuhet:

*“Xhaxhai zëvendëson babain.”*¹

Pjesët e turpshme të gruas

Nga ajo që u cek më parë, kuptojmë se çdo gjë që s'i lejohet femrës ta zbulojë, konsiderohet “auret” - pjesë e turpshme e trupit, e cila duhet të mbulohet dhe e cila ndalohet të zbulohet.

Aureti vlenë për burrat e huaj dhe për gratë jomuslimane, përveç fytyrës dhe duarve, të cilat, sipas Raziut, lejohen të zbulohen për shkak të nevojave të përditshme obligative. Gratë urdhërohen ta mbulojnë atë që nuk dikton nevoja për zbulimin e saj, por u lejohet si lehtësim ajo që moralisht është e zbuluar dhe të vërtetohet toleranca e parimeve të pastra të Islamit.

Raziu thotë: “Meqë nevoja dikton zbulimin e fytyrës dhe të duarve, atëherë (dijetarët juristë) i konsiderojnë si pjesë trupore jasht “aure-

¹ Transmetim i Muslimit.

tit”. Meqë zbulimi i këmbës nuk është i domosdoshëm, vërejmë se janë ndarë mendimet rreth asaj se a konsiderohet “auret” apo jo!²

Për dymbëdhjetë kategoritë e përmendura në ajetin e sures “*Nûr*”, femrës i lejohet t’i zbulojë stolitë e brendshme të saj, si p.sh. të veshëve, të fytit, të flokëve, të gjoksit, të të dy krahëve e të të dy nyjeve të këmbëve. Pjesët tjera të trupit, si p.sh. shpina, barku, kofshet, gjoksi dhe pjesa intime e trupit, janë të ndaluara para të tjerëve përveç bashkëshortit.

Kjo më mirë kuptohet nga ky ajet se mendimet e disa juristëve islamë që thonë se “auret” konsiderohet pjesa mes kërthizës dhe gjunjve. Siç duket, ajeti përputhet me disa juristë, të cilët thonë se “aureti” i ndaluar është ajo që nuk lejohet të zbulohet gjatë kryerjes së punëve të shtëpisë; këtu nënkuptohet se çdo gjë që zbulohet gjatë punëve të shtëpisë, lejohet të shihet për ata që ndalohen për martesë.

Për këtë shkak, Zoti i detyron gratë besimtare ta mbulojnë trupin e tyre me mbulesë të gjerë kur të dalin jashtë (shtëpisë), me të cilën do të dallohen nga gratë tjera jobesimtare. Me këtë rekomandim, Zoti i drejtohet Pejgamberit dhe i thotë:

“O Pejgamber! Thuaju bashkëshorteve tuaja, bijave tuaja dhe grave të besimtarëve le të vënë shamitë (mbulojnë) e veta mbi trupin e tyre, sepse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen”. (Ah’zâb, 59).

Në periudhën e xhahilijetit paraislam, disa gra dilnin në rrugë me trup të zbuluar, gjegjësisht nuk i mbulonin fytin, gjoksin dhe flokët, dhe për këtë shkak përcilleshin nga të papunët dhe të dhënit pas epshëve. Ajeti kur’anor i urdhëron gratë të mbulohen me qëllim që të mos u duken pjesët atraktive të trupit, dhe në këtë mënyrë e dallon besimtaren dhe e mbron nga rrugaçët dhe hipokritët. Pra, është e qartë se ky urdhër i ajetit përmban në vete mbrojtjen e grave nga të këqijat e të pamoralshëmve dhe aventurierëve, e kurrsesi nuk ka të bëjë me humbjen e besimit ndaj tyre. Gruaja që është e zbukuruar me stoli e veshmbathje të bukur, që ec në mënyrë provokative dhe që flet me stil joshës gjithmonë tërheq vëmendjen e meshkujve dhe i nxit t’i shkojnë pas. Këtë e vërteton ajeti kur’anor:

“Mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, por thuani fjalë të matura”. (Ah’zâb, 32).

² Tefsiri i Fahrud-din Raziut, vëll. 23, f. 203-206.

Islami ka qëndrim rigoroz në çështjen e mbulesës dhe të mbrojtjes së femrës muslimane; ai jep lehtësime vetëm për femrat në moshë. Zoti i Madhëruar thotë:

“E gratë e moshuara të cilat nuk dëshirojnë martesë më, për to nuk është mëkat ta heqin petkun mbulues të tyre, po duke mos qenë zbuluese të bukurive, megjithëse për to më së miri është të jenë të përmbajtura. All-llahu dëgjon, e di!” (Nûr, 60).

Këtu bëhet fjalë për gratë që janë në periudhën post-monopauzale, të cilat nuk kanë dëshirë për martesë e as për burra, si dhe nuk janë tërheqëse për burrat. Pra, Zoti u ofron grave të tilla lehtësime në heqjen e mbulesës së jashtme. Kur’ani e kufizon lehtësimin e tillë me kushtin: “*Duke mos qenë zbuluese të bukurive*”, ngase ka për qëllim lehtësimin dhe gjendjen komfore. Edhe pse ekziston ky lehtësim, më mirë do të ishte sikur të kërkonin më të përkryerën dhe largimin nga e dyshimta: “*Më së miri për to është të jenë të përmbajtura*”.

Hyrja e gruas në banjot publike

Për shkak të kujdesit të Islamit ndaj mbrojtjes së pjesëve të turpshme të trupit (auretit) dhe ndaj mbulimit të tyre, Pejgamberi a.s. e ka ndaluar femrën të hyjë në banjot publike dhe ta zbulojë trupin e saj para grave, të cilat i shfrytëzojnë rastet e tilla për bisedat e ditës. Pejgamberi a.s. gjithashtu tërheq vërejtjen rreth hyrjes së mashkullit në banjot publike përveç nëse është i mbuluar e të mos e shohin të tjerët. Nga Xhabiri r.a. transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kush beson në Zotin dhe në Ditën e gjykimit, le të hyjë në banjo publike vetëm me mbulesë (të pjesëve intime). Ai që beson në Zotin dhe në Ditën e gjykimit, le të mos e lejojë gruan e vet të hyjë në banjot publike”.¹

¹ Mundhiri thotë se këtë e transmetojnë Nesaiu, Tirmidhiu e Hakimi. Gjithashtu thotë se është sahih sipas Muslimit.

Nga Aisheja r.a. transmetohet se Pejgamberi a.s. e ka ndaluar hyrjen në banjot publike pastaj ua ka lejuar meshkujve, por me kusht që t'i mbulojnë organet intime.¹

Leja specifike i jepet gruas që është e sëmure. Nga Abdull-llah ibn Amri transmetohet se Pejgamberi a.s. për banjot publike ka thënë:

*“Le të hyjnë burrat por të mbuluar, dhe u ndalohet grave përveç të sëmures dhe lehones”.*²

Në isnadin e këtij hadithi ka diçka të dobët, mirëpo parimet e shariatit rreth lehtësimit për të sëmurët dhe lehtësimit për t'i kryer obligimet dhe adhurimet, e përforcojnë dhe e përkrahin atë. Gjithashtu e përforcon edhe parimi i njohur se s'ndalohet si masë preventive por lejohet për nevojë dhe interes. Gjithashtu e përforcon edhe transmetimi i Hakemit nga Abdull-llah ibn Abbasi se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Largohuni (frikohuni) prej shtëpisë që quhet banjo!” Kur i kanë thënë Pejgamberit të Zotit se aty shkojnë për pastrim dhe për shërim, atëherë ai u është përgjigjur: *“Le të mbulohet ai që hyn!”*³

Nëse femra hyn pa kurrfarë shkaku ose nevojë të domosdoshme, bën mëkat (haram) dhe meriton qortimin e Pejgamberit a.s. Ebul-Melih El-Hudhelij (r.a.) rrëfen se disa gra nga Humsi dhe Shami kanë shkuar te Aisheja r.a. dhe ajo u ka thënë: “A jeni ju prej vendeve ku shkojnë gratë e tyre në banjot publike! Pejgamberi a.s. ka thënë:

¹ Ebu Davudi e transmeton dhe e mbështet hadithin, pastaj e transmetojnë edhe Tirmidhiu e Ibën Maxhe.

² Transmetim i Ibën Maxhes, Ebu Davudit dhe në senedin e tij është Abdurrahman ibën Zijade ibën En'âm El-Afrîkî.

³ Transmetim i Hakemit, i cili e pranon si sahih me kushtin e Muslimit. Mundhiri nuk e kritikon në Tergîb.

“Ajo që zhveshet në ndonjë vend tjetër përveç në shtëpinë e bashkëshortit të saj, shkatërrojnë perden mes saj dhe Zotit të saj!”⁴
 Nga Ummu Seleme transmetohet se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Çdo femër që zhveshet në ndonjë vend tjetër përveç shtëpisë së saj, Zoti do ta shkatërrojë perden e Tij ndaj saj!”²

Meqë Islami ka këso qëndrime të rrepta ndaj hyrjes së grave në shtëpinë me katër mure, ku hyjnë vetëm gratë, atëherë si do të jetë dispozita për lakuriqet, të cilat e ekspozojnë auringun e tyre para burrave në rrugë e në plazhë, kryesisht para syve të uritur dhe instinkteve të provokuara?

Pra, këto shkatërrojnë çdo mbulesë midis tyre dhe Zotit mëshirues. Edhe burrat e tyre janë mëkatarë ngase janë kujdestarë me përgjegjësi edhe atë sikur ta dinin!

Ndalimi i shfaqjes së bukurisë (teberruxh)

Femra muslimane posedon karakteristika të cilat e dallojnë nga pabesimtarja dhe nga gruaja që i përket periudhës së xhahilijetit. Muslimania është e përmbajtur, me dinjitet, vetërespektuese dhe modeste, kurse gruaja që i përket periudhës së xhahilijetit mbështetet vetëm në shfaqjen e bukurisë dhe në atraksion.

Termi arab *teberruxh*, nënkupton ekspozimin e pjesëve atraktive të trupit, veshjen ose bisedën në formë provokuese, shfaqjen e stolive dhe veshjen e teshave të tejdukshme e provokative.

Mënyrat dhe format e shfaqjes së tillë janë të njohura për njerëzit e kohëve të lashta dhe të reja. Disa prej tyre i theksojnë edhe mufesirët gjatë komentimit të fjalës së Zotit, drejtuar grave të Pejgamberit a.s.:

⁴ Transmetim i Tirmidhiut dhe thotë se është hasen, pastaj Ibën Maxhe, Ebu Davudi dhe Hakimi.

² Transmetim i Ahmedit, Ebu Ja'la, Taberaniut dhe Hakimit.

“Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj siç shfaqej në injorancën e hershme”. (Ah'zâb, 33).

Muxhahidi thekson se këtu mendohet në daljen dhe shëtitjen e grave me burrat, siç ishte zakoni në kohën e xhahilijetit. Katadeja thotë se gratë e kishin zakoni të ecnin me stil seduktiv dhe ndijimor, kurse sipas Mukatilit, gratë e hedhnin shaminë në kokë pa e lidhur fare dhe i zbulonin vathët, qaforet dhe stolitë tjera në mënyrë provokative.

Këto ishin format e *teberruxhit* në periudhën e injorancës paraislame, dhe me sa duket, këto forma janë të pranishme edhe në periudhën e injorancës bashkëkohore por në një mënyrë edhe më ekstreme, sa që periudha e injorancës paraislame mund të karakterizohet me dëlirësi e dinjitet.

Si duhet të jetë femra muslimane?

Nëse gruaja muslimane dëshiron të pajiset me moralin, kulturën dhe etikën e Islamit, atëherë duhet t'i aplikojë dispozitat vijuese:

1. Ndalja e shikimit: stolia më e bukur e muslimanes është turpi dhe elementi më karakteristik i turpit është ndalja e shikimit. Zoti i Madhëruar thotë: *“Thuaju besimtareve që t'i frenojnë sytë”*.
2. Mospërzierja intime me meshkujt, p.sh. siç ndodh sot gjatë hyrjes në kinema, në amfiteatrot e universiteteve, në sallat e ligjëratave, në mjetet e transportit e kështu me radhë. Ma'kal ibn Jesari transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“T'i shpohet ndokujt koka me gjilpërë hekuri është më mirë se të prekë gruan që i ndalohet”.¹

3. Veshmbathja e saj duhet të përputhet me parimet dhe dispozitat e sheriatit islam. Veshja e sheriatit i posedon këto karakteristika:

- a. Të mbulojë tërë trupin përveç asaj që veçon Kur'ani, dhe më i saktë është mendimi se veçohen fytyra dhe duart.
- b. Të mos jetë e tejdukshme. Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Mundhiri thotë se këtë hadith e transmetojnë Taberaniu dhe Bejhakiu. Transmetuesit janë të besueshëm.

“Në zjarr do të hyjnë gratë lakuriqe, ato që veshin tesha të tejdukshme dhe provokative, nuk do të hyjnë në xhennet dhe nuk do ta shijojnë aromën e tij”.

Kur shkuan disa gra nga fisi Temîm me tesha të tejdukshme te Aisheja r.a., ajo ju tha:

“Nëse jeni besimtare, atëherë këto tesha nuk janë të besimtareve”.

Kur ka hyrë te Aisheja r.a. një nuse me mbulesë të hollë, ajo i ka thënë: *“Ajo që veshet kështu nuk i beson sures Nûr”.*

c. Që të mos i tregojë pjesët provokative të trupit edhe pse nuk është e tejdukshme, si p.sh. veshmbathja e qytetërimit të turpit dhe epshit (qytetërimi perëndimor), ku bëhen gara se cili model më së shumti i thekson pjesët provokative të trupit, me qëllim që të nxiten epshet e kësaj bote. Pastaj kjo mënyrë e veshjes është më provokative se veshja e hollë dhe e tejdukshme.

ç. Të mos i ngjajë veshmbathjes së meshkujve, si p.sh. pantallonat në kohën tonë, ngase Pejgamberi a.s. i ka mallkuar gratë që i imitojnë burrat në veshje dhe anasjelltas, ai e ka ndaluar mashkullin të veshë veshjen e gruas.

d. Që të mos jetë veshje që është specifike vetëm për pabesimtarët, hebraiket, të krishterët dhe idhujtarët, ngase në këtë mënyrë Islami orvatet t’i garantojë gruas islame pavarësinë në identitet duke e dalluar nga pabesimtarët. Pejgamberi a.s. thotë:

“Kush i ngjanë një populli, bëhet prej tyre”.

4. Të jetë e drejtë dhe e matur në ecje e në fjalë e t’u shmanget gjesteve provokative, ngase mënyra e tillë nuk i përket kulturës së muslimaneve. Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmurje në zemrën e tij, po thoni fjalë të matura”. (Ah'zâb, 32).

5. Të mos nxitë vëmendjen e meshkujve me stilitë e fshehura, me parfume apo me diç tjetër. Zoti i Madhëruar thotë:

“Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stilitë e tyre”. (Nûr, 31).

Në periudhën paraislame kur ecte femra, i kërciste këmbët me qëllim që t’i dëgjoheshin tringëllimat e byzylykëve të këmbëve. Këtë gjest e ndaloi Kur’ani me qëllim që të pengojë nxitjen e iluzio-

neve epsharake të meshkujve, dhe se një gjest i tillë tregon qëllimin e keq për t'i provokuar njerëzit. Këtij rangui i takojnë edhe ato që provokojnë me parfume e erëra të ndryshme nxitëse. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

*“Në qoftë se gruaja e parfumosur kalon pranë mexhlisit, është e pamoralshme.”*¹

Nga kjo nënkuptojmë se Islami nuk e burgosë femrën në shtëpi deri në vdekje, pra e lejon të dalë për namaz e për t'i kryer obligimet tjera të lejuara, qofshin fetare apo jofetare. Kështu vepronin gratë e sahabëve (r.a.), e disa dilyn dhe e shoqëronin Pejgamberin a.s. në luftë ashtu siç i shoqëronin edhe halifët dhe udhëheqësit pas tij. Pejgamberi a.s. i thotë gruas së vet Sevdasë:

*“Zoti ju lejon të dilni për t'i kryer nevojat tuaja.”*²

Pejgamberi a.s. përsëri thotë:

*“Nëse gruaja e ndonjërit prej jush kërkon leje për në xhami, mos e pengoni!”*³

Në një hadith tjetër thotë:

*“Mos i pengoni robëreshat e Zotit nga xhamitë e Zotit.”*⁴

Disa dijetarë ekstremistë mendojnë se gruas i ndalohet të shikojë në çfarëdo pjesë të trupit, duke u mbështetur në transmetimin e Tirmidhiut nga Nebhani, rob i Ummu Selemes, se kur ka hyrë ibn Ummu Mektumi,

¹ Mundhiri thotë se këtë hadith e transmetojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu dhe thotë se është hadith hasen. Gjithashtu e transmetojnë edhe Nesaiu, Ibën Huzejme dhe Ibën Habbani në sahihët e tyre. Pejgamberi a.s. thotë: *“Cila grua parfumoset për t'i provokuar njerëzit, konsiderohet e pamoralshme”*. Gjithashtu këtë e transmeton edhe Hakemi.

² Transmetim i Buhariut në *Kitabun-nikâh*.

³ Transmetim i Buhariut dhe Ibën Amrit.

⁴ Shiko tefsirin e Kurtubiut, vëll. 12, f. 228.

Pejgamberi a.s. i ka thënë asaj dhe Mejmunes: “Mbulohuni!”. Kur përgjigjen se ai është i verbër, ai u thotë: “Po ju a jeni të verbëra? A nuk e shihni atë?” Hulumtuesit thonë se ky hadith nuk është autentik për transmetuesit, ngase transmetues i këtij hadithi është Nebhani, robi i Ummu Selemes, i cili nuk merret si argument.

Edhe nëse pranohet si autentik, atëherë kjo rrjedh nga përpikëria e Pejgamberit ndaj grave të tij që kishin status special, ashtu siç ishte çështja edhe me mbulesën.

Kështu thonë edhe Ebu Davudi dhe imamët tjerë. Vazhdon domethënia e hadithit të vërtetë autentik, ku Pejgamberi a.s. e urdhëron Fatimenë, të bijën e Kajsit që ta kalojë idetin te shtëpia e Ummu Sherikit. Më vonë e ndërron mendimin e vet dhe thotë:

*“Tek ajo tubohen sahabët e mi, pra shko te Ummu Mektumi ngase ai është i verbër dhe nëse zhvishesh nuk të sheh”.*¹

Respekti i bashkëshortes ndaj musafirëve të bashkëshortit

Gruaja mund t’i shërbejë musafirët e burrit të saj në praninë e tij përderisa u përmbahet normave islame në veshmbathje, në lëvizje dhe në të folur. Natyrisht ata do ta shohin atë dhe gjithashtu edhe ajo do t’i shohë. Këtu nuk ka kurrfarë mëkati përderisa nuk ka rrezik nga involvimi i anës tjetër.

Buhariu, Muslimi dhe të tjerët transmetojnë se Sehl ibn Sa’di El-Ensariu ka thënë: Ebu Usajb Sa’di e ka thirrur Pejgamberin a.s. me sahabët e tij në martesën e vet, dhe ushqimin ua ka përgatitur e shtruar vet e shoqja e tij, Ummu Usajd. Ajo u kishte përgatitur gjatë natës një lëng prej hurmave në një enë guri. Kur e ka mbaruar Pejgamberi a.s. ushqimin e vet, ajo i ka bërë hurmat si qull dhe ia ka dhënë pijen Pejgamberit.

Shejhul Islami Ibn Haxher thotë se nga ky hadith nënkuptojmë faktin se gruaja i lejohet t’ju shërbejë musafirëve të burrit të saj. Është evidente se shërbimi i tillë lejohet në qoftë se nuk ekziston frika nga fitneja dhe nëse gruaja është e veshur me veshje të rregullt. Nëse

¹ Tefsiri i Kurtubiut vëll. 12, f. 228.

gruaja nuk është e veshur si duhet (sikur pjesa dërrmuese e grave tona në këtë kohë), atëherë paraqitja e saj para meshkujve është e ndaluar.

Homoseksualizmi është mëkat i madh

Na ka mbetur të dijmë atë që ka të bëjë me sistematizimin e instinktit seksual në Islam. Ashtu siç ndaloj amoralitetin dhe atë që shpie në kurvëri, Islami ndaloj edhe perversionin seksual që njihet me emrin “homoseksualizëm”. Ky akt pervers kundërshton rendin natyror, korrupton seksualitetin e njeriut dhe konsiderohet krim kundër të drejtave të femrave.

Përhapja e kësaj dukurie të fëlliqtë në shoqëri, shkatërron jetën e tyre, i shndërron në robër kështu që ata plotësisht harrojnë moralin, traditën dhe shijen. Mjafton të cekim atë që e potencon Kur’ani rreth popullit të Lûtit, të cilët e praktikonin këtë ves të fëlliqtë dhe i braktisnin gratë e tyre me qëllim që ta praktikonin aktin e tillë jo të rëndomtë, të gabuar dhe të ndaluar. Për këtë shkak, pejgamberi i tyre Luti u ka thënë:”

“(Të mjerët ju) A shkoni pas meshkujve të kësaj bote! E gratë tuaja i lini anash, të cilat Zoti juaj i krijoi për ju! Por ju jeni një popull që kalon çdo kufi!” (esh-Shuarâ, 165-166).

Prej qëndrimeve më të çuditshme të këtij populli që kundërshtonte instinktin, që kishte humbur rrugën e drejtë, që kishte moral të ulët dhe shije të prishur, është qëndrimi ndaj musafirëve të Lûtit, të cilët ishin engjëj të dërguar nga Zoti në formë të njerëzve me qëllim për t’i dënuar, për t’i sprovuar dhe për ta argumentuar qëndrimin e tyre. Në Kur’an thuhet kështu:

“E kur të dërguarit tanë i erdhën Lûtit, ai u keqësua për ta dhe u ngushtua rëndë me ardhjen e tyre e tha: “Kjo është ditë e vështirë!” Dhe populli i tij, që më parë bënte punë të turpshme, erdhi me nguti te ai (te Lûti) e ai tha: “O populli im, qe këto bijat e mia (gratë e atij vendi), janë më të pastra për ju, kini frikë pra All-llahun e mos më turpëroni me musafirët e mi, a nuk ka ndër ju ndonjë njeri i mençur (e t’u ndalojë nga e keqja)?” Ata thanë: “Po ti e ke të ditur se ne nuk kemi kurrfarë lakmie në bijat tua, ti e di me siguri se çka dëshirojmë ne!” Ai tha: “Ah, sikur të kisha fuqi kundër jush (t’ju zbrapsë), ose të kisha mbështetje në ndonjë përkrahje (të fisit), të fortë (do t’i mbroja musafirët e mi)!”. ”

(Engjëjt) thanë: "O Lût, ne jemi të dërguarit e Zotit tënd, ata (populli yt) nuk kanë për t'u afruar te ti, e ti nga fundi i natës udhëto me familjen tënde dhe askush prej jush të mos vështrojë mbrapa (familja do të shpëtojë), pos gruas sate. Ajo do të jetë e goditur me çka do të goditen edhe ata. Afati i tyre është mëngjesi, a nuk është mëngjesi afër?" (Hûd, 77-81).

Mendimet e dijetarëve rreth dënimit të atij që praktikon një ves të tillë të fëlliqtë janë të ndryshme. A duhet të dënohet si pusht apo të vritet aplikuesi dhe i aplikuari? Si të vriten, me shpatë, me zjarr apo me hedhje nga majat e fortesave?

Kjo vrazhdësi e tyre ka për qëllim pastrimin e shoqërisë islame nga këto mikrobe të dëmshme që shkatërrojnë individin dhe shoqërinë.

Masturbimi (Istimnâ)

Presioni nga grafullimi i instinktit (seksual) e detyron të riun që me anë të masturbimit ta ejakulojë spermën nga trupi i tij, për t'i qetësuar nervat dhe tensionin seksual. Shumica e dijetarëve këtë e ndalojnë duke argumentuar me fjalët e Malikit që mbështeten në ajetin kur'anor:

"Dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime) me përjashtim ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar, e kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që kanë shkelur normat e caktuara (El-Mu'minûn, 5-7).

Pra, masturbuesi i takon atij që kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat).

Transmetohet se imam Ahmed ibn Hanbeli e ka konsideruar spermën si sekrecion nga trupi dhe kështu ka lejuar nxjerrjen e saj. Kështu mendonte edhe Ibn Hazmi.

Fukahatë hanbelitë e kushtëzojnë masturbimin me dy gjëra:

1. Frika se mos po praktikohet kurvëria, dhe
2. Mosmundësia për martesë.

Sipas mendimit të Ahmed Ibn Hanbelit, kjo çështje e kushtëzuar me dy gjërat e lartpërmendura, mund t'i lejohet të riut që studion ose punon në vend të huaj, i cili gjendet para provokimeve të shumta dhe frikohet të mos bëjë ndonjë mëkat. Pra, në këto raste specifike, lejohet shuarja e tensionit seksual, por me kusht që të mos shndërron në traditë.

Këshilla e Pejgamberit a.s. ndaj të riut musliman që s'mund të martohet është më e preferuar se masturbimi, pra, të agjërojë, ngase agjërimi ia forcon dëshirën, ia mëson durimin, ia forcon devotshmërinë ndaj Zotit të Madhëruar dhe frikën prej Tij. Pejgamberi a.s. thotë:

“O ju të rinj, ata që mund ta mbajnë gruan le të martohen, ngase në këtë mënyrë i mbyllin sytë, dhe mbrohet dëlirësia. Ai që s'mundet (të martohet), atëherë le të agjërojë, ngase agjërimi ftoh pasionin seksual”¹.

¹ Transmetim i Buhariut.

NË MARTESË

S'ka murgëri në Islam

Në një anë Islami nuk lejon lidhje gjinore të pakufizuara dhe për këtë ndalon kurvërinë dhe çdo gjë që shpie në të, mirëpo në anën tjetër, lejon të kundërtën, gjegjësisht thërret në martesë dhe ndalon heqjen dorë dhe tredhjen.

Nuk i lejohet muslimanit të aftë për martesë ta refuzojë aktin e tillë me pretekst se i përqëndrohet vetëm Zotit, adhurimit të Tij dhe murgërimit e largimit nga kjo botë.

Pejgamberi a.s. ua ka potencuar disa sahabëve të tij të cilët anonin nga murgërimi, se kjo mënyrë trajtohet si devijim nga rruga e Islamit dhe si refuzim i Sunnetit të Pejgamberit a.s. Në këtë mënyrë ai i eliminoi mendimet e tilla të krishtera nga rrethi islam.

Ebu Kulâbe thotë se disa sahabe të Pejgamberit a.s. dëshironin ta refuzojnë këtë botë, t'i braktisin gratë e tyre dhe t'i qasen murgërimit. Pejgamberi a.s. foli fjalë të rrepta e pastaj tha:

“Ata (popujt) para jush u shkatërruan nga murgërimi, ishin të vrazhdë ndaj vetes dhe Zoti u bë i vrazhdë ndaj tyre. Disa prej tyre ende gjenden nëpër manastire e faltore. Adhuroni Zotin, mos i shoqëroni asgjë, shkoni në haxh e umre, bëhuni të drejtë dhe çdo gjë do të jetë e drejtë për ju!”¹

Për shkak të tyre u shpall ajeti:

¹ Transmetim i Abdurrezakut, Ibën Xherîrit dhe Ibën Mundhirit.

“O ju që besuat! Mos i ndaloni (mos i bëni haram) të mirat që për ju i lejoi All-llahu (i bëri hallall), dhe mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë (i kalojnë kufijtë e dispozitave të Zotit)”. (Mâide, 87).

Nga Muxhahidi transmetohet se disa njerëz si Uthman ibn Madh’uni dhe Abdull-llah ibn Amri dëshironin të heqin dorë nga kjo botë, të tredhen dhe të veshin tesha të papërpunuara. Për ta u shpall ajeti i lartpërmendur dhe ai që vijon.¹

Buhariu transmeton se një grup i sahabëve shkuan te shtëpitë e Pejgamberit a.s. për t’i pyetur bashkëshortet e tij rreth ibadetit të tij. Kur i dëgjuan, menduan sepërgjigjja është e pamjaftueshme dhe thanë: “Si mund të krahasohemi me Pejgamberin a.s. kur atij Zoti ia ka falur mëkatet e kaluara dhe të ardhshme!” Njëri prej tyre tha se do të agjërojë tërë jetën, tjetri tha se do të lutet tërë natën kurse i treti tha se nuk do të martohet asnjëherë. Kur e dëgjoi këtë Pejgamberi a.s. ua sinjalizoi gabimin dhe u tha:

“Unë e njoh më mirë se ju Zotin dhe më shumë se ju prej Tij frikohem, mirëpo natën e kaloj në lutje e gjumë, agjëroj, ha dhe martohem. Ai që largohet nga Sunneti im, nuk ka lidhje me mua (nuk më takon mua!)”.

Sa’d ibn Ebi Vekkasi thotë se

¹ Tefsiri i Ibën Xherîrit.

Pejgamberi a.s. e ka refuzuar murgërinë e Uthman ibn Medh'unit, dhe sikur të lejonte, të gjithë ne do të tredheshim.

Pejgamberi a.s. u thotë të gjithë të rinjve:

*“O ju të rinj! Ai që mund të kujdeset për gruan le të martohet, ngase kështu i mbyll shikimet dhe mbron veten.”*¹

Nga këto hadithe disa dijetarë e obligojnë martesën për çdo musliman që ka mundësi për të, kurse disa të tjerë e kushtëzojnë për atë që s'mund të qëndrojë e ta mbrojë veten.

Nuk i takon muslimanit të mos martohet nga frika prej rizkut të paktë apo prej përgjegjësisë por obligohet të përpiqet, të punojë dhe të presë begatinë nga Zoti, të cilën ua ka premtuar të martuarve që dëshirojnë të jenë të pastër e të dëlirë. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) dhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse jeni të varfër, All-llahu ju begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është bujar i madh, i gjithëdijshëm”. (Nûr, 32).

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Zoti e ka bërë hak t'u ndihmojë tre personave: të martuarin që dëshiron të mbrohet, robin që ia mundëson zotëriu i vet të paguajë e të fitojë lirinë dhe luftëtarin në rrugën e Zotit”.*²

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Nesaiut, Tirmidhiut, Ibën Maxhes dhe Hakimit.

Shikimi i të fejuarës

Kur vendos muslimani të martohet dhe të fejojë ndonjë femër, atëherë i lejohet ta shohë para se t'i fillojë hapat e martesës dhe ta njohë më mirë, me qëllim që të mos gabojë e të ngatërrohet me diçka që e urren.

Pasi që syri është zëdhënës i zemrës, atëherë mund të ndodhë që takimi me sy t'i afrojë zemrat dhe t'i bashkojë shpirtrat.

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejreja se ka thënë:

“Tsha te Pejgamberi a.s. kur erdhi një njeri dhe e lajmëroi se dëshironte të martohej me një grua prej ensarëve. Pejgamberi a.s. i tha: *“A e ke parë!”* Kur i përgjigjet se jo, atëherë vazhdon dhe i thotë: *“Shko ta shohish ngase ka diçka në sytë e ensarëve!”*

Mugire ibn Shu’be transmeton se kur e ka informuar Pejgamberin a.s. për fejesën e vet, ai i ka thënë:

“Shihe atë, ngase kështu mund të vazhdoni!” Kur erdhën prindërit e saj, ai ua transmetoi fjalët e Pejgamberit, mirëpo, me sa duket, ata nuk shprehën gatishmëri për një gjë të tillë. Kur dëgjoi vajza nga dhoma, i tha: “Pasi që Pejgamberi të urdhëroi të më shohësh,

atëherë më shiko...” Pastaj Mugireja thotë se “e pashë dhe e martova!”¹

Pejgamberi a.s. nuk i ka caktuar Mugires se sa duhet të takohet me të fejuarën e vet, gjegjësisht çka duhet të shohë në të fejuarën e vet. Sipas disa dijetarëve lejohet shikimi i fytyrës dhe i duarve, mirëpo këto pjesë janë të lejuara edhe në raste tjera jashtë fejesës. Pra, meqë bëhet fjalë për rast specifik, atëherë duhet të lejohet diçka më tepër se në rastet e rëndomta. Në një hadith të Pejgamberit a.s. thuhet:

“Kush dëshiron të fejojë ndonjë grua dhe kërkon të shohë diçka që indukon martesën, le të veprojë ashtu!”²

Disa dijetarë e teprojnë në atë se çka duhet të shihet, kurse disa të tjerë janë më rigorozë prandaj solucionin më i mirë është mesatarja. Sipas disa hulumtuesve, atij që kërkon fejesën i lejohet ta shohë atë që dëshiron ta fejojë por të veshur me teshat që i veshë para të jatit të vet, vëllait dhe atyre që janë të ndaluar për të. Bile, sipas hadithit të theksuar, i lejohet ta marrë në shoqërim me të jatit e saj ose me ndonjë që i ndalohet martesë me të dhe të shkojnë në vendet ku si zakonisht shkojnë për vizitë ose në vende tjera të lejuara për të njohur intelektin, shijen dhe tiparet e personalitetit të saj, por me kusht që të jetë e veshur me veshje sipas normave të sheriatit. Kjo është një pjesë e domethënies së hadithit të Pejgamberit a.s.: *“Dhe kërkon të shohë diçka që indukon martesën, le të veprojë ashtu!”*.

Nëse mashkulli dëshiron singërisht të fejojë ndonjë femër, atëherë i lejohet ta shohë atë me dijen ose pa dijen e saj e të familjes së saj.

Xhabir Ibn Abdull-llahu, për gruan e vet thotë: “Fshehesha pas dërrit për ta parë atë”.

Nga hadithi i Mugires nënkuptojmë se nuk i lejohet babait të pengojë të bijën e vet për të parë atë që dëshiron ta fejojë me qëllim të singërtë. Nëse e ndalon në emër të traditës, atëherë duhet të dijë se tradita i nënshtrohet sheriatit e jo e kundërta.

Nuk i lejohet babait, të fejuarit ose të fejuarës që ta keqpërdorin mundësinë (e afruar nga sheriat), dhe të lejojnë që i fejuari dhe e

¹ Arrihet pëlqimi dhe midis tyre qëndrojnë engjëjt. (Transmetim i Ahmedit, Ibën Maxhes, Tirmidhiut, Ibën Habbanit dhe Daramiut.

² Transmetim i Ebu Davudit.

fejuara në emër të fejesës të shkojnë në teatro, në klube e në qendra tregtare pa u shoqëruar me ndonjërin nga të ndaluarit e saj për martesë. Kjo traditë sot është e zakonshme në mesin e muslimanëve, të cilët dëshirojnë t'i imitojnë qytetërimin dhe traditat e Perëndimit.

Fejesa e ndaluar

Muslimanit nuk i lejohet ta fejojë gruan që është në idet, ngase në këtë periudhë e pengon martesa e kaluar. Dëshira për fejesë në këtë rast mund të shfaqet me anë të gjeleve indirekte ose sugjestionëve e jo nëpërmjet propozimit direkt. Zoti i Madhëruar thotë:

“Paraqitja juaj për martesë ndaj grave (që kanë kryer afatin e tyre), në mënyrë të tërthortë ose mbajtja e fshehtësisë në veten tuaj, nuk është mëkat për ju”. (El-Bekare, 235).

Gjithashtu i ndalohet muslimanit të fejojë gruan që është e fejuar me vëllain musliman, ngase i fejuari i parë ka të drejtën që duhet të respektohet për të ruajtur lidhjen dhe dashurinë midis njerëzve. Muslimani është larg moralit që kundërshton burrërinë dhe që i ngjanë grabitjes e sulmit. Në qoftë se i fejuari i parë e prishë fejesën dhe lejon të dytin që ta fejojë të fejuarën e tij, atëherë nuk ka kurrfarë mëkati.

Muslimi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Besimtari është vëlla i besimtarit. Nuk i lejohet besimtarit të japë çmim më të lartë se atë që e ka ofruar vëllai i tij (në fe) si dhe (nuk i lejohet) ta fejojë të fejuarën e vëllait të vet (në fe)”.¹

Buhariu gjithashtu transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Njeriu mund të fejojë të fejuarën e ndokujt tjetër vetëm në qoftë se prishet fejesa me të parin ose t'i japë leje i pari”.²

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Buhariut.

Pëlqimi i vajzës

Vajza jep pëlqimin për martesë dhe nuk i lejohet të jati të saj ose tutorit që ta refuzojë ose ta lë pas dore pëlqimin e saj. Pejgamberi a.s. thotë:

“Gruaja që ka qenë e martuar ka më shumë të drejtë për veten e saj se tutori, ndërsa prej vajzës kërkohet pëlqimi, e pëlqimi i saj është edhe heshtja”.¹

Një vajzë shkon te Pejgamberi dhe e lajmëron se i jati i saj dëshiron ta martojë me një person që ajoe urrenë dhe kur ia len asaj të drejtën për zgjedhje, ajo thotë: “Pranoj atë që veproji babai im por dëshiroj që t’u tregoj grave se kjo çështje nuk u takon etërve”.²

Nuk i lejohet babait ta vonojë martesën e së bijës së vet në qoftë se vjen dhe e kërkon një njeri me fe e moral. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Tri gjëra nuk vonohen: namazi, xhenazja dhe martesa me njeriun adekuat”.

Ai përsëri thotë:

“Nëse ju vjen ndokush që është fetar dhe i moralshëm, martone, e nëse jo, atëherë do të ndodhin fitne e korrupsion i madh në tokë”.³

Gratë e ndaluara

Muslimanit i ndalohet martesa me ndonjëren nga këto femra:

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Ibën Maxhes dhe i të tjerëve.

³ Po aty.

1. Gruaja e babait, qoftë e lëshuar ose që i ka vdekur burri. Kjo martesë lejohej në periudhën paraislame, mirëpo me shpalljen e Islamit kjo formë e martesës anulohet, ngase gruaja e babait ka trajtimin e nënës pas martesës së saj. Është e natyrshme që ndalimi i tillë të mbrojë autoritetin e prindit. Ndalimi i përhershëm i kësaj martese i këputë të gjitha shpresat dhe i përforcon lidhjet e respektit të ndërsjellë.

2. Nëna, pastaj gjyshja, qoftë nga nëna apo babai, e më tutje.

3. E bija, vajza e të bijës ose të birit, e më tutje.

4. Motra, qoftë nga babai ose nga nëna.

5. Halla - motra e babait, nga babai ose nga nëna.

6. Tezja - motra e nënës, nga babai ose nga nëna.

7. Bijat e vëllait.

8. Bijat e motrës.

Këto të afërta në Islam quhen *meharim* (të ndaluara) ngase muslimanit i ndalohen me ndalim të përhershëm, pa marrë parasysh kohën apo vendin. Për këto edhe burri quhet *mahrem* ngase është i ndaluar për to.

Urtësia e pengimit të martesës me gratë e lartpërmendura është e qartë.

a. Natyra e njeriut refuzon të ketë epshe seksuale ndaj nënës, motrës ose bijës së vet, bile ekzistojnë edhe disa kafshë që i refuzojnë lidhjet gjinore me të afërmet. Përveç kësaj, njeriu respekton tezen dhe hallën si nënën e vet, kurse xhaxhain dhe dajën si baba të vetin.

b. Sikur të mos kishte ndalim kategorik nga sheriat, atëherë do të rrezikoheshin lidhjet midis burrit dhe atyre ngase ekzistojnë lidhje të ngushta intime e private.

c. Midis burrit dhe këtyre të afërmeve ka dashuri stabile që manifestohet nëpërmjet respektimit, dhe për këtë shkak më mirë është për të që të kërkojë të huajat me anë të martesës, sepse kështu vendosen lidhje të reja dhe zgjerohet sfera e dashurisë midis njerëzve!

“Dhe në mesin tuaj bëri mëshirën dhe dashurinë!” (Er-Rrûm, 21).

ç. Dashuria instinktive që lind midis njeriut dhe të afërmeve të tij të cilat i cekëm pak më parë, dhe që mbështetet në lidhje shpirtërore e sentimentale, duhet të mbetet e fortë dhe e përhershme për të qenë bazë e lidhjes midis tyre dhe parim i kujdesit, dashurisë e respektit. Nëse kjo dashuri shndërrohet në martesë, në konflikt e mospajtim,

atëherë shkaktohen përçarje, lidhjet familjare s'janë stabile, të forta dhe të vazhdueshme.

d. Pasardhësit nga lidhjet e tilla me të afërmet mund të jenë të dobët dhe me të meta. Nëse në organizmin e personit ka ndonjë deformim fizik apo psikik, atëherë mund të trashëgohet në këtë mënyrë.

dh. Gruaja ka nevojë për ndokënd që mbron të drejtat e saj dhe interesin e saj para burrit, posaçërisht në rast të prishjes së marrëdhënieve midis tyre. Pra, si mund ta mbrojë atë kur vetë ai është sulmues i saj?

Martesa e ndaluar nga qumështi

9. Muslimanit i ndalohet martesa me gruan që i ka dhënë gji në vegjëli, ngase ajo ka fituar statusin e nënës nëpërmjet qumështit që është shndërruar në mish e eshtra. Të dhënit gji rezulton me lidhje të maternitetit mes tij dhe asaj. Këto lidhje në fillim mund të jenë të fshehta mirëpo në ndërdijen e tij deponohen dhe dalin në raste eventuale. Kushtëzohet ndikimi i ushqimit të tillë që të jetë në kohën e vegjëlisë, gjegjësisht para moshës dyvjeçare, kur qumështi konsiderohet ushqim i parë i foshnjës. Sasia e gjidhënies duhet të jetë pesë herë, gjegjësisht pesë thithje deri në ngopjen e foshnjës. Në bazë të transmetimeve nënkuptohet se numri pesë është më i preferuari dhe më i pranuari.

10. Gjithashtu ndalohen motrat nga qumështi, ngase sikur meshkujt që shndërrohen në vëllezër, ashtu edhe femrat shndërrohen në motra. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

*“Ç’ndalohet nga gjenealogjia, ndalohet edhe nga qumështi!”*¹ Siç ndalohen halla, tezja, e bija e vëllait dhe e bija e motrës nga gjenealogjia, gjithashtu ndalohen edhe nga qumështi.

Ndalimet nëpërmjet martesës

11. Ndalohet nëna e gruas në kurorë ngase sipas Islamit, pas kurorëzimit me të bijën e saj, ajo për bashkëshortin trajtohet si nënë e tij.

¹ Transmetim unanim.

12. Ndalohet edhe e bija e gruas me të cilën martohet burri, e nëse nuk ka marrëdhënie seksuale me të dhe e lëshon, atëherë i lejohet martesë me të bijën e saj.

13. Gjithashtu ndalohet gruaja e djalit të vërtetë e jo e djalit të adoptuar, ngase Islami nuk pranon legjislaturën e sistemit të adoptimit për shkak të kundërshtimit të të vërtetës dhe realitetit, gjë që rezultojnë me ndalimin e hallallit dhe lejimin e haramit. Zoti i Madhëruar thotë:

“E as nuk ua bëri djem tuaj të adoptuarit tuaj (fëmijët e tjetërkujt, që i adaptoni si të juaj). Këto janë vetëm thëniet tuaja që i shqiptoni me gojët tuaja, e All-llahu e thotë atë që është realitet, dhe Ai udhëzon në rrugë të drejtë”. (Ah'zâb, 4).

Pra, kjo është vetëm fjalë goje, nuk e ndryshon realitetin dhe nuk e bën të huajin të afërt.

Këto gjëra të lartpërmendura ndalohen për shkak të lidhjeve martesore që kanë nevojë për marrëdhënie të forta të ndërsjella.

Bashkimi i dy motrave

14. Islami ia ndalon muslimanit martesën me dy motra në të njëjtën kohë (ky akt lejohej në kohën paraislame). Me këtë ndalim Islami dëshiron të mbrojë dashurinë dhe lidhjen midis dy motrave, ngase mund të shkatërrohen po qe se bëhen gra të një burri. Islami në mënyrë të qartë ndalon martesën me dy motra njëkohësisht, kurse Pejgamberi shton e thotë:

لَا يُجْمَعُ بَيْنَ الْمَرْأَةِ وَعَمَّتِهَا وَلَا بَيْنَ الْمَرْأَةِ وَخَالَتِهَا.

“Nuk lejohet martesë me gruan dhe hallën e saj e as me tezen njëkohësisht”.¹

Pejgamberi gjithashtu thotë:

“Nëse veproni ashtu, do t'i këputni lidhjet e farefisnisë.”

Meqë Islami i përforcon lidhjet farefisnore, atëherë si mund të pranojë diçka që i shkatërron?!

¹ Transmetimi në dy sahihët.

Të martuarat

15. Nuk i lejohet gruas së martuar të martohet përderisa është në martesë. Gruaja e tillë mund të martohet vetëm në këto rrethana:

- a. Të përfundojë martesë me vdekje ose shkurorëzim,
- b. Të përfundojë koha e idetit e cila e mbron sinjeritetin e saj ndaj martesës së parë. Periudha e idetit për gruan me barrë zgjat deri në lindje, pa marrë parasysh se a është e gjatë apo jo.

Ideti i gruas të cilës i ka vdekur burri, zgjat katër muaj e dhjetë ditë. E shkurorëzuara pret kalimin e tre menstruacioneve me qëllim që të sigurohet pastërtia e gjakut nga frika se mos ka mbetur diçka nga sperma e burrit të mëparshëm. Ky kujdes vjen në shprehje nga frika se mos ngatërrohen rrjedhat. Kjo nuk vlen për të rejat dhe të moshuarat që s'kanë të përmuajshme dhe ideti i tyre zgjat tre muaj.

Zoti i Madhëruar thotë:

“E ato gra që janë të shkurorëzuara, janë të obliguara të presin tre menstruacione. Nëse ato i besojnë All-llahut dhe Ditës së fundit, atyre nuk u lejohet të fshehin atë që All-llahu e krijoi në mitrat e tyre”. (El-Bekare, 228).

“E ato nga gratë tuaja, të cilave u është ndërprerë cikli mujor (të përmuajshmet) nëse nuk e kanë ditur, koha e pritjes së tyre është tre muaj, gjithashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur të përmuajshmet. Ndërkaq, për gratë shtatzënë, afati i pritjes së tyre është derisa të lindin”. (Talâk, 4).

“E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë”. (El-Bekare, 234).

Të gjitha këto pësëmbëdhjetë lloje të grave të ndaluara për martesë, Kur'ani i përfshinë në tre ajete të sures “Nisa”:

“Mos u martoni me ato gra me të cilat ishin të martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para Islamit) sepse ajo ishte turpësi, përbuzje e traditë e shëmtuar.

U janë ndaluar juve (të martoheni me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat e vëllait, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gji, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja (vjehtat) dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej babait tjetër) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt e nëse nuk keni patur kontakt me to atëherë s'ka pengesë (të martoheni me ato vajza), dhe (janë të ndaluara) gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj (jo të bijve të adoptuar), dhe të bashkoni (përnjëherë në niqah) dy

motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtet, All-llahu falë shumë, është mëshirues i madh.

(Nuk ju lejohet të martoheni) edhe me gra të martuara (që kanë burra e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robërshat e luftës). Ky është obligim mbi ju nga All-llahu. U janë lejuar pos këtyre (që u përmendën), të tjerat që t'i merrni me pasurinë tuaj (me niqah) duke pasur për qëllim bashkëshortësinë e jo kurvërinë. E për atë që e përjetuat ju nga ato (gratë me të cilat patët kurorë), jepnu shpërblimin e tyre të caktuar se është obligim. E nuk ka pengesë për ju, pas përcaktimit (të niqahit), në atë që ju pëlqeni mes vete. All-llahu është i gjithëdijsëm, i urtë". (Nisâ, 22-24)

Gratë idhujtare

16. Ndalohet martesë edhe me gratë idhujtare, të cilat i adhurojnë putat si psh. idhujtares arabe ose idhujtares tjera të ngjashme me to. Zoti i Madhëruar thotë:

"Mos u martoni me idhujtare derisa ato të besojnë (Zotin). Një robërshë besimtare është më e vlefshme se një idhujtare, edhe nëse ajo (idhujtarja) ju mahnit. Mos u martoni as me idhujtarë derisa që ata të besojnë (Zotin). Një rob besimtar është më i vlefshëm se idhujtari edhe nëse ai ju mahnit. Ata ju ftojnë në zjarr, e All-llahu me mëshirën e vet ju fton në xhennet". (El-Bekare, 221).

Ajeti tregon se muslimanit i ndalohet martesë me idhujtare ashtu siç i ndalohet muslimanes të martohet me idhujtar për shkak të dallimit të madh në fe. Këta thërrasin në xhennet e ata në zjarr, këta besojnë Zotin, pejgamberinë e botën tjetër kurse ato i bëjnë shok Zotit, mohojnë pejgamberinë dhe refuzojnë botën tjetër.

Meqë në martesë ka qetësi e dashuri, atëherë si të afrohen këto dy palë të kundërta njëra me tjetrën?!

Martesa me gratë që janë ithtare të Librit

Kur'ani lejon martesën me gratë që janë ithtare të Librit, si p.sh. me hebraiket dhe të krishteret, ngase ka një trajtim të posaçëm ndaj ithtarëve të Librit dhe i konsideron ithtarë të fesë qiellore, pa marrë parasysh devijimet dhe ndryshimet që i kanë bërë. Ashtu siç lejohet

ngrënia e ushqimit të tyre, gjithashtu lejohet edhe lidhja martesore me gratë e tyre. Zoti i Madhëruar thotë:

“Sot i lejuam për ju ushqimet e mira dhe ushqimet (të therurat) e ithtarëve të Librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar). Gra të ndershme besimtare dhe (gra) të ndryshme nga ato të cilave u është dhënë Libri para jush, kur atyre u jepni pjesën e caktuar të kurorës, por duke pasur për qëllim martesën, e jo amoralitetin dhe jo si dashnore ilegale”. (Mâide, 5).

Kjo është një pasqyrë e tolerancës islame, e cila nuk mund të haset te asnjë fe tjetër qiellore. Edhe pse ithtarët e Librit akuzohen për kufër e humbje, i lejohet muslimanit të martohet me ithtaren e Librit. Ajo vazhdon në fenë e saj qiellore por në të njëjtën kohë është edhe grua e (muslimanit), amvise në shtëpinë e tij, qetësi për shpirtin e tij, ruajtëse e sekreteve të tij dhe nënë e fëmijëve të tij. Kur Zoti flet rreth çështjes së martesës dhe fshehtësirave të saj, thotë:

“Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe midis jush krijoi dashuri e mëshirë”. (Er-Rrûm, 21).

Këtu vlen të cekim se për muslimanin më shumë preferohet martesa me muslimanen e devotshme se sa me muslimanen që e pranon Islamin vetëm si trashëgim nga prindërit e vet.

Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

*“Merre atë që është fetare dhe do të jesh i lumtur!”*¹ Nëse e njohim këtë gjë, atëherë do të kuptojmë se për muslimanin më e mirë do të ishte martesa me ndonjë muslimane se sa me ithtaren e Librit.

Në qoftë se muslimani frikohet nga pasojat që i lë kjo martesë në besimin e fëmijëve të tij ose në sjelljet e tyre, atëherë obligohet të veprojë me mençuri dhe të largohet nga ky rrezik.

Në qoftë se numri i muslimanëve është i vogël (në mërgim), atëherë preferohet që të ndalohet martesa me jomuslimane, ngase në qoftë se ndodh e kundërta, atëherë nënkuptohet se shumë femra muslimane do të mbeten të pamartuara. Meqë, në këtë mënyrë shoqëria islame dëmtohet, atëherë dëmi i tillë mund të largohet me suspendimin gradual të këtij lejimi.

¹ Transmetim i Buhariut.

Martesa e muslimanes me jomuslimanin

I ndalohet muslimanes të martohet me jomuslimanin qoftë ithtar i Librit apo jo. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos i martoni idhujtarët derisa të besojnë!” (El-Bekare, 221)

Për besimtarët emigrante, thotë:

“Nëse vërtetoni se ato janë besimtare atëherë mos i ktheni ato te jobesimtarët, sepse as ato nuk janë të lejuara për ta e as ata nuk janë të lejuar për to!” (Mumteherine, 10).

Meqë nuk ka përjashtim për ithtarët e Librit, atëherë për të gjitha muslimanet martesë e tillë është e ndaluar.

Islami lejon muslimanin të martojë hebraiken ose të krishteren por nuk e lejon muslimanin të martohet me ndonjërin prej tyre, ngase burri është shtylla e shtëpisë, më i fuqishëm se gruaja dhe përgjegjës ndaj saj. Islami garanton besimin e gruas që është ithtare e Librit në martesën me muslimanin dhe i respekton të drejtat e saj në përgjithësi, mirëpo asnjë fe tjetër nuk i garanton të drejtat e gruas që i takon fesë tjetër e as lirinë e besimit të saj, si p.sh. Krishterimi dhe Hebraizmi.

Pra, si ta rrezikojë Islami ardhmërinë e muslimaneve dhe t'i gjuajë në duart e atyre që nuk e nderojnë fenë e tyre si dhe nuk i mbrojnë të drejtat e tyre?!

Në bazë të kësaj, nënkuptohet se burri obligohet të respektojë besimin e gruas së vet për të patur mirëkuptim në jetë.

Muslimani beson në origjinën e Hebraizmit dhe Krishterimit si fe qiellore, pa marrë parasysh devijimet. Ai beson në Tevratin e Inxhilit si libra të shpallur nga Zoti, ashtu siç beson në Musain dhe Isaun si peygamberë të Zotit. Pra, ithtarja e Librit jeton në kraharorin e njeriut që respekton fenë e saj, Librin e saj dhe Peygamberin e saj, bile ka imaan nëse vepron ndryshe, kurse hebreu apo i krishteri nuk e pranojnë as Islamin, as Librin e Islamit e as Peygamberin e Islamit; pra si mund të jetojë muslimania në atë rreth, kur dihet se ajo ka obligime fetare, farze e vaxhibe, hallalle e haramel? Është e pamundshme që muslimania ta mbrojë nderin e saj fetar dhe ta mbrojë fenë e saj kur ballafaqohet drejtpërdrejt me burrin e saj?

Kështu arsyetohet edhe qëllimi i Islamit që ndalon martesën e muslimanit me idhujtare. Meqë Islami refuzon idhujtarinë dhe totemiz-

min në mënyrë kategorike, atëherë si do të ketë qetësi, dashuri e harmoni midis tyre?!

Bashkimi i këtyre dyve i ngjan fjalës së një poetit arab antik që thotë:

*Çfarë martese bën Suhejli me Thurejjen,
Zoti i gëzofte, të dy harmoni s'mund të kenë
Kur ndahet, ajo është shamite,
e Suhejli kur ndahet, është jemenas!?*

Prostitutat

17. Me termin “prostituta” nënkuptojmë gratë që haptazi merren me kurvëri dhe fitojnë të holla nëpërmjet këtij profesioni. Murthid ibn Ebi Murthid kërkonte lejen prej Pejgamberit a.s. të martohet me një lavire që e njihte prej kohës paraislame e që quhej I'nâk, mirëpo ai refuzoi dhe zbriti ajeti i Kur'anit:

“Pushti nuk do të duhej të martohet me tjetërkë pos me ndonjë grua të përdalë ose idhujtare, e me gruan e përdalë nuk do të duhej të martohet kush pos ndonji pushti apo idhujtar. Ajo (lavrja), (ose martesa me të) është e ndaluar për besimtarët.” (Nûr, 3).

Pastaj Pejgamberi ia lexon këtë ajet dhe i thotë:

“Mos e marto!”¹

Zoti i Madhëruar lejon martesën me besimtarët dhe me ithtarët e Librit, ashtu siç lejon edhe martesën e burrave, por me kusht që të kenë për qëllim bashkëshortësinë e jo prostitucionin. Ai që se pranon këtë parim të Kur'anit konsiderohet mushrik, dhe i lejohet të martohet vetëm me mushrike. Ai që pranon këtë parim dhe obligohet se do ta aplikojë por martohet me atë që e ka të ndaluar për martesë, konsiderohet zani.

Ky ajet vijon pas ajetit të dënimit në suren “Nûr”:

“Laviren dhe pushtin t'i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna”. (Nûr, 2).

Ky është dënim fizik e ai është dënim etik. Ndalimi i martesës me pushtin e laviren, sipas traditës bashkëkohore, i ngjanë dënimit me

¹ Këtë ngjarje e transmetojnë Ebu Davudi, Nesaiu dhe Tirmidhiu.

heqjen e nderit të qytetarit, me anulimin e shtetësisë ose me privimin e disa të drejtave të posaçme.

Pasi që e sqaron kuptimin e ajetit të lartpërmendur, Ibn Kajjimi, (Zoti e mëshiroftë), thotë: “Ky parim është i qartë dhe i obliguar nga Kur’ani, bile obligim instinktiv dhe racional. Zoti i Madhëruar ia ndaloj robët të Vet të jetë burrë i tradhtuar, bashkëshort i mashtruar dhe njeri i degraduar i cili do të martohet me lavire. Zoti d.m.th. e mbolli në njerëzit instinktin që këtë ta urrejnë dhe ta dënojnë. Për këtë shkak, nëse dëshirojnë njerëzit të shajnë ndokënd, thonë: “Burri i lavires!” Zoti nuk e lejon muslimanin të jetë i tillë”.¹ “Ndalimi i tillë sqarohet më tepër nga fakti se gruaja e tillë bën krim kundër burrit të vet dhe shoqërisë. Ajo fëlliq shtratin e burrit të vet dhe shkatërron rrjedhën të cilën Zoti dëshiron ta mbrojë për hir të integritetit dhe funksionimit të pastër të shoqërisë, që e konsideron edhe dhunti të Vetën për njerëzinë. Prostitucioni shkakton kaos në lidhjet e rrjedhës familjare. Një prej karakteristikave të urta të sheriatit është ndalimi i martesës me lavire (prostitute) derisa të pendohet dhe ta bëjë të ditur se nuk është me barrë. (Pastërtia e saj vërtetohet me anë të të përmuajshmeve)”.

Po ashtu, lavirja është grua e degraduar...

Zoti i Madhëruar e ka bërë martesën për hir të dashurisë e mëshirës. Pasi që dashuria është e pastër, atëherë si mund e keqja të jetë e dashur për burrin e mirë? Burri quhet *zevxxh* nga dualiteti e që do të thotë barabarësi: dy të martuarit janë dy palë të barabarta, e sipas sheriatit, nuk mund të jenë të barabartë i miri me të keqen, ngase në raste të tilla nuk lindin dashuria, mëshira ose respekti i ndërsjellë. E vërtetë është fjala e Zotit kur thotë:

“Të këqijat (gra ose fjalë) janë për të këqijtë dhe të këqijtë janë për të këqijat, ndërsa të ndershmet janë për të ndershmit dhe të ndershmit janë për të ndershmet”. (Nûr, 26).

Martesa e përkohshme (mut’a)

Martesa në Islam është kontratë e fortë dhe betim i rëndësishëm mes dy bashkëshortëve për një jetë të përbashkët e të përhershme, me qëllim që të realizohet fryti psikik të cilin e potencon Kur’ani (qetësia shpirtërore, mëshira dhe dashuria). Qëllimi qytetëruar i

¹ *Igâthetul-lehefân* vëll. 1, f. 66-67.

martësës është të sigurohet vazhdimësia dhe të mbrohet ekzistenca e gjinisë njerëzore.

“All-llahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja - fëmijë e nipër dhe ju furnizoi me (ushqime) të mira.” (Nahl, 72).

Martesa *mut'a* nënkupton lidhjen bashkëshortore me interval kohor të caktuar dhe me kompensim të posaçëm, pa u realizuar ajo që u cek më parë. Këtë lloj të martësës Pejgamberi a.s. e lejoi para stabilizimit legjislativ të Islamit. Ai e lejoi në rrugë e beteja e pastaj e ndaloi në mënyrë të përhershme.

Në fillim e lejoi ngase njerëzit ishin në fazën e quajtur “periudhë e tranzicionit” prej xhahilijetit në Islam, dhe ishin mësuar me prostitucionin që ishte shumë i përhapur në periudhën paraislame.

Pasi që për Fenë islame njerëzit dilnin në luftë e xhihad, filluan të ndiejnë vështirësi nga largimi prej grave të tyre. Pjesëmarrësit e tillë ishin të fortë e të dobët, dhe ekzistonte frika që të dobëtit të ngatërroheshin me prostitucionin, që konsiderohet rrugë më e keqe dhe më e pamoralshme. Ata që ishin të fortë dëshironin ta tredhnin vetveten. Në këtë kontekst ibn Mes'udi thotë:

“Luftonim bashkë me Pejgamberin a.s. pa i patur gratë me ne, dhe thamë: ‘A nuk tredhemi?’ Kështu Pejgamberi a.s. na ndaloi këtë mendim dhe na lejoi të martohemi për një kohë të caktuar”.¹

Pra, lejimi i martësës së kufizuar në kohë (*mut'a*), ishte zgjidhje e problemit të grupit të dobët dhe atij të fortë, si dhe hap për vazhdimin legjislativ deri te jeta e përkryer martesore, në të cilën realizohen të gjitha qëllimet, gjegjësisht realizohen mbrojtja, stabilizimi, vazhdimësia, mëshira, dashuria dhe zgjerimi i lidhjeve shoqërore.

Mënyra graduale e Kur'anit për ndalimin e alkoolit dhe kamatës, të cilat ishin të përhapura në periudhën paraislame, gjithashtu nga Pejgamberi a.s. u aplikua edhe për ndalimin e kurvërisë. Pejgamberi në fillim e lejoi *mut'a* martesën por më vonë rreptësisht e ndaloi. Këtë e vërejmë qartë nga transmetimet e Aliut dhe të një grupi të

¹ Transmetim unanim.

sahabëve r.a. Muslimi transmeton në *Sahihun* e vet se Sibre El-Xhuhni

ka luftuar me Pejgamberin a.s. në çlirimin e Mekkes dhe se ua ka lejuar *mut'a* martesën mirëpo pas një kohe shumë të shkurtë Pejgamberi a.s. ua ndaloi dhe ju tha:

“Zoti ua ndalon atë deri në Ditën e Kijametit”.

A thua ndalohet rreptësisht kjo martesë ashtu siç ndalohet martesa me nënën, bijën dhe ngrënia e cofëtirave, e gjakut dhe e mishit të derrit, apo lejohet në rast të nevojave obligative?

Sipas mendimit të përgjithshëm të sahabëve, pas stabilizimit të sheriatit ky ndalim është kategorik dhe pa kurrfarë përjashtimesh, përveç Ibn Abbasit, i cili mendonte ndryshe, gjegjësisht e lejonte në raste të nevojës obligative. Kur pyetet për martesën e tillë, e lejon, ndërsa kur robi i tij e pyet se a lejohet në rast kritik dhe kur ka pak gra, ai i përgjigjet: “Po!”¹

Kur e kupton Ibn Abbasi se njerëzit fillojnë ta keqpërdorin mundësinë e tillë dhe nuk e respektojnë rastin e nevojës obligative, atëherë e ndryshon mendimin e vet dhe e ndalon.²

Martesa me më shumë gra

Islami është fe që përputhet me instinktin, shqyrton realitetin dhe largohet nga çdo teprim i dëmshëm. Këtë e vërejmë qartë në qëndrimin e tij ndaj poligamisë, gjegjësisht ia lejon muslimanit martesën me më shumë se një grua për qëllime të rëndësishme njerëzore, qofshin individuale apo shoqërore.

Shumë fe e shoqëri paraislame lejonin martesën me më shumë gra, numri i të cilave arrinte me dhjetëra ose me qindra sosh pa kurrfarë kushtëzimesh e përkufizimesh, mirëpo kur u shpall Islami, caktoi kufizime e kushte për poligaminë. Numrin më të madh të grave e lejoi deri në katër. Kur e pranoi Islamin, Gîlan eth-Thekafiu kishte dhjetë gra, dhe në atë rast Pejgamberi a.s. i tha:

¹ Transmetim i Buhariut.

² *Zâdul-me'âd*, vëll. 4, f. 7, botim i Subejhit. Transmetimi i Bejhakiut.

“Zgjedh prej tyre vetëm katër, e të tjerat lëshoi!”¹

Pejgamberi gjithashtu i urdhëronte të mbajnë nga katër gra edhe ata të cilët rishtazi e pranonin Islamin ndërsa ishin të martuar me tetë² ose pesë gra.³

Martesa e Pejgamberit a.s. me nëntë gra ishte specifike nga Zoti për shkak të nevojës për thirrje në jetën e tij dhe nevojës së ummetit për to pas vdekjes së tij.

Drejtësia është kusht për lejimin e martesës me më shumë gra

Islami e kushtëzon muslimanin që në martesën me më shumë se një grua të jetë plotësisht i drejtë mes dy ose më shumë grave të tij, gjëgjësisht të jetë i drejtë në veshmbathje, në ushqim, në vendbanim dhe në furnizim. Ai që nuk mund të jetë i drejtë në këto obligime, nuk mund të martohet me më shumë se një grua. Në këtë kontekst Zoti i Madhëruar thotë:

“Nëse frikoheni se nuk do të jeni të drejtë, atëherë (martohuni) me një (grua)!” (Nisâ, 3).

Pejgamberi a.s. thotë:

“Nëse ndokush ka dy gra dhe anon nga njëra prej tyre, Ditën e Kijametit do të heqë gjysmën e trupit zvarrë”.⁴

Animi i theksuar në këtë hadith nënkupton keqpërdorimin e të drejtave që ju takojnë e jo vetëm animin sentimental. Pra, meqë kjo ka të bëjë me një drejtësi të pamundshme, vërejtëm se Zoti falë dhe mëshiron:

¹ Transmetim i Shafiut, Ahmedit, Tirmidhiut, Ibën Maxhes, Ibën Ebi Shejbes, Darukutnit dhe Bejhakiut.

² Transmetim i Ebu Davudit.

³ Në Musnedin e tij.

⁴ Transmetim unanim.

“Ju kurrësi nuk do të mund ta mbani drejtësinë midis grave edhe nëse përpiqeni, pra mos anoni plotësisht nga njëra e ta lini tjetrën si të varur”. (Nisâ, 129).

Kur Pejgamberi a.s. dëshironte të udhëtojë, përdorte shortin dhe cilën i binte shigjeta, e shoqëronte. Ai këtë e bënte me qëllim që ta pengonte hidhërimin dhe ta ruante qetësinë e të gjithave.¹

Pejgamberi a.s. i cili vepronte me drejtësi, thotë: “O Zot, kjo është ndarja ime për atë që e posedoj, më fal për atë që s’e posedoj e Ti e posedon!”²

Urtësia e lejimit të martesës me më shumë gra

Islami është fjala e fundit e Zotit me të cilën e përfundoi ciklin e mesazheve dhe për këtë shkak miratoi sheriatin e përgjithshëm e të përhershëm që vlen për të gjitha vendet dhe për mbarë njerëzinë në botë. Ai nuk vlen për qytetarin më shumë sesa për fshatarin, e as më shumë për vendet arktike sesa për ato ekuatoriale, ai gjithashtu nuk kufizohet për një kohë e t’i lërë pas dore kohët dhe gjeneratat tjera. Ai e çmon nevojën e individëve dhe të shoqërisë pa kurrfarë dallimi. Meqë ka njerëz që kanë dëshirë të madhe për vazhdimin e rrjedhës mirëpo janë të martuar me gra sterile, atëherë a nuk do të ishte më mirë që ata të martohen edhe me gra tjera dhe ta realizojnë dëshirën e vet, por me kusht që t’i mbrojnë të drejtat e të parës?

Gjithashtu ka njerëz që kanë potencial të madh seksual mirëpo janë të martuar me gra frigjide, të sëmura ose me periudhë të gjatë të të përmuajshmeve. Nëse këta njerëz s’mund të durojnë atëherë pse t’u mos u lejohet martesë me një grua tjetër në vend që të kenë dashnore?

Mund të ndodhë që numri i grave të jetë më i madh se i burrave, veçanërisht në raste të luftës kur vriten burrat dhe fëmijët, dhe në këtë rast në interes të shoqërisë është që këto gra të martohen e jo të mbeten të privuara nga jeta bashkëshortore, që është e gërshetuar me qetësi, dashuri, mbrojtje dhe ndjenja materiale.

Për gratë që janë më në numër se burrat ka tri alternativa:

1. Të jetojnë tërë jetën në privimin e tillë të hidhur.
2. Të jenë objekt kënaqësie e epshi të ndaluar për burrat ose,

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i autorëve të suneneve.

3. Të martohen me njerëz të martuar që mund t'i furnizojnë dhe t'i respektojnë.

S'ka dyshim se alternativa e fundit është zgjidhje më e përshtatshme e më e drejtë, dhe për këtë ekziston edhe parimi i Islamit:

“Po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më të mirë se i All-llahut?” (Mâide, 50).

Kështu është çështja e martesës me më shumë gra për të cilën Perëndimi i krishterë i kritikon muslimanët, kurse në anën tjetër ua lejon meshkujve të vet të kenë shumë dashnore, duke i injoruar të gjitha kufizimet dhe përgjegjësitë ligjore ose etike ndaj gruas ose ndaj rrjedhës që pason nga poligamia joligjore, jofetare e jomorale! Pra, cila prej këtyre dy zgjidhjeve është më e drejtë dhe më e udhëzuar?

MARRËDHËNIET MIDIS BASHKËSHORTËVE

Kur'ani i thekson qëllimet shpirtërore të martesës dhe i konsideron parime mbi të cilat ngrihet jeta bashkëshortore, gjegjësisht thekson qetësinë e shpirtit nëpërmjet lidhjes gjinore nga dashuria midis dy bashkëshortëve, zgjerimin e dashurisë dhe njohjes nëpërmjet martesës, rritjen e dashurisë dhe mëshirës njerëzore dhe dashurinë e prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Në këtë kontekst, All-llahu i Madhëruar thotë:

“Dhe nga argumentet e Tij (të Madhërisë së Tij) është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe ndërmjet jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Er-Rrûm, 21).

Marrëdhëniet seksuale

Përveç kësaj, Kur'ani nuk e mohon aspektin trupor për marrëdhëniet seksuale ndërmjet burrit e gruas. Ai e udhëzon qenien njerëzore në rrugën më të mirë duke i plotësuar kërkesat e nevojës seksuale, me qëllim që ta mënjanojë praktikën e dëmshme dhe të devijuar.

Transmetohet se hebrenjtë dhe zjarrputistët largoheshin gjatë kohë nga gratë e tyre kur ato i kishin të përmuajshmet, ndërsa të krishterët kanë marrëdhënie të tilla pa u mërzhitur fare për periudhën e tillë. Në kohën paraislame, gruas që i kishte të përmuajshmet, nuk i jepnin ushqim, nuk i jepnin të pijë, nuk i lejonin të hynte në shtrat dhe nuk e linin të qëndrojnë në shtëpi, pikërisht si hebrenjtë dhe zjarrputistët.

Kur e pyetën disa muslimane Pejgamberin se ç'u lejohet dhe ç'u ndalohet në kohën e të përmuajshmeve, u shpall ajeti vijues:

“Të pyesin ty për të përmuajshmet (hajzin), thuaj: “Ajo është gjendje e neveritur andaj largohuni prej grave gjatë të përmuajshmeve dhe mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen. E kur të pastrohen atëherë afrohuni atyre, ashtu siç u ka lejuar All-llahu.

All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme". (El-Bekare, 222).

Disa beduinë menduan se fjalët "largohuni prej tyre" nënkuptojnë mosjetesën e përbashkët në shtëpi, dhe për këtë Pejgamberi a.s. ua shpjegoi qëllimin e ajetit dhe u tha: *"Ju urdhëron të largoheni nga marrëdhëniet seksuale në kohën e të përmuajshmeve e jo t'i largoni nga shtëpia ashtu siç i largonin të huajt"*. Kur e dëgjuan këtë, hebrenjtë thanë: "Ky njeri dëshiron të veprojë krejtësisht ndryshe nga ne!"¹

S'ka gjë nëse muslimani dëshiron të dëfrehet me gruan e tij larg "vendit të dhembjes". Kështu, Islami, si përherë merr qëndrim mesatar mes ekstremistëve që e largojnë gruan gjatë të përmuajshmeve nga shtëpia dhe ekstremistëve tjerë që kanë marrëdhënie seksuale me to.

Mjekësia bashkëkohore ka zbuluar materie helmuese e të dëmshme për trupin. Gjithashtu ajo ka zbuluar edhe shkakun se pse duhet burri të largohet nga marrëdhënia seksuale në këtë kohë. Organet riprodiktive mbushen përplot dhe nervat bëhen shumë sensitive nga sekretimi i gjëndrave internale. Marrëdhënia seksuale mund t'i dëmtojë e ndoshta edhe të pengojnë derdhjen e gjakut nga të përmuajshmet dhe kështu të shkaktojë ndezjen e organeve seksuale.²

Marrëdhëniet e ndaluara

Sa u përket marrëdhënieve seksuale, Zoti i Madhëruar thotë:

"Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj, afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi, por përgatitni për veten tuaj, dhe kini frikë All-llahun, e ta dini se fundi juaj është tek Ai, e besimtarëve jepu myzhde". (El-Bekare, 223).

Për shkak të zbritjes së këtij ajeti, dijetari indus Velijull-llah Dehlavi thotë: "Hebrenjtë i kufizonin mënyrat e marrëdhënieve seksuale pa ndonjë parim hyjnor. Edhe ensarët (e Medines) i imitonin në këtë çështje dhe thonin: "Në qoftë se burri depërton në vaginë përderisa gruaja është e shtrirë në bark, fëmija do të jetë i vëngër". Për këtë shkak zbriti ajeti: "Afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi", që don të thotë se s'është me rëndësi pozita por me kusht që procesi të kryhet në vaginë, ngase në këtë çështje s'ka asgjë që ka lidhje me

¹ Shiko tefsirin e Raziut, vëll. 6, f. 66.

² Shiko librin *El-Islamu vet-tibbul-hadith* të autorit të ndjerë Abdulaziz Ismail.

interesin e përgjithshëm fetar ose politik, por është thjesht çështje e shijes personale.

Thashethemet e tilla bëheshin nga hebrenjtë, mirëpo Zoti i Madhëruar i anuloi.¹

Feja nuk i përcakton pozitat e marrëdhënies seksuale por kërkon që burri të frikohet nga Zoti se do ta takojë, dhe të largohet nga marrëdhënia anale, ngase anusi është vend i fëlliqur dhe i dhembjes, si dhe një akt i tillë u ngjanë homoseksualëve të fëlliqtë. Pra, feja me plot të drejtë e ndalon këtë lloj të marrëdhënies. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

*“Mos bëni marrëdhënie anale me gratë (tuaja)!”*² Për atë që ka marrëdhënie anale me gruan e vet, thotë: *“Ky është homoseksualizëm i vogël”*.³ Kur e pyeti një grua rreth marrëdhënies seksuale vaginale nga shpina, ai ia lexoi ajetin: *“Gratë tuaja janë vendmbjellje e juaj, afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi, por vetëm me një mbështetje”*.⁴

Umeri r.a. shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “O i dërguari i Zotit, u shkatërrova! Kur Pejgamberi a.s. pyeti se çka e shkatërroi, ai i thotë: “Mbrëmë pata marrëdhënie vaginale nga shpina!” Pejgamberi nuk i thotë gjë derisa u shpall ajeti i lartpërmendur, e pastaj i thotë: *“Nga para ose nga pas, por largohu anusit dhe (marrëdhënies) gjatë të përmuajshmeve”*.⁵

Ruajtja e sekreteve bashkëshortore

Kur’ani i lavdëron bashkëshortet e mira duke konstatuar:

“All-llahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë respektuese, janë besnike ndaj së fshehtës”. (Nisâ, 34).

Ajo që duhet të ruhet si fshehtësi është lidhja intime midis burrit e gruas, e cila nuk duhet të jetë temë e bisedave nëpër mexhlise, e takimeve me shokë e shoqe. Në një hadith të Pejgamberit a.s. thuhet:

¹ *Huxhaxhetull-llahil-bâliga*, vëll. 2, f. 134.

² Transmetim i Tirmidhiut, i Nesaiut dhe i Ibën Maxhes.

³ Transmetim i Nesaiut.

⁴ Transmetim i Ahmedit.

⁵ Transmetim i Ahmedit dhe Tirmidhiut.

إِنَّ مِنْ شَرِّ النَّاسِ مَنْزِلَةً عِنْدَ اللَّهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ الرَّجُلُ يُفْضِي
إِلَى الْمَرْأَةِ وَتُفْضِي إِلَيْهِ ثُمَّ يَنْشُرُ سِرَّهَا.

“Prej njerëzve më të këqij te Zoti Ditën e Kijametit është burri i cili i tregon gruas fshehtësira dhe anasjelltas, e pastaj e zbulon fshehtësinë e saj”¹.

Nga Ebu Hurejreja transmetohet:

“Pejgamberi a.s. na fali dhe pas dhënies së selamit u kthye drejt nga ne dhe tha: *“Qëndroni ulur! A ka ndonjë njeri në mesin tuaj që shkon te familja e vet, e mbyll derën, e heq perden dhe del e thotë: “Kështu bëra me familjen time, kështu bëra me familjen time!”*”

Të gjithë heshtën. Pastaj u kthye drejt grave dhe u tha: *“Cila flet prej jush?”* Një vajzë e Ke’abit u ngrit në një këmbë dhe u zgjat që ta shohë Pejgamberi dhe ta dëgjojë atë që flet, e pastaj tha: *“Po për Zotin! Ata flasin dhe ato flasin!”* Pastaj Pejgamberi a.s. na tha: *“A e dini se ç’janë të tillët dhe të tillat që veprojnë kështu? Ata që veprojnë kështu, qofshin meshkuj apo femra, janë djaj të cilët*

¹ Transmetim i Muslimit dhe Ebu Davudit.

takojnë njëri-tjetrin në rrugë dhe i qetësojnë epshet e tyre kurse njerëzit i shikojnë.”¹

Ky rrëfim emfatik mjafton që muslimani të largohet nga kjo marrëzi ngase asnjë musliman nuk dëshiron të jetë djall ose si djalli.

Kontracepcioni

S’ka dyshim se mbrojtja e rrjedhës njerëzore është prej qëllimeve parësore të martesës. Mbrojtja e rrjedhës varet nga vazhdimi i riprodksionit. Islami preferon riprodksionin e shumtë dhe i bekon fëmijët qofshin djem apo vajza. Ai gjithashtu lejon planifikimin e familjes në qoftë se ekzistojnë shkaqe dhe nevoja të rëndësishme. Mënyra më e njohur në kohën e Pejgamberit a.s. për kontracepcion ishte *a'zli* ose derdhja e spermës jashtë vaginës (*coitus interruptus*). Në dy sahihët transmetohet nga Xhabiri se edhe sahabët e apliknin mënyrën e tillë në kohën e pejgamberisë dhe të shpalljes:

“Në kohën e Pejgamberit a.s. kur shpallej Kur’ani, ne e apliknim largimin (*coitus interruptus*).”
Në *Sahihun* e Muslimit thuhet:

“E apliknim largimin (*coitus interruptus*) në kohën e Pejgamberit, dhe kur dëgjoi Pejgamberi a.s., nuk na ndaloi!
Një njeri shkoi te Pejgamberi a.s. dhe i tha:

يَا رَسُولَ اللَّهِ! إِنَّ لِي جَارِيَةً وَأَنَا أَعَزُّ عَنْهَا، وَإِنِّي أَكْرَهُ
أَنْ تَحْمِلَ وَأَنَا أُرِيدُ مَا يُرِيدُ الرَّجَالُ. وَإِنَّ الْيَهُودَ تُحَدِّثُ: أَنَّ
الْعَزْلَ الْمَوْدَّةَ الصُّغْرَى!! فَقَالَ عَلَيْهِ السَّلَامُ: كَذَبَتْ
الْيَهُودُ. لَوْ أَرَادَ اللَّهُ أَنْ يَخْلُقَهُ مَا اسْتَطَعَتْ أَنْ تَصْرِفَهُ.

“O Pejgamber i Zotit! Kam një robëreshë. Dëshiroj atë që dëshirojnë burrat! Nuk dëshiroj që ajo të mbetet me barrë dhe për këtë shkak e aplikoj *coitus interruptus-in* me të. Hebrenjtë thonë se

¹ Transmetim i Ahmedit, Ebdu Davudit dhe Bezzarit.

në këtë mënyrë varrosen fëmijët të gjallë”. Pejgamberi a.s. i tha: “*Hebrenjtë gabojnë! Nëse Zoti dëshiron të krijojë fëmijë, ti nuk mund ta pengosh!*”¹

Qëllimi i Pejgamberit a.s. ishte se gjatë aplikimit të largimit mund të ndodhë që ndonjë pikë e spermës së burrit të depërtojë e të bëhet mbarësimi pa dijen e tij.

Në mexhlisin e Umerit u bisedua rreth largimit dhe një njeri tha: “Ata mendojnë se kështu varrosen fëmijët të gjallë!” Aliu thotë: “Nuk mund të ketë varrosje të gjallë përderisa fëmija nuk kalon shtatë faza: prej një ajke e një balte në ujë, në copë gjaku, në gjak të ngurtë, në copë mishi, në eshtra e në mish dhe pastaj në krijesë tjetër”.

Në atë rast Umeri i thotë: “Ke të drejtë, Zoti të dhashtë jetë!”

Shkaqet për kontracepcion

Shkaku i parë që lejon kontracepcionin është frika për jetën ose shëndetin e nënës nga shtatzënia ose lindja, por me kusht që këtë ta vendosë mjeku specialist dhe besnik. Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos u shkatërroni me duart tuaja!”

“Mos e mbytni veten tuaj! Zoti është mëshirues i juaj!”

Shkaku tjetër është frika nga vështirësimi i rrethanave me lindjen e fëmijëve saqë mund të obligohet ndokush të bëjë diçka haram me qëllim që t’i plotësojë nevojat familjare. Zoti i Madhëruar thotë:

“All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju!” (El-Bekare, 185).

“All-llahu s’dëshiron t’u sjellë ndonjë vështirësi”. (Mâide, 6).

Gjithashtu si shkak mund të jetë edhe frika nga keqësimi i shëndetit të fëmijëve dhe nga pengesat në rritjen e tyre. Në *Sahihun* e Musli-mit transmetohet nga Usame ibn Zejdi se një njeri ka shkuar te Pej-gamberi a.s. dhe i ka thënë:

¹ Transmetimi i autorëve të suneneve.

يَا رَسُولَ اللَّهِ، إِنِّي أَعَزَلُ عَنْ امْرَأَتِي. فَقَالَ لَهُ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: لِمَ تَفْعَلُ ذَلِكَ؟ فَقَالَ الرَّجُلُ: أُشْفِقُ عَلَى وَلَدِهَا - أَوْ قَالَ - عَلَى أَوْلَادِهَا. فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ: لَوْ كَانَ ضَارًّا لَضَرَّ فَارِسَ وَالرُّومَ.

“O i dërguari i Zotit, unë largohem nga gruaja (aplikoj *coitus interruptus*)!” Kur e ka pyetur Pejgamberi për shkakun, ai i ka thënë: “Frikohem për fëmijën e saj”, ose “për fëmijët e saj”, pastaj Pejgamberi a.s. i ka thënë: “*Sikur të ishte i dëmshëm, do të ishte i dëmshëm për persianët dhe romakët*”.¹

Siç duket, Pejgamberi mendonte se rastet e tilla të rralla nuk ndikojnë në ummetin, ngase në të kundërtën do t'i dëmtonin persianët dhe romakët të cilët atëherë ishin më të fuqishmit mbi sipërfaqen e tokës.

Shkaku tjetër i arsyeshëm është frika se mos vallë ndikon shtatzënia ose lindja e re në shëndetin e fëmijës që thithë. Pejgamberi a.s. e quante “gilë” marrëdhënien seksuale me nënën që i jep gji fëmijës ose thënë më mirë, marrëdhënien që shkakton shtatzëni përderisa nëna ende i jep gji fëmijës. Ai e quan me këtë term ngase shtatzënia e tillë e dobëson qumështin e nënës dhe e dëmton fëmijën që thithë. Pejgamberi a.s. e mbronte interesin e ummetit dhe e ndalonte atë që ishte e dëmshme. Prej përpjekjeve të tij për ummetin e vet, është thënia e tij:

لَا تَقْتُلُوا أَوْلَادَكُمْ سِرًّا فَإِنَّ الْغَيْلَ يُدْرِكُ الْفَارِسَ فَيُدْعَثُهُ.

“Mos i mbytni fëmijët tuaj fshehurazi ngase “gile-ja” e zë kalorësin dhe e gjuan prej kalit”.² Pejgamberi a.s. nuk e ndaloi këtë formë për ta bërë haram, ngase i shihte popujt e fuqishëm të kohës së tij, të cilët e aplikonin pa pësuar dëme. Ai frikohej se do të jetë shumë vështirë për burrat të abstenojnë nga gratë e tyre gjatë periudhës së gjidhënies e cila mund të zgjasë edhe dy vjet. Ai thotë:

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Ebu Davudit.

*“Mendoja ta ndaloj “gile-në” mirëpo pashë se persianët dhe romakët e aplikonin pa i dëmtuar fëmijët e tyre.”*¹

Kur flet Ibn Kajjimi për lidhjen mes këtij hadithi dhe hadithit *“Mos i mbytni fëmijët tuaj fshehurazi”*, thotë: “Pejgamberi a.s. ka vërejtur se shtatzënia e dëmton fëmijën që thithë ashtu siç dëmtohet kalorësi nga rrëzimi prej kalit. Kjo mënyrë dëmton por jo deri në mbytjen e fëmijës. Ai i këshillonte burrat të largohen nga marrëdhëniet seksuale që shkaktojnë shtatzëninë me gruan që i jep gjë fëmijës, por nuk i ndalonte. Ai dëshironte ta ndalojë me qëllim që ta mbrojë shëndetin e fëmijës që thithë gjë, por gjithashtu e dinte se burrat do të përjetojnë vështirësi të mëdha posaçërisht të rinjtë, dhe kështu më tepër do ta dëmtonte shoqërinë. Pas një harmonizimi të këtyre gjërave, ai vendosi që mos ta ndalojë, ngase gratë e dy popujve më të fuqishëm të kohës së tij u jepnin gjë fëmijëve të tyre gjatë shtatzënisë pa ndikuar fare në fuqinë apo në numrin e tyre.

Pra, për këtë shkak ai nuk e ndaloi “gile-në”.²

Në kohën tonë janë zbuluar metoda të reja kontraceptive që realizojnë interesin për të cilin përpiquej Pejgamberi a.s. gjegjësisht mbrojtjen e fëmijës që thithë nga dëmet që mund të ndodhin gjatë shtatzënisë së nënës së tij në një anë dhe në anën tjetër, mënjanimin e vështirësive për burrat nga abstenimi ndaj grave gjatë shtatzënisë. Nga e tërë kjo konkludojmë se intervali ideal mes dy fëmijëve, sipas Islamit, duhet të jetë 30 ose 33 muaj për atë që dëshiron të plotësojë fazën e periudhës së gjidhënies.

Imam Ahmed dhe të tjerët lejojnë një gjë të tillë në qoftë se e lejon gruaja, ngase ajo duhet të japë pëlqimin e saj se a do të pranojë të përjetojë kënaqësinë seksuale dhe se a dëshiron fëmijë tjetër apo jo. Umeri r.a. e ka ndaluar largimin (*coitus interruptus-in*) pa pëlqimin e gruas.

Ky ishte një vendim i rëndësishëm i Islamit për mbrojtjen e të drejtës së gruas në kohën kur nuk respektohej asnjë e drejtë e saj.

¹ Transmetim i Muslimit.

² *Miftahu daris-se'ade*, f. 620 dhe *Zâdul-me'âd*, vëll. 4, f. 16.

Aborti

Islami lejon muslimanen të ndërmarrë masa preventive kontraceptive por nuk lejon të kryhet krim mbi shtatzëninë kur të paraqitet realisht.

Fukahatë janë të mendimit se aborti pas formimit të fetusit dhe frymëzimit të shpirtit është i ndaluar dhe konsiderohet krim. Nuk i lejohet muslimanit ngase në këtë rast ai bën krim mbi të gjallin që ka krijuar të plotë dhe formë të gjallë. Nëse bëhet aborti dhe fëmija del i gjallë e pastaj vdes, atëherë duhet të paguhet kompensim (dijeti), ose më së paku të dënohet materialisht nëse del i vdekur. Nëse vërtetohet nga ana e mjekut besnik se jeta e fëmijës në bark rrezikon jetën e nënës, atëherë sheriat lejon dënim më të lehtë. Nëse në këtë rast duhet të kryhet aborti atëherë lejohet, ngase nuk duhet që nëna të sakrifkohet sepse ajo është origjina e fetusit. Ajo ka të drejtë në jetë, ka fat të pavarur në jetë si dhe ka të drejta të cilat i takojnë dhe përgjigjet për to. Përveç kësaj, ajo është shtylla e familjes dhe për këtë shkak nuk është e logjikshme që jeta e saj të sakrifkohet për fetusin që nuk ka ende personalitet të vetin, si dhe është pa obligime e përgjegjësi.¹

Imam Gazaliu bën dallim midis kontracepcionit dhe abortit dhe thotë: “Kontracepcioni nuk është si aborti, ngase aborti është krim mbi gjallesën e formuar. Ekzistenca ka fazat e veta: faza e parë është depërtimi i spermës në mitrën e gruas dhe përzierja e saj me vezoret e gruas, e pastaj përgatitet për pranimin e jetës. Shkatërrimi i këtij procesi konsiderohet krim. Nëse fetusin arrin një madhësi të konsiderueshme, atëherë aborti konsiderohet edhe më i keq ndërsa krimi shtohet edhe më tepër në qoftë se fetusin frymëzohet me shpirt. Krimi e arrin kulmin kur fetusin hiqet i gjallë (nga nëna).”²

Të drejtat bashkëshortore

Theksuam më parë se martesë është kontratë e fortë, me të cilën All-llahu lidhë burrin dhe gruan. Pas martesës burri merr statusin e “bashkëshortit” pas atij si “individ”. Në të vërtetë ai quhet bashkëshort ngase prezanton edhe një qenie tjetër me të cilën i ndanë të mirat dhe të këqijat.

¹ Shejh Sheltut, *El-Fetavâ*, f. 464.

² *El-Ihja'u*, libri *En-Nikah*, f. 47

Kur'ani e përshkruan fuqinë e kësaj lidhjeje midis burrit e gruas dhe thotë:

“Ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato!” (El-Bekare, 187).

Nga ky ajet nënkuptohet se martesë ngërthen në vete mbrojtjen, mbulesën, përkrahjen dhe zbulimin ndaj njëri-tjetrit. Për këtë shkak burri dhe gruaja në jetën bashkëshortore kanë të drejta të cilat duhet t'i respektojnë ndaj njëri-tjetrit. Të gjitha të drejtat janë ekuivalente, përveç asaj që e posedon njeriu nga intuita. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Edhe atyre (grave) u takon e drejta sikurse edhe përgjegjësia në bashkëshortësi, e burrave u takon një përparësi ndaj tyre”. (El-Bekare, 228).

Përparësia ka të bëjë me përgjegjësinë e burrit si mirëmbajtës i familjes.

Një njeri e ka pyetur Pejgamberin a.s.:

“O Pejgamber i Zotit, çfarë të drejta mund të kërkojë gruaja nga burri i saj?” Ai i është përgjigjur: *“Ta ushqejë ashtu siç e ushqen veten, ta veshë ashtu siç e veshë veten, të mos i mëshojë në fytyrë, të mos e nënçmojë dhe të mos largohet prej saj përveç brenda shtëpisë (të mos ik).”*¹

Bashkëshortit musliman nuk i lejohet ta lërë pas dore veshmbathjen dhe ushqimin e bashkëshortes. Në një hadith pejgamberik thuhet:

*“Humbja e mirëmbajtjes ndaj atyre që janë nën përgjegjësi (që janë të varur) është mëkat për njeriun”.*²

Nuk lejohet mëshuarja në fytyrën e gruas për shkak se në këtë mënyrë nënçmohet nderi i njeriut si njeri dhe dëmtohet pjesa më e bukur e trupit. Nëse burri obligohet ta disiplinojë gruan e vet në çaste të rebelimit të hapur, nuk i lejohet ta rrahë aq shumë sa që ta

¹ Transmetim i Ebu Davudit dhe Ibën Habbanit në Sahihun e tij.

² Transmetim i Ebu Davudit, Nesaiut dhe Hakimit.

lëndoje ose t'i shkaktoje dhembje. Kjo vjen parasysh vetëm atëherë në qoftë se metodat tjera dështojnë.

Nuk i lejohet muslimanit ta nënçmojë gruan e vet e ta ofendojë me fjalë të urrejtura, si p.sh. frazën “Zoti të mëshoftë” etj.

Për të drejtat e gruas ndaj burrit Pejgamberi a.s. thotë:

“Nuk i lejohet gruas që beson në Zot, të lejojë hyrjen e atij që burri e urren. Ajo nuk duhet të dalë jashtë shtëpie nëse nuk dëshiron ai dhe të mos bëjë diç që i kundërshton rregullat e tij, si dhe të mos largohet nga shtrati i tij (të mos refuzojë aktin gjinor). Po ashtu ajo s’duhet ta rrahë në qoftë se ka trup më të fuqishëm se ai. Nëse ai është më tepër gabimtar, atëherë ajo duhet ta qetësojë. Nëse e pranon pëlqimin e saj, atëherë pëlqimin e saj do ta pranojë edhe Zoti. Nëse nuk është e kënaqur me të, atëherë Zoti do ta pranojë arsyen e saj”.¹

Toleranca e ndërsjellë bashkëshortore

Burri duhet të jetë tolerant ndaj gruas së vet në rast se sheh diçka që nuk i pëlqen dhe që e urren. Ai duhet të dijë se ka të bëjë me një genie njerëzore që ka karakteristika të posaçme natyrore. Pra, ai duhet t’i harmonizojë cilësitë e mira të saj me jo të mirat, dhe sjelljet e mira me gabimet e saj. Në një hadith thuhet: “*Le të mos e*

¹ Transmetim i Hakimit.

*urrejë besimtari besimtaren. Nëse ndonjë gjë nga ajo nuk i pëlqen, ndoshta mund t'i pëlqejë diçka tjetër”.*¹

Zoti i Madhëruar thotë:

“Bëni jetë të mirë me to. Nëse i urreni ato, bëni durim, sepse ndodh që All-llahu të japë shumë të mira në një gjë që ju e urrenit.” (Nisâ, 19).

Islami kërkon prej burrit të jetë tolerant dhe durimtar ndaj asaj që e urren te gruaja e vet ashtu siç kërkon edhe prej gruas të jetë tolerante e durimtare ndaj tij aq sa ka mundësi dhe durim dhe ia tërheq vërejtjen që të mos e kalojë natën pa u pajtuar me burrin të cilin e ka hidhëruar. Në një hadith thuhet:

*“Namazi i tre personave nuk ngrihet më lartë se një pëllëmbë nga kokat e tyre: personi i cili falet me xhematin që e urren atë; gruaja që kalon natën pa u pajtuar me burrin që e ka hidhëruar dhe dy vëllezërit e kacafytur.”*²

Kundërshtimi dhe grindja

Meqë burri është përgjegjës i shtëpisë dhe bartës i familjes në bazë të strukturës, aftësisë dhe pozitës së tij dhe dhënës i mehrit e furnizues i saj, atëherë nuk i lejohet gruas ta kundërshtojë autoritetin e tij e ta shkatërrojë shtëpinë. Në qoftë se burri has në kundërshtim me gruan e tij dhe ballafaqohet me grindje, ai obligohet ta korrigjojë duke filluar me fjalë të mira, me udhëzime efektive dhe me mirëkuptim. Në qoftë se nuk arrin sukses, atëherë duhet të largohet nga shtrati, me pretekst se ndoshta kështu do të ndikojë në natyrën e saj që ajo të përmirësohet. Në qoftë se edhe kështu nuk ka sukses, atëherë i lejohet ta rrahë me dorë por me kusht që të largohet nga fytyra dhe nga pjesët tjera të ndieshme. Nëse edhe kjo mënyrë dështon, atëherë i lejohet ta rrahë me shkop ose me ndonjë vegël tjetër që shkakton dhembje. Rrahja e tillë ka karakterin e ngjarjes që e për-

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Ibën Maxhes dhe Ibën Habbanit në Sahihun e vet.

shkroi Pejgamberi a.s. në një rast hidhërimi me shërbëtorin e vet, kur i thotë:

لَوْلَا الْقِصَاصُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ لَأَوْجَعْتُكَ بِهَذَا السَّوَاكِ .

“Sikur të mos ishte hakmarrja Ditën e Kijametit, do të të rrahja me këtë misvak”.¹

Pejgamberi a.s. i shmangej metodës së rrahjes dhe thoshte:

“Pse ta rrahë ndokush gruan e vet ashtu siç rrihet robi, kur mund të flejë me të në fund të ditës!”²

Për ata që i rrahin gratë thotë: “Ata me siguri nuk janë më të mirët e mesit tuaj”.³

Imami ibn Haxher thotë: “Hadithi i Pejgamberit a.s.

“Më të mirët e mesit tuaj nuk rrahin”, vërteton se rrahja në përgjithësi është e lejuar por me qëllim disiplinor dhe në raste konkrete. Më mirë do të ishte sikur të mjaftonte me kërcënim në qoftë se ka sukses, dhe në këtë rast burri duhet të largohet nga përdorimi i forcës, sepse forca shkakton urrejtjen që është në kundërshtim me harmoninë e pritur nga martesë. Forca lejohet në qoftë se bëhet ndonjë mëkat ndaj Zotit. Në një hadith të transmetuar nga Nisaiu, Aisheja r.a. thotë:

¹ Ibën Sa’di në *Et-tabakat*.

² Transmetim i Ahmedit dhe i Buhariut.

³ Në *Fet’h* transmetohet nga Ahmedi, Davudi, Nesaiu, Ibën Habbani dhe Hakimi e të cilët e konsiderojnë si hadith Sahih nga Ijas ibën Abdull-llah ibën Ebi Dhibab.

“Pejgamberi a.s. nuk e ka rrahur asnjë grua të veten e asnjë shërbëtor të tij. Në realitet, ai nuk e ka rrahur askënd me dorë, me përjash-tim të rrahjes për hir të Zotit, ose për ndalimin e harameve të cak-tuara nga Zoti, apo për shpagimin në emër të Zotit.”¹ Në qoftë se situata keqësohet edhe më tepër, atëherë ndërhyjnë njerëz të mençur e të devotshëm nga shoqëria islame për ta përmirësuar situatën dhe zgjedhin dy pari të mençura nga të dy palët për gjykim, me qëllim që t’i zgjidhin mosmarrëveshjet midis tyre. Ndoshta sinqeriteti i tyre do të jetë i frytshëm dhe Zoti do t’i pajtojë.

Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“E ata që keni dro kryelartësisë së tyre, këshilloni, madje largoni nga shtrati (e më në fund) edhe rrahni (lehtë, nëse nuk ndikojnë këshillat e as largimi), e nëse ju respektojnë atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. All-llahu është më i larti, më i madhi. Nëse i frikësoheni përçarjes midis tyre (burrit e gruas), dërgoni një pari të drejtë nga familja e tij dhe një pari të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësit) kanë për qëllim pajtimin, All-llahu ju mundëson afrimin midis tyre (burrit e gruas). All-llahu është i dijshtëm, është njohës i mirë”. (Nisâ, 34-35).

Kur lejohet shkurorëzimi (Talâku)

Nëse të gjitha këto orvatje dështojnë dhe nëse të gjitha metodat e ndërmarra pësojnë disfatë, atëherë muslimanit i lejohet zgjidhja e fundit të cilën e ka caktuar sheriat.

Pra, në këto raste të papëlqyeshme, vetëm shkurorëzimi mund t’i zgjidhë problemet. Islami me urrejtje e lejon këtë mënyrë, nuk e pëlqen e as nuk e preferon. Pejgamberi a.s. thotë:

¹ *Fet-hul-bârî*, vëll. 9, f. 249.

“Hallalli më i urrejtur është shkurorëzimi (Talâku)”, ose “Hallalli më i urrejtur te Zoti është shkurorëzimi (Talâku).”¹

Trajtimi i Talâkut si hallall i urrejtur vërteton se ky është lehtësim në rast nevojë, gjegjësisht atëherë kur bashkëjetesa vështirësohet dhe kur dy paritë gjykojnë se vështirë është të përmirësohen marrëdhëniet midis burrit e gruas. Sipas një thënieje, ndarja bëhet atëherë kur nuk ka pajtim. Zoti i Madhëruar thotë:

“Por nëse ndahen prej njëri - tjetrit, All-llahu begaton me mirësinë e tij secilin prej tyre”. (Nisâ, 130).

Shkurorëzimi para Islamit

Nuk është Islami i vetmi që lejoi shkurorëzimin, por ky akt ishte i njohur edhe para tij në tërë botën, përveç te disa popuj. Kur hidhërohej burri e dëbonte gruan nga shtëpia, qoftë me të drejtë apo pa të drejtë, ndërsa gruaja s’kishte kurrfarë mbrojtje, kompensim ose të drejtë.

Në kohën e civilizmit grek, shkurorëzimi ishte i njohur dhe nuk kufizohej me kurrfarë kushtesh. Te romakët shkurorëzimi ishte pjesë e kontratës së kurorëzimit, bile gjykatësi kishte të drejtë të bënte shkurorëzimin edhe në qoftë se burri e gruaja vendosnin të mos ndahen. Martesa fetare te romakët në fillim e ndalonte shkurorëzimin, mirëpo në të njëjtën kohë, i jepte autoritet shumë të gjerë e të pakufizuar bashkëshortit ndaj bashkëshortes, bile edhe ta vrasë. Pas një kohe e lejoi ashtu siç e lejonte e drejta civile.

Shkurorëzimi sipas Hebraizmit

Feja hebreje e përmirësoi pozitën e gruas por gjithashtu e lejon edhe shkurorëzimin me një kompetencë më të gjerë. Në qoftë se konstatohet se gruaja është delikuede nga aspekti i moralit, obligohej burri ta lëshojë bile edhe në qoftë se i falej krimi i bërë. Ligji e obligon burrin ta lëshojë gruan në qoftë se nuk ka lindur ndonjë fëmijë brenda dhjetë vjetëve.²

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² *El-Islamu dinun âmmun*, merhumi Ferid Vexhdi, f. 172.

Shkurorëzimi sipas Krishterimit

Në krahasim me fetë që i cekëm, Krishterimi është i vetmi që lejoi shkurorëzimin, dhe kështu e kundërshtoi Hebraizmin. Në Inxhil ndalohet shkurorëzimi nga vetë Mesihu ashtu siç ndalohet martesja e të shkurorëzuarave dhe të shkurorëzuarve. Në Ungjillin e Mateut, 5: 31, 32, thuhet: “Thuhet se kush e lëshon gruan, duhet t’i japë certifikatë të shkurorëzimit, kurse unë them: “Kush e lëshon gruan për shkaqe të amoralitetit, e bën të pamoralshme, dhe ai që e marton të shkurorëzuarën, konsiderohet se ka bërë amoralitet”.

Në Ungjillin e Markut, 10: 11, 12, thuhet: “Kush e lëshon gruan dhe martohet me një tjetër, bën amoralitet. Edhe gruaja nëse e braktisë burrin dhe martohet me një tjetër, bën krim amoraliteti.”

Ungjilli e arsyeton këtë qëndrim të rreptë me pretekst se “atë që e bashkon Zoti, nuk duhet ta ndajë njeriu”.¹

Kjo frikë është e vërtetë, mirëpo është për t’u habitur se si mund të jetë shkak i shkurorëzimit. Kur thuhet se Zoti i bashkon dy bashkëshortët, nënkuptohet se Ai ua ka lejuar martesën dhe për këtë shkak mund t’i mbështeten Zotit, edhe pse njeriu është i drejtpërdrejtë në kontratën e martesës. Në qoftë se Zoti urdhëron shkurorëzimin për shkaqe objektive, gjithashtu edhe ndarja është prej Zotit, edhe pse njeriu është i drejtpërdrejtë në ndarje. Nga e gjithë kjo nënkuptojmë se njeriu nuk ndanë atë që e ka bashkuar Zoti, por Zoti është bashkues dhe ndarës. A nuk është Zoti, Ai i cili i ndanë për arsye të amoralitetit? Pse nuk i ndanë për ndonjë arsye tjetër?

¹ Shiko *Ungjillin e Mateut*, 19:6, dhe *Ungjillin e Markut*, 10:9.

Mendimet e llojlojshme të krishtere rreth shkurorëzimit

Edhe pse Inxhili e përjashtoi nga ndalimi i shkurorëzimit lejimin në rast të amoralitetit, vërejmë se ithtarët e doktrinë katolike e komentojnë përjashtimin e tillë, dhe thonë: “Këtu nuk nënkuptohet se ky parim është i posaçëm dhe se ka çështje të tjera, në të cilat lejohet shkurorëzimi. Në ligjin e Mesihit nuk ka fare shkurorëzim. Kur potencohet shkaku i amoralitetit, këtu nënkuptohet se vetë kurorëzimi është i anuluar, ndërsa autenticiteti dhe vlera e tij ligjore janë vetëm çështje ekzoterike, ngaqë ka të bëjë me amoralitetin. Me këtë rast, burrit i lejohet, bile obligohet që ta largojë gruan”.¹

Doktrina protestante e lejon shkurorëzimin në raste të posaçme, si p.sh. në raste të amoralitetit të gruas, tradhtisë së saj dhe në disa raste të tjera të cilat i thekson Inxhili. Edhe pse e lejon shkurorëzimin në një anë, në anën tjetër e ndalon rreptësisht rimartesën e të shkurorëzuarit ose të shkurorëzuarës.

Koncili i Kishës Ortodokse në Egjipt i lejon ithtarët e vet të bëjnë shkurorëzim për shkak të amoralitetit, gjegjësisht ashtu siç theksohet në Inxhil. Koncili e lejon shkurorëzimin edhe për shkaqe të tjera, si p.sh. për sterilitetin që zgjatë më shumë se tre vjet; për sëmundjet kronike si dhe për sëmundjet e pashërueshme. Tradicionalistët ortodoksë e refuzojnë shkurorëzimin për shkaqet që nuk përmenden në Inxhil dhe lejimin e martesës së të shkurorëzuarit ose të shkurorëzuarës. Në bazë të këtij parimi, Gjyqi krishter egjiptas refuzoi kërkesën e një gruaje të krishterë, e cila kërkonte shkurorëzim nga burri i saj i vështirë. Në vendimin e gjyqit thuhet:

“Është për t’u habitur se disa priftërinj dhe anëtarë të Koncilit kish-tar të përgjithshëm ecin krahas me kohën, i pranojnë kërkesat e atyre që kanë besim të dobët dhe lejojnë shkurorëzimin për arsye të patheksuara në Inxhil...Vendimi definitiv i Ligjit të krishterë është ndalimi i shkurorëzimit përveç në raste të amoralitetit... Gjithashtu edhe martesë e të shkurorëzuarve konsiderohet martesë e fëlliqur, bile edhe amoralitet.”²

¹ Nga komentimet e *Degës së hulumtimeve fetare* në Institutin koptian katolik të *Ungjillit të Mateut*, fq. 29.

² Gazeta *El-Ehram*, data 1.3.1956.

Pasojat e qëndrimit të Krishterimit ndaj shkurorëzimit

Pasojë e qëndrimit të tillë të çuditshëm ndaj shkurorëzimit në Krishterim është shkatërrimi i natyrës njerëzore dhe i nevojave jetësore të cilat disa herë rezultojnë me ndarje. Përveç kësaj, të krishterët filluan ta refuzojnë fenë e tyre dhe këshillat e ungjijve të tyre. Rezultati përfundimtar ishte “largimi i atyre që i bashkoi Zoti”. Perëndimorët e krishterë miratuan ligje civile, të cilat ua lejojnë daljen nga burgu i tillë i përhershëm. Për fat të keq, shumica e tyre si p.sh. amerikanët, e tepruan aq shumë në çështjen e shkurorëzimit për arsye triviale. Disa filozofë të Perëndimit mendojnë se shkurorëzimi i lehtë shkatërroi shenjtërinë e lidhjes martesore dhe se anulon shumë baza të jetës familjare.

Një gjykatës i shkurorëzimit, i cili i takon elitës së gjykatësve të njohur, deklaroi se jeta bashkëshortore do të shkatërrohet në vendin e tyre dhe do të zëvendësohet me lidhjet e pakufizuara midis burrave e grave, ashtu siç ndodh me transaksionet komerciale, të cilat mund të këputen edhe për arsye me të dobëta. Meqë nuk do të ketë lidhje fetare ose të dashurisë midis çifteve të tilla, këta do të bashkohen vetëm për t'i përjetuar kënaqësitë e llojllojshme, gjë që është në kundërshtim të plotë me mësimet e çdo feje:

“Ky fenomen i rregullimit të çështjeve personale me anë të ligjit civil është në kundërshtim me mësimet e çdo feje, dhe në botë ekziston vetëm te popujt e Perëndimit të krishterë; hindusët, budistët dhe zjarrputistët i aplikojnë parimet të cilat i rregullojnë çështjet e tyre personale. Ne mund të gjejmë në mesin e tyre njerëz që kanë bërë risi fetare në çështjet publike por jo edhe në çështjet personale, kryesisht në martesë, shkurorëzim, ngase këto janë çështje që i përkasin jetës familjare.”¹

Krishterimi është shërim i përkohshëm e jo ligj i përgjithshëm

Ajo që përmendet rreth shkurorëzimit në Inxhil mund të jetë shtojcë që ishte rezultat i ndryshimeve të cilat i përjetuan ungjijt gjatë shekujve të fundit...

¹ *Hukukul-insan fil-islam*, dr. Ali Abdulvahid, f. 58.

Hulumtuesi serioz i ungjijve vëren se Isai a.s. nuk ka patur për qëllim vënien e një ligji të përgjithshëm e të përjetshëm për të gjithë njerëzit. Mësimet e tij korrigjojnë teprimet e çifutëve rreth shkurorëzimit.

Në kaptinën e nëntëmbëdhjetë të Ungjillit të Mateut thuhet se kur është transferuar Isai (a.s.) prej Xhelili nëpër Jordani, i janë afruar farisienët për ta sprovuar dhe e kanë pyetur: “A i lejohet burrit ta lëshojë gruan për çfarëdo shkak?” Ai është përgjigjur: “A nuk keni lexuar se Zoti në fillim e ka krijuar qenien njerëzore dhe e ka ndarë në meshkuj e femra? Për këtë shkak njeriu i braktisë prindërit e vet e jeton me gruan e tij, dhe bëhen një trup. Këta nuk do të jenë më dy persona por një trup. Atë që e bashkon Zoti, nuk e ndanë njeriu”. Pastaj kanë vazhduar me pyetjen tjetër: “Pse ka urdhëruar Musai që gruas t’i jepet certifikata e shkurorëzimit?” Përgjigja e tij ka qenë: “Musai ju ka lejuar t’i shkurorëzoni gratë tuaja për shkak të vrazhdësisë së zemrave tuaja. Nuk ka qenë kështu prej fillimi! Unë ju them: “Ai që shkurorëzon gruan e vet, përpos për shkak të amoralitetit dhe merr një tjetër, ka bërë amoralitet; ai që martohet me të shkurorëzuarën, bën amoralitet.”

Në atë rast, nxënësit e tij i kanë thënë: “Në qoftë se është e tillë gjendja e burrit me gruan e vet, atëherë më mirë do të ishte sikur të mos martohej.” (Mateu, 19: 1-10).

Nga ky dialog konkludojmë se Isai ka dëshiruar që me anë të përkufizimit të lejimit të shkurorëzimit, vetëm në rast të amoralitetit, t’i korrigjojë eksceset të cilat i kishin shtuar hebrenjtë në ligjin e Musait. Ky shërim ka qenë për një periudhë të përkohshme derisa u miratua ligji i përgjithshëm dhe i përhershëm nëpërmjet dërgimit të Muhammedit a.s.

S’ka arsye të thuhet se Isai ka dëshiruar ta caktojë këtë si ligj të përhershëm për njerëzit, bile edhe havariunët dhe nxënësit e tij e kanë pranuar me vështirësi, duke thënë: “Në qoftë se është e tillë gjendja e burrit me gruan e vet, atëherë më mirë do të ishte sikur të mos martohej”. Siç duket, me aktin e martesës njeriu ngarkon mbi vete një barrë të rëndë që s’mund ta largojë në asnjë mënyrë, pa marrë parasysh se sa e vështirë mund të jetë jeta e përbashkët në qoftë se ekziston urrejtja dhe mospëlqimi i temperamenteve.

Një dijetar i vjetër ka thënë: “Tortura më e madhe vjen nga shoqërimi (jeta e përbashkët) i asaj që as nuk pajtohet me ty e as nuk të lëshon!”

Një poet arab thotë:

“Barra më e rëndë e kësaj bote për të lirin është kur s’mund të largohet nga shoqërimi i armikut!”.

Përkufizimet e Islamit në rregullat e shkurorëzimit

Sheriati islam ka caktuar përkufizime të shumta me qëllim që sa më shumë ta ngushtojë sferën e shkurorëzimit.

Islami ndalon shkurorëzimin që është rezultat i shkaqeve jovalide dhe përfundim i pakonsultuar me të gjitha metodat të cilat i cekëm për zgjidhjen e konfliktit.

Disa fukaha mendojnë se shkurorëzimi që dëmton burrin e gruan dhe që shkatërron interesin e të dyve pa arsye, si p.sh. harxhimi i pasurisë, konsiderohet i ndaluar. Pejgamberi a.s. thotë:

*“Mos dëmtoni veten e as të tjerët!”*¹

Zoti dhe Pejgamberi nuk i duan ata të cilët i lëshojnë gratë dhe mar-tohen me të tjera me qëllim që të kënaqen me partnere të ndryshme. Pejgamberi a.s. i quan njerëzit e tillë “shijues” dhe thotë:

*“Nuk i dua shijuesit, qofshin burra apo gra!”*²

Pejgamberi përsëri thotë: *“Zoti nuk i do shijuesit, qofshin burra apo gra!”*³

Abdull-llah ibn Abbasi thotë: “Divorci lejohet vetëm në rast nevojë.”

Divorci i gruas me të përmuajshmet konsiderohet i ndaluar

Në qoftë se rrethanat dhe arsyet valide diktojnë që të ndërmerret hapi i shkurorëzimit, muslimani duhet ta zgjedhë kohën e përshtatshme, ngase nuk i lejohet të shpejtojë e të veprojë sipas dëshirës së vet. Koha e përshtatshme nënkupton gruan e pastër pa të

¹ *El-Mugni*, Ibën Kuddame, vëll. 7, f. 77. Hadithin e transmetojnë Ibën Maxhe dhe Darikutni.

² Transmetim i Darikutnit dhe Taberaniut.

³ Taberaniu e transmeton në librin e tij *El-kebîr* me sened sahih.

përmuajshmet, pa nifas dhe të mos ketë patur marrëdhënie seksuale para ciklit të fundit. Në qoftë se gruaja është shtatzënë, atëherë burri duhet të jetë i njoftuar.

Cikli i të përmuajshmeve e obligon burrin të largohet nga marrëdhënia gjinore me gruan, dhe për këtë burri mund të jetë nervoz dhe të kërkojë shkurorëzim, kështu që ai duhet ta presë mbarimin e ciklit e pastaj ta shkurorëzojë pa iu afruar fare.

Ashtu siç ndalohet shkurorëzimi gjatë ciklit të të përmuajshmeve, gjithashtu ndalohet edhe pas marrëdhënieve seksuale gjatë periudhës së pastërtisë së saj, sepse ekziston mundësia e shtatzënisë, dhe kur të kuptojë burri se gruaja e tij është me barrë, mund ta ndërrojë mendimin e ndarjes për hir të fëmijës së posanisur në barkun e saj.

Në qoftë se ajo është e pastër, ose e di se është shtatzënë dheedhe më tutje insiston ta shkurorëzojë, atëherë kuptohet se shkurorëzimi është pasojë e antipatisë së thellë dhe në këtë rast i lejohet ta lëshojë.

Në *Sahih* transmetohet se Abdull-llah ibn Umeri e ka lëshuar gruan e tij kur ajo ka patur të përmuajshmet. Kur e ka pyetur Umer ibn Hattabi Pejgamberin a.s. për këtë çështje, ai i ka thënë:

“Thuaji le ta kthejë, e pastaj kur të jetë e pastër dhe e paprekur, si të dojë le ta shkurorëzojë”. Shkurorëzimi bëhet në vigjilje të fillimit të pastërtisë së grave. Zoti i Madhëruar thotë:

“O ti Pejgamber, kur të lëshoni gratë, lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre (në kohën e pastërtisë)!” (Talâk, 1).

Sipas një transmetimi tjetër, i ka thënë:

“Thuaj ta kthejë e pastaj ta shkurorëzojë, qoftë e pastër ose shtatzënë”.

Shtrohet pyetja se a është shkurorëzimi i tillë efektiv? Mendimi i njohur është se shkurorëzimi i tillë konsiderohet efektiv, ndërsa burri shkurorëzues konsiderohet mëkatar.

Një grup fukahashë nuk e pranojnë si efektiv, ngase shkurorëzimin e tillë nuk e kanë bërë legjislativ asnjëherë. Meqë nuk është i lejuar e as legjislativ, atëherë si mund të jetë efektiv?!

Ebu Davudi transmeton me sened autentik se Ibn Umeri është pyetur rreth

burrit që e lëshon gruan me të përmuajshmet, e ai i ka thënë pyetësit se kur e ka lëshuar gruan e vet me të përmuajshmet, Pejgamberi a.s. ia ka kthyer pa e marrë parasysh shpalljen e shkurorëzimit.

Betimi në shkurorëzim është i ndaluar

Nuk i lejohet muslimanit të betohet në shkurorëzim për ta kryer ndonjë punë, ose t'i kërcënohet gruas së vet me ndonjë çështje e t'i thotë se nëse e bën atë, do ta lëshojë.

Betimi në Islam ka rëndësi të posaçme, gjegjësisht betimi mund të bëhet vetëm në emër të Zotit të Madhëruar. Pejgamberi a.s. thotë:

“Ai që betohet në diçka tjetër përveç Zotit, trajtohet si idhujtar”.¹

“Ai që betohet, le të betohet në Zotin ose le të heshtë!”²

E shkurorëzuara kalon kohën e pritjes në shtëpinë e ish-bashkëshortit të saj

Në Sheriatin islam është vaxhib që e shkurorëzuara ta kalojë kohën e pritjes në shtëpinë e vet, gjegjësisht në shtëpinë e ish-burrit të saj dhe i ndalohet të dalë jashtë shtëpisë. Gjithashtu edhe burrit i ndalohet ta largojë nga shtëpia pa ndonjë arsye, ngase është i obliguar që gjatë periudhës së pritjes të përpiqet ta rikthejë në qoftë se është shkurorëzimi i parë apo i dytë. Qëndrimi i saj në shtëpi mund të

¹ Transmetim i Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Hakemit.

² Transmetim i Muslimit.

ndikojë që ta rishqyrtojë problemin para se të përfundojë e gjitha. Sidoqoftë, në periudhën e pritjes pastrohet mitra, mund të rishqyrtohet e tërë situata, mund të ndryshojnë zemrat, të ripërtërihen mendimet, i hidhëruari mund të qetësohet, i revoltuari mund të pajtohet dhe urrejtësi mund të dashurojë.

Kur flet Zoti i Madhëruar për të shkurorëzuarat, thotë:

“Kini frikë All-llahun, Zotin tuaj, dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre, e edhe ato të mos dalin ndryshe vetëm nëse bëjnë ndonjë vepër të keqe të vërtetuar. Këto janë dispozitat e All-llahut, e kush del jashtë dispozitave të All-llahut, ai ka dëmtuar vetveten. Ti nuk e di, All-llahu pas asaj mund të të japë diçka rishtazi!” (Talâk 1).

E kur të jetë shkurorëzimi i pashmangshëm, atëherë kërkohet prej dy bashkëshortëve të ndahen me dinjitet e respekt, pa dëmtime, trillime e shkelje të të drejtave. Zoti i Madhëruar thotë:

“Ose mbani (i ktheni në jetën bashkëshortore) si duhet, ose ndanu prej tyre si është e udhës!” (Talâk, 2).

“Lëshimi është dy herë, e pastaj, ose jetë e njerëzishme ose shkurorëzim me mirëkuptim.” (El-Bekare, 229).

“Për të devotshmit është obligim që edhe për gratë e lëshuara të bëjnë një furnizim të zakonshëm”. (El-Bekare, 241).

Shkurorëzimi i përsëritur

Muslimanit i lejohen tri shpallje të shkurorëzimit. Çdo shpallje e shkurorëzimit kushtëzohet të bëhet në periudhën e pastërtisë së gruas, kur edhe s’ka patur marrëdhënie seksuale me të.

Burri mund ta shpallë shkurorëzimin e gruas një herë dhe të pret kalimin e *iddetit*. Gjatë periudhës së *iddetit*, të dy mund të rikthehen pa u rimartuar. Nëse kjo periudhë kalon, atëherë janë plotësisht të shkurorëzuar dhe secili prej tyre ka të drejtë të martohet me ndonjë tjetër ose të rimartohen. Në qoftë se dëshirojnë të rimartohen, atëherë kanë nevojë për kurorëzim të ri.

Nëse e lëshon gruan për të tretën herë, atëherë kuptohet se është absurde që të jetojnë së bashku, dhe për këtë shkak nuk i lejohet (burrit) ta rikthejë pas shpalljes së tretë përderisa gruaja të martohet me burrë tjetër, edhe atë martesa të jetë ligjore, e vërtetë dhe e qëlluar e jo vetëm për t’ia mundësuar rikthimin te burri i parë.

Muslimanët të cilët deklarojnë tri shpallje të shkurorëzimit në një kohë ose vetëm në një shpallje, janë kundërshtarë të sheriatit të Zotit dhe devijojnë nga rruga e drejtë e Islamit. Njëherë Pejgamberi a.s. ka dëgjuar se një njeri e kishte shpallur shkurorëzimin tri herë në një kohë, dhe është ngritur i hidhëruar e ka thënë:

“Ai luan me Librin e Zotit, e unë jam në mesin tuaj?!” Në atë rast, një njeri është ngritur dhe i ka thënë: “O i dërguari i Zotit, a ta vras?”¹

Jetë e njerëzishme ose shkurorëzim me mirëkuptim

Nëse burri e lëshon gruan dhe kalon periudha e iddetit, para burrit ka dy alternativa.

1. Ose ta kthejë e të jetojnë jetë të njerëzishme, të mirë e të përmirësuar por jo me qëllim që ta dëmtojë ose ta torturojë.
2. Ose ta shkurorëzojë me mirëkuptim, ta lë deri në përfundimin e periudhës së iddetit e të ndarjes pa fjalë e thashetheme fyese dhe pa i shkelur të drejtat që i takojnë njëri-tjetrit.

Burrit nuk i lejohet ta kthejë pak para përfundimit të iddetit me qëllim që sa më gjatë ta maltretojë e ta pengojë nga martesë me ndonjë burrë tjetër, ngase këtë metodë e aplikonin njerëzit e periudhës paraislame.

Zoti i Madhëruar ndalon maltretimin e tillë të grave në Librin e Tij (në Kur'an) në një mënyrë që i trondit zemrat:

“E kur t’i keni lëshuar gratë, dhe ato i afrohen afatit të tyre, atëherë ose i mbani si duhet, ose i lini si duhet (ta mbarojnë afatin), e mos i mbani sa për t’i dëmtuar, e të bëheni të padrejtë. E kush e bën atë, ai e ka dëmtuar veten. Dispozitat e All-llahut mos i merrni për shaka. Përkujtoni të mirat e All-llahut ndaj jush dhe atë që ua shpalli Kur’anin dhe dispozitat e sheriatit me të cilat ju udhëzon dhe kini frikë All-llahun e ta dini se All-llahu është i gjithëdijsëm për çdo gjë.” (El-Bekare, 231).

¹ Transmetim i Nesaiut.

Nëse studiohet ky ajet famëlart, do të shohim se përmban shtatë fraza, në të cilat ka paralajmërime dhe tërheqje vërejtjesh që vijnë njëra pas tjetrës, që mjaftojnë për atë që ka zemër dhe dëgjon.

Gruaja e shkurorëzuar s'duhet penguar që të martohet me atë që dëshiron

Kur të përfundojë iddeti i të shkurorëzuarës, nuk i lejohet burrit të saj, tutorit ose ndokujt tjetër që ta pengojë martesën e saj me atë që e dëshiron përderisa i fejuari dhe e fejuara shprehin pëlqimin e tyre për martesë legjislative e tradicionale.

Ata që bëjnë përpjekje të dominojnë mbi të shkurorëzuarën e tyre nëpërmjet kërcënimeve ndaj saj ose ndaj familjes së saj, në rast se martohet me ndonjë tjetër, u ngjajnë njerëzve që jetuan në injorancën paraislame. Të tillë janë edhe anëtarët e familjes së gruas ose tutorët e saj të cilët pengojnë të shkurorëzuarën t'i kthehet burrit të saj me mirëkuptim sepse, siç thotë Zoti, *"përmirësimi është më i mirë"*.

Në këtë kontekst ajeti thotë:

"Dhe kur i lëshoni gratë, e ato e përmbushin afatin e tyre (të pritjes), nëse pëlqejnë mes vete ashtu si kërkojnë rregullat, mos i pengoni që të martohen për burrat e tyre. Në këtë këshillohet ai që prej jush e beson All-llahun dhe botën tjetër. Kjo është më e dobishme për ju, më e pastër, se All-llahu e di e ju nuk e dini". (El-Bekare, 232).

E drejta e bashkëshortes të kërkojë shkurorëzim

Gruaja e cila e urrenë burrin e vet dhe s'mund të jetojë bashkë me të, ka të drejtë të lirohet nga martesa duke ia kthyer burrit të vet mehrin e paguar dhe dhuratat e dhuruara nga ai, ose kthimi do të realizohet varësisht nga pëlqimi i ndërsjellë, gjegjësisht më pak apo më shumë. Preferohet që ai të mos kërkojë më shumë se sa i ka dhënë. Zoti i Madhëruar thotë:

"E nëse kini frikë se ata të dy nuk do të mund t'i ruajnë dispozitat e All-llahut, atëherë për atë me çka ajo bën kompensim, për ata të dy nuk ka mëkate". (El-Bekare, 229).

Gruaja e Thabit ibn Kajsit ka shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë: “O Pejgamberi i Zotit! Thabit ibn Kajsi s’ka kurrfarë dobësie në moral e në fe por ndiej antipati ndaj tij”. Pastaj e ka pyetur. “Ç’ke marrë prej tij!” e ajo i ishte përgjigjur: “Një kopsht”. Ai përsëri e ka pyetur:

“A ia kthen kopshtin?”, e ajo i ka thënë: “Po!” Në atë rast, Pejgamberi a.s. i ka thënë Thabitit: “Prano kopshtin dhe lëshoje atë!”¹

I ndalohet gruas të shpejtojë në kërkimin e ndarjes nga burri në qoftë se nuk ka arsye valide. Pejgamberi a.s. thotë:

*“Ndalohet aroma e xhennetit për secilën grua që kërkon ndarjen nga burri i vet pa arsye”.*²

Ndalohet torturimi i bashkëshortes

Nuk i lejohet burrit ta torturojë gruan e vet me qëllim që ajo të kërkojë ndarje dhe t’ia kthejë pasurinë ose një pjesë të saj, përderisa nuk ka bërë ndonjë amoralitet të dukshëm. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, nuk është e lejuar për ju të trashëgoni gratë në mënyrë të dhunshme e as t’i shtrëngoni për t’u marrë diçka nga ajo që u keni dhënë atyre, përveç nëse ato bëjnë ndonjë amoralitet të hapur”. (Nisâ, 19).

Në qoftë se burri dëshiron të ndahet me qëllim që të martohet me një grua tjetër, atëherë i ndalohet të marrë diçka prej saj. Zoti i Madhëruar thotë:

“Në qoftë se dëshironi të ndërroni (të merrni) një grua në vend të një gruaje (të lëshuar), e asaj (të lëshuarës) i keni pas dhënë shumë të madhe, mos merrni prej saj asnjë send. A do ta merrni atë pa të drejtë e në mënyrë

¹ Transmetim i Buhariut dhe i Nesaiut.

² Transmetim i Ebu Davudit.

mizore? Dhe si mund ta merrni atë kur njëri - tjetrit i jeni bashkuar (në një shtrat) dhe kur ato kanë marrë prej jush një besë të fortë?" (Nisâ, 20-21).

Ndalohet betimi me braktisje (nga bashkëshortja)

Një prej karakteristikave pozitive të Islamit është mbrojtja e të drejtës së gruas. Islami ndalon burrin ta hidhërojë gruan e vet dhe të largohet prej shtratit të saj e të largohet prej saj aq sa nuk mund të përballojë natyra e saj femërore. Në qoftë se betohet se nuk do t'i afrohet (se nuk do të ketë marrëdhënie gjinore me të) i jepet afat prej katër muajsh, por nëse qetësohet shpirti i tij, ëmbëltohet hidhërimi i tij dhe e kaplon ndërgjegjja para përfundimit të katër muajve, ose në fund të kësaj periudhe, atëherë Zoti ia fal gabimin dhe ia hap derën e pendimit të sinqertë, ndërsa ai obligohet ta kompensojë betimin me pendim.

Nëse kjo kohë kalon pa u penduar dhe pa iu kthyer gruas, atëherë ajo shkurorëzohet për shkak të lënies pasdore të të drejtave të saj.

Disa fukaha e shkurorëzojnë pas kalimit të kohës së tillë pa e pritur fare vendimin e gjykatësit, kurse disa të tjerë e pezullojnë procesin te gjykatësi pas kalimit të kohës dhe prej njeriut të tillë kërkohet që të qetësohet e të pajtohet me gruan ose të bëhet shkurorëzimi, dhe në këtë rast, ai është plotësisht i lirë në zgjedhje.

Betimi në braktisjen e gruas në sheriatin islam njihet me emrin "ilâ'u", që theksohet edhe në Kur'an:

"Për ata që betohen se do të largohen prej grave të tyre (të mos kenë kontakt me to), afati i pritjes është katër muaj. Në qoftë se pendohen (heqin dorë nga betimi), s'ka dyshim se All-llahu bën falje dhe mëshiron. E në qoftë se ata kanë vendosur për shkurorëzim, All-llahu dëgjon (fjalët e tyre), i di (qëllimet e tyre)". (El-Bekare, 226-227).

Afati katërmujor është caktuar me qëllim që të jepet mundësi e plotë për t'u kthyer burri nga betimi dhe t'i kthehet rrugës së drejtë, si dhe kjo është periudha më e gjatë e gruas në të cilën mund të durojë largimin nga burri i vet.

Në këtë kontekst komentuesit komentojnë ngjarjen që ka ndodhur me Umerin r.a. gjatë kontrollit të tij natën nëpër Medine, gjegjësisht dëgjimin e tij të një gruaje që recitonte:

"Nata është e gjatë dhe errësira më ka kapluar.

*Nuk më flihet, ngase nuk kam shok për të luajtur;
Betohem në Zotin se sikur të mos frikohesha prej Tij
do ta shkatërroja këtë shtrat copë-copë”.*

Pasi e dëgjoi Umeri, e hulumtoi rastin e saj dhe zbuloi se burri i saj kishte shkuar në një ekspeditë ushtarake para një kohe të gjatë. Në atë rast e pyeti motrën e vet Hafsen: “Sa gjatë mund të qëndrojë gruaja e ndarë nga burri?, e ajo i përgjigjet: “Katër muaj!” Pas kësaj ngjarjeje, udhëheqësi i besimtarëve (Umeri r.a.) vendosi që të mos e largojë asnjë të martuar nga gruaja më shumë se katër muaj.

FËMIJËT DHE PRINDËRIT

Islami mbron gjenezën familjare

Fëmija është fryt i babait të vet dhe bartës i karakteristikave të tij. Gjatë jetës së tij, fëmija është kënaqësi e syve të tij, si dhe pas vdekjes së tij, fëmija është vazhdim i ekzistimit dhe reprezentues i pavdekshmërisë së tij. Ai i trashëgon cilësitë dhe atributet e babait, ashtu siç i trashëgon karakteristikat dhe veçoritë pozitive e negative, të mira e të këqija. Fëmija është pjesë e zemrës së babait dhe e trupit të tij. Për këtë shkak, Zoti ndalon kurvërinë dhe obligon martesën për ta ruajtur rrjedhën e të mos përzihen spermat, ngase do të ishte e pamundshme njohja e babait të vërtetë të fëmijës, apo prindi t'i njohë vajzat dhe djemtë e vet!

Martesa e kufizon gruan me një burrë dhe asaj i ndalohej ta tradhtojë ose të mbjell diçka që është e tjetërkujt. Kështu, të gjithë fëmijët që i lindë në shtratin bashkëshortor, konsiderohen fëmijë të burrit të saj pa deklarata të hapta nga babai ose nga nëna. Pejgamberi a.s. thotë: *“Fëmija është i shtratit”*.¹

Ndalohej mohimi i atësisë

Nuk i lejohet burrit ta mohojë rrjedhën e fëmijës që e lindë gruaja në shtratin e tij përderisa janë ende të martuar njëri me tjetrin. Mohimi i tillë mund të shkaktojë dëme të mëdha dhe turp të madh për gruan dhe fëmijën. Pra, nuk i lejohet atij të dyshojë haptazi, të japë gjykim të shpejtë ose të shpifë thashetheme ofenduese.

Në qoftë se është i bindur se gruaja e ka tradhtuar, edhe atë me argumente të plota dhe fakte të pamohueshme, atëherë sheriatu islam nuk lejon ta rritë atë që mendon se nuk është i tij dhe t'ia lë trashë-

¹ Transmetim unanim.

giminë atij, ose, më së paku, nuk e lë të dyshojë tërë jetën. Sheriati në këtë rast ia cakton zgjedhjen që në lëndën e fikhut quhet *li'ân*. Nëse ndokush është i bindur ose ka dyshim të madh se gruaja e tij ka lindë fëmijën e tjetërkujt por nuk ka argumente, atëherë i lejohet ngritja e procesit në gjyq dhe gjykatësi ta zbulojë të vërtetën. Kjo çështje në Kur'an potencohet kështu:

“Ndërsa ata të cilët shpifin për gratë e veta dhe nuk kanë dëshmitarë tjetër përveç vetes, dëshmimi i çdonjërit prej tyre është: të betohet katër herë në All-Illahun se e thotë të vërtetën. Hera e pestë e betimit është: mallkimi i All-Illahut qoftë mbi të nëse ai gënjen. E nga ajo (nga gruaja për të cilën është shpifur) largohet dënimi, nëse katër herë betohet në All-Illahun se ai (shpifësi) gënjen. Hera e pestë e betimit duhet të jetë që ta godasë hidhërimi i All-Illahut atë (gruan) nëse ai ka thënë të vërtetën”. (Nûr, 6-9).

Në këtë rast, dy bashkëshortët do të ndahen përgjithmonë dhe fëmija i jepet nënës.

Adoptimi është i ndaluar në Islam

Meqë babait nuk i lejohet mohimi i rrjedhës së fëmijës nga shtrati i tij, atij gjithashtu nuk i lejohet ta adoptojë fëmijën që nuk është prej rrjedhës së tij. Arabët e periudhës paraislame dhe popujt tjerë historikisht kanë qenë të njohur me adoptimin e fëmijëve në rrjedhat e tyre. Burri ka patur të drejtë ta adoptojë fëmijën që e ka dashur, ta pranojë haptazi dhe ta bëjë anëtar të familjes së vet me të drejta të plota. Ky fëmijë i adoptuar pastaj e ka marrë emrin e familjes dhe i ka gëzuar të gjitha të drejtat e saj. Ky akt i tillë nuk e ka penguar fëmijën e adoptuar që të ketë prind dhe prejardhje të njohur.

Kur u paraqit Islami, adoptimi ishte i përhapur në shoqërinë arabe, bile edhe vetë Pejgamberi a.s. e kishte adoptuar Zejd ibn Thabitin gjatë periudhës paraislame. Zejdi ishte djalë arab i zënë rob në një luftë të arabëve në periudhën e xhahilijetit, pastaj i blerë nga Hakim ibn Hazzami për hallën e tij Hatixhen. Kur ajo u martua me Pejgamberin, ia dhuroi Pejgamberit a.s., dhe më vonë, kur babai dhe xhaxhai i tij e gjejnë vendqëndrimin e tij e kërkojnë prej Pejgamberit a.s., i cili i jep liri të plotë për vendosje, mirëpo ai e zgjedhë Pejgamberin a.s. e jo babain dhe xhaxhain e vet. Për këtë shkak, Pejgamberi a.s. e liron dhe e adopton me deklaram publik para po-

pullit. Prej kësaj kohe, ai njihet si Zejd ibn Muhammed dhe ishte i pari prej robërve që i besuan (Islamit).

Çfarë qëndrimi kishte Islami ndaj këtij rregullimi paraislam. Sipas Islamit, adoptimi falsifikon natyrën dhe realitetin, bën që individ i huaj të hyjë në familje e të jetojë në mesin e grave të cilat janë të ndaluara dhe të huaja për të. Gruaja e burrit që adopton nuk është as nënë, as motër e as hallë e tij..., dhe kryesisht fëmija i adoptuar është i huaj për të gjithë.

Ky fëmijë i adoptuar, në të cilin thirren burri e gruaja se është bir i tyre, ka të drejtë trashëgimie, e në anën tjetër, u pengon të afërmit e vërtetë që e meritojnë trashëgiminë. Shumëherë të afërmit e vërtetë kanë xhelozitë ndaj këtij të huaji që hyn në familje dhe i grabit të drejtat e tyre, dhe kështu paraqet pengesë midis tyre. Ka raste të shumta kur xhelozia e tillë grafullon ndez zjarrin e fitneve dhe i shkatërron marrëdhëniet familjare!! Për këtë shkak Kur'ani e ndaloi këtë sistem paraislam, e bëri haram në përgjithësi dhe i zhdukuri të gjitha gjurmët e tij:

“Nuk ua bëri djem tuaj të adoptuarit tuaj. Këto janë vetëm thënie tuaja që i shqiptoni me gojët tuaja, e All-llahu e thotë atë që është realitet, dhe Ai udhëzon në rrugë të drejtë. Ju thirrni (mbështetni) ata në etërit e vërtetë të tyre, kjo është më e drejtë se All-llahu, e nëse nuk i dini etërit e tyre, atëherë ata janë vëllezërit tuaj dhe të afërmit tuaj në fe”. (Ah'zâb, 4-5).

Nga fjalët e shkëlqyera kur'anore: “Nuk ua bëri djem tuaj të adoptuarit tuaj” nënkuptojmë se adoptimi është deklaram i zbrazët që s'ka lidhje me realitetin objektiv. Deklarimi gojor nuk i ndryshon të vërtetat e as realitetin, nuk e bën të huajin të afërt e as nuk i ofron rrjedhë origjinale dhe nuk e bën të adoptuarin fëmijë të juajin. Ky deklaram ose çfarëdo qoftë fjalimi simbolik nuk mundet që gjakun e dikujt ta fusë në dejtë e djalit të adoptuar. Gjaku i të adoptuarit nuk zgjon në zemrën e njeriut dashurinë prindore, në zemrën e fëmijës nuk ka ndjenja birërore (filiale), nuk i trashëgon karakteristikat e virtytet e as atributet fizike, intelektuale e psikike të prindit.

Islami ndaloi çdo gjë që fitonte i adoptuari, gjegjësisht ndaloi trashëgiminë por, nga ana tjetër, lejoi martesën me gruan e të adoptuarit.

Në trashëgimi, Kur'ani vlerëson vetëm lidhjet e gjakut, të martesës dhe të familjes së vërtetë:

“E farefisi ka më shumë përparësi ndaj njëri-tjetrit...” (Enfâl, 75).

Sa i përket martesës, në Kur'an potencohet se ndalohet me gratë e fëmijëve të vërtetë e jo të të adoptuarve:

“Dhe gratë e bijve tuaj që janë të lindjes suaj!” (Nisâ, 23).

Njeriut i lejohet martesa me gruan e djalit të adoptuar ngase ajo është grua e njeriut të huaj; nëse shkurorëzohet, ka të drejtë ta martojë.

Shembulli praktik i anulimit të adoptimit legal

Kjo çështje nuk ishte e lehtë për njerëzit, ngase adoptimi ishte sistem shoqëror i rrënjosur thellë në jetën e arabëve. Urtësia e Zotit ndikoi që gjurmët e tij të mos zhduken vetëm me fjalë por edhe me vepër. Urtësia hyjnore, për këtë detyrë zgjodhi vetë Pejgamberin e Zotit me qëllim që të zhdukë dyshimin dhe t'i largojë vështirësitë që i kishin besimtarët në lejimin e martesës së të shkurorëzuarave të të adoptuarve, si dhe t'i bindë se hallall është ajo që e lejon Zoti e haram ajo që e ndalon Zoti. Zejd ibn Thabiti, i cili njihej me emrin Zejd ibn Muhammed, ishte i martuar me Zejneb bint Xhahshin, kushërirë e Pejgamberit a.s. Kur u shtuan ankesat e Zejdit nga grua-jja e tij, Pejgamberi a.s. i informuar nga ana hyjnore, e dinte se Zejdi do ta lëshojë dhe se vetë ai do të martohet me të pas shkurorëzimit, mirëpo dobësia njerëzore ndikoi në të sepse kishte frikë se do të ballafaqohej me njerëzit.

Çdoherë që i ankohej Zejdi, i thoshte:

“Mbaje gruan dhe frikoku prej Zotit!”. Në këtë rast u shpall ajeti i Kur'anit i cili e qortoi Pejgamberin a.s. dhe në të njëjtën kohë i dha kurajë që të ballafaqohej me shoqërinë nëpërmjet shkatërrimit të gjurmëve që kishin mbetur nga ky sistem i vjetër dhe imitim i rrënjosur, që pengonte njeriun të martohej me gruan e të adoptuarit të vet.

Zoti i Madhëruar thotë:

“(Përkujto) kur i the atij që All-llahu e kishte shpërblyer (me besim) e edhe ti i pate bërë mirë: “Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga Zoti!”, e ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që All-llahu do ta

zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t'i frikësohesh All-llahut. E pasi që Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzuam atë, e për të mos patur besimtarët vështirësi (mekat) në martesën me gratë e të adoptuarve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i All-llahu është i kryer! (Ah'zâb, 37).

Pastaj vazhdon Kur'ani dhe e mbron Pejgamberin, konfirmon lejin e martesës së tillë dhe zhduk vështirësinë:

“Pejgamberit nuk i përket qortimi për atë që All-llahu e ngarkoi me të. Ky ishte ligj i All-llahut edhe ndër ata që ishin më parë, e urdhri i All-llahut është vendim i kryer. (Ligji i All-llahut ndër) Ata të cilët i kumtojnë shpalljet e All-llahut, i frikësohen vetëm All-llahut e askujt tjetër pos Tij, e All-llahu është i denjë të jetë llogaritës. Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai është i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshtëm për çdo gjë”. (Ah'zâb, 38-40).

Adoptimi për rritje dhe kujdes

Ky është adoptimi të cilin e zhduku Islami dhe i cili prezentonte pranimin e fëmijës si fëmijë (nga gjaku) i vërtetë; edhe pse ishte i tjetërkujt i bashkangjitej rrjedhës dhe familjes. Kështu, njeriu ia jepte të gjitha të drejtat birërore, e lejonte të jetojë bashkërisht në familje, me ndalimin e martesës dhe të drejtat për të fituar trashëgimi.

Ekziston një lloj i njerëzve që e quajnë “adoptim” por ai nuk është i ndaluar nga Islami. Adoptimi i tillë ka të bëjë me pranimin e jetimit ose të të braktisurit, konsiderimin e tij si fëmijë i vërtetë. Njeriu e merr fëmijën e tillë për ta rritur e edukuar. Kështu, ai i jep vendbanim, e ushqen, e veshë, e mëson dhe e trajton si fëmijë të vetin por jo edhe si fëmijë të vërtetë të vetin. Parimet birërore (filiale), të cekura pak më parë, nuk vlejnë për këtë lloj adoptimi.

Feja e Zotit lavdëron gjestin e tillë dhe njeriun e tillë e shpërblen me xhennet. Pejgamberi a.s. thotë:

“Unë dhe mbajtësi i jetimit jemi në xhennet si këta dy gishta (i ka ngritur gishtin tregues dhe atë të mesëm).”¹

Edhe fëmija i braktisur trajtohet si jetimi. Këtij më së tepërmi i përshatatet emri “udhëtar”, prandaj Islami urdhëron të kihet kujdes ndaj tij.

Në qoftë se njeriu nuk ka pasardhës, atëherë i lejohet t’i dhurojë fëmijës së tillë diçka nga pasuria e vet, eventualisht gjatë jetës së tij ose të lë porosinë për një të tretën e pasurisë para vdekjes.

Mbarësimi artificial

Islami ndalon kurvërinë dhe adoptimin për ta mbrojtur rrjedhën ashtu siç ndalon edhe mbarësim artificial në rast se realizohet me spermën e huaj. Profesori i njohur Shejh Sheltuti thotë: “Në këtë rast bëhet krim i madh dhe mëkat i papërshtatshëm, si dhe akti i tillë i ngjanë kurvërisë ngase kanë esencë të barabartë dhe rezultat të përbashkët; kryesisht merret sperma e njeriut të huaj dhe futet në trupin e gruas pa patur lidhje ligjore e kurorëzim, që i mbron ligji natyror dhe sheriatu qiellor. Sikur të mos ishte shkalla e këtij krimi pak më e ulët do të aplikoheshin dënimi për kurvërinë, ashtu siç e përshkruan sheriatu i inspiruar hyjnor.

Nëse mbarësimi bëhet me spermë të njeriut të huaj, atëherë, pa dyshim ky akt konsiderohet krim më i madh dhe më i keq se adoptimi. Fëmija nga mbarësimi artificial është sikur adoptimi i cili fut element të huaj në rrjedhë. Mbarësimi i tillë gjithashtu barabarëzohet me kurvërinë, të cilën e refuzojnë ligjet hyjnore dhe ndërgjegjja e njeriut të virtytshëm, ngase në këtë mënyrë njeriu bie në nivel të shtazëve ku nuk ka ndjenja për lidhje fisnike shoqërore”.²

Ngarkimi i fëmijës ndokujt tjetër përveç babait konsiderohet mallkim

Islami ndalon babain të mohojë rrjedhën e fëmijës së vet pa kurrfarë shkak, ashtu siç ndalon edhe t’ia ngarkojë ndokujt tjetër. Këtë akt Pejgamberi a.s. e konsideron mëkat të madh që meriton mallkimin nga Krijuesi dhe krijesat. Aliu r.a. ka lexuar në minber një hadith të Pejgamberit që thotë:

¹ Transmetim i Buhariut, Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

² Shiko *Fetavâ*, Shejh Sheltut, f. 300.

*“Ai që ia ngarkon veten ndokujt tjetër përveç babait të vet dhe robi që ia ngarkon veten ndokujt tjetër përveç pronarëve të tij të vërtetë, janë të mallkuar nga Zoti, engjëjt dhe mbarë njerëzimi, dhe prej tyre nuk do të pranohet pendimi dhe lirimi i tyre Ditën e gjykimit”.*¹ Sa'd ibn Ebi Vekkasi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Xhenneti ndalohet për atë që ia ngarkon veten ndokujt tjetër me vetëdije se nuk është babai i tij”.*²

Mos i vritni fëmijët tuaj

Meqë Islami e mbron në këtë mënyrë rrjedhën, gjithashtu cakton edhe të drejtat prindërore dhe birërore për fëmijën dhe prindin. Fëmija ka të drejtë jete dhe asnjë baba ose nënë nuk ka të drejtë ta vrasë fëmijën ose ta mbysë të gjallë, ashtu siç vepronin arabët në periudhën paraislame, ngase si djali ashtu edhe vajza kanë trajtim të njëjtë. Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos i mbytni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë, se Ne ua sigurojmë furnizimin tuaj, e mbytja e tyre është mëkat i madh”. (Isrâ, 31).

“Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla, për çfarë mëkati janë mbytur?” (Tekvîr, 8, 9).

Islami e ndalon këtë akt barbar në mënyrë kategorike ngase është krim i qëllimtë dhe armiqësi kundër qenies së dobët pa marrë parasysh faktorin shtytës, qoftë ekonomik si psh. frika nga varfëria e furnizimi, ose joekonomik, si p.sh. vrasja e vajzës prej frikës nga nderi. Kur është pyetur Pejgamberi a.s. se

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

أَيُّ الذَّنْبِ أَكْبَرُ؟ فَقَالَ: أَنْ تَجْعَلَ لِلَّهِ نَدًّا وَهُوَ خَلَقَكَ!
قِيلَ ثُمَّ أَيُّ؟ قَالَ: أَنْ تَقْتُلَ وَلَدَكَ مَخَافَةَ أَنْ يَطْعَمَ مَعَكَ.

cili mëkat është më i madh, ai është përgjigjur:

"T'i përshkruhet hyjnia ndokujt tjetër përveç All-llahut, i cili të krijoi!" Kur vazhdojnë dhe e pyesin përsëri për mëkatin tjetër më të madh, ai u thotë: *"Të vrasësh fëmijën tënd nga frika se do ta ndashë ushqimin tënd me të"*.¹

Pejgamberi kërkonte premtimin e grave dhe të burrave se nuk do të bëjnë një krim të tillë:

"Se nuk do t'i shoqërojnë asnjë send All-llahut, se nuk do të vjedhin; se nuk do të bëjnë kurvëri, se nuk do t'i mbysin fëmijët e tyre." (Mumtehine, 12).

E drejta e prindit ndaj fëmijës është që ta emërojë me emër të mirë, e jo me ndonjë emër që do ta dëmtojë kur të rritet. I ndalohet ta quaj me ndonjë emër që prezanton robërinë ndaj ndokujt tjetër përveç All-llahut, si p.sh. Abdun-nebi (robi i Pejgamberit) ose Abdul-mesih (robi i Isait) etj.

Fëmija gëzon të drejtën e rritjes, zhvillimit, edukimit dhe furnizimit. Pra, prindërve nuk u lejohet t'i lënë pasdore ose t'i abrogojnë të drejtat e tilla të fëmijëve.

Pejgamberi a.s. thotë: *"Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë përgjegjësi për kopetë tuaja!"*.²

*"Për njeriun është mëkat të humbë kujdesin ndaj atij që varet prej tij."*³

"Zoti do ta marrë në përgjegjësi çdo bari për kopenë e tij, të mbrojtur apo të humbur; derisa do ta pyesë edhe njeriun për anëtarët e familjes së tij".⁴

Trajtimi i barabartë i fëmijëve

Prindi duhet të ketë trajtim të barabartë ndaj të gjithë fëmijëve, posaçërisht kur bëhet fjalë për dhënien e dhuratave. Atij gjithashtu i ndalohet që disa fëmijë t'i favorizojë me dhurata e disa jo pa ndonjë arsye valide, ngase në këtë mënyrë lind xhelozia, e cila mund të

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

³ Transmetim i Ebu Davudit, Nesaiut dhe Hakimit.

⁴ Transmetim i Muslimit, Ahmedit dhe Ebu Davudit.

shkaktojë armiqësi dhe urrejtje midis tyre. E njëjta gjë vlen edhe për nënën. Pejgamberi a.s. thotë:

اعْدِلُوا بَيْنَ آبْنَائِكُمْ. اَعْدِلُوا بَيْنَ آبْنَائِكُمْ. اَعْدِلُوا بَيْنَ
أَبْنَائِكُمْ.

*“Veproni drejt me fëmijët tuaj! Veproni drejt me fëmijët tuaj! Veproni drejt me fëmijët tuaj!”*¹

Gruaja e Beshir ibn Sa’d El-Ensarit ka dëshiruar që fëmijës së saj Nu’mān ibn Beshirit t’i dhurojë diçka specifike, si p.sh. kopsht ose skllav, dhe kështu, ka kërkuar prej burrit të saj të shkojë e ta pyesë Pejgamberin a.s.. Kur ka shkuar te Pejgamberi, i ka thënë:

“O i dërguari i Zotit, gruaja ime kërkon prej meje që t’i dhuroj fëmijës së saj një skllav!” Pejgamberi a.s. e ka pyetur: “*A ka fëmija vëllezër?*” Kur i është përgjigjur se ka, atëherë e ka pyetur: “*A ju ke dhënë edhe atyre diçka të tillë?*” Kur i përgjigjet se jo, atëherë i thotë: “*Kjo nuk është korrekte, e unë mund të dëshmoj vetëm të drejtën!*”² Sipas transmetimeve tjera ai ka thënë:

“Mos lyp prej meje të dëshmoj të pavërtetën. Fëmijët duhet të kenë trajtim të barabartë ashtu siç është e drejta e tyre që ty të të krenojnë!”

*“Kini frikë prej Zotit dhe trajtoni fëmijët me drejtësi të barabartë!”*³ Sipas Imam Ahmedit, lejohet favorizimi i arsyeshëm, në qoftë se fëmija është i hendikepuar.⁴

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Buhariut dhe Muslimit.

³ Transmetim i Ahmedit, Nesaiut dhe Ebu Davudit.

⁴ *El-Mugnî*, vëll. 5, f. 605.

Respektimi i parimeve të Zotit në trashëgimi

Kur bëhet fjalë për trashëgiminë, gjithashtu i ndalohet prindit të bëjë dallime midis fëmijëve. Atij i ndalohet që t'i shmangë vajzat ose fëmijët e gruas që s'është favorite me të. Gjithashtu edhe të afërmit nuk i lejohet ta largojë të afërmin që meriton trashëgiminë, edhe atë nëpërmjet ndonjë tradhtie. Trashëgiminë Zoti e ka caktuar me diturinë, drejtësinë dhe urtësinë e vet; secilit ia ka caktuar pjesën që e meriton, dhe kërkon prej njerëzve që t'i respektojnë rregullat e tilla.

Ai që e kundërshton këtë sistem dhe ndarjen e tillë ai ka dyshuar në Zotin e tij!

Në tre ajete të Kur'anit Zoti thekson çështjen e trashëgimisë: në fund të ajetit të parë thotë:

“Ju nuk dini se kush është më afër dobisë suaj, prindërit tuaj ose fëmijët tuaj. (Ky përcaktim është) urdhër nga All-llahu. Vërtet, All-llahu është më i dijsmi, më i urti. (Nisâ, 11).

Në fund të ajetit të dytë thotë:

“E duke mos dëmtuar (trashëguesit). Ky përcaktim është porosi prej All-llahut. All-llahu është i gjithëdijsëm, jo i ngutshëm. Këto janë (dispozita) të caktuara prej All-llahut. Kush i bindet All-llahut (urdrave të Tij) dhe Të dërguarit të Tij, atë e dërgon në xhennete nën të cilët burojnë lumenj. Aty do të jenë përgjithmonë. E ky është shpëtim i madh! (Nisâ, 12-13).

Në fund të ajetit të tretë thotë:

“All-llahu ua sqaron, ashtu që të mos humbni. All-llahu di për çdo send”. (Nisâ, 176).

“Kush devijon nga ajo që ka caktuar Zoti për trashëgiminë, largohet nga e drejta të cilën e ka sqaruar Zoti, i kundërshton parimet e Zotit të Madhëruar, dhe le të presë dënimin nga Zoti me zjarr të përhershëm dhe me dënim të rëndë”. (Nisâ, 14).

Mosrespektimi i prindërve është mëkat i madh

Fëmija obligohet që të ketë sjellje të mira dhe t'i respektojë e t'i nderojë prindërit e vet.

Respektimi i prindërve është instinkt natyror që duhet të përforcohet me vepra të matura e të sinqerta. Më tepër potencohen obligimet e fëmijëve ndaj nënës për shkak të mundimeve që i përjeton ajo gjatë shtatzënisë, lindjes, gjdhënies dhe kujdesit për rritjen e tij. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Ne e urdhëruam njeriun t’u bëjë mirë prindërve të vet, ngase nëna e vet me mundim e barti dhe me vështirësi e lindi, e bartja e tij dhe gjdhënia e tij zgjat tridhjetë

muaj”. (Ahkâf, 15).

Një njeri ka shkuar te Pejgamberi a.s. dhe e ka pyetur:

“Kush e meriton më së shumti shoqërimin tim?” Pejgamberi i është përgjigjur tri herë “*nëna yte*”, e të katërtën herë i thotë: “*babai yt*”.¹ Mosrespektimin e prindërve Pejgamberi e konsideron mëkat të madh dhe e radhit menjëherë pas shirkut në Zotin e Madhëruar, ashtu siç potencohet edhe në Kur’an.

Në një transmetim të Buhariut dhe Muslimit thuhet:

“A t’ju informoj për tri gjëra që janë mëkate të mëdha?” Kur i tha në se po, atëherë ai ju tha: *“Shirku në Zotin e Madhëruar; mosrespektimi i prindërve”,* dhe meqë ishte i mbështetur, ulet dhe vazhdon: *“... gënjeshtria dhe dëshmia e rrejshme”*.

Pejgamberi a.s. thotë:

“Tre persona nuk hyjnë në xhennet: mosrespektuesi i prindërve, kodoshi dhe gruaja që i imiton meshkujt”.²

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Nisaut, i Bezzarit me sened të mirë dhe i Hakimit.

Në një hadith tjetër thotë:

*“Të gjitha mëkatet Zoti i vonon aq sa të dojë deri në Ditën e gjykimit përveç të mosrespektuesit të prindërve, ia shpejton (dënimin) gjatë jetës para vdekjes”.*¹

Zoti xh.sh. porosit kujdesin ndaj prindërve kur të bëhen të moshuar, kur të dobësohen dhe kur të kenë nevojë për ndihmë. Në këtë kontekst, Kur’ani thotë:

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetërkënd pos Tij, dhe të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka zënë pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as “of” e as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, por thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im, mëshiroi ata dy sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”. (Isrâ, 23-24).

Kur komentuesit e sqarojnë këtë ajet, thonë: “Sikur Zoti të dinte diçka më të ulët se “uf”, sa i përket respektit ndaj prindërve, do ta ndalonte edhe atë!”

Ofendimi i prindërve është mëkat i madh

Pejgamberi a.s. jo vetëm që e ndalon ofendimin e prindërve por e konsideron edhe mëkat të madh. Në këtë kontekst, ai thotë:

“Mëkati më i madh është kur njeriu i mallkon prindërit e vet”. Njerëzit u habitën nga njeriu i mençur e besimtar se si mund t’i

¹ Transmetim i Hakimit me sened sahih.

mallkojë prindërit kur ata e sollën në jetë, dhe i thanë Pejgamberit: “Si mund njeriu t’i mallkojë prindërit e vet? Ai u përgjigj dhe u tha: “*Ai ofendon (shan) prindin e ndokujt tjetër e tjetri ofendon prindin e tij, dhe ai ofendon nënën e ndokujt tjetër, e tjetri ofendon nënën e tij*”.¹

E ç’ndodh me atë që i ofendon (shanë) në fytyrë?!

Voluntarizmi për xhihad pa lejen e prindërve nuk lejohet

Për ta mbrojtur Islami pëlqimin e prindërve, ndalon fëmijën që të përcaktohet vullnetarisht për xhihad pa lejen e prindërve, edhe pse xhihadi në rrugë të Zotit, sipas Islamit, ka vlerë më të madhe se lutësi i natës dhe agjëruesi i ditës.

Abdull-llah ibn Amër Ibn Asi transmeton se

جَاءَ رَجُلٌ إِلَى نَبِيِّ اللَّهِ ﷺ فَاسْتَأْذَنَهُ فِي الْجِهَادِ، فَقَالَ:
أَحْيَىٰ وَالِدَاكَ؟ قَالَ: نَعَمْ. قَالَ: فَفِيهِمَا جَاهِدُ.

një njeri ka shkuar te Pejgamberi a.s. për të marrë leje për xhihad, dhe Pejgamberi e ka pyetur: “*A i ke të gjallë prindërit?*”. Kur i thotë se po, atëherë Pejgamberi i thotë: “*Xhihadi yt është në shërbimin e tyre!*”²

Sipas një transmetimi tjetër thuhet se

أَقْبَلَ رَجُلٌ إِلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَقَالَ: أُبَايِعُكَ عَلَى الْهَجْرَةِ
وَالْجِهَادِ أَبْتَغِي الْأَجْرَ مِنَ اللَّهِ. قَالَ لَهُ فَهَلْ مِنْ وَالِدَيْكَ أَحَدٌ
حَيٌّ؟ قَالَ: نَعَمْ، بَلْ كِلَاهُمَا حَيٌّ. قَالَ: أَفَتَبْتَغِي الْأَجْرَ مِنَ
اللَّهِ؟ قَالَ: نَعَمْ. قَالَ: فَارْجِعْ إِلَى وَالِدَيْكَ فَأَحْسِنْ
صُحْبَتَهُمَا.

një njeri ka shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë: “Të jap për hixhret dhe xhihad me qëllim që ta fitoj shpërblimin nga Zoti!” Pejgamberi a.s. e ka pyetur: “*A i ke të gjallë prindërit?*” Kur i përgjigjet se i ka të dy të gjallë, i thotë: “*A kërkon shpërblim prej*

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

Zotit?” Kur i përgjigjet se po, atëherë i thotë: “*Kthehu te prindërit dhe shoqëroi me mirësi!*”¹

Ndërkaq në një transmetim tjetër thuhet:

جَاءَ رَجُلٌ إِلَى رَسُولِ اللَّهِ ﷺ فَقَالَ: جِئْتُ أَبَايَ عَكَ عَلَى
الْهَجْرَةِ، وَتَرَكْتُ أَبَوَيَّ يَبْكِيَانِ. فَقَالَ: ارْجِعْ إِلَيْهِمَا
فَأُصْحِكُهُمَا كَمَا أَبْكَيْتَهُمَا.

“Ka shkuar një njeri te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë: “Kam ardhur të ta jap besën për hixhret, por i kam lënë prindërit në vaj!” Në atë rast, Pejgamberi a.s. i ka thënë: “*Shko dhe bëri të qeshin ashtu siç i bëre të qajnë!*”²

Nga Ebu Sa’di transmetohet se një jemenas ka emigruar te Pejgamberi a.s. i cili e ka pyetur:

“A ke lënë ndokënd në Jemen?” Kur i thotë se i ka lënë dy prindërit e tij, e pyet: “A të kanë dhënë leje?” Kur i thotë se jo, atëherë Pejgamberi i thotë: “*Shko dhe merr leje prej tyre, e nëse të lejojnë, shko për xhihad, nëse jo, atëherë vepro mirë me ta*”.³

Prindërit idhujtarë

Më e bukura e Islamit rreth prindërve është ndalimi i mosrespektimit të tyre, qofshin edhe idhujtarë e pabesimtarë, bile qofshin edhe aq ekstremistë saqë orvaten ta largojnë fëmijën e tyre musliman nga Islami. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Të jeshë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, sepse vetëm tek Unë është kthimi juaj. E nëse ata të dy tentojnë që të më përshkruash Mua shok, për çka t’i nuk ke kurrfarë argumenti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote do të keshë mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

³ Transmetim i Ebu Davudit.

kthyer nga Unë, pastaj kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar." (Llukmân, 14-15).

Me këto dy ajete muslimani urdhërohet që të mos i dëgjojë për atë që e urdhërojnë që ta bëjë, ngase krijesa nuk respekton mëkatën kundër Krijuesit, i cili mëkat është më i madh se shirku ndaj Zotit? Në anën tjetër, ai urdhërohet t'i respektojë e të sillet mirë me ta në çështjet e kësaj bote por pa rënë nën ndikimin e tyre në besimin e tij. Ai duhet ta përcjellë rrugën e besimtarëve mirëbërës që i mbështeten Zotit, ndërsa çështjen e prindërve të vet ia lë Gjykatësit më të drejtë, atëherë kur prindërit nuk do të mund t'i ndihmojnë fëmijës e as fëmija prindërve të vet.

De facto, ky është kulmi i tolerancës që s'mund të krahasohet me fetë tjera!

KAPITULLI I KATËRT

HALLALLI DHE HARAMI NË JETËN E PËRGJITHSHME TË MUSLIMANIT:

- Në besime e tradita
- Në transaksione
- Në dëfrim e rekreim
- Në marrëdhëniet shoqërore
- Në marrëdhëniet e muslimanit me jomuslimanët

NË BESIME E TRADITA

Besimi i shëndoshë është baza e shoqërisë islame, ndërsa monoteizmi është esenca e këtij besimi dhe shpirti i gjithë Islamit. Me anë të sheriatit dhe udhëzimeve Islami e mbron besimin e tillë dhe monoteizmin e pastër. Ai gjithashtu i lufton besimet xhahilite të cilat ishin të njohura në periudhën e idhujtarëve, me qëllim që ta pastrojë shoqërinë islame nga idhujtaria dhe rruga e humbur.

Respektimi i ligjeve të Zotit në Gjithësi

Parimi i parë i besimit që e mbolli Islami në shpirtrat e muslimanëve është se kjo Gjithësi e madhe, ku jeton njeriu nën qiellin e saj dhe mbi tokën e saj, nuk është kaotike dhe se nuk zhvillohet jashtë ligjeve të caktuara, si dhe nuk lëvizë sipas dëshirave të krijesave, ngase dëshirat e tyre janë të verbra, të humbura, të kundërta dhe kontradiktore:

“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në to”. (El-Mu'minûn, 71).

Kjo Gjithësi ka ligje e zakone të pandryshueshme e konstante të cilat në asnjë mënyrë nuk ndryshojnë. Në Kur'an thuhet:

“Nuk do të gjeshë në Ligjin e Zotit ndonjë ndryshim”. (Fâtir, 43).

Muslimanët mësuhan nga Libri i Zotit të tyre dhe nga Sunneti i Pejgamberit të tyre që t'i respektojnë ligjet e tilla kozmike, t'i studiojnë shkaqet dhe relacionet të cilat i ka caktuar Zoti midis gjërave dhe t'i refuzojnë të gjitha shkaqet ekzoterike të cilat i propagandonin priftërinjtë, sharlatanët dhe manipuluesit e fesë.

Kundërshtimi i besëtytnive dhe mitologjive

Kur u paraqit Pejgamberi a.s., në shoqërinë e atëhershme ekzistonin disa njerëz që njiheshin me emrin *kehhân* ose *arrâfin* (fallxhorë e astrologë), të cilët pretendonin se i njihnin ngjarjet e të kaluarës dhe të ardhmërisë nëpërmjet kontakteve me xhinët ose me krijesa të ngjashme me to, dhe për këtë shkak Pejgamberi a.s. u shpalli luftë gënjeshtarëve të tillë, të cilët nuk mbështeteshin në dituri të vërtetë, në rrugë të drejtë dhe në Librin ndriçues (udhërrëfyes), dhe ua lexoi ajetin që ia shpalli Zoti:

“Thuaj: “Askush veç All-llahut as në qiej, as në tokë, nuk e di të fshehtë, as nuk e di se kur ringjallen”. (Neml, 65).

Pra, as engjëjt, as xhinët e as njerëzit nuk e dinë të fshehtë!

Me urdhrin e Zotit, Pejgamberi thekson:

“Thuaj: “Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi as ndonjë dëm, pos çka do All-llahu. Sikur ta dija të fshehtë, do t'i shtoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëmse qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë “. (El-A'râf, 188).

Zoti i Madhëruar informon për xhinët e Sulejmanit:

“Sikur ta dinin të fshehtë, nuk do të vazhdonin të qëndronin nën mundimin e rëndë”. (Sebe', 14).

Ai i cili pretendon se e njeh fshehtësinë e vërtetë, e mashtron Zotin, të vërtetën dhe njerëzit. Një delegacion ka shkuar te Pejgamberi a.s. me paragjykimin se ai u takon atyre që e njohin të fshehtë, dhe kështu fshehën diçka në dorë dhe e pyetën për të, e ai iu përgjigj me sinqeritet:

“Unë nuk jam parashikues; parashikuesi dhe fallxhorët do të hyjnë në zjarr!”

Besimi në parashikuesit e ardhmërisë është kufër

Islami nuk i sulmon vetëm parashikuesit dhe fallxhorët, por gjithashtu i trajton si mëkatarë edhe ata që shkojnë te ata, i pyesin dhe ju

besojnë miteve e besëtytnive të tyre. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Namazi nuk i pranohet dyzet ditë atij që shkon te fallxhori, e pyet dhe u beson fjalëve të tij”.¹

Ai gjithashtu thotë:

“Kush shkon te fallxhori dhe u beson fjalëve të tij, bën kufër në atë që i është shpallur Muhammedit a.s.”²

Muhammedit a.s. i është shpallur se vetëm Zoti e di të fshehtë të kurse Muhammedi jo, bile as ndonjë tjetër!

“Thuaj: “Unë nuk ju them juve se i kam në kompetencë depot e All-llahut (e t’ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se e di fshehtësinë, as nuk them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua.” (El-En’âm, 50).

Nëse muslimani e kupton këtë qartazi nga Kur’ani dhe përsëri beson se disa krijesa e dinë fshehtësinë e kaderit dhe fshehtësitë tjera, atëherë bën kufër në atë që Zoti ia zbriti Pejgamberit a.s.

Kërkimi i fatit me short

Për arsytet të cilat i theksuam më parë, Islami ndaloi kërkimin e fatit përmes shortit. Ky lloj i shortit përbëhej prej shigjetave të cilat i përdornin arabët paraislamë, dhe kishin dy anë të shkruara; në njërin shkruante “Zoti më urdhëroi”, në anën tjetër “Zoti më ndaloi”, kurse ana e tretë ishte e pashkruar. Kur dëshironin të

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Bezzarit me sened të mirë e të fortë.

niseshin në rrugë ose të martoheshin, shkonin te shtëpitë e idhujve, ku ishin shigjetat, dhe prej tyre e kërkonin fatin e tyre.

Në qoftë se ishte shigjetë urdhëruese, niseshin, nëse ishte ndaluese, abstenonin, ndërsa nëse dilte ajo e pashkruara, atëherë e përsëritnin derisa të dilte e shkruara urdhëruese ose ndaluese.

Kjo mënyrë e kërimit të fatit i ngjanë asaj që kërkon shoqëria jonë nëpërmjet rërës, guaskave, hapjes së faqeve, letrave, galmave dhe qitjes fall nga filxhani. Të gjitha këto forma janë haram në Islam.

Pas theksimit të ushqimeve të ndaluara, Zoti i Madhëruar thotë:

“(Dhe u është ndaluar) të kërkonit me short fatin. Kjo është mëkat ndaj All-llahut”. (Mâide, 3).

Pejgamberi a.s. thotë:

“Nuk i arrin gradat e larta ai që konsultohet me fallxhorët, ai që kërkon fatin nëpërmjet shigjetave dhe ai që kthehet nga rruga për shkak të ndonjë paralajmërimi!”¹

Magjia (sihri)

Islami gjithashtu e lufton magjinë dhe magjistarët. Për ata që mësojnë magjinë, në Kur'an thuhet:

“Mësojnë atë që i dëmton e që nuk është e dobishme për ta”. (El-Bekare, 102).

Pejgamberi a.s. e konsideron magjinë si një prej mëkateve më të mëdha e të urrejtura, të cilat shkatërrojnë popuj e individë dhe i degradojnë ata që e praktikojnë në këtë botë para ahiretit. Në këtë kontest, ai thotë:

¹ Transmetim i Nesaiut.

“Largohuni prej shtatë gjërave shkatërruese!” Kur e pyesin se cilat janë ato, ai u përgjigjet: “Shirku ndaj Zotit, magjia (sihri), vrasja e asaj që e ka ndaluar Zoti të vritet përveç me arsye, marrja e kamatës, marrja e pasurisë së jetimit, ikja nga fushëbeteja dhe akuzimi i grave të mbrojtura e besimtare (për amoralitet).”¹

Disa fukaha të Islamit mendojnë se magjia është kufër ose shpie në kufër, kurse disa të tjerë thonë se magjistari duhet të vritet për ta pastruar shoqërinë prej pasojave të tij.

Kur’ani na mëson se si të mbrohem prej dëmit të magjistarëve.

“Të atyre që lidhin dhe fryejnë në nyja”. (Felek, 4).

Fryerja e nyjes është metodë e magjistarëve. Në një hadith thuhet:

“Ai që frynë në nyja, bën magji, e ai që bën magji, bën shirk”.²

Islami ndalon muslimanin të shkojë te paralajmëruesit për t’i pyetur rreth çështjeve të fshehta, ashtu siç ia ndalon shkuarjen te magjistari dhe mbështetjen në magji për shërim nga sëmurja ose për zgjidhjen e ndonjë problemi të vështirë, bile edhe Pejgamberi a.s. distancohet prej tij. Në këtë kontekst, ai thotë:

“S’është prej nesh ai që kërkon ogur ose që lypë t’i kërkohet ogur; ai që kërkon fall ose që lypë t’i kërkohet fall dhe ai që bën magji ose që lypë t’i bëhet magji!”³

Ibn Mes’udi thotë:

“Kush shkon te fallxhori, magjistari ose te paralajmëruesi dhe i pyetë e u beson, bën kufër në atë që i është shpallur Muhammedit a.s.”⁴

Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Taberaniut me dy senede, ndërsa transmetuesit e vetëm një senedi janë autentikë.

³ Transmetim i Bezzarit me sened të mirë.

⁴ Transmetim i Bezzarit dhe i Ebu Ja’liut me sened të mirë.

“Nuk hyn në xhennet alkoolisti, besimtari i magjisë dhe shkatërruesi i lidhjeve me farefisin.”¹

Ndalimi nuk vlen vetëm për magjistarin, por edhe për atë që beson në të, që e inkurajon dhe që beson në atë që i thuhet. Harami është edhe më i madh kur magjia përdoret për çështjet që janë të ndaluara, si p.sh. për ndarjen e burrit prej gruas, për dëmtim fizik dhe për çështje të tjera që janë të njohura në rrethin e magjistarëve.

Përdorimi i hajmalive

Në këtë kategori hyn përdorimi i hajmalive, i guaskave dhe i gjërave tjera të ngjashme, me bindje se mbrojnë nga sëmurja ose shërojnë. Në shekullin XX, ende ka njerëz që vënë potkua të kalit në derë kurse në shumë vende tjera sot e kësaj dite ka njerëz që e shfrytëzojnë injorancën e njerëzve, u shkruajnë hajmali e u lexojnë gjëra magjepsëse duke pretenduar se kështu mbrojnë bartësin e saj nga agresori i shpirtave të këqij, xhinëve, syri, zilia etj.

Islami i refuzon intrigat e mashtruesve të tillë, ngase ai vetë përmbanë parime dhe metoda për masat parandaluese e shëruese. Pejgamberi a.s. thotë:

“Kërkoni shërim ngase Ai që ka krijuar sëmundjen e ka krijuar edhe shërimin!”²

Në një hadith tjetër thotë:

“Ka shërim prej tri gjërave: prej mjaltit, derdhjes së gjakutnga damari dhe kanterizimit me zjarr”³.

¹ Transmetim i ibën Habbanit në *Sahihun* e tij.

² Transmetim i Ahmedit.

³ Transmetim unanim.

Në krahasim me kohën tonë, këto tre lloje prezentojnë shërimin nëpërmes medikamenteve orale, operacioneve dhe terapive elektrike. Përdorimi i rruzave, i guaskave dhe i talismanëve për shërim ose preventivë, konsiderohet injorancë dhe humbje si dhe kundërshton ligjet e Zotit dhe monoteizmin e Tij.

Transmetohet se Ukbe ibn Amiri ka shkruar te Pejgamberi a.s. si një prej dhjetë personave. Pejgamberi a.s. ka pranuar betimin e nëntë personave ndërsa prej të dhjetit jo. Kur e kanë pyetur pse ka vepruar ashtu, ai është përgjigjur: *“Në krahun e tij ka hajmali.”*

Kur e ka hequr bartësi hajmalinë e vet, atëherë Pejgamberi a.s. e ka pranuar dhe ka thënë:

“Bartësi i tyre bën shirk”.¹

Në një hadith tjetër, thotë:

“Zoti mos ia plotësoftë dëshirat atij që mbanë hajmali, Zoti mos e mbroftë atë që mbanë guaska”.²

Nga Umran ibn Husejni transmetohet se

Pejgamberi a.s. e ka parë një njeri duke mbajtur hajmalinë në krah dhe i ka thënë: *“Mjerë për ty! Ç’është kjo?”* Ai i përgjigjet: *“Të më mbrojnë nga dobësia!”* Në atë rast Pejgamberi a.s. i ka thënë: *“Kjo vetëm e shton dobësinë tënde! Gjuaje atë, ngase nëse vdes me të, asnjëherë nuk do të shpëtosh!”*³

Këto mësimet të Pejgamberit a.s. ndikuan te sahabët e tij dhe u larguan nga çështjet e tilla të kota dhe nga besimi në to.

¹ Transmetim i Hakemit dhe i Ahmedit.

² Transmetim i Ahmedit dhe i Ebu Ja’lasi me sened të mirë kurse Hakemi me sened sahih.

³ Transmetim i Ahmedit, Ibën Habbanit në sahihun e tij dhe i Ibën Maxhes.

Isa ibn Hamza transmeton se ka shkuar te Abdull-llah ibn Hakimi i sëmurë nga ethet dhe i ka thënë: “Mbanë hajmali!” Ai i përgjigjet: “Zoti më mbroftë nga ajo!”, ose sipas një transmetimit tjetër: “Më shumë preferoj vdekjen se atë!” Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kush mban hajmali, do t’i mbetet vetëm mbështetja në të”.¹

Kur Ibn Mes’udi ka hyrë te gruaja e vet, ka parë diçka të lidhur në qafën e saj, ia ka këputur dhe i ka thënë: “Familja e Abdull-llahut nuk ka nevojë t’i shoqërojë Zotit diçka që s’është e lejuar!” Pastaj thotë:

“E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *“Inkantacionet, hajmalitë dhe magjia janë shirk”*. Disa i thonë: “O Ebu Abdurrahman, ne i njohim inkantacionet dhe hajmalitë por ç’është magjia? Ai u përgjigjet: “Ajo është diçka që e bëjnë gratë me qëllim që t’i duan burrat e tyre.”² Pra, ky është një lloj sihri.

Dijetarët thonë se ndalohen inkantacionet dhe hajmalitë e shkruara në gjuhë të huaj nga frika se mos ka diçka të përzier me pabesim dhe magji. Në qoftë se gjuha është e kuptueshme dhe në të përmendet emri i Zotit, atëherë është mustehab, ngase në këtë rast ajo prezanton një lloj lutjeje te Zoti për shërim.

Hajmalitë e njerëzve paraislamë ishin të përziera me magji, shirk e talismane të pakuptueshme. Transmetohet se Ibn Me’sudi r.a. e ka ndaluar gruan e tij të mbajë hajmali paraislame ndërsa i ka thënë: “Një ditë dola jasht shtëpisë me ç’rast më shikoi një njeri dhe sytë e mi papritmas filluan të lotojnë (d.m.th. ai i qëllloi me sy të keq). Kur fillova të lexoj *inkantacion* lotimi m’u ndal, e kur e ndala leximin, lotimi sërish filloi.” Në atë rast Ibn Mes’udi tha: “Ky është djalli; kur i nënshtrohesh të lë të qetë mirëpo kur e refuzon, të godet me gisht në sy! Sikur të veproje ashtu siç vepronte Pejgamberi a.s. do

¹ Transmetim i Tirmidhiut.

² ¹bën Habbanit në Sahihun e tij dhe i Hakemit me rezyme.

të ishte më mirë për ty dhe për shërimin tënd. Laji sytë me ujë dhe thuaj: “O Zot i njerëzve, largoma dhembjen! Më shëro ngase Ti je shërues! Vetëm shërimi Yt është shërim që s’le pas vete asnjë sëmundje!”

Parandjenja e fatkeqësisë (pesimizmi)

Parandjenja e fatkeqësisë ose pesimizmi nga disa gjëra, si p.sh. nga disa vende, kohë ose persona, është iluzion që ekziston në shumë shoqëri e individë. Në kohët e lashta, populli i ka thënë Salihit:

“Ne parandjejmë fatkeqësi me ty dhe me ata që janë me ty!” (Neml, 47)

Kur goditej Faraoni dhe populli i tij me ndonjë fatkeqësi:

“Fatin e zi ia përshkruanin Musait dhe atyre (besimtarëve) që ishin me të”. (El-A'râf, 131).

Kur pabesimtarët e humbur përjetonin ndonjë sprovim të keq, ia mvishnin peygamberëve të Zotit:

“Ne parandjejmë kob me ju...” (Jâsîn, 18).

Përgjigjja e peygamberëve ishte:

“Fati i keq është i juaj!” (Jâsîn, 19),

gjegjësisht pesimizmi juaj është nga pabesimi dhe kokëfortësia juaj si dhe nga arroganca juaj ndaj Zotit dhe Peygamberit të Tij.

Arabët e periudhës paraislame kishin traditë të gjatë në praktikimin e gjërave të tilla, mirëpo, kur u paraqit Islami, i zhduku dhe popullin e nxori në rrugë të drejtë e të vërtetë.

Peygamberi a.s. i konsideronte paralajmërimin, fallin dhe magjinë të një kategorie. Në këtë kontest, ai thotë:

“Nuk është prej nesh ai që parandjen ose që kërkon t’i parandjehet diçka, ai që qet fall ose kërkon t’i qitet falli dhe ai që bën magji ose kërkon t’i bëhet magji!”¹

Peygamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Taberaniut nga Ibën Abbasi me sened hasen.

“Shkrimi në rërë, fati nga gura lecat dhe parandjenja prej diçkaje janë adhurim i ndokujt tjetër përveç Zotit”.¹

Parandjenja e tillë nuk ka bazë shkencore e as reale por nënkupton animin drejt dobësisë e besimi në ulizone, sepse në të kundërtën, si mund të shpjegohet fakti kur njeriu i mençur beson se fatkeqësia i vjen nga ndonjë person i posaçëm, nga ndonjë vend, nga ndonjë zë i shpezëve, nga ndonjë lëvizje e syrit ose nga dëgjimi i ndonjë fjale?! Në qoftë se natyra e dobët ndikon në pesimizmin e njeriut nga disa gjëra për shkaqe specifike, atëherë njeriu i tillë duhet t’i përballojë kësaj ndjenje e ta kapërcejë, posaçërisht kur bëhet fjalë për periudhën e punës dhe realizimit.

Në një hadith merfu’ e thuhet:

“Prej tri gjërave askush nuk mund të shpëtojë: prej dyshimit, paramendimit pesimist dhe zilisë: Nëse dyshon mos e ndiq atë, nëse ke paramendim pesimist mos u kthe dhe nëse ke zili, mos e kapërce cakun (mos e tepro)”.²

Këto tri gjëra janë vetëm paramendime dhe paragjykime të cilat nuk ndikojnë në sjelljen praktike dhe Zoti i falë ata. Ibn Mes’udi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Parandjenja e të keqes (nga gjërat) është shirk; parandjenja e të keqes është shirk; parandjenja e të keqes është shirk”.

Ibn Mes’udi thotë:

“Askush prej nesh nuk mund të largohet nga ndikimi i këtyre gjërave por Zoti i mënjanon me devotshmëri”.³

¹ Transmetim i Ebu Davudit, Nesaiut dhe Ibën Habbanit në Sahihun e tij.

² Transmetim i Taberaniut.

³ Transmetim i Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

Ibn Mes'udi dëshiron të thotë se çdo njeri që i përjeton këto gjëra në zemrën e tij, mund t'i shmangë me devotshmëri dhe të shpëtojë nga ndikimi i tyre.

Lufta kundër traditave të periudhës paraislame

Islami u shpalli luftë besimeve dhe besëtytnive të periudhës paraislame për shkak të rrezikut të tyre ndaj intelektit, moralit dhe sjelljes, ashtu siç u shpalli luftë edhe traditave të periudhës paraislame që mbështeteshin në nacionalizëm, shovinizëm, vetëmburrje, krenari dhe glorifikim të fisit.

S'ka shovinizëm në Islam

Që në fillim Islami zhduku çdo lloj të shovinizmit duke ua ndaluar muslimanëve të përfaqësohen ose të thërrasin në të. Pejgamberi a.s. është distancuar nga ai që vepron kështu, duke thënë:

“S’është prej nesh kush thërret në shovinizëm, s’është prej nesh ai që lufton për shovinizëm dhe s’është prej nesh ai që vdes për shovinizëm!”¹

S’ka dallim midis ngjyrave të lëkurës as midis popujve botërorë. Në asnjë pjesë të botës muslimanit nuk i lejohet të jetë kundërshtar i ndonjë ngjyre, race apo vendi.

Nuk i lejohet atij që beson në Zotin e Madhëruar dhe në Ditën e gjykimit që ta përkrahë me çdo kusht popullin e vet pa gjykuar se a është i drejtë apo jo, i mirë apo jo.

Transmetohet nga Vâthile ibn El-Eska se

قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ! مَا الْعَصِيَّةُ؟ قَالَ: أَنْ تُعِينَ قَوْمَكَ عَلَى الظُّلْمِ.

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

i ka thënë Pejgamberit a.s.: “O Pejgamber, ç’është shovinizmi?” Ai i është përgjigjur: “*T’i ndihmoh popullit tënd në gabim (tirani)*”.²

“O ju që besuat, përherë të jeni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër (interesi) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve... (Nisâ, 135).

“Të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë”. (Mâide, 8).

Pejgamberi a.s. e ndryshoi konceptimin e këtij termi që mbizotëronte në periudhën paraislame dhe që nënkuptonte parimin:

“Ndihmoi vëllait tënd, qoftë dëmtues ose i dëmtuar!”. Kur ua përsëriti Pejgamberi të njëjtën frazë por me domethënie tjetër, shokët e tij u habitën dhe e pyetën:

“O i dërguari i Zotit! I ndihmojmë nëse është i dëmtuar por si t’i ndihmojmë edhe kur të jetë dëmtues? Ai u përgjigj: “*E pengoni nga dëmtimi, dhe kështu e ndihmoni!*”²

Nga kjo nënkuptojmë se çdo thirrje shoviniste ose raciste është thirrje xhahilite nga e cila distancohen Islami, Pejgamberi dhe Kur’ani.

Islami njeh vetëm parimin e besimit dhe lidhjen e besimit si dhe njerëzit i dallon vetëm në bazë të imanit e kufrit. Pabesimtari që nuk beson Islamin është kundërshtar i muslimanit qoftë edhe më i afërmi i tij... Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe Ditën e gjykimit e ta dojë atë që kundërshton All-llahun dhe Të dërguarin e Tij edhe sikur të jenë ata (kundështarët) prindërit e tyre ose fëmijët e tyre, vëllezërit e tyre ose farefisi i tyre”. (Muxhâdele, 22).

“O ju që besuat! Mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë”. (Et-Tevbe, 23).

² Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Buhariut.

Prejardhja dhe ngjyra nuk janë të rëndësishme

Buhariu transmeton se Ebu Dherri dhe Bilall Habeshiu r.a. (ishin prej të parëve që pranuan Islamin) janë zënë mes vete dhe e kanë ofenduar njëri - tjetrin. Në atë gjendje hidhërimi Ebu Dherri i thotë Bilallit: “O biri i zezakes!” Kur ankohet Bilalli te Pejgamberi a.s. për këtë ofendim, ai i thotë Ebu Dherrit:

“A e turpërove me nënën e tij? Ende ka në ty ndikim të periudhës së xhahilijetit!”¹

Transmetohet nga Ebu Dherri se Pejgamberi i ka thënë:

“Shiko veten sepse nuk je më i mirë se i kuqi e zezaku. Privilegjet bëhen nëpërmjet devotshmërisë ndaj Zotit”.²
Pejgamberi a.s. thotë:

“Të gjithë jeni (fëmijë) të Ademit, e Ademi është krijuar prej dheut”.³

Kështu Islami ndalon muslimanin të mburret me prejardhjen që është formë e xhahilijetit paraislam, gjegjësisht ai ndalon mburrjen me gjyshërit dhe stërgjyshërit si dhe t’i thuhet njëri - tjetrit: “Unë jam i biri i filanit”, “unë kam këtë prejardhje”, “t’i rrjedh prej kësaj familjeje”, “unë jam prej të bardhëve e ti je prej zezakëve” ose “unë jam arab e ti je i huaj” etj.

Çfarë vlere ka prejardhja kur në realitet të gjithë njerëzit kanë një origjinë, dhe po qe se vlerësohet prejardhja, atëherë çfarë rëndësie ka nëse thuhet se filani është i biri i këtij ose atij prindi?

Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Ahmedit.

³ Transmetim i Bezzarit.

“Gjenealogjia e tillë nuk duhet të jetë shkas për ofendimin e ndokujt. Të gjithë jeni (bij) të Ademit... Dallimi ndërmjet njëritjetrit bëhet vetëm në bazë të fesë dhe devotshmërisë.”¹

Në një hadith tjetër thuhet:

“Njerëzit janë të Ademit dhe Havës... Zoti nuk ju pyet për prejardhjen tuaj në Ditën e gjykimit! Më i privilegjuari prej jush tek Zoti është ai që është më i devotshëm.”²

Pejgamberi a.s. hidhërohej pa masë prej atyre që mburreshin me gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre, dhe në mënyrë kategorike thoshte:

لَيَنْتَهِيَنَّ أَقْوَامٌ يَفْتَخِرُونَ بِآبَائِهِمُ الَّذِينَ مَاتُوا إِنَّمَا هُمْ فَحْمُ
جَهَنَّمَ، أَوْ لَيَكُونُنَّ أَهْوَنَ عَلَى اللَّهِ مِنَ الْجُعَلِ الَّذِي يُدْهَدُهُ
الْخَرَّ بِأَنْفِهِ. إِنَّ اللَّهَ أَذْهَبَ عَنْكُمْ عُبْيَةَ الْجَاهِلِيَّةِ وَفَخَرَهَا
بِالْأَبَاءِ، إِنَّمَا هُوَ مُؤْمِنٌ تَقِيٌّ وَفَاجِرٌ شَقِيٌّ. النَّاسُ بَنُو آدَمَ،
وَأَدَمُ خُلِقَ مِنْ تُرَابٍ.

“Le të përfundojnë njerëzit që mburren me etërit e tyre të cilët vdiqën sepse ata do të konsiderohen si material xhehennemi. Zoti e ka zhdukur prej jush mburrjen e xhahilijetit dhe krenarinë me etër. Njeriu është ose i devotshëm e besimtar ose mëkatar. Njerëzit janë (bij) të Ademit dhe Ademi është krijuar prej dheut”.³

Ky hadith i rikujton ata të cilët mburreshin me stërgjyshërit e tyre si p.sh. faraonët, kisranianët, arabët e periudhës paraislame dhe të huajt tjerë të cilët, sipas fjalëve të Pejgamberit a.s. janë vetëm material djegës në xhehennem.

Në Haxhxin e lamtumirës, ku prezentonin mijëra njerëz që dëgjonin për Islamin në vendin e shenjtë dhe në muajin e shenjtë, Pejgamberi a.s. ka ligjëruar ligjëratën e lamtumirës e cila i përmbante këto parime:

¹ Transmetim i Ahmedit.

² Transmetim i ibën Xheririt.

³ Transmetim i Ebu Davudit, Tirmidhiut, Bejhakiut dhe Mundhirit.

“O ju njerëz! Zoti juaj është Një; s’ka përparësi të arabit mbi të huajin e as të të huajit mbi arabin, as të kuqit mbi zezakun e as të zezakut mbi të kuqin përveç (përparësisë) në devotshmëri. (Më i privilegjuari i mesit tuaj është ai që është më i devotshëm!).”¹

Të mbajturit zi për të vdekurin

Prej traditave të periudhës paraislamit, të cilat i luftoi Islami, ishte edhe çështja e vdekjes dhe ajo që kishte të bëjë me të, si p.sh. të mbajturit zi, vajtimi, eksponimi i mjerimit dhe pikëllimit...

Islami i mëson ithtarët e vet se vdekja është transferim prej një shtëpie në një shtëpi tjetër, e jo zhdukje absolute. Pikëllimi nuk e rikthen të vdekurin e as që pengon vendimin e Zotit. Pra, muslimani obligohet ta pranojë vdekjen ashtu siç pranon ndonjë fatkeqësi me durim të plotë, duke shpresuar takimin në botën e Ahiretit dhe duke recituar ajetin kur’anor:

“Të Zotit jemi dhe Atij i kthehemi”. (El-Bekare, 156)

Ajo që veprohet në mesin e popullit paraislam konsiderohet haram. Prej veprave të tilla është distancuar edhe Pejgamberi a.s., me konstatimin e tij:

“Nuk është prej nesh ai që u bie shuplakë faqeve, i shqyen xhepat (teshat) dhe pisket me piskamë të periudhës xhahilite.”²

Nuk i lejohet muslimanit të veshë tesha zie ose të braktisë veshjen e vet të rëndomtë për hir të pikëllimit e mjerimit, përveç gruas të cilës i ka vdekur burri, e cila obligohet të mbajë idetin prej katër muaj e dhjetë ditëve për hir të sinjeritetit ndaj martesës dhe lidhjes së shenjtë midis të dyve. Ajo pra nuk duhet të vishet me tesha të bukura dhe s’duhet të fejojë gjatë periudhës së idetit, e cila, sipas Islamit, është vazhdim i martesës së mëparshme me shumë të drejta.

Nëse i ka vdekur ndokush tjetër përveç burrit, si psh. babai, i biri ose vëllai, atëherë gruas nuk i lejohet të mbajë zi më tepër se tri ditë.

¹ Transmetim i Bejhakiut.

² Transmetim i Buhariut.

Buhariu transmeton nga Zejneb bint Ebi Seleme, e cila transmeton nga Ummu Habibeja (gruaja e Pejgamberit) kur i ka vdekur babai i saj Ebu Sufjan ibn Harbi dhe nga Zejneb bint Xhahshi kur i ka vdekur vëllai i saj. Ajo transmeton se të dyja janë parfumosur dhe pastaj kanë thënë: “Për Zotin, s’kemi nevojë për parfume, por e kemi dëgjuar Pejgamberin a.s. se ka thënë:

*“Nuk i lejohet gruas që beson në Zotin dhe në Ditën e Ahiretit të mbajë zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, ajo që i ka vdekur burri duhet të mbajë zi katër muaj e dhjetë ditë.”*¹

Të mbajturit zi për burrin e vdekur është obligim pa kurrfarë lehtësimesh. Një grua ka shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i ka thënë:

“Burri i vajzës sime ka vdekur, dhe syri i saj është infektuar, a duhet të vëdojë “kahl”? Pejgamberi a.s. i ka thënë: “Jo”. Pastaj ajo ka vazhduar ta pyesë tri herë me radhë, e ai i është përgjigjur vetëm me “jo”.² Nga përgjigjja e tij nënkuptojmë se zbukurimi gjatë periudhës së idetit është i ndaluar.

Pikëllimi i patepruar dhe qarja pa zë janë gjëra instinktive dhe për këtë shkak nuk konsiderohen mëkat.

Umeri i ka dëgjuar disa gra duke qajtur për Halid ibn Velidin, dhe kur ka dashur një njeri t’i pengojë, ai i ka thënë: “Le të qajnë për Ebu Sulejmanin përderisa nuk vajtojnë me zë e as nuk hedhin dhé në fytyrë”.

¹ Transmetim i Buhariut në *Sahihun* e vet.

² Transmetim i Buhariut. Transmetimet e Ummu Habibes dhe Zejnebes janë të njëjta.

TRANSAKSIONET

Zoti i ka krijuar njerëzit të varur njëri prej tjetrit. Asnjë individ nuk i posedon të gjitha gjërat që i nevojiten, dhe atë që s'e ka e merr prej të tjerëve. Zoti i ka inspiruar që të bëjnë transaksione të gjërave dhe të artikujve nëpërmjet shitblerjes, me qëllim që të sigurohet jeta dhe të jetë e begatshme e produktive.

Kur u dërgua Pejgamberi a.s., arabët praktikonin lloje të ndryshme të transaksioneve dhe të ndërrimit të pasurisë. Ai i pranoi ato lloje që nuk konfrontoheshin me parimet e sheriatit, e ato që konfrontoheshin i ndaloi. Ndalimet e tij kishin arsye specifike, p.sh. tregtia me artikujt e ndaluar, transaksionet me mashtrime dhe profite të jashtëzakonshme dhe padrejtësia ndaj donjë pale në kontratë etj.

A. Ndalimi i shitjes së gjërave të ndaluara

Tregtia me gjërat të cilat janë të ndaluara konsiderohet e ndaluar, si p.sh. tregtia me derra, verë, pije alkoolike, puta, kryqe, statuja etj. Në qoftë se tregtia e tillë lejohet, atëherë nënkuptohet lejimi dhe përhapja e tyre në popull dhe në formë konsekuente, i inkurajon njerëzit të bëjnë haram. Me ndalimin e tillë mënjanohej dhe injorohen si dhe largohen njerëzit prej tyre e nuk kontaktojnë me to. Pejgamberi a.s. thotë:

إِنَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ حَرَّمَ بَيْعَ الْخَمْرِ وَالْمَيْتَةِ وَالْخِنْزِيرِ
وَالْأَصْنَامِ.

*“Zoti dhe Pejgamberi i Tij ndalojnë shitjen e verës, cofëtirave, derrit dhe putave”.*¹ Ai gjithashtu thotë:

إِنَّ اللَّهَ إِذَا حَرَّمَ شَيْئًا حَرَّمَ ثَمَنَهُ.

¹ Transmetim unanim.

“Kur Zoti ndalon diçka, ndalon edhe fitimin prej saj”.²

B. Ndalohet shitja e pasigurt

Çdo kontratë tregtie që ka hapësirë për konflikt, për shkak të sasisë së pacaktuar për ndërrim ose shpërndarje ose për shkak të dyshimit që mund të shkaktojë grindje midis dy palëve, është e ndaluar nga ana e Pejgamberit a.s. si masë preventive. Këtu bën pjesë lloji i transaksionit, ku s’ka garanci se shitësi mund t’i shpërndajë gjërat për të cilat merr pagesë. Kështu, Pejgamberi a.s. ka ndaluar pranimin e pagesës për hamshor, për brendësinë e deves, për peshkun në det, për shpezët e pazëna në ajër, për deven që është akoma në mitër, ngase ekziston elementi i pasigurisë deri në përfundimin e transaksioneve të tilla.²

Pejgamberi a.s. vërente se populli i shitte frytet që ende nuk kishin dalë as në fushë e as në kopsht. Në qoftë se shkatërroheshin frytet nga ndonjë faktor natyror, atëherë lindte grindja ndërmjet njerëzve në kontratë se cili prej tyre do ta paguante humbjen. Për këtë shkak Pejgamberi a.s. ndaloi shitjen e fryteve derisa haptazi të dukej se ishin në gjendje të mirë,³ përveç nëse kushtëzohej vjelja e tyre aty për aty. Ai gjithashtu ndaloi shitjen e kallirit derisa të bëhej i bardhë dhe të sigurohej nga parazitët i bimëve.⁴

Në këtë kontekst ai thotë:

“Nëse Zoti pengon frytin, atëherë pse të shfrytëzoni pasurinë e vëllait?! ”⁵

Sidoqoftë, nuk ndalohet çdo tregti e pasigurt, p.sh. ndonjëri mund të blejë shtëpi pa ditur gjendjen e themeleve të saj ose çfarë ka brenda mureve të saj. Ndalohet shitja e gjësëndit që është qartësisht i pasigurt dhe që mund të shkaktojë konflikt ose shfrytëzim të padrejtë të të hollave të njerëzve. Nëse rreziku i pasigurisë është i vo-

² Transmetim i Ahmedit dhe Ebu Davudit.

² Transmetim i Muslimit dhe i të tjerëve.

³ Transmetim i Buhariut dhe i Muslimit.

⁴ Transmetim i Muslimit.

⁵ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

gël (në bazë të përvojës e traditës), atëherë shitja nuk është e ndaluar, si p.sh. ndokush mund t'i shesë perimet që zhvillohen në tokë si p.sh. karrota, qepa e rrepa edhe pse janë në tokë; ose të fushave me trangull, shalqin etj.

Sipas Imam Malikit, lejohet shitja e asaj që është e nevojshme dhe që ka rrezik të cilin mund ta durojë edhe kontrata.¹

C. Manipulimi me çmimet

Islami i ofron liri tregut sipas rregullave natyrore ekzistuese dhe sipas kërkesës e ofertës. Kur rriteshin çmimet, populli kërkonte prej Pejgamberit a.s. t'i fiksojë, mirëpo ai u përgjigjej:

“Zoti është Ai që i fikson çmimet, dorëhapur e sigurues, dhe shpresoj se kur do të takohem me Të, askush prej jush nuk do të ankohet prej meje për ndonjë padrejtësi në gjak ose në pasuri!”²

Pejgamberi i Islamit deklaroi se ndërhyrja në lirinë e individëve pa arsye konsiderohet padrejtësi, dhe se njeriu duhet të takohet me Zotin pa u komprometuar në këtë mënyrë.

Në qoftë se në treg ndërhyjnë faktorë artificialë, si p.sh. tubimi i disa tregtarëve dhe manipulimi i tyre me çmime, atëherë interesi shoqëror ka më shumë përparësi se liria e disa individëve, dhe në këtë rast lejohet fiksimi i çmimeve për shkak të nevojës së shoqërisë për t'u mbrojtur nga shfrytëzuesit e pashpirtë. Kjo vlen atëherë kur (tregtarët) kundërshtojnë rregullat dhe parimet.

Hadithi i lartpërmendur nuk nënkupton se të gjitha fiksime të çmimeve janë të ndaluara, pa marrë parasysh rrethanat, pos atëherë kur dëshirohet të pengohet dëmtimi dhe të mbrohet nga padrejtësia e dukshme.

Dijetarët hulumtues kanë konkluduar se varësisht nga ndikimi i natyrës së rrethanave, kontrollimi i çmimeve në një kohë mund të jetë i padrejtë dhe i ndaluar kurse në ndonjë kohë tjetër mund të jetë i drejtë dhe i lejuar.

¹ Ibën Tejmije, *El-Kavâi'dun - nurâniye*, f. 118.

² Transmetim i Ebu Davudit, Tirmidhiut, Ibën Maxhes, Dârimiut dhe Ebu Ja'laut.

Në qoftë se fiksimi i çmimeve i detyron njerëzit t'i shesin artikujt e tyre me çmim të papërshtatshëm për ta ose nëse pengon profitin e logjikshëm e të lejuar nga Zoti, atëherë konsiderohet haram.

Në qoftë se fiksimi i çmimeve siguron barabarësinë midis njerëzve, p.sh. detyrimi i shitësve të pranojnë çmimin e barabartë e të caktuar në bazë të artikujve të tjerë krahasues dhe pengimi i tyre të marrin më tepër, atëherë konsiderohet i lejuar, bile edhe i obligueshëm.

Hadithi i lartpërmendur ka të bëjë me situatën e parë, gjegjësisht në qoftë se tregtarët i shesin artikujt me standard të rëndomtë pa bërë manipulime me çmimet, por i rrisin sipas mungesës së artikujve ose rritjes së popullatës (në bazë të ligjit të ofertës e kërimit), atëherë, pasi që kjo vjen nga Zoti, detyrimi i tyre për shitje të artikujve me çmime të fiksuara konsiderohet i padrejtë.

Sa i përket situatës së dytë, në qoftë se tregtarët refuzojnë shitjen e artikujve edhe pse njerëzit kanë nevojë për to, me qëllim që të sigurojnë çmime më të larta se të rëndomtat, atëherë duhet të detyrohen që t'i shesin me çmimin që është ekuivalent me artikujt, dhe në këtë rast, fiksimi i çmimeve nënkupton stabilizimin e çmimeve krahasuese për artikujt ekuivalentë dhe përputhjen me standardin e drejtësisë që kërkohet nga ana e Zotit të Madhëruar.¹

Mallkimi i grumbullimit

Islami garanton lirinë e konkurrencës individuale e natyrore në treg, mirëpo mallkon ata të cilët nën ndikimin e ambicieve dhe lakmisë, grumbullojnë pasurinë dhe bëhen të pasur nëpërmjet manipulimit me çmimet e artikujve ushqimorë dhe të artikujve tjerë të nevojshëm. Për këtë shkak Pejgamberi a.s. ka ndaluar grumbullimin e tillë duke e gjykuar me fjalë të rrepta e kategorike:

*“Zoti distancohet prej atij që e grumbullon ushqimin dyzet ditë”.*²
Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

¹ Shiko *Risâletul-hisbe* nga Shejhul-islam Ibën Tejmije dhe *Et-Turukul-hikmijje*, nga Ibn Kajjimi.

² Transmetim i Hakemit, Ibën Ebi Shejbes dhe Bezzarit.

“Vetëm mëkatar i grumbullon”.¹ Termi *Hâtiun* (mëkatar) këtu nuk është përdorur rastësisht meqë Kur’ani kështu i ka quajtur edhe perandorët tiranë si Faraonin, Hamanin dhe ushtarët e tyre:

“Vërtet, Faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin kundërshtarë (gabonin me qëllim)”. (Kasas, 8).

Pejgamberi a.s. sqaron psikologjinë dhe egoizmin e grumbulluesit:

بِئْسَ الْعَبْدُ الْمُحْتَكِرُ، إِنَّ سَمِعَ بِرُخْصٍ سَاءَهُ، وَإِنْ سَمِعَ
بِغَلَاءٍ فَرِحَ.

“Robi grumbullues është më i keqi; kur dëgjon lirimin, dëshpërohet dhe kur dëgjon shtrenjtimin, gëzohet”.²

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

“Blerësi është i furnizuar (i begatuar) kurse grumbulluesi i mallkuar”.³

Në këtë rast, tregtari fiton në dy mënyra:

1. Ose e deponon artikullin për ta shitur me çmim të lartë atëherë kur njerëzit e kërkojnë por s’mund ta gjejnë, dhe kështu obligohen ta blejnë pa marrë parasysht se me çfarë çmimi shitet,
2. Ose e sjell artikullin dhe e shet me fitim simbolik, e më vonë bën tregti tjetër dhe fiton, e kështu me radhë. Ky profit është më i përshtatshëm për interesin publik dhe më i frytshëm, kurse pronari (tregtari) është i begatuar, ashtu siç paralajmëron Pejgamberi i Zotit.

Prej haditheve të rëndësishme rreth grumbullimit të pasurisë dhe manipulimit me çmimet është hadithi i transmetuar nga Ma’kal ibn Jesâri, shok i Pejgamberit a.s. Ai rrëfen se kur është sëmurë, i ka ardhur në vizitë Ubejdull-llah ibn Zijadi (guvernator emevit) dhe i ka thënë: “A e di, o Ma’kal, se unë kam derdhur gjak të ndaluar?” Kur i është përgjigjur se jo, atëherë ka vazhduar: “A e di se kam ndërhyrë në çmimet e artikujve të muslimanëve?” Me këtë Ma’kali ka kërkuar prej njerëzve rreth tij që t’i ndihmojnë të ngrihet, e

¹ Transmetim i Muslimit.

² Rezîni e ka theksuar në librin etij *El-Xhami’u*.

³ Transmetim i Ibën Maxhes dhe Hakimit.

pastaj tha: “O Ubejdull-llah, dëgjo të të tregoj diçka që e kam dëgjuar prej Pejgamberit a.s. më shumë se njëherë.

Unë e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “*Zoti do ta ulë në zjarr Ditën e gjykimit atë që ndërhyr në çmimet e artikujve të muslimanëve me qëllim që t’i rrisë ato*”.

Pastaj e ka pyetur: “A e ke dëgjuar këtë (hadith) nga Pejgamberi a.s.?”, ndërsa ai i është përgjigjur: “Më shumë se një ose dy herë”.¹ Nga hadithet e tilla dijetarët kanë konkluduar se ndalimi i grumbullimit të mallit bëhet në dy raste:

1. Kur grumbullimi i mallit në një shtet për atë kohë është i dëmshëm për popullatën
2. Kur qëllimi kryesor i grumbullimit është që me ngritjen e çmimeve të realizohet profiti më i madh.

Ndërhyrja në tregun e lirë

Në kategorinë e grumbullimit të ndaluar nga Pejgamberi a.s. bën pjesë edhe shitja e qytetarit mallin e fshatarit:

Dijetarët e sqarojnë këtë akt dhe thonë se ka të bëjë me të huajin që sjell diçka të nevojshme për ta shitur me çmimin e ditës, mirëpo i shkon qytetari dhe i thotë: “Ma jep mua artikullin tënd e ta shes për ty me çmim më të lartë por më ngadalë”. Nëse shitjen e bën vetë fshatari, çmimi është më i lirë dhe dobia do të jetë për të dy anët (për popullin) dhe për vete.

Kjo mënyrë e tregut ishte shumë e njohur në atë kohë. Enesi ka thënë: “Na u ndalua që qytetari të shesë për fshatarin, qoftë edhe vëlla (i vërtetë) nga babai e nëna”.²

Në këtë mënyrë ata mësuan se interesi i përgjithshëm qëndron mbi lidhjet personale. Pejgamberi a.s. ka thënë:

¹ Transmetim i Ahmedit dhe Taberaniut.

² Transmetim unanim.

“Le të mos shesë qytetari për fshatarin por lëshoni njerëzit të furnizojnë njëri-tjetrin me rizkun e Zotit”.¹

Fjala e shkurtër pejgamberike: *“Lëshoni njerëzit të furnizojnë njëri-tjetrin me rizkun e Zotit”*, prezenton parimin e rëndësishëm në fushën e tregtisë, gjegjësisht të mbizotërojë konkurrenca natyrore në çmimet dhe në shitjet e tregut, si dhe faktorët natyrorë, pa ndërhyrjen e individëve manipulues.

Kur është pyetur Ibn Abbasi për domethënien e *“Le të mos shesë qytetari për fshatarin”*, ka thënë: *“Të mos jetë ndërmjetës”*,² dhe kjo nënkupton se lejohet në qoftë se ndërmjetësi e lajmëron për çmimet, e këshillon dhe e njofton për gjendjen e tregut pa marrë kompensim. Kjo mbështetet në faktin se Zoti këshillon dhe se këshilla është pjesë e fesë, bile edhe fe e plotë. Muhammedi a.s. thotë:

“Feja është këshillim”,³ e në një hadith tjetër përsëri thotë: *“Nëse donjëri prej jush kërkon këshillë prej vëllait të vet, le ta këshillojë!”*⁴

Ndërmjetësi shpeshherë preokupohet me profitin e vet dhe harron interesin e përgjithshëm në transaksionet e tilla.

Lejohet ndërmjetësimi tregtar

Ndërmjetësimi lejohet në rastet tjera që përjashtohen nga rasti i lartpërmendur, ngase ndërmjetësiluan rolin e udhërrëfyesit dhe të

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Buhariut.

³ Transmetim i Muslimit.

⁴ Transmetim i Ahmedit.

lidhësit midis shitësit dhe blerësit. Në këtë mënyrë, ai ua lehtëson të dyve punën për transaksionet profitabile.

Ndërmjetësimi tregtar sot konsiderohet më i nevojshëm se në kohët e kaluara ngase lidhen kontrata për transaksione tregtare, për eksport e import dhe për tregti me shumicë e pakicë, kështu që roli i ndërmjetësve ka rëndësi shumë të madhe. Nuk është keq që ndërmjetësi të fitojë ndonjë profit sipas kontratës.

Buhariu transmeton në *Sahihun* e vet se Ibn Sirini, Ata'u, Ibrâhimi dhe Hasani lejonin profitin e ndërmjetësit. Ibn Abbasi thotë: "Mund të thuhet: "Shiti këto tesha, dhe çka të teprojë mbi këtë çmim, të takon ty!" Ibn Sirini thotë: "Mund të thuhet: "Shite me këtë çmim dhe profitin do ta marrësh ti ose do ta ndajmë përgjysmë!" Pejgamberi a.s. thotë:

اَلْمُسْلِمُونَ عِنْدَ شُرُوطِهِمْ.

"Muslimanët u përmbahen kushteve!"¹

Ndalohet eksploatimi dhe mashtrimi tregtar

Për ta penguar manipulimin e tregut, Pejgamberi a.s. gjithashtu ndalon të ashtuquajturin *nexhesh*.² Sipas komentimit të Ibn Umerit, nocioni *nexhesh* nënkupton propozimin e çmimit më të lartë pa patur qëllim blerjeje, por për hir të rritjes së çmimit nga të tjerët. Shumëherë këto kontrata bëhen për t'i mashtruar të tjerët.

Për të mbrojtur transaksionin nga çdo formë e eksploatimit tregtar dhe e mashtrimit me çmime, Pejgamberi a.s. ka ndaluar shitjen e artikujve para arritjes në treg,³ meqë në këtë mënyrë mbrohet çmimi i realtë sipas kërimit e ofertës së vërtetë, sepse ndodh që pronari i artikujve të mos i dijë çmimet e realta në treg. Në këtë mënyrë, Pejgamberi a.s. i ofron mundësi zgjedhjeje kur të hyjë në treg.⁴

¹ Transmetim i Buhariut, Ahmedit, Ebu Davudit, Hakimit dhe i të tjerëve.

² Transmetim unanim.

³ Transmetim i Muslimit, Ahmedit dhe Ibën Maxhes.

⁴ Transmetim i Muslimit.

Kush na mashtron, s'është prej nesh

Islami i ndalon të gjitha format e mashtrimit në çdo shitblerje dhe në çdo transaksion midis njerëzve. Muslimani obligohet të jetë i sinqertë në të gjitha çështjet (e fitimit).

Këshillimi në fe është më i vlefshëm se çdo profit në këtë botë. Pejgamberi a.s. thotë:

“Të dy palët e transaksionit tregtar kanë të drejtë ta anulojnë atë (transaksionin) përderisa ende nuk janë ndarë. Në qoftë se flasin të vërtetën dhe janë të sinqertë, do të jenë të bekuar në transaksionin e tyre, e në qoftë se mashtrojnë dhe gënjejnë, atëherë bekimi do të zhduket?”¹

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

“Nuk lejohet shitja e artikullit pa e treguar cilësinë e tij. Gjithashtu është haram për ndokënd që di diçka (rreth cilësisë së artikullit) e nuk flet”².

Njëherë, kur ka kaluar Pejgamberi a.s. afër një tregtari me drith, i ka pëlqyer drithi, e ka futur dorën në të dhe e ka parë se në brendi drithi është i lagët. Kur e ka pyetur tregtarin se ç'është ajo lagështi, ai i ka thënë se është nga shiu. Në atë rast, Pejgamberi a.s. i ka

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Hakimit dhe i Bejhakiut.

thënë: *“Pse nuk e nxjerr përsipër që ta shohin njerëzit?! Kush na mashtron, s’është prej nesh!”*¹

Sipas një transmetimi tjetër,

Pejgamberi a.s. ka kaluar afër një kapice me drith, të cilën shitësi e kishte rregulluar shumë bukur, e ka futur dorën në të dhe ka parë se kokrrat e brendshme ishin të këqija, dhe në atë rast i ka thënë: *“Këtë shite me këtë çmim e atë me këtë çmim (shite të ndarë). Kush na mashtron, s’është prej nesh!”*²

Kështu vepronin edhe të parët e muslimanëve, tregonin cilësinë e mallit pa fshehur gjë, tregonin të vërtetën dhe nuk mashtronin, ishin të sinqertë e jo gënjeshtarë!

Kur Ibn Sirini shiti një dele, i tha blerësit: “Lejon të të tregoj një mangësi të saj; e gjuan ushqimin me këmbë”.

Kur Hasan ibn Salihi shiti një skllave, i tha blerësit: “Një herë tek ne ka pështyer gjak!” Edhe pse kjo ka ndodhur vetëm një herë, ndërgjegjja e besimtarit e ka detyruar ta potencojë, edhe pse ka humbur në çmim.

Betimi i shpeshtë

Harami është edhe më i madh atëherë kur mashtrimi përforcohet me betim të rrejshëm. Pejgamberi a.s. në përgjithësi e ka ndaluar betimin e shpeshtë, e në veçanti betimin e rrejshëm. Në këtë kontekst ai thotë:

*“Betimi e shet artikullin por e zhdukë begatinë!”*³

Pejgamberi a.s. e urrente betimin e shpeshtë, ngase në këtë mënyrë nxitet dyshimi i të dy palëve dhe zhduket madhërimi i emrit të Zotit nga zemra.

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Ahmedit.

³ Transmetim i Buhariut.

Mashtrimi në matje e peshim

Edhe fshehja në matje e peshim është një formë prej formave të mashtrimit. Kur'ani përqëndrohet në këtë aspekt të transaksionit tregtar dhe e konsideron si një prej dhjetë obligimeve të përsëhruara në fund të sures "En'âm":

"Zbatoni me drejtësi masën dhe peshojën. Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij:" (El-En'âm, 152).

"Masën mbushne kur matni dhe peshoni me peshojë të drejtë". (Isrâ, 35).

"Të mjerët ata që mangut masin e peshojnë. Ata që kur masin prej njerëzve, për vete e plotësojnë, e kur u masin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangut. A nuk e dinë të tillët se kanë për t'u ringjallur? Në një Ditë të madhe. Në Ditën kur njerëzit ngrihen për të dalë para Zotit të botëve". (Mutaffifin, 1-6).

Meqë drejtësia absolute është vështirë të paramendohet, atëherë muslimani obligohet të jetë i drejtë aq sa ka mundësi: "*Ne obligojmë shpirtin aq sa ka mundësi!*"

Kur'ani na rrëfen për një popull që ka vepruar në mënyrë të padrejtë në tregti, që ka mashtruar në matje e peshim dhe që ka qenë mizor ndaj njerëzve. Duke i marrë parasysh të gjitha këto, Zoti dërgoi pejgamber për t'i udhëzuar në rrugë të drejtë e të sinqertë dhe në monoteizëm. Ky popull ka qenë populli i Shuajbit. Zoti u drejtohet si qortues e predikues:

"Plotësoni matjen, e mos u bëni prej atyre që lënë mangut! Dhe matni me peshojë (kandar) të saktë (preciz). Dhe mos i lini mangut sendet e njerëzve, e mos bëni shkatërime në tokë". (Esh-Shuarâ, 181-183).

Kjo marrëdhënie korrekte duhet të jetë shëmbëlltyrë e jetës, e marrëdhënieve dhe e transaksioneve të muslimanit, pra ai nuk duhet të masë me dy standarde, një për vete e një për të tjerët, gjegjësisht, një për vete dhe për ata që i do dhe një për njerëzit në përgjithësi; në standardin e vet dhe të ithtarëve të vet është preciz dhe tepron kurse në standardin e të tjerëve fsheh dhe pakëson.

Ndalohet blerja e gjërave të vjedhura

Një prej formave të cilat i ndalon Islami për ta luftuar krimin dhe për ta ngushtuar rrethin e kriminelit, është edhe ndalimi për musli-

manin që të blejë diçka që e di se është e vjedhur, e marrur me dhunë, ose pa të drejtë. Në qoftë se blen diçka të tillë, atëherë i ndihmon dhunuesit, vjedhësit dhe uzurpuesit në dhunë, vjedhje e uzurpim.

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Kush blen diçka të vjedhur dhe e di se është e vjedhur, barazohet në mëkat dhe në turp”.*¹

Mëkatin nuk e fshinë kalimi i kohës së gjatë nga vjedhja ose uzurpimi, ngase, sipas sheriatit islam, koha e gjatë nuk e shndërron haramin në hallall dhe nuk e zhduk të drejtën e pronarit të vërtetë, ashtu siç lejohet me disa ligje pozitive.

Ndalimi i kamatës

Islami lejon rritjen e kapitalit me anë të tregtisë:

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete”. (Nisâ, 29).

(Islami) i lavdëron ata që udhëtojnë nëpër tokë për të bërë tregti:

“Dhe të tjerët që gjallërojnë nëpër tokë duke kërkuar nga begatitë e All-llahut”. (Muzemmil, 20).

Islami ndalon çdo mënyrë të rritjes së pasurisë nëpërmjet kamatës, qoftë me pakicë ose me shumicë. Ai i qorton hebrenjtë, të cilët edhe pse e kishin të ndaluar, përsëri merrnin kamatë. Në mesin e shpalljeve të fundit të ajeteve kur'anore, janë edhe ajetet vijuese të sures “Bekare”:

“O ju që besuat, kini frikë All-llahun dhe nëse jeni besimtarë të singertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me All-llahun dhe Të dërguarin e Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takojnë kokat e mallit tuaj, askë nuk e dëmtoni, as vetë nuk dëmtoheni”. (El-Bekare, 278-279).

¹ Transmetim i Bejhakiut.

Pejgamberi a.s. në mënyrë të hapur i shpallte luftë kamatës dhe atyre që merrnin kamatë duke e treguar rrezikun që i kanosej shoqërisë:

*“Kur të përhapen kamata dhe kurvëria në një shoqëri, vetë e lejoj-në dënimin nga Zoti”.*¹

Islami nuk ishte i pari që ndaloi kamatën, por të njëjtin qëndrim e kishin edhe fetë tjera qiellore si p.sh. në Hebraizëm, kryesisht në Dhiatën e vjetër thuhet: “Nëse varfërohet vëllai yt, ndihmoi dhe mos fito prej tij as profit e as dobi” (verseti 24, kapitulli 22, Dalja). Gjithashtu edhe Krishterimi e ndalon. Në këtë kontekst, në Ungjillin e Lukës thuhet: “Bëni të mira; atij që i jepni, mos pritni t’ua kthejë...” (Luka, 6:30).

Për fat të keq, në Dhiatën e vjetër janë bërë disa falsifikime dhe termi i lartpërmendur “vëllai yt”, ka të bëjë vetëm me hebreun. Në Deuteronominë thuhet: “Të huajit jepi me kamatë por vëllait tënd mos i jep me kamatë!” (Deut. 23-20).

Urtësia e ndalimit të kamatës

Me ndalimin e kamatës Islami mbron interesin njerëzor, moralin, shoqërinë dhe ekonominë në përgjithësi.

Dijetarët islamë i kanë analizuar arsyet dhe urtësinë e ndalimit të kamatës me argumente të shëndosha, të cilat edhe zbulimet e reja shkencore i kanë konfirmuar, bile edhe kanë shtuar mendime të reja. Mjafton të cekim vetëm mendimet e Raziut në tefsirin e tij.

1. Kamata nënkupton marrjen e pasurisë së njeriut pa këmbim. Ai që shet një derhem për dy, fiton një derhem ekstra. Pasuria e njeriut vlen për t’i përmbushur nevojat e tij dhe ka shenjtëri të madhe. Në këtë kontekst, hadithi i Pejgamberit a.s. thotë:

*“Pasuria e njeriut është e shenjtë ashtu siç është gjaku i tij”.*² Kështu, marrja e pasurisë pa kompensim është haram.

¹ Transmetim i Hakimit dhe Ebu Ja’lasë me sened të mirë.

² Transmetim i Ebu Ne’îmit në librin e tij *El-Hilje*.

2. Mbështetja në kamatë i largon njerëzit nga puna, ngase pronari i derhemit fiton një derhem ekstra nëpërmjet kamatës, qoftë para ose pas kohës së caktuar, edhe atë pa punuar fare.

Vlera e punës në mënyrë konsekuente do të jetë në favor të tij, dhe nuk do të ketë problem në udhëheqjen e biznesit ose në rrezikimin e financave të tij në tregti ose në industri. Kështu njerëzit do të largohen nga dobitë. Biznesi në botë nuk mund të vazhdojë pa industri, tregti, ekonomi, ndërtim e projektim. Në të gjitha këto ka rrezikim të kapitalit. (Nga aspekti ekonomik, ky është një argument i padyshimtë).

3. Lejimi i kamatës i dekurajon njerëzit t'i bëjnë mirë njëri-tjetrit ashtu siç kërkon Islami. Nëse kamata ndalohet në një shoqëri, njerëzit do t'i huazojnë njëri-tjetrit me plot dëshirë pa prituri më shumë se ajo e huazuara, e nëse kamata lejohet, personi që ka nevojë do të obligohet të kthejë edhe më tepër, dhe në këtë mënyrë dobësohen ndjenjat për mirëbërje dhe miqësi ndaj huazuesit me kamatë. (Ky është aspekti moral i ndalimit të kamatës).

4. Në shumë raste, marrësi i kamatës është i pasur kurse ai që merr hua me kamatë, i varfër. Nëse lejohet kamata, i pasuri do ta eksploatojë të varfërin, gjë që kundërshton shpirtin e mirësisë dhe të mirëbërjes. (Ky është aspekti social i ndalimit të kamatës.)¹

Pra, kamata nënkupton shtrydhjen e të dobët në favor të të fortit, e si rezultat përfundimtar, i pasuri bëhet më i pasur kurse i varfëri edhe më i varfër. Në këtë mënyrë krijohen dallime të mëdha ndërmjet klasave socio-ekonomike në shoqëri. Natyrisht, e tërë kjo krijon te të varfërit urrejtje ndaj të pasurve, shkakton mosdurimin ndaj njëri-tjetrit dhe rezulton me revolucione ekstreme dhe parime shkatërruese.

Historia dëshmon se kamata dhe marrësit e kamatës rrezikojnë politikën, shtetin, sigurimin lokal dhe ndërkombëtar.

Dhënësi me kamatë dhe evidentuesi

S'ka dyshim se Zoti dhe njerëzit mallkojnë marrësin e kamatës, i cili jep hua një shumë me kusht që t'i kthehet me një shumë më të madhe. Islami nuk e përkufizon krimin vetëm me marrësin e kamatës, por, siç e ka traditë, edhe me marrësin e kamatës, me evidentuesin dhe me dy dëshmitarët. Në një hadith të Pejgamberit thuhet:

¹ Tefsiri i Fahrudin Raziut, vëll. 7, f. 4 botim i Abdurrahman Muhammedit.

*“Zoti e mallkon marrësin e kamatës, atë që e paguan, evidentuesin dhe dy dëshmitarët”.*¹

Në qoftë se ndokush është i obliguar të marrë hua me kamatë, atëherë mëkatar është vetëm ai që huazon me kamatë:

1. Këtu kushtëzohet nevoja e vërtetë, e jo vetëm qëllimi për diçka më luksoze. Nevoja duhet të jetë aq e domosdoshme saqë pa të mund të shkatërrohet, si p.sh. ushqimi, veshmbathja dhe ilaçet.

2. Lejimi vlen aq sa ka nevojë, p.sh. në qoftë se mjaftojnë nëntëqind denarë, nuk lejohet të merren një mijë denarë hua.

3. Njeriu duhet të orvatet maksimalisht që të largohet nga kriza materiale nëpërmjet metodave tjera, e vëllezërit muslimanë obligohen që t’i ndihmojnë. Nëse nuk ka kurrfarë mundësie tjetër, atëherë të marrë pa e tepruar dhe pa e kapërcyer nevojën. Zoti mëshiron dhe falë!

4. Nëse vepron kështu, atëherë le (të mos kënaqet) por ta urrejë (mënyrën e tillë) derisa Zoti t’i sigurojë ndonjë rrugëdalje.

Pejgamberi a.s. mbështetet në mbrojtjen e Zotit nga borxhi

Muslimani duhet të dijë se parimet e fesë së tij e obligojnë të jetë i matur në jetë dhe ekonomist në aspektin financiar.

“Mos teproni, Ai nuk i do tepruesit”. (En’namë, 141)

“Mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër janë vëllezër të djajve”. (Isrâ, 26-27).

Kur’ani kërkon prej besimtarëve të shpenzojnë në rrugë të Zotit, mirëpo nuk i obligon të japin tërë pasurinë e tyre por vetëm diçka prej saj. Ai që jep pak, nuk varfërohet. Kjo maturi dhe modesti e mbron muslimanin nga borxhi posaçërisht kur dihet se Pejgamberi a.s. nuk dëshironte që muslimani të hyjë në borxh, ngase borxhi e mundon natën dhe e nënçmon ditën.

Pejgamberi a.s. mbështetej në mbrojtjen e Zotit nga borxhi dhe i lutej:

¹ Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit, Tirmidhiut, Nesaiut dhe Ibën Maxhes.

*“O Zot, mbështetem në mbrojtjen tënde nga pesha e borxhit dhe nga zemërimi i njerëzve”.*¹

Ai përsëri thotë:

“Kërkoj mbrojtjen e Zotit nga kufri dhe borxhi”. Në atë rast, një njeri i thotë: “O i dërguari i Zotit, a e krahason kufrin me borxhin?” Pejgamberi i përgjigjet: *“Po!”*²

Kur falte namaz shpeshherë thoshte:

“O Zoti ynë, kërkoj mbrojtjen Tënde nga mëkati e borxhi”. Kur e pyetën pse kërkon shpeshherë mbrojtjen e Zotit nga borxhi, ai përgjigjet: *“Ai që ka borxh, gënjen dhe i then premtimet”*³

Nga këto hadithe kuptojmë se borxhi mund të rrezikojë moralin e njeriut.

Ai nuk e falte namazin e xhenazes nëse i vdekuri nuk i kishte pastruar borxhet. Ai i frikësonte njerëzit me qëllim që të mos e përjetonin fundin e tillë. Kur e pasuroi Zoti me plaçkat e luftës, ai vet i paguante borxhet (e të tjerëve).⁴

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Shehidit i falet çdo gjë përveç borxhit”.*⁵

Në bazë të këtyre udhëzimeve, muslimani hyn në borxh vetëm kur ka nevojë të madhe, dhe kur hyn në borxh gjithmonë mendon ta kthejë.

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Nesaiut dhe Hakimit.

³ Transmetim i Buhariut.

⁴ Transmetim i Xhabirit dhe Ebu Hurejres.

⁵ Transmetim i Muslimit.

Në një hadith tjetër thuhet:

*“Kush merr borxh prej njerëzve dhe dëshiron t’ua kthejë, Zoti do t’i ndihmojë ta kthejë, e kush merr borxh dhe nuk ka për qëllim ta kthejë, Zoti do ta shkatërrojë”.*¹

Meqë muslimani merr borxh vetëm në raste të nevojës së domosdoshme, atëherë ç’mund të thuhet për huanë me kamatë?

Shitja me pagesë të shtyrë (kredi)

Muslimanit i lejohet shitblerja me para të gatshme ose me pagesë të shtyer sipas marrëveshjes së ndërsjellë. Pejgamberi a.s. ka blerë ushqim prej një hebreu me kusht që t’i paguajë pas një kohe të caktuar, dhe si garanci e kishte lënë mburojën e vet.²

Në qoftë se shitësi kërkon çmim më të lartë për shkak të shtyerjes (kështu veprojnë shumica e tregtarëve që shesin me këste), vërejmë se disa juristë e ndalojnë këtë lloj tregtie ngase e krahasojnë me kamatën, kurse shumica e dijetarëve e lejojnë ngase në esencë është e lejuar pa tekst ndalimi, kështu që nuk mund të krahasohet me kamatën. Shitësi e rrit çmimin për arsye që ka, përderisa nuk bën eksplotim të hapur e tirani të hapur, dhe në këtë mënyrë bëhet haram.

Shevkani thotë: “Në bazë të arsyeve legale, ithtarët e shkollave shafi’ite e hanefite, Zejd ibn Aliu, Muejjid Bil-lah dhe pjesa dërrmuese e fukahave e konsiderojnë të lejuar”.³

Parapagimi

Muslimanit i lejohet të parapaguajë një çmim specifik për një sasi të caktuar të artikujve, me qëllim që të pranojë sasinë në kontratë pas një kohe të fiksuar. Kjo në fikhun islam njihet me termin: “*Es-selem*”. Ky lloj transaksioni ishte i njohur në Medinë, dhe kur erdhi Pejgamberi a.s. bëri disa ndryshime e vendosi kushte të reja që të

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Buhariut.

³ *Nilul evtâr*, vëll. 5, f. 153.

përputhen me rregullat e transaksionit sipas sheriatit. Ibn Abbasi thotë: “Kur shkoj Pejgamberi a.s. në Medine, i pa se parapaguanin për frytet një ose dy vjet më parë, dhe u tha:

“Kush parapaguan, atëherë le të paguajë për masë e peshë të caktuar me kohë të caktuar”.¹

Caktimi i tillë i matjes, peshës dhe kohës, eliminon konfliktin dhe mosmarrëveshjen. Ata si zakonisht parapaguanin frytet e palmave, mirëpo Pejgamberi a.s. ua ndaloj për shkak të mosmarrëveshjes që mund të shkaktohej nga ndonjë pengesë (natyrore) dhe të mos ketë fare fryte.

Forma më e qëlluar e këtij transaksioni është të mos kushtëzohet fryti i palmës e as gruri i tokës por të kushtëzohet me kilogramë. Në qoftë se eksploatohet pronari i palmave dhe i tokës dhe detyrohet të pranojë një kontratë të tillë, ky transaksion konsiderohet haram.

Partneriteti ndërmjet kapitalit dhe punës

Ndokush mund të thotë se Zoti ua ka shpërndarë talentet dhe pasuritë njerëzve sipas kaderit dhe urtësisë. Shpeshherë shohin se ndonjëri ka talent dhe përvojë por s’ka shumë pasuri ose aspak, përdërisa ndokush tjetër ka shumë pasuri por ka pak përvojë ose aspak. Pra, pronari i pasurisë pse të mos ia japë pasurinë e vet atij që ka talent e përvojë, por me kusht që profitin t’ia kthejë përgjysmë ose sipas marrëveshjes së ndërsjellë? Kështu, i talentuari do të ketë dobi prej pasurisë, e i pasuri prej talentit, posaçërisht kur bëhet fjalë për projekte të mëdha që kanë nevojë për kontributin e shumë investuesve, kur dihet se ka njerëz që kanë pasuri të madhe por s’kanë kohë të lirë e mundësi për investime?

Pse njerëzit e ditur e me përvojë të mos i shfrytëzojnë këto pasuri në projektet e tilla të mëdha?

Ne themi se sheriatu islam nuk e pengon partneritetin e kapitalit me përvojën ose siç thotë fikhu islam, të kapitalit me punën, por me kusht që ky partneritet të mbështetet në parime të drejta dhe në bazë të shëndoshë. Në qoftë se poseduesi i kapitalit dëshiron të bëhet

¹ Transmetim i Buhariut, Muslimit dhe i të tjerëve.

partner me punëtorin, atëherë ai duhet gjithashtu të dakordohet se do t'i ndajë të gjitha fitimet nga ky partneritet.

Sheriati islam në kooperimin e tillë, të cilin fukahatë e quajnë *El-Mudaribe* ose *El-kirâd*, i kushtëzon që të dy palët të marrin pjesë të barabartë në fitim ose në humbje. Sasia e fitimit ose e humbjes caktohet sipas marrëveshjes së ndërsjellë.

Ata duhet të caktojnë që njëri të investojë 1/2, 1/3 ose 1/4, më pak ose më shumë, e tjetri pjesën tjetër.

Kooperimi ndërmjet kapitalit e punës nënkupton kooperimin ndërmjet dy partnerëve që do ta ndajnë profitin e fituar, qoftë i lartë apo i ulët, që do t'i respektojnë kushtet e parapara midis tyre dhe që do ta përfshijnë bashkërisht humbjen. Nga ky harmonizim i punëve nuk duhet të habitemi ngase pronari i kapitalit humb kapitalin e vet kurse partneri i punës, kohën dhe mundin.

I tillë është ligji islam për këtë partneritet.

Në anën tjetër, në qoftë se pronarit të kapitalit i garantohet ndonjë profit i fiksuar, pa marrë parasysh nivelin e profitit ose të humbjes, do të jetë padrejtësi e dukshme dhe anim në favor të kapitalit kundër përvojës dhe punës së investuar. Kjo është gjithashtu edhe kundër realitetit të investimit, i cili gjithmonë i përmban elementet e rrezikut. Në këtë mënyrë inkurajohet dëshira për profit të garantuar pa punë e rrezik, gjë që nënkupton paraqitjen e kamatës.

Pejgamberi a.s. e ka ndaluar partneritetin në tokën e kultivuar,¹ në të cilin kontrata i jep njërit partner prodhimin e tokës së caktuar ose sasi të fiksuar drithi, si p.sh. një ose dy tonë. Ai e ka ndaluar këtë ngase transaksioni i tillë i ngjan bixhozit. Në qoftë se toka prodhon diçka ose asgjë, në këtë rast njëri prej partnerëve do të marrë pjesën e tij, kurse tjetri krejtësisht do të humbë, gjë që kundërshton të drejtën.

Involvimi i ndarjes së tillë të *muzare'as*² në bazë të kushtit nga hadithi i lartpërmendur, sipas mendimit tim është bazë e konsensusit të fukahave, se asnjë partneritet nuk vlen në qoftë se fiksohet profiti i njërit partner, pa marrë parasysh se investimi është profitabil apo jo. Ata thonë:

¹ Transmetim i Muslimit.

² Shiko më gjerësisht transmetimin e mendimit të shejh Muhamed Abduhut dhe shejh Abdulvehhab Hallafit, nga dr. Muhamed Jûsuf Musa në traktatin *El-islamu ve mushkilâtunel-hâdire*. Këta dy nuk dakordohen me fukahatë rreth kontratave të partneritetit, duke thënë se s'kanë baza nga Kur'ani e as nga Sunneti. Unë mendoj se analogjia për *muzare'an* vlen edhe për partneritetet tjera. Zoti e di!

“Nëse njëri prej dy partnerëve e kushtëzon profitin edhe nëse humb, ai do të marrë aq sa ka kushtëzuar, e nëse profiti është i madh, atëherë ai përsëri do ta marrë shumën e fiksuar dhe kështu do të dëmtohet nga kushti i paraparë”.

Kjo analizë përputhet me frymën e Islamit, i cili të gjitha ofertat e njerëzve i bazon në drejtësinë e urtë e të qartë.

Partneriteti i pronarëve të kapitalit

Ashtu siç i lejohet muslimanit ta përdorë pasurinë e vet për ndonjë qëllim të lejuar ose t’ia japë ndonjë personi të aftë e me përvojë që ta investojë në rrezik të përbashkët, gjithashtu i lejohet të hyjë në partneritet me pronarë të tjerë të kapitalit në investimet industriale, tregtare etj.

Ka aktivitete dhe projekte që kanë nevojë për më shumë se një mendje, një dorë e një kapital. Individit kurrë nuk mund ta arrijë vet suksesin që e korrë me shoqëri të përbashkët. Zoti i Madhëruar thotë: “*Ndihmoni në mirësi e devotshmëri*”. Çdo gjë që është në favor të individit e shoqërisë dhe mënjanon të keqen, është mirësi e devotshmëri por me kusht që qëllimi të jetë i mirë.

Islami jo vetëm që lejon partneritetin e tillë, por e bekon dhe premton ndihmën e Zotit në këtë botë e në botën tjetër. Kështu kushtëzohet që partneriteti të jetë brenda sferës së hallallit nga Zoti dhe të mos ketë lidhje me kamatën, mosmarrëveshjen, tiraninë, dëmtimin dhe tradhtinë. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

يَدُ اللَّهِ عَلَى الشَّرِيكَيْنِ مَا لَمْ يَخُنْ أَحَدُهُمَا صَاحِبَهُ،
فَإِذَا خَانَ أَحَدُهُمَا صَاحِبَهُ رَفَعَهَا عَنْهُمَا.

“Dora e Zotit është mbi dy partnerët përderisa nuk mashtrojnë njëri-tjetrin, e kur të fillojnë ta mashtrojnë njëri-tjetrin e heq prej të dyve”.¹

Dora e Zotit këtu nënkupton ndihmën, inspirimin dhe bekimin e Tij. Në një hadith kudsî, Pejgamberi a.s. transmeton se Zoti thotë:

¹ Transmetim i Darikutnit.

“Unë jam i treti mes dy partnerëve përderisa nuk tradhtojnë njëri-tjetrin, e kur të fillojnë mashtrimin e njëri-tjetrit, Unë largohem,¹ dhe vjen djalli”.²

Kompanitë e sigurimit

Një prej formave të reja bashkëkohore është ajo e kompanive të sigurimit, të cilat ofrojnë sigurim të jetës dhe sigurim nga fatkeqësitë! Shtrohet pyetja se çfarë qëndrimi ka Islami ndaj kompanive të tilla dhe a i pranon?

Para se t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje, dëshiroj të pyes për natyrën e këtyre kompanive dhe për relacionin ndërmjet të siguruarit dhe kompanisë së sigurimit. Më konkretisht, a është personi i siguruar partner i pronarëve të institucionit për sigurim?

Në qoftë se është partner, atëherë secili individ i siguruar duhet të jetë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në profit ose humbje, sipas rregullave të Islamit.

Në sigurimin nga fatkeqësitë e ndryshme, i siguruari paguan një sasi të hollash në vit. Nëse objekti i siguruar mbrohet (qoftë shitore, fabrikë, anije ose diçka tjetër), atëherë kompania e merr tërë sasinë pa kthyer gjë, e në qoftë se ndodh ndonjë katastrofë, atëherë jep kompensimin sipas marrëveshjes së paraparë, dhe kështu kjo formë është shumë larg natyrës së tregtisë dhe partneritetit.

Në qoftë se ndokush paguan 2000 dollarë (ose ndonjë valutë tjetër) për sigurimin e jetës dhe vdes pas pagesës së premisë së parë, atëherë i takon shuma e plotë prej 2000 dollarësh, e në qoftë se është partner tregtie, atëherë i takojnë vetëm premia dhe profiti.

Nëse i siguruari mund të paguajë vetëm disa premi dhe s’ka mundësi të vazhdojë pagesën e të gjitha premive, atëherë do të humbë një shumë të madhe ose tërë premiet e paguara.

(Sipas Islamit), këtu mund të thuhet vetëm se kushti është jovalid.

Nuk pranohet arsyeja se të dy palët (i siguruari dhe kompania) kanë bërë kontratën me pëlqim të ndërsjellë dhe me vetëdije të plotë, ngase edhe huazuesi e huamarrësi me kamatë bëjnë marrëveshje të ndërsjellë ashtu siç veprojnë dhe dy bixhozxitë mirëpo marrëveshja e ndërsjellë e tyre nuk është valide. Kontrata është valide nëse mbështetet në drejtësinë e qartë, nëse nuk bie nën ndikimin e

¹ Transmetim i Ebu Davudit dhe i Hakimit, i cili e konsideron sahih.

² Këtë shtojcë e ka theksuar Rezîni në veprën e tij *El-Xhami ’u*.

mosmarrëveshjes dhe eksploatimit dhe nëse nuk siguron profitin e vetëm një pale.

Pra, drejtësia është bazë e parimit: “As veten mos e dëmto e as të tjerët!”

A janë kompanitë e tilla kooperuese

Pasi që lidhja midis të sigurvearit dhe kompanisë nuk është lidhje midis dy partnerëve, atëherë çfarë natyre ka lidhja e tillë! A është lidhje kooperuese? Këto asociacione pra, janë institucione kooperuese që i ndihmojnë bashkëpronarëve që kanë dhënë kontribut vullnetar financiar me qëllim që të ndihmojnë njëritjetrit?!

Për të patur kooperim të shëndoshë ndërmjet çfarëdo shoqërie për t’i ndihmuar anëtarit të vet në rast fatkeqësie, duhet të ekzistojnë kushtet vijuese që të grumbullohen kontributet:

1. Të paguajë shumën e obliguar si kontribut vullnetar nga respekti vëllazëror, dhe nga kjo premi e grumbulluar të ndihmohen ata që kanë nevojë.

2. Kjo pasuri e grumbulluar mund të shfrytëzohet vetëm me metoda ligjore.

3. Nuk i lejohet individit të kontribuojë diçka me qëllim që të marrë kompensim me një shumë të caktuar në rast aksidenti, por t’i jepet nga pasuria e shoqërisë aq sa t’i kompensohet humbja ose një pjesë e saj, varësisht nga mundësitë që i ofron shoqëria.

4. Kontributi konsiderohet dhuratë dhe kthimi i tij ndalohej.¹

Këto kushte aplikohen në disa institucione e kooperativa tona, ku individë paguan anëtarësi mujore në formë kontributi pa rikthim dhe pa kushtëzime, që në rast fatkeqësie të fitojë ndonjë kompensim financiar të caktuar.

Këto kushte aspak nuk aplikohen në kompanitë e sigurimit, posaçërisht në sigurimin e jetës.

1. Të sigurvearit nuk paguajnë me qëllim të kontributit vullnetar.

2. Kompanitë e sigurimit i investojnë të hollat në biznesin që punon me kamatë. Muslimanit i ndalohej pjesëmarrja në aktivitete të tilla, dhe të këtij mendimi janë të gjithë fukahatë ekstremë e liberalë.

¹ Prof. Muhammed Gazali, *El-Islamu vel-menâhixhul-ishtirâkijje*, f. 131, bot. II.

3. I siguruari merr prej kompanisë (kur të përfundojë periudha e kontratës) premittë e paguara me profit të tepërt. A nuk është kjo kamatë e pastër?!

Përveç kësaj, sigurimi kundërshton tërë konceptin e kooperimit mes popullit. Parimi i kooperimit nënkupton faktin se i varfëri dhe ai që ka nevojë duhet të paguhet më tepër se i pasuri. I pasuri, i cili paguan premi më të larta, merr më shumë në raste të vdekjes ose të aksidentit se i varfëri.

4. Kush dëshiron ta ripërtërijë kontratën, humb një pjesë të madhe të saj, gjë që sipas Islamit nuk pranohet.¹

Modifikimet

Unë mendoj se kontrata e sigurimit kundër fatkeqësive mund të modifikohet dhe të bëhet më afër parimeve islame, gjegjësisht më afër kontratës së ashtuquajtur “Donacion me kushtëzim kompensimi”. I siguruari i paguan kompanisë me kusht që ajo t’ia kompensojë në rast fatkeqësie me një shumë që do t’ia plotësojë nevojat nga humbja. Disa shkolla juridike islame lejojnë llojin e tillë të transaksionit. Në qoftë se ky modifikim pranohet dhe në qoftë se kompania nuk bën biznes me kamatë, atëherë sigurimi nga aksidentet mund të lejohet.

Sa i përket sigurimit të jetës, mendoj se është shumë larg transaksioneve të biznesit islam.

Sistemi islam i sigurimit

Nëse Islami kundërshton mënyrat dhe metodat e veprimeve aktuale të kompanive për sigurim, kjo nuk do të thotë se e refuzon edhe vetë konceptin e sigurimit. Ai refuzon metodën dhe mjetin, por në qoftë se përgatiten forma të reja që nuk kundërshtojnë transaksionet e biznesit islam, atëherë Islami i shpreh mirëpranim.

Sidoqoftë, sistemi islam i siguron muslimanët dhe jomuslimanët që jetojnë në shtetin islam në mënyra të veta të posaçme ose nëpërmjet

¹ Rreth sigurimit më gjerësisht shiko: Dr. Jûsuf Musa, *El-Islamu ve mushkilâtunâ-el-hâdire*, f. 64; Muhammed Gazali, *El-Islamu vel-menâhixhul -ishtirâkijje*, f. 129; dy punime në revistën *Nûrul-Islami* nga merhumi shejh Ibrâhim Xhebâli VI/VII 1349/h, dhe fetvanë e shejh Ahmed Ibrâhimit në revistën *Minberul Islam*.

ndihmës së ndërsjellë midis anëtarëve të shoqërisë apo nëpërmjet qeverisë dhe *bejtul-malit*.

Bejtul-mali është institucion i sigurimit të përgjithshëm për secilin që jeton nën hijen e shtetit islam.

Sheriati islam gjithashtu i siguron individët në raste të fatkeqësive të ndryshme dhe u ndihmon që t'u bëjnë ballë katastrofave që i përjetojnë. Theksuam më parë se individit që përjeton katastrofë (ose fatkeqësi), i lejohet të kërkojë prej autoritetit administrativ (qeverisë) që t'i ndihmohet me kompensim për t'ia lehtësuar gjendjen krejtësisht ose pjesërisht.¹

Kur Pejgamberi a.s. flet për sigurimin e trashëgimtarëve pas vdekjes, thotë:

“Unë jam më afër muslimanit se vetja e tij. Në qoftë se le pasuri pas vete, ajo u takon trashëgimtarëve, e në qoftë se le pas vete borxh ose familje me fëmijë të vegjël, atëherë unë përgjigjem për ta”.²

(Kjo nënkupton përgjegjësinë e qeverisë islame.)

Forma më e madhëruar e sheriatit islam për sigurimin e ithtarëve të vet është ndarja e zekatit atyre që kanë borxh e që i përkasin kategorisë *gârimîn* (njerëz në borxh). Sipas disa komentuesve nga selefi, termi *gârim* nënkupton atë që i është djegur shtëpia, që i është shkatërruar pasuria ose tregtia nga ndonjë katastrofë...

Disa fukaha lejojnë që njerëzve të tillë t'u ndalohet zekati për t'i rikthyer në gjendjen e mëparshme, pa marrë parasysh se sa është shuma e duhur.

Shfrytëzimi i tokës së kultivuar

Në qoftë se muslimani posedon tokë të kultivuar, atëherë obligohet ta punojë e ta mbjell. Islami urren lënien e tokës pasdore ngase në

¹ Shiko hadithin e transmetuar nga Kubejse në kreun e *Përtacisë dhe punës* të këtij libri.

² Transmetim unanim.

këtë mënyrë shkatërrohen begatitë dhe humb pasuria. Pejgamberi a.s. ndalon humbjen e pasurisë.

Në këtë çështje, poseduesi i tokës ka disa obcione:

1. Vetë ta mbjellë e të kujdeset deri në pjekjen e fryteve. Kjo mënyrë është e lavdëruar dhe meriton shpërblimin e Zotit për dobinë që e fiton njeriu, shpeza ose kafsha nga kultivimi i tokës. Pjesa dërrmuese e sahabëve të Pejgamberit a.s, gjegjësisht ensarët, vetë e mbillnin tokën.

2. Në qoftë se vetë pronari nuk mund ta punojë, atëherë ia jep me qira atij që ka mundësi ta punojë dhe që ka mjete për punë, ndihmës, farë e kafshë, edhe atë pa marrë kurrfarë kompensimi prej mbjellësit. Këtë formë edhe Islami e obligon. Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Kush posedon tokë, le ta punojë ose le t’ia japë vëllait të vet”.*¹

Xhabiri transmeton se në kohën e Pejgamberit a.s. e kishin patur zakon të mbillnin tokën, dhe si kompensim merrnin atë që kishte mbetur nga drithi ose diç tjetër, dhe se Pejgamberi a.s. kishte thënë:

مَنْ كَانَتْ لَهُ أَرْضٌ فَلْيَزْرِعْهَا أَوْ لِيُحْرِثْهَا أَخَاهُ، وَإِلَّا
فَلْيَدَعْهَا.

*“Kush ka tokë le ta punojë ose le t’ia japë vëllait të vet ta punojë, apo le ta braktisë”.*²

Disa nga dijetarët e parë pranuan formën ekzoterike të hadithit dhe thanë se toka përdoret vetëm në këto dy mënyra: ose ta mbjellë vet ose t’ia japë atij që e mbjell pa kurrfarë kompensimi. Kështu, toka mbetet pronë e pronarit ndërsa fryti i kultivuesit.

Ibn Hazmi transmeton nga një varg transmetuesish se Euza’i ka thënë: “Ata’i, Mekhuli, Muxhahidi dhe Hasan Basriu thonin: “Toka e kultivuar nuk çmohet as me derhemë e as me dinarë. Njeriu duhet ose ta mbjellë ose t’ia japë (atij që e mbjell).”

Abdull-llah ibn Abbasi thotë se në këto hadithe nuk obligohet dhënia e tokës (nuk është vaxhib) por është rekomandim i preferuar (mendub).

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

Buhariu transmeton nga Amir ibn Dinari se ka thënë: “I thashë Tavusit (shoku më i ngushtë i Ibn Abbasit): Pse nuk largohesh nga *muhâbere*,¹ ngase njerëzit mendojnë se Pejgamberi a.s. e ka ndaluar atë?” Tavusi i përgjigjet: “Më i dituri i tyre (Ibn Abbasi) më ka lajmëruar se Pejgamberi a.s. nuk e ka ndaluar, por ka thënë:

“Sikur ndonjëri prej jush t’ia japë (tokën) vëllait të vet, do të ishte më mirë se marrja e shumë s s caktuar prej tij”.²

3. Gjysmëtaria e prodhimit.

Mënyra e tretë është t’ia japë ndonjërit që e punon me veglat e veta kultivuese, me farën e vet dhe me kafshët e veta por me kusht që të përpjesëtohet prodhimi me përqindje. Përqindja mund të jetë 1/2, 1/3, më shumë ose më pak, varësisht nga kontrata. Pronarit të tokës i lejohej t’i ndihmojë kultivuesit me farë, me mjete ose me kafshë. Ky obcion njihet si gjysmëtari.

Në të dy sahihët transmetohet se Pejgamberi a.s. ua ka dhënë hajberianëve tokën për ta punuar e kultivuar, por me kusht që prodhimin ta ndajnë përgjysmë. Këtë hadith e transmetojnë sahabët Ibn Umeri, Ibn Abbasi dhe Xhabir Ibn Abdull-llahu.

Ata që e lejojnë gjysmëtarinë e tillë mbështeten në hadithin e lartpërmendur dhe thonë: “Ky veprim është autentik dhe i njohur. Kështu veproi Pejgamberi a.s. deri në vdekje, pastaj halifët rashi-dinë deri në vdekje e pastaj edhe pasardhësit e tyre. I gjithë Ehl-ul-bejti gjithashtu e praktikonte këtë metodë. Kështu vepruan edhe gratë e Pejgamberit a.s. ...

Si mund ta abrogojë ndokush këtë obcion kur praktikohet në kohën e Pejgamberit a.s., në kohën e halifëve të tij dhe në kohën e sahabëve?! Nëse supozohet se është abroguar gjatë jetës së Pejgamberit a.s., atëherë si u praktikua edhe më tej në kohën e hulefave të tij a.s., kur dihet mirë ngjarja e Hajberit? Pse asnjë transmetues nuk e ka transmetuar abrogimin e tillë e as që ka informuar diç për të?”³

¹ Transmetim i Ahmedit dhe Muslimit, *Muhabere* nënkupton mbjelljen e një pjese të tokës.

² Transmetim i Buhariut.

³ *El-Mugnî*, Ibën Kuddame, vëll. 5, f. 384.

Lloji i ndaluar i veprimtarisë bujqësore

Në kohën e Pejgamberit a.s. ekzistonte një lloj i gjysmëtarisë të cilin e kishin ndaluar sahabët e tij për shkak të ekzistimit të mos-marrëveshjeve e injorancës që shpënin në grindje. Ky lloj gjithashtu kundërshtonte esencën e drejtësisë të cilën e nxiste Islami në të gjitha aspektet.

Pronarët e tokës i kushtëzonin kultivuesit që një pjesë e caktuar e tokës ose një sasi e caktuar nga produkti t'u takojë atyre kurse pjesa tjetër që mbetet ose gjysmëtaria t'u takojë kultivuesve.

Qëndrimi i Pejgamberit a.s. ishte që çdo gjë të ndahet në mënyrë të barabartë. Ai nuk lejonte që ndokush ta marrë prodhimin e tokës kurse tjetri jo. Në qoftë se pjesa e caktuar e tokës nuk prodhon diçka, atëherë pjesën tjetër e merr vetëm njëra palë. Pra, e drejta duhet të mbizotërojë te të dy palët. Në qoftë se prodhimi është i pasur, atëherë të dy fitojnë e nëse jo, atëherë të dy pësojnë. Në këtë mënyrë, efekti shpirtëror i të dyve do të jetë më pozitiv.

Buhariu transmeton se Râfi' Ibn Hadîxhi, ka thënë: "Ne kishim më shumë tokë punuese në Medinë, dhe ndonjëri prej nesh e jepte tokën, kurse një pjesë prej saj e ruante për vete. Ndonjëherë ndonjë katastrofë e përfshinte njërin pjesë kurse tjetrën jo, e ndonjëherë ndodhte e kundërta. Pejgamberi a.s. na ndaloj nga ky veprim!"

Edhe Muslimi transmeton se Râfi' Ibn Hadîxhe ka thënë: "Njerëzit e jepnin tokën në kohën e Pejgamberit a.s. dhe si kompensim merrnin atë që rritej në rrëkeza, në mexhe ose diçka nga të mbjellat, dhe ndodhte që njëra pjesë të shkatërrohej e tjetra jo dhe anasjelltas, e njerëzit kishin vetëm investimet e tilla. Për këtë shkak, Pejgamberi a.s. e ndaloj praktikën e tillë."

Gjithashtu Buhariu transmeton nga ai se Pejgamberi a.s. ka pyetur:

"Ç'bëni me tokën tuaj të kultivuar?" Ata i janë përgjigjur: "E japim me kompensim prej 1/4 nga prodhimi ose prej sasisë së caktuar nga elbi e hurma." Në atë rast, Pejgamberi a.s. u ka thënë: *"Mos veproni ashtu!"*

Kjo nënkupton se pronarët merrnin sasi të caktuar për çdo person (ose siç thuhet: për çdo kokë), kurse pjesën tjetër e ndanin me kultivuesit p.sh. në 1/4 ose në 3/4.

Këtu vërejmë se Pejgamberi a.s. kishte kujdes ndaj realizimit të drejtësisë së përgjithshme në shoqërinë e tij dhe ndaj mënjanim të të gjithë faktorëve që mund të shkaktonin grindje e armiqësi në shoqërinë e besimtarëve.

Zejd Ibn Thabiti transmeton se dy njerëz të kacafytur për shkak të tokës, kanë shkuar te Pejgamberi a.s., e ai u ka thënë:

“Nëse kështu ndodh me ju, atëherë mos i jepni fushat tuaja!”¹

Pronari i tokës dhe punëtori janë të obliguar që të jenë zemërgjerë ndaj njëri-tjetrit dhe të mos e teprojë asnjëri. Nga Ibn Abbasi transmetohet se Pejgamberi a.s.

nuk e ka ndaluar gjysmëtarinë por ka urdhëruar që të ketë respekt të ndërsjellë midis pronarit e punëtorit.²

Kur kanë kërkuar prej Tâvûsit të largohet nga gjysmëtaria ngase Pejgamberi e ka ndaluar atë, ai ka thënë:

“Unë ju ndihmoj atyre (kultivuesve) dhe i ushqej!”³

Pra, qëllimi i tij nuk është që vetëm ai të fitojë prej tokës, por edhe t’ju ndihmojë e t’i ushqejë.

E tillë është shoqëria islame!

Ekzistojnë disa pronarë të tokës që e lënë tokën të papunuar ngase askush nuk mund t’ua ofrojë kompensimin që e kërkojnë. Për këtë shkak, Umer Ibn Abdulazizi u dërgon shkresë përgjegjësve në hali-fatën e tij dhe u thotë: “Jepni 1/3, 1/4, 1/5... ose 1/10 e tokës, dhe mos e lini të shkatërruar!”

4. Dhënia e tokës me qira

Obcioni i katërt është që pronari i tokës t’ia japë tokën ndonjë kultivuesi për një shumë të caktuar të hollash (ar ose argjend).

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Transmetim i Tirmidhiut.

³ Transmetim i Ibën Maxhes.

Shumë fukahë të njohur e lejojnë këtë formë kurse disa të tjerë e ndalojnë duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberit a.s. që ndalon dhënien e tokës me qira.

Disa pjesëmarrës të Luftës së Bedrit si Râfi' Ibn Hadîxhi, Xhabiri, Seidi, Ebu Hurejre dhe Ibn Umeri transmetojnë se Pejgamberi a.s. ka ndaluar dhënien e tokës me qira.¹ Nga qiraja e tillë veçohet mënyra e praktikuar nga Pejgamberi a.s. në Hajber dhe nga Hulefai Rashidinët.

Përcjellësi i zhvillimit juridik të kësaj çështjeje do të vërejë se Ibn Hazmi ka thënë: "Sipas transmetimit të Rafiut dhe të tjerëve, kur ka ardhur Pejgamberi a.s. njerëzit e jepnin tokën me qira. Pa dyshim, qiraja ekzistonte para dhe pas dërgimit të Pejgamberit a.s. Në këtë çështje s'mund të dyshojë asnjë i mençur. Pastaj gjithashtu është vërtetuar nga transmetimi i Xhabirit, Ebu Hurejres, Ebu Seidit, Rafiut, pjesëmarrësit në Betejën e Bedrit dhe Ibn Umerit se Pejgamberi a.s. në përgjithësi e ka ndaluar dhënien e tokës me qira. Kështu lejimi është abroguar dhe kush mendon se abrogimi është anuluar (lejimi i qirasë), është gënjeshtar, mashtrues dhe i paditur. Kjo ndalohet me tekst kur'anor, përveç në raste të argumentimit me fakte. Në këtë rast, askush nuk mund të gjejë argumente përveç lejimit të dhënies së 1/3 ose 1/4 nga Pejgamberi a.s. në Hajber pas ndalimit shumëvjeçar. Pejgamberi e ka praktikuar këtë çështje deri në vdekje."²

Një grup i fukahave të hershëm kishte mendim të njëjtë. Tâvûsi, i cili ishte fakih i Jemenit dhe tabi'in i njohur, e urrente dhënien e tokës me qira me ar e argjend, por lejonte 1/3 dhe 1/4. Kur i thanë disa njerëz se Pejgamberi a.s. e ndalonte dhënien e tokës me qira, ai u replikoi: "Kur Muadh Ibn Xhebeli erdhi tek ne (i dërguari i Pejgamberit në Jemen), filloi të japë 1/3 dhe 1/4, dhe ne veprojmë ashtu deri më sot." Me sa duket, ai mendon se ndalohet dhënia e tokës me qira me ar e argjend, kurse gjysmëtaria lejohet.

Transmetohet se Muhammed Ibn Sirini dhe Kasim Ibn Muhammed Ibn Ebu Bekër Es-Siddik lejonin dhënien e 1/3, 1/4 ose 1/10, por ndalonin dhënien me qira.

Nga një grup tjetër i tabi'inëve transmetohet se e ndalonin në përgjithësi dhënien e tokës me qira, qoftë me të holla ose me gjysmë-tari. S'ka dyshim se këtyre mund t'u argumentohet lejimi i gjysmë-

¹ Shiko *El-Muhal-la*, vëll. 8, f. 212.

² *El-Muhal-la*, vëll. 8, f. 224.

tarisë me praktikimin e Pejgamberit a.s., të halifëve të tij dhe të Mu'adhrit në Jemen.

Këtë fakt e ka pranuar edhe legjislacioni praktik i muslimanëve gjatë periudhës së parë, kurse ndalimi i dhënies së tokës me qira financiare argumentohet me argumente tradicionale e racionale.

Analogjia ndalon qiranë me të holla

Rezonimi korrekt analitik i burimeve të Islamit dhe tekstet e qarta e të vërteta ndalojnë dhënien e tokës së kultivuar me qira në të holla.

1. Pejgamberi a.s. ndalon dhënien e tokës me qira, gjegjësisht dhënien e një pjese të saj, si p.sh. 1 ose 2 ha. por lejon 1/2, 1/3, 1/4, me qëllim që të fitohet ose të dështohet bashkërisht.

Fiksimi i fitimit të njëres palë dhe mundësia e humbjes së palës tjetër në prodhim konsiderohet mund e lodhje si dhe radhitet në sferën e kamatës dhe bixhozit.

Nëse mendojmë rreth qirasë në të holla brenda këtij konteksti, atëherë nuk do të gjejmë asnjë dallim mes kësaj forme dhe asaj të ndaluarës? S'ka dyshim se pronari i tokës siguron fitimin e vet me qiranë financiare, kurse ai që e merr me qira luan me fatin e vet, me punën e lodhjen e vet ngase nuk e di se a do të fitojë apo do të humbë si dhe nuk e di se a do të prodhojë toka diçka apo jo.

2. Ai që e jep tokën me qira, meriton shumën e caktuar për arsye se ai ia përgatit atë marrësit me qira, ia mundëson fitimin. Qiraja për pronarin është edhe kompensim i shkatërrimit të mundshëm gradual.

Çfarë përgatitje i ofron pronari marrësit me qira? Zoti e ka përgatitur tokën për kultivim e jo pronari i saj. Pastaj, si mund ta shkatërrojë mbjellja tokën kur dihet se toka nuk hahet dhe nuk priset me mbjellje ashtu siç prishen ndërtesat e makinat nga përdorimi?

3. Përveç kësaj, njeriu jep me qira shtëpinë dhe fiton dobi të drejtpërdrejtë. Kështu ndodh edhe me dhënien e makinave me qira. Nga ana tjetër, fitimi nga toka e marrur me qira nuk është i drejtpërdrejtë dhe i sigurt. Marrësi me qira nuk fiton ashtu siç fiton me shtëpinë, por ai orvatet dhe punon me shpresë se do të fitojë diçka. Atëherë, si mund të krahasohet dhënia e shtëpisë me qira me dhënien e tokës me qira? Pra, kjo analogji nuk është korrekte.

4. Në *Sahih* transmetohet se Pejgamberi a.s. ka ndaluar shitjen e fryteve para se të vërtetohet se a janë të shëndosha apo jo. Në këtë kontekst, ai ka thënë:

“Nëse Zoti pengon frytin, atëherë si do ta lejojë ndonjëri prej jush marrjen e pasurisë së vëllait të vet?!”

Kur kështu ndodh me blerjen e kushtëzuar të fryteve, atëherë ç’ndodh me atë që e jep tokën pjellore të papunuar e të pambjellur? A nuk është më e drejtë që këtij t’i thuhet: “Nëse Zoti pengon frytin, atëherë si do ta lejojë ndonjëri prej jush marrjen e pasurisë së vëllait të vet?”

Unë me sytë e mi i kam parë plantacionet e pambukut të shkatërruara nga krimbat. Pronarët e tokës e kërkonin pagesën e qirasë kurse kultivuesit me qira kontrata i obligonte ta paguajnë. Pra, ku janë këtu drejtësia e solidariteti të cilat i predikon Islami?

Drejtësia realizohet atëherë kur të dy palët fitojnë nga mbjellja ose dështojnë.¹

Ibn Tejmije lejon dhënien me qira, por në anën tjetër mendon se gjysmëtaria përputhet me drejtësinë dhe parimet e sheriatit. Në këtë kontekst ai thotë: “Gjysmëtaria është më e lejuar se dhënia me qira, dhe më afër drejtësisë dhe parimeve të sheriatit, ngase aty fitojnë ose humbin të dy palët. Në dhënien me qira ndodh e kundërta, ngase pronari merr qiranë kurse qiraxhiu mund të ketë dobi nga mbjellja ose jo.”²

Dijetari i njohur Ibn Kajjim e përshkruan tiraninë e emirëve dhe të ushtarëve ndaj bujqve dhe thotë:

“Nëse ushtarët dhe emirët i respektojnë bujqit sipas normave të sheriatit të Zotit, të Pejgamberit dhe të Hulefai-Rashidinëve, do të kenë dobi të madhe prej tyre dhe Zoti do t’ua hapë dyert e begatisë nga qielli e toka. Ata do të fitonin më shumë nga 1/4 se sa fitojnë me presion e tirani. Injoranca dhe lakmia e tyre i obligojnë të jenë tiranë e të bëjnë mëkat dhe të pengojnë begatinë e furnizimin e gjerë.

¹ Shiko më gjerësisht në: *El-Muhal-la*, Ibën Hazmi, vëll. 8; *El-Kavâ'idun-nûrâ-nijje*, Ibën Tejmije; *Mulkijetul-erdi fil-islam*, Ebu El-A'lâ El-Mevdûdî; *Mulkijetul-erdi fil-islam*, prof. Mahmud Ebus-Se'ud, revista *El-Muslimûn*, viti i parë.

² *El-Hisbe fil-islam*, Ibën Tejmije, f. 21.

Përveç kësaj, ata privohen nga bereqeti i kësaj bote, si dhe do të dënohen në botën tjetër!!”

Nëse shtrohet pyetja se ç’është legjislative nga Zoti, nga Pejgamberi e nga sahabët për ndonjërin që dëshiron t’i aplikojë, thuhet: “Gjysmëtaria e drejtë ku pronari i tokës dhe kultivuesi janë të barabartë, pa patur asnjëri prej tyre privilegje për të cilat Zoti nuk ka caktuar autoritet. (Këto privilegje) i shkatërrojnë shtetet, i prishën njerëzit, penguan begatinë dhe nxitën ushtarët e emirët që të ushqehen me haram.

Trupi i rritur me haram më parë digjet në zjarr!”

Këtë gjysmëtarë të drejtë e aplikojnë muslimanët e kohës së Pejgamberit a.s. dhe të Hulefai-Rashidinëve. Kështu vepronte familja e Ebu Bekrit, familja e Umerit, familja e Uthmanit, familja e Aliut dhe familjet tjera të muhaxhirëve. Atë e aplikojnë edhe sahabët e mëdhenj, si Ibn Mes’udi Ubej bin Ka’b Zejd ibn Thabiti; medhhebi i fukahave të hadithit, si Ahmed ibn Hanbeli, Is’hak ibn Rahavejhi, Muhamed ibn Ismail Buhari, Davud ibn Ali, Muhamed ibn Is’hak ibn Huzejme, Ebu Bekër ibn Mundhir, Muhammed ibn Nasir El-Mervezi; medhhebi i imamëve të përgjithshëm muslimanë, si Lejth ibn Sa’di, ibn Ebi Lejla, Ebu Jûsufi, Muhamed ibn Hasan etj.

Pejgamberi a.s. ka lidhur kontratë me banorët e Hajberit që ta punojnë tokën dhe prodhimin ta përgjysmojnë me harxhimet e tyre për përgatitjen e tokës dhe të farës. Kjo kontratë ka vazhduar gjatë jetës së tij deri atëherë kur Umeri i nxjerr nga Hajberi.

Në bazë të kësaj, dijetarët mendojnë se fara mund të jetë e kultivuesit (sipas Sunnetit) ose e të dyve.

Buhariu transmeton në *Sahihun* e vet se Umeri r.a. vepronte me popullin sipas mënyrës vijuese: Në qoftë se Umeri e sjell farën, i takon gjysma, e nëse e sjellin ata, atëherë u takon më shumë se gjysma.¹

Në të gjitha hadithet e transmetuara kultivuesit i sigurohet gjysma, bile më tepër e jo më pak.

Zemra është më e qetë atëherë kur pjesa e kultivuesit nuk është më e vogël se gjysma, pikërisht ashtu siç vepruan Pejgamberi a.s. dhe halifët me hebrejntë e Hajberit.² Nuk është e përshtatshme që pjesa e tokës jopjellore të jetë më e madhe se pjesa e njeriut.

¹ *Et-Turukul-hikemijje*, Ibën Kajjim, f. 248-250.

² Shiko më gjerësisht: Ibën Hazëm, *El-Mehal-la*, vëll. 8; prof. Ebu A’la El-Mevdûdi, *Mulkijetul-erdi fil-islam*; Muhamed Ebu Sau’ud, *Istiglâlul-erdi fil-islam*.

Partneriteti në kultivimin e kafshëve

Partneriteti në rritjen e kafshëve është i zakonshëm në vendet islamike, posaçërisht në fshatra. Njëra palë investon plotësisht ose pjesërisht kurse pala tjetër kujdeset për mbikëqyrjen dhe rritjen, dhe në këtë mënyrë ndarja bëhet në formën e barabartë të prodhimit dhe profitit. Për ta kuptuar më mirë këtë partneritet, do t'i sqarojmë format e partneritetit:

1. FORMA E PARË

Partneriteti për tregti, si p.sh. rritja e viçit derisa të bëhet lopë, kujdesi i lopëve dhe buallicave për qumësht.

Në këtë formë njëra palë financon kurse tjetra punon në mbikëqyrjen e rritjen e kafshëve; ushqimin e paguajnë të dy palët, dhe kur shiten, profitin e ndajnë sipas kontratës.

Nuk është e drejtë që njëra palë të harxhojë pa fituar asgjë, kur profiti ndahet në dy pjesë. Pra, kjo është e qartë!

2. FORMA E DYTË

Partneriteti midis palës që pagan dhe asaj që kujdeset e mbikëqyrë por me kusht që si kompensim të marrë qumështin ose t'i shfrytëzojë kafshët në lavër, në mbjellje e ujitje.

Kjo formë pranohet në qoftë se kafsha është e madhe dhe realisht jep qumësht ose vlen për punë. Është e vërtetë se pala e dytë që mbikëqyrë dhe që e shfrytëzon kafshën për qumësht ose punë, nuk barazohet me palën e parë. Këtu ka një lloj mosmarrëveshjeje, por ne e lejojmë ngase mosmarrëveshjen e tillë mund ta krahasojmë me të tjera të ngjashme në sheriatin islam.

Sipas një hadithi të Pejgamberit, në qoftë se kafsha zihet peng, mund të përdoret ose të mjelet:

“Njeriu që kujdeset për kafshën e zënë peng, mund ta përdorë e ta mjel.” Këtë hadith e transmeton Buhariu nga Ebu Hurejreja.

Në këtë hadith, Pejgamberi a.s. lejon që kujdesi ndaj kafshës të kompensohet me kalërim nëse është e sojit të kalërimit ose me mjellje nëse është e sojit mjellës.

Në qoftë se kjo lejohet në rastin e pengmarrjes për shkak të nevojës së ndërsjellë midis njerëzve, me mundësi që harxhimet të jenë më të vogla ose më të mëdha se fitimi nga kalërimi ose mjellja, mendoj se

duhet të lejohet një gjë e tillë në feramat e kafshëve për nevojat e njerëzve.

Ky konkludim nga hadithi i lartpërmendur është mendim personal imi, dhe shpresoj se është korrekt.

Partneritetin me kafshët e vogla (që s'mund të punojnë e as të mjelelen) me harxhime të njërës palë dhe me mbikëqyrje e rritje të palës tjetër, Islami nuk e lejon, ngase njëra palë vetëm harxhon pa patur mundësi kompensimi me punë ose qumësht, e në anën tjetër, vetëm pala tjetër fiton. Kjo s'është në pajtim me drejtësinë që e predikon Islami në të gjitha bashkëpunimet dhe transaksionet.

Në qoftë se të dy palët bashkërisht harxhojnë derisa të vijë koha e fitimit, atëherë, sipas mendim tonë, kjo është e lejuar.

DËFRIMI DHE REKREIMI

Islami është fe praktike dhe nuk ngrihet në stratosferën e idealeve të imagjinuara, por qëndron me njeriun në tokën e realitetit objektiv. Ai nuk i trajton njerëzit si engjëj me dy, tre e katër krahë, por si njerëz që hanë e që ecin nëpër tregje. Ai nuk i obligon që gjithmonë të bëjnë dhikër, që heshtja e tyre të jetë meditim, të dëgjojnë vetëm Kur'an dhe tërë kohën ta kalojnë në xhami. Ai pranon se Zoti i ka krijuar njerëzit me nevoja e dëshira, kështu që kanë nevojë për ushqim e pije ashtu siç kanë nevojë për relaksim dhe kënaqësi.

Kohë për këtë e kohë për atë

Disa as'habë të Pejgamberit a.s. e arritën kulmin e vlerave shpirtërore saqë mendonin se duhet të jenë gjithmonë seriozë, përherë të adhurojnë, të largohen nga çdo kënaqësi e kësaj jete dhe e kësaj bote, të mos dëfrehen e të mos merren me rekreim. Ata mendonin se sytë e mendimet e tyre duhet të përqëndrohen vetëm në botën tjetër e larg kësaj bote.

Sahabi i njohur Handhale El-Esîdî, i cili ka qenë shënues i veprave dhe fjalëve të Pejgamberit a.s., flet për veten dhe thotë:

Më takoi Ebu Bekri dhe më pyeti: Si je, o Handhale?

Iu përgjigja: Handhale është hipokrit!!

Ebu Bekri i thotë: *Subhanall-llah*, ç'thua?

Handhale: Kur jemi te Pejgamberi a.s., na e përshkruan zjarrin dhe xhennetin sikur t'i kishim parë para syve, por kur dalim prej tij, na preokupojnë gratë, fëmijët e pasuria dhe harrojmë shumë gjëra!!

Ebu Bekri: Për Zotin, edhe me ne ndodh kështu!

Handhale - U nisëm së bashku dhe shkuam te Pejgamberi a.s.

Handhale: O Pejgamber i Zotit, Handhale është hipokrit!

Pejgamberi a.s.: "*Pse?*"

Handhale: O Pejgamber i Zotit! Kur jemi te ti, na e përshkruan zjarrin dhe xhennetin sikur t'i shihnim me sy, mirëpo kur dalim, na preokupojnë gratë, fëmijët e pasuria, dhe kështu harrojmë shumë gjëra!!

Pejgamberi a.s.: "*Pasha Atë që shpirtin tim e ka në dorë! Nëse vazhdoni të jetoni ashtu siç jeni te unë, engjëjt do t'ua jepnin dorën*"

kur pushoni e kur ecni, por o Handhale, pak për këtë e pak për atë. Ai i përsëriti tri herë fjalët: Pak kohë për këtë e pak kohë për atë!”¹

Pejgamberi a.s. si njeri

Jeta e Pejgamberit a.s. konsiderohet shembull ideal i jetës së përkryer njerëzore. Ai në vetmi falte namaz, gjatë kohë lutej, qante dhe qëndronte në këmbë derisa i fryheshin këmbët. Në të vërtetë, ai nuk krahasonte asgjë me Zotin, mirëpo me njerëzit dhe në jetën e përditshme vepronte si njeri që i do të mirat, folte ngapak, buzëqeshte, bënte shaka dhe e thoshte vetëm të vërtetën.

Pejgamberi a.s. e donte lumturinë dhe e urrente pikëllimin dhe gjërat që shkaktojnë pikëllimin, si p.sh. borxhet e lodhjet, si dhe mbështetje në mbrojtjen e Zotit nga e keqja e tillë:

“O Zot, mbështetem në ty nga mërzia dhe mjerimi!”²

Nga shakatë e tij transmetohet se një plakë i ka thënë:

“O Pejgamber i Zotit, lute Zotin që të hyj në xhennet!” Ai i përgjigjet: “Oj nëna e filanit, në xhennet nuk hyjnë plakat!” Në atë rast, ajo pikëllohet e qan se nuk mund të hyjë në xhennet, dhe kur e sheh ashtu, Pejgamberi a.s. ia shpjegon qëllimin dhe i thotë: “Në xhennet nuk do të hyjë plaka si plakë, por në formë tjetër, gjegjësisht hyn e re dhe e virgjër!”

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Ebu Davudit.

Pastaj ia lexon ajetin e Kur'anit:

“Ne i kemi krijuar ato në një krijim të ri! Dhe ato i kemi bërë virgjëresha. Të dashuruara (për burrat e vet) të një moshe! (Vākia, 35-37)¹

Relaksimi i mendjes

Gjithashtu edhe sahabët e tij të pastër e të mirë bënë shaka, qeshnin, luanin dhe merreshin me sport për ta qetësuar trupin e mendjen dhe për të marrë fuqi për vazhdimin e rrugës serioze, ngase rruga ishte e gjatë.

Ali ibn Ebu Talibi thotë: “Mendjet lodhen ashtu siç lodhen trupat, pra trajtoni me urtësi!”

Ai gjithashtu thotë: “Çlodhni mendjet kohë pas kohe, ngase kur mendja është e lodhur, verbohet!”

Ebu Derdaja thotë: “Unë e zbavis zemrën time me diçka triviale me qëllim që ta forcoj për të vërtetën!”

Muslimanit i lejohet të dëfrehet e të bëjë shaka për ta qetësuar shpirtin ashtu siç i lejohet t’i qetësojë edhe shokët e vet me ndonjë rekretim të lejuar, por nuk i lejohet që tërë kohën ta kalojë në këtë mënyrë, të largohet nga obligimet dhe të bëjë shaka me çështjet serioze. Në këtë kontekst thuhet: “Bëni shaka sa kripa në gjellë!”

Muslimanit gjithashtu nuk i lejohet të bëjë shaka me nderin e njerëzve. Zoti i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, nuk bënë të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë se ata të cilët përqeshin dikë tjetër.” (Huxhurât, 11)

Gjithashtu muslimanit nuk i lejohet të përdorë gënjeshtren si mjet për humor. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. tërheq vërejtjen dhe thotë:

“Mjerë për atë që gënjen për t’i bërë njerëzit të qeshin! Mjerë për të! Mjerë për të!”²

¹ Transmetim i Abd ibën Hamidit dhe Tirmidhiut.

² Transmetim i Tirmidhiut.

Sportet e lejuara

Ekziston një numër i madh i sporteve dhe i lojërave artistike të cilat Pejgamberi a.s. ua lejoi muslimanëve për rekreim e dëfrim në një anë dhe për t'i përgatitur psikikisht për adhurimet dhe obligimet tjera, të jenë më aktivë e më të qëndrueshëm. Këto ushtrime ua shtojnë fuqinë dhe i përgatisin për xhihad në rrugë të Zotit.

Vrapimi

Sahabët r.a. kishin traditë të vraponin ndërsa Pejgamberi a.s. i inkurajonte. Transmetohet se Aliu r.a. ka qenë vrapues i shpejtë.

Vetë Pejgamberi a.s. bënte gara me gruan e vet Aishenë r.a. për ta dëfruar atë, për ta kënaqur veten dhe për t'u dhënë shembull sahabëve të vet.

Aisheja r.a. thotë:

“Dilnim në gara unë dhe Pejgamberi i Zotit, dhe e mundja derisa filloi të më lodhë mishi (rritja e peshës), e atëherë ai filloi të më mund.” Pejgamberi a.s. i thotë: “*Kjo (mundje) fshin të parën!*”¹

¹ Transmetim i Ahmedit dhe Ebu Davudit.

Mundja

وَقَدْ صَارَعَ النَّبِيُّ ﷺ رَجُلًا مَعْرُوفًا بِقُوَّتِهِ يُسَمَّى رُكَانَهُ
فَصَرَعه النَّبِيُّ أَكْثَرَ مِنْ مَرَّةٍ. وَفِي رِوَايَةٍ أَنَّ النَّبِيَّ ﷺ صَارَعَهُ
– وَكَانَ شَدِيدًا – فَقَالَ: شَاءَ بِشَاءٍ. فَصَرَعه النَّبِيُّ ﷺ،
فَقَالَ: عَاوِدْنِي فِي أُخْرَى، فَصَرَعه النَّبِيُّ، فَقَالَ: عَاوِدْنِي،
فَصَرَعه النَّبِيُّ الثَّلَاثَةَ، فَقَالَ الرَّجُلُ: مَاذَا أَقُولُ لِأَهْلِي؟ شَاءَ
أَكَلَهَا الذُّئْبُ، وَشَاءَ نَشَرَتْ، فَمَا أَقُولُ لِلثَّلَاثَةِ؟! فَقَالَ النَّبِيُّ
ﷺ: مَا كُنَّا لِنُجْمِعَ عَلَيْكَ أَنْ نَصَرَعَكَ وَنُغْرِمَكَ، خُذْ
غَنَمَكَ.

Pejgamberi a.s. ka dalur në mundje me Rukânin që ishte i njohur me fuqinë e tij, dhe disa herë e ka mundur.¹ Në një transmetim thuhet se Pejgamberi ka dalur në mundje me të (ishte i fuqishëm)! Pasi që mundja ishte e vështirë, Rukâne ka thënë: “Një dele për një dele!”² Kur e ka mundur Pejgamberi a.s., ka kërkuar përsëri t’i del dhe kështu tre herë (e ka mundur). Pas gjithë kësaj, Rukâne ka thënë: “Ç’t’i them familjes? Një dele e ka ngrënë ujku, e dyta ka ikur, e ç’tu them për të tretën?” Pejgamberi a.s. i ka thënë:

“Ne nuk dëshirojmë të të mundim dhe të marrim diçka prej teje. Merri delet!”

Në bazë të këtij hadithi, fukahatë argumentojnë se vrapimi lejohet, qoftë burra me burra ose burra me gra të ndaluara për t’u martuar me to ose me gratë në kurorë.

Ata gjithashtu argumentojnë se garat, mundja dhe sportet e tilla nuk e komprometojnë nderin, diturinë, virtytin dhe moshën. Kur dilte Pejgamberi a.s. në gara me Aishenë, ishte në moshën pesëdhjetë-vjeçare.

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

² Me siguri bëhet fjalë për periudhën para ndaljes së bixhozit.

Harkëtaria

Prej sporteve të lejuara janë garat në harkëtari dhe me armët tjera. Kur sahabët e Pejgamberit a.s. bënë gara në harkëtari, ai i inkurajonte dhe u thoshte:

*“Gjuani, edhe unë jam me ju!”*¹

Pejgamberi a.s. mendonte se harkëtaria nuk është vetëm sport apo hobi, por gjithashtu se prezenton një lloj force, për të cilën urdhëron edhe Zoti: *“E ju përgatituni sa të keni mundësi force!”*

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Fuqia është në harkëtari, fuqia është në harkëtari, fuqia është në harkëtari!”*² Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

عَلَيْكُمْ بِالرَّمْيِ فَإِنَّهُ مِنْ خَيْرِ لَهْوِكُمْ.

*“Praktikoni harkëtarinë ngase është sporti më i mirë për ju!”*³

Pejgamberi a.s. ndaloi që si shënjestër të caktohen pulat ose diçka e ngjashme me to e të gjuhen. Kjo formë praktikohej në periudhën paraislame.

Abdull-llah ibn Umeri ka parë një grup njerëzish duke vepruar ashtu, dhe u ka thënë:

إِنَّ النَّبِيَّ ﷺ لَعَنَ مَنْ اتَّخَذَ شَيْئًا فِيهِ الرُّوحُ عَرَضًا.

*“Pejgamberi a.s. ka mallkuar atë që merr gjallesën si shenjë!”*⁴

Pejgamberi a.s. e mallkonte këtë lloj të shënjestrës ngase maltretohej kafsha në një anë, e në anën tjetër, njeriut nuk i lejohet të harxhojë e as të dëfrehet në llogari të kafshëve të gjalla.

Për këtë shkak Pejgamberi a.s. ndaloi torturimin dhe vrasjen e panevojshme të kafshëve.⁵ Ai gjithashtu i ndaloi njerëzit që t'i nxisin kafshët që të kacafyten në mes vete.

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Muslimit.

³ Transmetim i Bezzarit dhe i Taberaniut me sened të mirë.

⁴ Transmetim unanim.

⁵ Transmetim i Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

Arabët e kishin zakon që t'i nxirrnin në dyluftim dy desh ose dy dema e t'i kacafytnin njëri me tjetrin deri në ngordhje ose afër ngordhjes, ndërsa ata rretheqark qeshnin e dëfreheshin. Dijetarët thonë: "Ndalohet nxjerrja e kafshëve në dyluftim ngase në këtë mënyrë ato torturohen e lodhen pa nevojë por vetëm për zbavitje!"

Gjuajtja me shtiza

Gjuajtja me shtiza është sport i njëjtë si harkëtaria. Pejgamberi a.s. ua lejoi etiopianëve t'i demonstrojnë shkathtësitë e tyre me shtiza. Ai e lejoi edhe Aishenë t'i shikojë, kurse vet i inkurajonte duke u thënë:

"Vazhdo, o Beni Erfedel!" (Me këtë emër ishin të njohur etiopianët në mesin e arabëve).

Umeri, i cili për nga natyra ishte tejet serioz, nuk e donte këtë sport dhe dëshiroi ta ndalojë mirëpo Pejgamberi a.s. nuk ia lejoi atij një gjë të tillë.

Në dy sahihajnët transmetohet se Ebu Hurejreja ka thënë: "Etiopianët ishin duke gjuajtur me shtiza në praninë e Pejgamberit a.s. dhe papritmas Umeri merr disa guraleca dhe i gjuan ata, mirëpo në atë rast Pejgamberi a.s. i thotë:

"Lëri të luajnë, o Umer!"

Toleranca fisnike e Pejgamberit u duk në lejin e tij që të merren me këtë sport në xhaminë e tij, me qëllim që ta harmonizojë këtë botë me botën tjetër, që xhamia të jetë vendtubim i muslimanëve në raste serioze e dëfrimi. Sporti i tillë nuk është vetëm dëfrim e rekreim por gjithashtu është edhe ushtrim. Në bazë të këtij hadithi, dijetarët muslimanë thonë: "Xhamia është për çështjet e shoqërisë islame, e në të lejohet çdo gjë që është në favor të fesë."

Shikoni muslimanët bashkëkohorë, të cilët ua kanë humbur xhamive jetën e fuqinë dhe në të shumtën e rasteve i kanë shndërruar në qendra të të papunëve përtacë.

Ky hadith përmban udhëzim fisnik për mënyrën e trajtimit të gruas dhe për dëfrimin e tyre me gjëra të lejuara.

Aisheja, gruaja e Pejgamberit a.s., thotë: “Pejgamberi a.s. më mbulonte me gujën e tij dhe i shikoja etiopianët si luanin në xhami. Ai qëndronte derisa lodhesha. Kështu e vlerësonin kohën e vajzës së re, e cila ishte e etur për dëfrim.”¹

Kalërimi

Zoti i Madhëruar thotë:

“Edhe kuajt (i krijoi), edhe mushkat edhe gomarët, për t’u hipur atyre dhe si stoli.” (Nahl, 8)

Pejgamberi a.s. thotë:

“Me kuajt është e lidhur begatia.”²

Ai gjithashtu thotë:

ارْمُوا وَاَرْكَبُوا

“Praktikoni harkëtarinë dhe kalërimin!”³

Pejgamberi po ashtu thotë:

كُلُّ شَيْءٍ لَيْسَ مِنْ ذِكْرِ اللَّهِ فَهُوَ لَهُ أَوْ سَهْوٌ، إِلَّا أَرْبَعٌ
خِصَالٌ: مَشْيُ الرَّجُلِ بَيْنَ الْغَرَضَيْنِ (لِلرَّمْيِ) وَتَأْدِيبُهُ
فَرَسَهُ، وَمُلَاعَبَتُهُ أَهْلَهُ، وَتَعْلِيمُهُ السَّبَاحَةَ.

“Çdo gjë që është jashtë përmendjes së Zotit është zbavitje e dëfrim, përveç katër gjërave: ecja prej shenjës në shenjë (gjatë

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Buhariut.

³ Transmetim i Muslimit.

harkëtarisë), ushtrimi i kalit, luajtja me familjen dhe mësimi i notit.”¹

Umeri r.a. thotë:

“Mësoni fëmijëve notin dhe harkëtarinë dhe ushtroni si të kërcejnë në shpinën e kalit!”

Ibn Umeri transmeton se Pejgamberi a.s. organizonte gara në kalërim dhe fituesit i jepte dhuratë.²

Pejgamberi a.s. vepronte kështu dhe i inkurajonte për gara sportive me qëllim që t’i ushtronte psikikisht dhe t’i disiplinonte.

Kur është pyetur Enesi se

a lidhnin bast në kohën e Pejgamberit a.s. dhe se a lidhte edhe Pejgamberi a.s. bast, ai është përgjigjur: “Po për Zotin, Pejgamberi vuri bast në një kalë të quajtur “Subha” dhe kur fitoi, u gëzua!”³

Basti lejohet në qoftë se vënia bëhet nga ata që janë jasht garuesve ose vetëm njëri prej tyre, e në qoftë se marrin pjesë të dy dhe fituesi merr prej të dyve, atëherë nuk lejohet ngase i ngjan bixhozit të ndaluar. Këtë lloj të kuajve, Pejgamberi a.s. i quan “*kuaj të djallit*” ngase përgatiten për bixhoz. Ai e konsideron mëkat çmimin, ushqimin dhe kalërimin e tyre.⁴

Pejgamberi a.s. thotë: “*Kuajt janë tre lloje: lloji i rrahmanit (Zotit), lloji i njeriut dhe lloji i djallit. Lloji i Zotit ka të bëjë me çdo gjë që ka lidhje me rrugën e Zotit (secili veprim i tij); lloji i djallit ka të bëjë me atë që është objekt bixhozi e basti, kurse lloji i njeriut ka të bëjë me atë që është për mbarësim dhe si mbrojtës nga varfëria.*”⁵

¹ Transmetim i Taberaniut me sened të mirë.

² Transmetim i Ahmedit.

³ Transmetim i Ahmedit.

⁴ Transmetim i Ahmedit.

⁵ Transmetim unanim.

Gjuetia

Islami e pranon gjuetinë si sport të dobishëm, i cili, në të vërtetë është edhe dëfrim, ushtrim e fitim, qoftë me armë si p.sh. me shigjeta ose me kafshë si p.sh. me qen e fajkua. Më parë biseduam rreth kushteve që i parasheh Islami për gjuetinë.

Islami e ndalon gjuetinë vetëm në dy raste: 1. Në periudhën e haxh-xhit e të umres, ngase në këtë kohë mbretëron paqja e plotë, nuk vritet asgjë dhe nuk derdhet gjaku. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, mos e mbytni gjahun duke qenë ju në ihram! Gjahu tokësor u është ndaluar sa të jeni në ihram!” (Mâide, 95-96)

2. Gjuetia ndalohet edhe në haremin e Mekkes, ngase, sipas Islamit, kjo zonë është zonë e paqes dhe e sigurisë për çdo gjallesë, shpezë ose bimë. Pejgamberi a.s. thotë:

“Aty nuk gjuhet, nuk priten drunjtë dhe nuk prishet atmosfera.”¹

Tavlla

Çdo lojë që luhet me të holla dhe përmban elemente të bixhozit, konsiderohet e ndaluar. Bixhozi nënkupton lojën kur lojtari ose fiton ose humb. Kur’ani bixhozin e kategorizon në një kategori me alkoolin, idhujtarinë dhe kërkimin e fatit me shigjeta.

Pejgamberi a.s. thotë:

“Kush i thotë shokut të vet eja të luajmë bixhoz, duhet të japë sadaka.” Pra, vetë thirrja në bixhoz është mëkat dhe obligon sadakanë.

Në qoftë se tavlla shndërrohet në bixhoz, atëherë ndalohet, e nëse jo, disa dijetarë thonë se është haram e disa të tjerë thonë se është e urrejtur (mekruh) e jo haram. Ndaluesit argumentojnë me transmetimin e Burejdes se Pejgamberi a.s. ka thënë:

¹ Transmetim unanim.

“Kush luan tavllë i ngjan atij që prek me dorë mishin dhe gjakun e derrit.”¹

Ebu Musa transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kush luan tavllë, bën mëkat ndaj Zotit dhe Pejgamberit të Tij.”²

Të dy hadithet janë të qarta e të përgjithshme për çdo lojtar që luan apo nuk luan bixhoz.

Shevkani thotë: “Transmetohet se Ibn Mugaffeli dhe Ibn Musejjebi lejojnë tavllën që s’ka lidhje me bixhozin dhe siç duket, të dy mendojnë se hadithet kanë të bëjnë vetëm me bixhozin.”

Shahu

Shahu është lojë shumë e popullarizuar. Mendimet e dijetarëve rreth kësaj loje janë të ndryshme: disa e lejojnë, disa e ndalojnë e disa e konsiderojnë të urrejtur.

Ndaluesit argumentojnë me hadithe të transmetuara nga Pejgamberi a.s., mirëpo hulumtuesit dhe ekspertët e Hadithit kanë vërtetuar se shahu u paraqit pas vdekjes së Pejgamberit a.s. kështu që të gjitha ato hadithe janë të fabrikuara, të rrejshme.

Edhe sahabët kanë qëndrime të ndryshme. Ibn Umeri e trajton si tavllaja, kurse Aliu e konsideron bixhoz (ndoshta kur i fiton tiparet e bixhozit), e sipas disa të tjerëve, është mekruh.

Megjithatë, transmetohet se disa sahabë e tabi’inë (gjenerata e dytë e dijetarëve) e lejonin. Në mesin e lejuesve ishin Ibn Abbasi, Ebu Hurejre, Ibn Sirini, Hisham ibn Urve, Se’id ibn Musejjeb dhe Se’id ibn Xhubejri. Mendimin e këtyre dijetarëve e pranojmë edhe ne, ngase në esencë lejohet dhe s’ka asnjë tekst që e ndalon. Përveç dëfrimit e zbavitjes, në të ka ushtrim të mendjes dhe trurit, dhe për këtë shkak edhe dallohet nga tavllaja. Thuhet se fitorja në tavllanë varet nga fati dhe i ngjan kërkimit të fatit me shigjeta, kurse fitorja në shah varet nga aftësia e strategjia dhe i ngjan harkëtarisë.

Shahu lejohet nëse plotësohen tre kushtet vijuese:

1. Të mos jetë shkak i vonimit të namazit, ngase është i njohur si vjedhës i kohës.
2. Të mos kombinohet me bixhoz, dhe

¹ Transmetim i Muslimit, Ahmedit dhe Ebu Davudit.

² Transmetim i Ahmedit, Ebu Davudit, Ibën Maxhes dhe Malikit në *Muvat-ta*.

3. Lojtari ta mbrojë gojën nga fjalët e turpshme e vulgare gjatë lojës.

Nëse nuk respektohen këto kushte ose disa prej tyre, atëherë konsiderohet haram (i ndaluar).

Kënga dhe muzika

Kënga është zbavitje që i qetëson shpirtrat, i gëzon zemrat dhe i kënaq veshët. Islami e lejon këngën që nuk përmban në vete fjalë të turpshme, dëm e nxitje për mëkat. Këngën mund ta shoqërojë muzika që nuk ngacmon e provokon. Kënga preferohet në raste festive si p.sh. në ditët e Bajramit, martesës, kthimit të udhëtarit (kurbet-çiut), lindjes etj. Aisheja r.a. transmeton se kur është martuar një grua me një ensar, Pejgamberi i ka thënë:

“Oj, Aishe, a u zbavitën? Ensarët e duan zbavitjen!”¹

Ibn Abbasi transmeton se Aisheja ka martuar një të afërme të saj me një ensar, e në atë rast ka ardhur Pejgamberi a.s. dhe ka pyetur: *“A e keni përgatitur vajzën?”* thanë: -Po - u përgjigjën njerëzit *“A dërguat me të dikë që di të këndojë?”* Unë thashë: Jo. – *“Ensarët janë popull që e do këngën, dhe ju është dashur të dërgoni ndonjë që këndon: “Ju erdhëm, ju erdhëm! Na përshëndetni ashtu si ju përshëndesim!”²*

Aisheja transmeton se në ditët e Mines, ka ardhur Ebu Bekri tek ajo dhe aty ka parë dy vajza që këndonin dhe i bienin defit në praninë e

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Ibën Maxhes.

Pejgamberit a.s. që e kishte mbuluar kokën me shall. Kur ka dashur Ebu Bekri t'i dëbojë, Pejgamberi a.s. e ka zbuluar fytyrën dhe i ka thënë:

"Lëri o Ebu Bekër! Këto janë ditë feste!" (Në festën e Bajramit të kurbanit).¹

Në librin *El-Ihja'u*, Imam Gazaliu i përmend hadithet e këndimit të dy vajzave, luajtjen e etiopianëve në Xhaminë e Pejgamberit a.s. dhe inkurajimin e Pejgamberit duke u thënë:

"Vazhdoni, o Beni Erfide"; pyetjen e Pejgamberit drejtuar Aishesë se a dëshiron t'i shohë; qëndrimin e të dyve bashkërisht derisa ajo ishte lodhur dhe lojën e Aishesë me vajzat tjera, dhe pastaj thotë: Të gjitha këto hadithe transmetohen në të dy sahihët dhe qartazi argumentojnë se kënga dhe loja nuk janë haram.

Nga këto hadithe mund të konkludojmë:

1. (Lejimi) i lojës; dhe duket qartazi tradita e etiopianëve për lojë e vallëzim.
2. Praktikimi i tyre në xhami.
3. Thënia e Pejgamberit a.s.: *"Vazhdoni, o Beni Erfede"*. Meqë këtu shohim se ka kërkesë për lojë, atëherë si mund të thuhet se është haram?
4. Pejgamberi a.s. ua ndaloi Ebu Bekrit dhe Umerit pengimin dhe dëbimin e lojtarëve e këngëtarëve, me arsyetim se ishte ditë feste, gjegjësisht ditë gëzimi dhe se kënga në raste të tilla është shprehje gëzimi.
5. Qëndrimi i gjatë i tij me Aishenë që të shohin e dëgjojnë argumenton moralin e mirë për kënaqjen e grave e fëmijëve me lojë. Kjo nënkupton se kështu është më mirë se vrazhdësia e asketizmit dhe largimi nga kjo botë.
6. Pyetja e Pejgamberit a.s. drejtuar Aishesë në fillim:

*"A dëshiron t'i shohish?"*²

7. Lejimi i këngës dhe i defit..., e kështu me radhë, deri në fund të asaj që e përmend Gazaliu në kapitullin e këngës.

Transmetohet se shumë sahabë e tabi'inë (r.a.) dëgjonin këngë pa vërejtur ndonjë të keqe në to.

¹ Transmetim uanim.

² Transmetim i Buhariut.

Hadithet që ndalojnë këngën janë të dobëta dhe të gjitha kritikohen nga kritikët dhe dijetarët e Hadithit. Kâdî Ebu Bekër ibn Arabiu thotë: “Hadithet që ndalojnë këngën nuk janë autentike!” Gjithashtu edhe Ibn Hazmi thotë: “Çdo transmetim rreth kësaj çështjeje është i pavlefshëm dhe i trilluar.”

Shpeshherë kënga dhe muzika kombinohen me dëfrim, alkool e zbavitje të natës, dhe për këtë shkak shumë dijetarë i ndalojnë ose i urrejnë (mekruh). Disa prej tyre thonë: “Kënga përmban tregime boshe”, fjalë që përmenden në ajetin.

“Po, ka nga njerëzit që blejnë tregime boshe me qëllim që t’i largojnë njerëzit prej rrugës së All-llahut pa patur kurrfarë fakti dhe për t’i marrë ato (ajetet) e All-llahut si tallje. Për ta me siguri është përgatitur dënim i turpshëm.” (Llukmân, 6)

Ibn Hazmi thotë: “Ajeti potencon një gjë të shëmtuar, të cilën kush e punon, bëhet kafir, gjegjësisht marrjen e ajeteve të Zotit si tallje. Në qoftë se ndokush e blen Kur’anin për të devijuar nga rruga e Zotit dhe për ta marrë si tallje, atëherë ai është kafir, dhe pikërisht këtë e qorton Zoti i Madhëruar e jo atë që blen tregime boshe për relaksim dhe qetësimin e shpirtit, por jo të devijojë nga rruga e Zotit.”

Kur flet Ibn Hazmi për ata që thonë se kënga nuk i takon “të vërtetës” por “humbjes” duke u mbështetur në ajetin kur’anor: “*Pas të vërtetës nuk ka tjetër pos humbje (iluzione)*”, thotë: “Pejgamberi a.s. ka thënë:

*“Veprat gjykohen sipas qëllimeve, dhe çdo njeri do ta marrë atë që e ka për qëllim!”*¹

Pra, kush dëshiron të dëgjojë këngën me qëllim që të bëjë mëkat, ai është mëkatar (fasik), (dhe kështu në çdo gjë përveç këngës), e kush dëshiron ta relaksojë shpirtin, të përforcohet në adhurimin e Zotit dhe si stimulim për mirëbërje, ai i nënshtrohet Zotit, është bamiresh dhe vepra e tij i takon të vërtetës. Kush nuk dëshiron nënshttrimin e as mëkatin, bën diçka neutrale dhe të padëmshme, si p.sh. dalja e njeriut në kopshtin e vet për shëtitje, ulja e tij para derës së shtëpisë së vet për të shikuar ose ngjyrosja e rrobave me ngjyrë të kaltër ose të gjelbër, e kështu me radhë...”

¹ Transmetim unanim.

Sidoqoftë, ekzistojnë disa përkufizime që duhet të merren parasysh kur bëhet fjalë për çështjen e këndimit:

1. Tematika e këngës nuk duhet të kundërshtojë moralin islam dhe mësimet e Islamit. Këngët që glorifikojnë alkoolin ose ftojnë në konsumimin e tij, ndalohen të këndohen e të dëgjohen. Kështu ndodh edhe me gjërat tjera të ngjashme!

2. Ndoshta tematika përputhet me udhëzimin islam por mënyra e këndimit e shndërron prej hallallit në haram, p.sh. lëvizjet provokative që nxisin epshin, fitnen e emocionet.

3. Islami jo vetëm që kundërshton teprimin në çdo gjë, bile edhe në adhurim, por gjithashtu nuk pranon edhe teprimin në dëfrim dhe teprimin në kohë, e koha është jetë?!

S'ka dyshim se teprimi në të lejuarat vjedh kohën e obligimeve. Në këtë kontekst thuhet: "Ç'do teprim humb diçka tjetër!"

4. Çdo individ është gjykatësi më i mirë i vetvetes. Në qoftë se kënga ka tipare që i provokojnë epshet, që shpiejnë në mëkat dhe ndikojnë që aspekti shtazarak të dominojë mbi aspektin shpirtëror, atëherë njeriu obligohet të largohet dhe të mbyll derën nëpër të cilën mund të depërtojë fitneja në zemër, fe e moral, dhe kështu të shpëtojë e të pushojë.

5. Mendimi unanim është se ndalohet kënga që kombinohet me gjëra të ndaluara, p.sh. të këndohet në gazmendet me alkool, të ekzekutohet me striptiz. Pikërisht për këtë lloj Pejgamberi a.s. ua tërheq vërejtjen familjes dhe dëgjuesve duke iu kërcënuar me dënim të rëndë:

*"Prej ummetit tim do të pijnë alkool. E quajnë me emra tjerë dhe afër kokave të tyre janë muzikantët e këngëtarët. Zoti do t'i bëjë që t'i gëlltisë toka dhe do t'i shndërrojë në majmuna e derra!"*¹

Kjo nuk do të thotë se Ai do t'i transformojë në formë fizike por në formë psikike e shpirtërore. Në trupin e njeriut do të jetë shpirti i majmunit dhe i derrit.

¹ Transmetim i Ibën Maxhes.

Bixhozi është identik me alkoolin

Islami lejon lojën e rekreimit mirëpo ndalon çdo gjë prej tyre që kombinohet me bixhoz, gjegjësisht me gjëra ku lojtari fiton ose humb. Më parë theksuam hadithin e Pejgamberit a.s.:

“Kush i thotë shokut të vet 'eja të luajmë bixhoz', duhet të japë sadaka.”

Muslimanit nuk i lejohet që nëpërmjet bixhozit të dëfrehet, të zbatet e të kalojë kohën e lirë. Atij gjithashtu nuk i lejohet që nëpërmjet bixhozit të fitojë.

Urtësia e madhe dhe qëllimet e madhëruara qëndrojnë pas ndalimit islam të bixhozit:

1. Islami dëshiron që muslimani të fitojë nëpërmjet ligjeve të Zotit, të kërkojë rezultate prej premisave të tij, të hyjë në shtëpi nga dera e t'i presë pasojat nga arsyet!

Bixhozi (kësaj kategorie i takon edhe lotaria), ndikon në njeriun që t'i presë fatin, rastin dhe dëshirat e zbrazëta, e jo punën, seriozitetin dhe respektimin e arsyeve të cilat i ka krijuar All-llahu xh.sh. dhe ka urdhëruar që të zbatohen.

2. Në Islam pasuria e muslimanit është e shenjtë; ajo mund t'i merret vetëm në mënyrë të ligjshme ose me dëshirën e tij të lirë si dhuratë ose sadaka. Në qoftë se i merret me bixhoz, kjo mënyrë konsiderohet e paligjshme.

3. S'është çudi se në këto raste lind armiqësia dhe urrejtja ndërmjet lojtarëve, edhe pse formalisht deklarojnë se e pranojnë humbjen. Në mesin e tyre ka gjithmonë fitues e humbalaqë. Humbësi hesht nga mospëlqimi, hidhërimi dhe humbja e shpresës: aty ka dështim nga hidhërimi e humbja e pasurisë ashtu siç ka edhe pesimizëm nga mosluarja e lojës fituese.

4. Humbja e shpresës e nxit lojtarin që ta përsërisë lojën me shpresë se do ta rikthejë pasurinë e humbur, kurse fituesin e nxit fitimi që të luajë përsëri, gjegjësisht dëshira që prej pak të fitojë më shumë, dhe kështu me radhë. Pas pak kohe, fati i fituesit humb dhe ai dështon. Kështu, të dy lidhen njëri me tjetrin dhe s'mund të largohen. Ky është edhe shkak i dështimit të lojtarëve të bixhozit.

5. Për këtë shkak ky pasion prezenton rrezikun më të madh ndaj shoqërisë dhe ndaj individit. Nëpërmjet tij humbën koha e mudi,

njerëzit shndërrohen në përtacë, marrin prej jetës e nuk japin, harxhojnë e nuk prodhojnë.

Bixhozi gjithmonë e preokupon bixhozxiun nga obligimet e tij ndaj Zotit, ndaj vetes, ndaj familjes dhe ndaj popullit.

Ndodh që adhuruesi i “tavolinës së gjelbër” të shesë fenë, nderin e vatanin. Shoqërimi i kësaj tavoline e largon prej të gjitha shoqërive tjera dhe ia mbjell animin nga bixhozi në çdo gjë, bile edhe në fe, besim e popull, edhe atë me shpresë se do të ketë fitim iluzor.

Sa të sinqerta e të madhëruara janë fjalët e Kur'anit kur alkoolin dhe bixhozin i cilëson identikë, ngase dëmet e tyre e kaplojnë individin, familjen, vatanin dhe moralin.

I dhënuri në alkool është i njëjtë me të dhënurin në bixhoz, bile rrallëherë mund të gjenden njëri pa tjetrin.

Sa i sinqertë është Kur'ani kur na mëson se këto dy gjëra janë vepra të djallit, i krahason me idhujtarinë e me kërkimin e fatit nga shigjetat dhe i trajton si gjëra të fëlliqta prej të cilave obligohet largimi:

“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të shkaktojë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po u jepni fund (alkoolit e bixhozit)? (Mâide, 90-91).

Lotaria është formë e bixhozit

Lotaria është një prej formave të bixhozit, dhe për këtë shkak ndaj saj nuk duhet të ketë plogështi e lejim në emër të “asociacioneve humanitare”, dhe “qëllimeve njerëzore.”

Ata që e lejojnë lotarinë me këtë pretekst, u ngajnë atyre që tubojnë kontribute vullnetare për qëllime të tilla nëpërmjet vallëzimit të ndaluar dhe “artit” të ndaluar.

Të dy grupeve u themi: “Zoti është i mirë dhe pranon vetëm të mirën.”

Ata që mbështeten në këto forma, na bëjnë me dije se në shoqëri nuk ka më ndjenja për mirëbërje, për mëshirë e për bamirësi, gjeqjesisht se vetëm nëpërmjet bixhozit e zbavitjes së ndaluar mund të grumbullohen ndihmat vullnetare. Islami nuk e kërkon këtë prej shoqërisë së vet ngase beson në mirësinë e njeriut i cili vetëm në-

përmjet mënyrave të pastra i arrin qëllimet e pastra. Mënyrat e tilla të pastra përmbajnë thirrjen në bamirësi, nxitjen e ndjenjave njerëzore dhe thirrjen në besimin e Zotit të Madhëruar dhe në Ditën e Ahiretit.

Shkuarja në kinema

Shumë muslimanë pyesin se çfarë qëndrimi ka Islami ndaj kinemasë, dramës dhe kështu me radhë, ose a i lejohet muslimanit të shkojë në këto vende apo jo?

S'ka dyshim se kinemaja e të ngjashmet me të luajnë rol të rëndësishëm udhëzues e dëfryes. Funksioni i saj është i njëjtë sikur funksionet tjera, dhe kryesisht mund të përdoret për gjëra të mira ose të këqija. Kinemaja vetvetiu nuk është vend i ndaluar, por gjykimi për ndalim ose lejim varet nga roli që do ta luajë.

Mendojmë se kinemaja është e lejuar dhe ka karakteristika pozitive, preferohet dhe kërkohet në qoftë se plotësohen kushtet vijuese:

1. Të jetë e pastër nga tematikat e turpshme e të pamoralshme dhe çdo gjë që kundërshton besimin islam, ligjet dhe etikën e tij. Ndalohej filmat të cilët provokojnë epshet e kësaj bote, nxisin mëkatën, cytin krimin dhe propagandojnë idetë e devijuara ose besimet e trilluara. Pra këto gjëra janë të ndaluara për muslimanin dhe nuk i lejohet t'i inkurajojë.

2. Të mos e largojë nga kryerja e obligimeve fetare dhe përgjegjësi-ve të kësaj bote. Kur bisedohet për namazet, dihet se Zoti e ka obliguar muslimanin me pesë namaze në ditë, dhe në këtë kontekst atij nuk i lejohet të humbë ndonjë namaz të caktuar (p.sh. namazin e akshamit) për shkak të shfaqjes së ndonjë filmi. Zoti i Madhëruar thotë:

“Pra, shkatërrimi është për ata që falen e të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.” (Mâûn, 4-5)

Këtu moskujdesi nënkupton lënien e namazit derisa t'i shkojë koha. Pos tjerash, Kur'ani ndalon alkoolin dhe bixhozin për shkak se pengojnë përmendjen e Zotit dhe faljen e namazit.

3. Njeriu që shkon në kinema duhet të largohet nga shtyerjet dhe përzierjet ndërmjet burrave e grave të huaja, për shkak se mund të shkaktohen fitne e dyshim, e posaçërisht kur dihet se shfaqja jepet me perde të lëshuara e në errësirë. Më parë theksuam hadithin pejgamberik:

“Më mirë është për ndonjërin prej jush që t’i shpohet koka me gjilpërë hekuri se sa ta prek gruan që nuk i lejohet”.¹

¹ Transmetim i Bejhakiut dhe Taberanit. Transmetuesit e këtij hadithi janë njerëz të besueshëm e autentikë.

NË MARRËDHËNIET SHOQËRORE

Sipas Islamit, marrëdhëniet shoqërore mbështeten në dy parime fundamentale:

1. Mbrojtja e vëllazërimit, që është lidhje e fortë midis njerëzve.
2. Mbrojtja e të drejtave individuale dhe e shenjtërisë së jetës së individit, nderit dhe pasurisë me garanci të shariatit islam.

Ndalohet çdo fjalë, punë ose sjellje që i kundërshton këto dy parime fundamentale, dhe shkalla e haramit varet nga sasia e dëmit material ose moral.

Në ajetet vijuese ka shembuj tipikë të të ndaluarave që dëmtojnë vëllazërimin dhe shenjtëritë e njerëzve:

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti). O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë tjera sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëra-tjetrën) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos mbikëqyrni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai e pranon shumë pendimin!” (Huxhurât, 10-12)

Në fillim të këtyre ajeteve Zoti i Madhëruar thotë se besimtarët janë vëllezër. Këta i lidh vëllazëria fetare me vëllazërinë njerëzore. Qëllimi i vëllazërimit është të njohin njëri-tjetrin e jo të injorohen, të bashkohen e të mos ndahen, të duhen e të mos urrehen, të jenë të singertë e të mos kenë lidhje të turpshme, të jenë të bashkuar e të mos ndahen njëri prej tjetrit. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Mos urreni njëri-tjetrin, mos përgojoni njëri-tjetrin dhe mos kini zili ndaj njëri-tjetrit, por bëhuni robër të Zotit dhe vëllezër!”¹

Nuk i lejohet muslimanit të largohet nga muslimani

I ndalohet muslimanit të largohet nga muslimani, t’i ndërprejë marrëdhëniet me të e të shmanget prej tij. Nëse dy muslimanë grinden njëri me tjetrin, sipas Islamit u lejohen vetëm tri ditë derisa të pajtohen, e pastaj të orvaten që t’i mënjanojnë mendjemadhësinë, hidhërimin e armiqësinë. Prej cilësive të lavdëruara në Kur’an është edhe:

“I butë ndaj besimtarëve”. (Mâide, 45)

Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Nuk i lejohet muslimanit të largohet prej vëllait të vet më shumë se tri ditë. Kur të kalojnë tri ditë, le ta takojë e ta përshëndesë; në qoftë se i përshëndeturi ia rikthen përshëndetjen, atëherë do të kenë shpërblim të përbashkët, e nëse jo, atëherë i përshëndeturi do të jetë mëkatar kurse përshëndetësi është i pastër.”²

Ndalimi më emfatik i prishjes së marrëdhënieve është në rastin e lidhjeve familjare. Islami i obligon muslimanët që t’i përforcojnë lidhjet e farefisnisë së tillë:

“Dhe kini frikë All-llahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.” (Nisâ, 1)

¹ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

² Transmetim i Buhariut.

Pejgamberi a.s. e përshkruan rëndësinë e mbrojtjes së kësaj lidhjeje tek Zoti dhe thotë:

الرَّحِمُ مُعَلَّقَةٌ بِالْعَرْشِ تَقُولُ: مَنْ وَصَلَنِي وَصَلَهُ اللَّهُ وَمَنْ قَطَعَنِي قَطَعَهُ اللَّهُ.

*“Farafisi është i lidhur me Arshin dhe thotë: Ai që bashkohet me mua, Zoti do t’ia mbrojë bashkimin, e ai që largohet prej meje, Zoti do ta largojë.”*¹

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

لَا يَدْخُلُ الْجَنَّةَ قَاطِعٌ.

*“Nuk do të hyjë në xhennet ai që i ka ndërprerë marrëdhëniet.”*²

Disa dijetarë e komentojnë si ndërprerës të lidhjeve farefisnore, e disa të tjerë si ndërprerës të rrugës. Sidoqoftë, që të dy trajtohen në mënyrë të njëjtë.

Lidhja fisnore nuk nënkupton vetëm ndihmën ndaj të afërmit, ngase kjo është gjë e natyrshme, por obligon vazhdimin e lidhjes edhe nësetë afërmit largohen. Pejgamberi a.s. thotë:

*“I afërt nuk është ai që i shpërblen të afërmit e tij por ai që i lidh marrëdhëniet kur të largohen prej tij!”*³

Kjo ndodh kur ndarja nuk bëhet në emër të Zotit, e në qoftë se ndodh për Zotin, atëherë këto udhëzime nuk vlejnë. Lidhja më e fortë midis besimtarëve realizohet nëpërmjet dashurisë për hir të Zotit ose urrejtjes për hir të Zotit.

Pejgamberi a.s. dhe sahabët e tij u larguan 50 ditë prej tre personave të cilët qëndruan pas shpine në Betejën e Tebukut. Bojkotimi i tyre ishte aq i përgjithshëm saqë tre personat nuk dinin se si të vepronin ose nga të shkonin derisa filluan të ndjejnë se edhe toka e gjerë është shndërruar në burg të tyre. Askush nuk i vizitonte, as nuk bisedonte me ta e as nuk i përshëndette. Ky bojkot vazhdoi derisa

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Buhariut.

³ Transmetim i Buhariut.

Zoti e pranoi pendimin e tyre dhe i shpalli Pejgamberit a.s. se Ai ua ka falur.¹

Pejgamberi a.s. është larguar prej disa grave të veta 40 ditë.

Abdull-llah ibn Umeri është larguar prej djalit të vet deri në vdekje sepse ai nuk ka pranuar një hadith që ia ka transmetuar babai i tij nga Pejgamberi a.s., me të cilin ua ndalon burrave që t'i pengojnë gratë e të mos i lënë të shkojnë në xhami.²

Largimi dhe armiqësia midis muslimanëve nuk duhet asnjëherë të shkaktohen nga ndonjë arsye e kësaj bote, ngase, sipas Zotit, për muslimanin e tërë bota është aq pak e vlefshme saqë s'meriton që për hir të saj të prishen marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve muslimanë. Si mund të ndodhë kjo kur larguesi privohet nga mëshira dhe falja e Zotit! Në hadithin autentik thuhet:

“Dyert e xhennetit hapen ditën e hënë dhe ditën e enjte dhe Zoti fal secilin rob që nuk ka bërë shirk në Zotin përveç njeriut që ka armiqësi me vëllain e vet. Në këtë rast, thotë: “Shikoni këta dy derisa të pajtohen! Shikoni këta dy derisa të pajtohen! Shikoni këta dy derisa të pajtohen!”³

Në qoftë se ndonjëri ka të drejtë, mjafton t'i vijë vëllai e t'i kërkojë falje, dhe kështu obligohet ta pranojë faljen e ta përfundojë armiqësinë. Atij i ndalohet dëbimi dhe refuzimi i faljes? Pejgamberi a.s. ia tërheq vërejtjen refuzuesit dhe i thotë se nuk do të takohet me të në shatërvanin e xhennetit Ditën e Kijametit.”⁴

Rregullimi i mosmarrëveshjeve

Nëse dy të grindur obligohen të pajtohen në bazë të vëllazërimit, atëherë për shoqërinë ekziston obligimi tjetër. Meqë shoqëria islame

¹ Transmetim i Buhariut dhe Muslimit.

² Transmetim i Ahmedit. Shiko traktatin e Sujutit *Ezzexhru bil-hixhri*.

³ Transmetim i Muslimit.

⁴ Transmetim i Taberaniut.

nënkupton shoqërinë e ndihmës së ndërsjellë dhe të bashkëpunimit, atëherë nuk i lejohet që të shohë se disa ithtarë të saj grinden dhe janë në konflikt, e të lejojë intensifikimin e zjarrit dhe zgjerimin e konfliktit. Në këto raste obligohen të mençurit dhe të aftit që të ndërhyjnë e t'i rregullojnë mosmarrëveshjet midis tyre, ta respektojnë të vërtetën dhe të largohen nga animi. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni paktim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun.” (Huxhurât, 10)

Në një hadith Pejgamberi a.s. tregon vlerën e ndërmjetësimit të tillë përmirësues dhe rrezikun nga armiqtë e konflikti:

“A t’ju tregoj se ç’është më e vlefshme se namazi, agjërimi e sadakaja?” Kur iu përgjigjën pozitivisht, vazhdoi: “Rregullimi i mosmarrëveshjeve, ngase konflikti nga mosmarrëveshja është brisk. Nuk them se i pret flokët por e pret fenë.”¹

Mos të tallet një popull me një popull tjetër

Zoti në ajetet e lartpërmendura ka ndaluar një sërë gjërash për ta mbrojtur vëllazërinë dhe shenjtërinë e njerëzve.

1. Ndalimi i parë është tallja e njerëzve.

Nuk i lejohet besimtarit që njeh Zotin dhe që shpreson në botën e Ahiretit, të tallet me ndonjë njeri ose me ndonjë grup njerëzish ngase në këtë rast ka mendjemadhësi të fshehtë dhe arrogancë, sarkazëm, nënçmim i të tjerëve dhe injorancë mbi mënyrat se si e mat Zoti bamirësinë. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse

¹ Transmetim i Tirmidhiut dhe i të tjerëve.

mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin". (Huxhurât, 11)

Mirësia tek Zoti matet me besim, sinjeritet e lidhje të mirë me Zotin e Madhëruar, e jo me formë, trupa, autoritet e pasuri.

Pejgamberi a.s. thotë:

*"Zoti nuk i shikon format tuaja e as pasuritë tuaja por i shikon zemrat tuaja dhe veprat tuaja!"*¹

A duhet të tallet njeriu me njeriun, qoftë burrë apo grua, për ndonjë deformim trupor, mangësi trupore ose për shkak të varfërisë?

Transmetohet se kur janë zbuluar këmbët e Ibn Mes'udit, njerëzit që kanë qenë afër tij i kanë parë se janë të holla e të dobëta dhe kështu kanë filluar të qeshen. Në atë rast Pejgamberi a.s. u ka thënë:

*"A qeshni për këmbët e tij të holla! Betohe me në Atë që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, këmbët e tij peshojnë më shumë se kodra e Uhudit."*²

Kur'an i rrëfen se si talleshin kriminelët idhujtarë me elitën muslimane, posaçërisht me ata të dobëtit si Bilalli e Ammari dhe si do të ndërrohet situata Ditën e gjykimit dhe do të ndodhë e kundërta:

"Mëkatarët ishin ata të cilët përqeshën ata që besuan. Dhe kur kalonin (besimtarët) pranë tyre (idhujtarëve), ata i bënë me sy njëri-tjetrit. E kur ktheheshin te familjet e veta ktheheshin të kënaqur. Dhe kur i shihnin ata (besimtarët), thoshin: "S'ka dyshim se këta (besimtarët) janë të humbur!" Po Ne nuk i caktuam ata (idhujtarët) si roja të atyre (besimtarëve). E sot, (në Ditën e gjykimit), ata që besuan do të tallen me jobesimtarët." (Mutaffifîn, 29-34)

Ajeti kur'anor në mënyrë të qartë ndalon përqeshjen e grave ndaj grave tjera ngase realisht ato janë të njohura me këtë ves.

¹ Transmetim i Muslimit.

² Transmetim i Tajalisit dhe Ahmedit.

Mos përgojoni njëri-tjetrin

2. Në kuptimin etimologjik termi *lemz* nënkupton prerjen dhe goditjen (me thikë, me shpatë ose me diçka tjetër), ndërsa terminologjikisht do të thotë përgojim i njerëzve sikur të preheshin me thikë ose të qëlloheshin me shigjetë. Është e vërtetë se fjala është më e mprehtë se shpata e thika dhe për këtë shkak edhe e dyta me radhë në kategorinë e ndalimeve.

Një poet ka thënë:

*“Plagët nga shpata mund të shërohen një ditë
por plagët nga gjuha s’munden asnjëherë.”*

Forma e ndalimit në këtë ajet është shumë suptile. Kur thuhet: *“Mos përgojoni vetveten”*, nënkupton bashkësinë e besimtarëve sikur të ishin një shpirt, të gjithë ndihmojnë njëri-tjetrin dhe bashkëpunojnë. Kështu, ai që përgojon vëllain e vet, në të vërtetë përgojon vetveten, ngase përgojimi del prej tij dhe atij i kthehet.

Mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape

3. Gjithashtu ndalohet etiketimi i njëri-tjetrit me llagape, gjegjësisht me emra që ndokush i urren e që nënçmojnë. Njeriut nuk i lejohet ta dëmtojë vëllain e vet dhe ta etiketojë me llagape që i urren e që e dëmtojnë dhe kështu t’i shkaktojë dhembje e t’i shkelë ndjenjat e vëllazërisë islame.

Dyshimi

4. Islami dëshiron që shoqërinë e vet ta themelojë në bazë të dëlirësisë së shpirttrave dhe besimit të ndërsjellë e jo në dyshime, mosbesime e akuzime.

Kështu, në ajet përmendet edhe ky ndalim i katërt me radhë me qëllim të mbrojtjes së shenjtërive të njerëzve në baza të Islamit:

“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat!” (Huxhurât, 12)

Muslimanit nuk i lejohet të dyshojë në vëllain e vet musliman pa arsye e argumente të qarta. Në esencë, njerëzit janë të pastër, dhe

kështu, nxitjet e dyshimit nuk duhet të drejtohen nga i pastërti e të akuzohet. Pejgamberi a.s. thotë:

*“Kini kujdes ndaj dyshimit! Dyshimi është biseda më e rrejshme!”*¹

Njeriu nga natyra është i dobët dhe nuk mund të shpëtojë nga paramendimet e tilla ndaj disa njerëzve, posaçërisht ndaj atyre me të cilët janë lidhjet e keqësuar dhe për këtë shkak ai obligohet që të mos dorëzohet e t’i përcjell veset e tilla. Në një hadith thuhet:

*“Nëse dyshon, mos u bind në të!”*²

Spiunimi

5. Mosbesimi në të tjerët shkakton dyshimin në zemër dhe spiunimin. Dyshimi është formë e brendshme kurse spiunimi, formë e jashtme.

Islami e ndërton shoqërinë në baza të pastra të jashtme e të brendshme, dhe për këtë shkak spiunimin e krahason me dyshimin. Shpeshherë dyshimi shkakton spiunimin!

Njerëzit kanë shenjtëri, për të cilat ndalohet spiunimi dhe përcjellja e fshehtësive të tyre, qoftë edhe atëherë kur bëjnë mëkat të fshehtë e jo publik.

Nga evidentuesi i Ukbe ibn Amirit, Ebu El-Hejthemi (sahab) transmetohet se i ka thënë Ukbe ibn Amirit: “Fqinj të tanë pijne alkool, dhe për këtë e thirrja policinë që t’i arrestojë.” Në atë rast, ai i ka thënë: “Mos i thirr, por këshilloi dhe kërcënohu!” Ebu Hejthemi i ka thënë: “U thashë ta braktisin por nuk më dëgjuan dhe për këtë do ta thërras policinë që t’i arrestojë!” Ukbeja ka reaguar: “Mjerë ti, mos vepro ashtu! E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:

مَنْ سَتَرَ عَوْرَةَ فَكَأَنَّمَا اسْتَحْيَا مَوْءُودَةً فِي قَبْرِهَا.

*“Kush mbulon një fshehtësirë i ngjan atij që ngjall vajzën e varrosur të gjallë nga varri!”*³

Sipas Pejgamberit a.s., spiunimi i fshehtësive të njerëzve është prej karakteristikave të hipokritëve, të cilët deklarojnë me gojë se besojnë por me zemër jo, dhe të tillët i ka qortuar publikisht.

Ibn Umeri transmeton se

¹ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

² Transmetim i Taberaniut.

³ Transmetim i Ebu Davudit, i Nesaiut, Ibën Habbanit në *Sahih* dhe i Hakimit.

صَعَدَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ عَلَى الْمِنْبَرِ فَنَادَى بِصَوْتٍ رَفِيعٍ
فَقَالَ: يَا مَعْشَرَ مَنْ أَسْلَمَ بِلِسَانِهِ وَلَمْ يُفِضْ الْإِيمَانَ إِلَى قَلْبِهِ!
لَا تُؤْذُوا الْمُسْلِمِينَ، وَلَا تَتَّبِعُوا عَوْرَاتِهِمْ، فَإِنَّهُ مَنْ يَتَّبِعْ
عَوْرَةَ أَخِيهِ الْمُسْلِمِ يَتَّبِعْ اللَّهُ عَوْرَتَهُ، وَمَنْ يَتَّبِعْ اللَّهُ عَوْرَتَهُ
يَفْضَحْهُ وَلَوْ فِي جَوْفِ رَحْلِهِ.

Pejgamberi a.s. ka hipur në minber dhe ka bërë titur me zë të lartë:

*“O njerëz që keni besuar me gojë e jo me zemër! Mos i dëmtoni muslimanët dhe mos i spiunoni fshehtësitë e tyre! Zoti do t’i përcjell fshehtësitë e atij që i përcjell fshehtësirat e vëllait të vet! Kujt ia përcjell Zoti fshehtësirat, do ta turpërojë qoftë edhe brenda shtëpisë së tij.”*¹

Për ta mbrojtur jetën private të njerëzve, Pejgamberi a.s. ndaloi rreptësisht hyrjen e dikujt në shtëpi të huaj pa marrë leje nga njerëzit që banojnë aty si dhe derisa të mos ketë kujdes që mos t’i shqetësojë banorët e saj. Ai ka thënë:

مَنْ اطَّلَعَ فِي بَيْتِ قَوْمٍ بِغَيْرِ إِذْنِهِمْ فَقَدْ حَلَّ لَهُمْ أَنْ
يَفْقَهُوا عَيْنَهُ.

*“Lejohet verbërimi i syrit të atij që shikon vjedhurazi në shtëpitë e njerëzve pa lejen e tyre!”*²

Ai gjithashtu ndaloi spiunimin e bisedave të njerëzve pa dijen e pëlqimin e tyre, dhe në këtë kontekst thotë:

مَنْ اسْتَمَعَ إِلَى حَدِيثِ قَوْمٍ وَهُمْ لَهُ كَارِهُونَ صُبَّ فِي
أُذُنِهِ الْأَنْكُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ.

*“Ai që i dëgjon vjedhurazi bisedat e njerëzve pa pëlqimin e tyre, veshët do t’i mbushen me plumb të shkrirë Ditën e gjykimit.”*³

Kur’ani obligon çdonjërin që dëshiron të vizitojë ndokënd në shtëpinë e tij, të mos hyjë pa leje e përshëndetje:

“O ju që besuat, mos hyni në shtëpi të huaj pa kërkuar leje dhe pa i përshëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju në mënyrë që të merrni mësim. Por nëse

¹ Transmetim i Tirmidhiut dhe Ibën Maxhes.

² Transmetim unanim.

³ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

nuk gjeni aty asnjë, atëherë mos hyni në to derisa t'u jepet leje, e nëse u thuhet kthehuni, ju pra kthehuni. Kjo është më e ndershme për ju. All-llahu di çdo gjë që veproni ju!" (Nûr, 27-28)

Në hadithin pejgamberik thuhet:

*"Çdonjëri që zbulon fshehtësi dhe depërton me sy në shtëpi të huaj pa marrë lejen, bën kundërvajtje të cilën nuk duhet ta bëjë."*¹

Tekstet e ndalimit të spiunimit kanë karakter të përgjithshëm dhe kanë të bëjnë udhëheqësit ashtu edhe me të udhëhequrit. Mua'vija transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

*"Nëse i përcjell fshehtësitë e njerëzve do t'i korruptosh ose do t'i afrosh afër korruptimit."*²

Ebu Umame transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë:

*"Nëse udhëheqësi mbjell dyshimin në popull, e korrupton!"*³

Gibeti, folja pas shpine

6. Ndalimi i gjashtë që ceket në këto ajete është gibeti!

"Mos përgojoni njëri-tjetrin!" (Huxhurât, 12)

Pejgamberi a.s. është orvatur që t'ua shpjegojë sahabëve të vet domethënien e këtij nocioni nëpërmjet metodës së tij të posaçme që zhvillohej me pyetje e përgjigje:

¹ Transmetim i Ahmedit dhe Tirmidhiut.

² Transmetim i Ebu Davudit dhe Ibën Habbanit në *Sahihun* e tij.

³ Transmetim i Ebu Davudit.

“A e dini ç’është gibeti?” Ata i thanë: “Zoti dhe Pejgamberi i Tij janë më të ditur!” Pastaj vazhdoi: *“T’ia theksosh vëllait tënd atë që e urren!”* Kur pyetet për atë që me të vërtetë ekziston tek vëllai, ai u përgjigjet: *“Nëse e thua atë që e ka, bën gibet, e nëse nuk e ka, bën shpifje.”*¹

Njeriu urren atë që ka të bëjë me moralin, me krijesën, me rrjedhën e tij e kështu me radhë.

Aisheja transmeton se i ka thënë Pejgamberit a.s.: “A sheh se Safija (gruaja e Pejgamberit a.s.) është kështu e ashtu (e shkurtë)? Pejgamberi a.s. i ka replikuar:

*“Ke thënë një fjalë që sikur ta përziye me ujin e detit, do ta errësonte.”*²

Gibeti është pasion për t’i shkatërruar të tjerët dhe dëshirë për ta përgojuar nderin e njerëzve, autoritetin e tyre dhe shenjtëritë e tyre në mungesë të tyre.

Gibeti është argument i zemërngushtësisë dhe i frikës, ngase godet pas shpine. Kjo cilësi u takon cilësive negative. Me gibet merren vetëm të pasuksesshmit. Ai është vegël shkatërrimi ngase rrallëkush shpëton prej gjuhës së gibetçiut.

Kur’ani e përshkruan gibetin në formë rrëqethëse:

“A mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur!” (Huxhurât, 12)

Meqë njeriu urren të hajë mishin e çdo njeriu, atëherë si mund të hajë mishin e vëllait të vet, edhe atë të vëllait të vdekur?!

Çdoherë që ndodhte diçka e tillë, Pejgamberi a.s. e ripërsëriste këtë përshkrim rrëqethës për t’ua ngulitur njerëzve në zemër.

Ibn Mes’udi thotë:

¹ Transmetim i Muslimit, Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Nesaiut.

² Transmetim i Ebu Davudit, Tirmidhiut dhe Bejhakiut.

Ishim te Pejgamberi a.s., dhe kur shkoi njëri, e zëvendësoi tjetri dhe foli keq për të. Në atë rast Pejgamberi a.s. i tha: *“Qëroi dhëmbët!”* Kur e pyeti: “Prej çkafit t’i pastroj, kur nuk hëngra mish”, ai iu përgjigj: *“Ti hëngre mishin e vëllait tënd!”*¹
Xhabiri transmeton:

“Ishim te Pejgamberi a.s. dhe filloi të fryjë një frymë me erë të qelbur. Në atë rast Pejgamberi a.s. tha: *“A e dini se ç’është kjo erë? Kjo është era e atyre që i përgojnë besimtarët.”*²

Kur lejohet gibeti

Të gjitha këto tekste argumentojnë shenjtërinë e haramit personal të individit në Islam, mirëpo dijetarët muslimanë veçojnë disa forma nga gibeti i ndaluar. Ky veçim duhet të vlejë vetëm në rast të nevojës, p.sh. i dëmtuari i cili ankohet nga dëmtuesi dhe flet për atë që të tjerët e urrejnë. Ky ka të drejtë të veprojë kështu për ta mbrojtur drejtësinë dhe për ta përshkruar dëmin e përjetuar. Zoti i Madhëruar thotë:

“All-llahu nuk do publikimin e shprehjeve të këqija përveç (publikimit) të atij që i është bërë padrejtësi. All-llahu është dëgjues, i dijshtëm!” (Nisâ, 148)

Kur të pyet ndokush rreth ndonjë personi me qëllim tregtie, ta martojë me vajzën e tij ose ta autorizojë për ndonjë punë të rëndësishme. Edhe pse në këtë rast konfrontohet këshillimi i obligueshëm i fesë me mbrojtjen e nderit të të munguarit, obligimi i parë është më i rëndësishëm dhe më i shenjtë, dhe për këtë i jepet përparësi.

¹ Transmetim i Taberaniut me transmetim autentik.

² Transmetim i Ahmedit me transmetim autentik.

Kur janë paraqitur dy persona për ta fejuar Fatime Bint Kajsin, e kanë kërkuar prej Pejgamberit a.s. mendimin e tij, e ai për njërin ka thënë:

“Ai s’është për kurrjë dhe s’ka pasuri të veten”, kurse për tjetrin ka thënë:

“Ai s’e lëshon shkopin nga supi.” (ka për qëllim se është rrahës i madh i grave.)

Gjithashtu lejohet të bisedohet për ndonjë person pa dijen e tij nëse opinioni i përgjithshëm ose sjellja fetare e obligojnë një gjë të tillë për t’i ndihmuar ndaj ndonjë të keqe, ose të përmendet emri, titulli apo karakteristika që janë të urrejtura për personin në mungesë, por pa të cilat nuk mund të identifikohet p.sh. “njeriu sakat” ose “njeriu me një sy.”

Gjithashtu lejohet në hetimin e dëshmitarëve dhe në hulumtimin e transmetuesve të hadithit dhe të lajmeve.¹

Rregulla e përgjithshme e lejimit të këtyre formave varet nga dy gjëra: nga nevoja dhe nga nijeti (vendosja).

1. Nuk lejohet ky haram në qoftë se nuk ekziston nevoja e madhe për përmendjen e asaj që e urren i munguari. Në qoftë se nevoja përfundon me bisedë të tërthortë, atëherë nuk duhet të përmendet qartazi, apo në qoftë se mjafton forma e përgjithshme, atëherë s’ka nevojë për specifikim. Në qoftë se pyetësi pyet se ç’mendon për njeriun që vepron kështu apo ashtu, do të ishte më mirë të mos thotë: “çmendon për filanin!” E gjithë kjo lejohet me kusht që të përmendet ajo që ekziston, e në të kundërtën, shpifja është haram.

2. Pas kësaj, nijeti luan rolin definitiv dhe njeriu më së miri e ndien këtë gjë në vete. Nijeti dallon midis dëmit dhe shërimit, midis pyetjes dhe nënçmimit, midis gibetit dhe kritikës dhe mes këshillës dhe autoritetit. Besimtari më së miri e vlerëson veten sesa udhëheqësi tiran dhe shoku lakmitar.

¹ *El-Ihjau*, Gazali; *Sherhun-Nevevi*, Muslimi; *Risaletu ref’ir-ribeti fi mâ jexhûzu ve ma lâ jexhûzu*, Sheukani.

Është e vërtetë në Islam se dëgjuesi është shok i të munguarit, dhe kështu obligohet që ta mbrojë vëllain e vet nga gibeti. Në hadithin e Pejgamberit a.s. thuhet:

“Nëse ndokush mbron nderin e vëllait të vet të munguar, Zoti do të obligohet ta shpëtojë nga zjarri.”¹

“Kush mbron autoritetin e vëllait të vet në këtë botë, Zoti do ta mbrojë fytyrën e tij nga zjarri Ditën e Kijametit.”²

Në qoftë se ndokush nuk mund ta mbrojë vëllain e vet nga fjalët e këqija ose nuk ka guxim t’u përballojë, atëherë së paku duhet ta braktisë mexhlisin e të mos afrohet derisa të ndërrohet tema e bisedës, e në qoftë se ndodh e kundërta, atëherë Zoti thotë:

“Ju jeni pra, si ata!” (Nisâ, 140)

Thashethemet

7. Kur bisedohet rreth gibetit në Islam, gjithashtu mund të bisedohet edhe për një ves të cilin Islami rreptësisht e ndaloi, gjegjësisht për thashethemet. Ky nocion nënkupton përcjelljen e fjalëve prej njërit te tjetri duke shkaktuar grindje midis tyre, duke i prishur marrëdhëniet midis tyre ose duke i keqësuar edhe më tepër.

Që në fillim të periudhës mekkase, Kur’ani e ka kritikuar këtë dukuri të keqe:

“Mos e respekto askë që betohet shumë dhe është i poshtër! Që është përgojues e përcjell fjalë ndër njerëz!” (Kalem, 10, 111)

Pejgamberi a.s. thotë:

“Ai që merret me thashetheme nuk do të hyjë në xhennet!”³

¹ Transmetimi i Ahmedit me sened hasen.

² Transmetim i Tirmidhiut me sened hasen.

³ Transmetim unanim.

Nemmâmi nënkupton atë që gjendet në mesin e shoqërisë, i dëgjon fjalët e tyre dhe pastaj merret me thashetheme, kurse *katati* nënkupton atë që i dëgjon bisedat pa dijen e biseduesve dhe pastaj merret me thashetheme.

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Më të këqij prej robërve të Zotit janë ata që merren me thashetheme, ata që i ndajnë të afërmit dhe ata që i njollosin të pastërtit.”*¹

Për rregullimin e mosmarrëveshjeve dhe për ta çrrënjësuar armiqësinë, Islami lejon ndërmjetësin përmirësues që t'i fshehë fjalët e këqija të të dyve e të shtojë fjalë të mira të padëgjuaara prej asnjërit.

Në një hadith thuhet:

“Nuk është gënjeshtar ai që pajton dy veta me fjalë të mira ose shton fjalë të mira!”

Islami hidhërohet shumë me ata të cilët dëgjojnë fjalë të këqija dhe në shpejtësi i transmetojnë për të fituar diçka, për të bërë intrigë ose nga dëshira për shkatërrim e divergjencë.

Njerëzit e tillë nuk kënaqen vetëm me atë që e dëgjojnë, por të nxitur nga dëshira për shkatërrim, shtojnë e gënjejnë edhe më tepër se ajo që kanë dëgjuar.

*Nëse dëgjojnë mirësinë, e fshehin,
nëse dëgjojnë të keqen, e përhapin dhe
nëse nuk dëgjojnë gjë, gënjejnë.*

Ka hyrë një njeri te Umer Ibn Abdulazizi dhe ka thënë diç të urrejtur për një njeri, dhe në atë rast Umeri i ka thënë:

“Nëse dëshiron, do ta shqyrtojmë çështjen tënde; nëse gënjen, i përket grupit që ceket në ajetin:

“Nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrton mirë!” (Huxhurât, 6);

Nëse flet të vërtetën atëherë i përket grupit që ceket në ajetin

¹ Transmetim i Ahmedit.

“Që është përgojues e përcjell fjalë ndër njerëz!”
(Kalem, 11);

E nëse dëshiron, ne këtë mund ta falim!” Pas kësaj, ai i ka thënë:
“Më fal o prijës i besimtarëve, nuk do ta përsëris asnjëherë!”

Shenjtëria e nderit

8. Pamë se si i mbron Islami nderin dhe dinjitetin, bile pamë se kujdesin ndaj mbrojtjes së nderit të njerëzve e ka ngritur deri në shkallën e shenjtërisë. Abdull-llah ibn Umeri një ditë e shikonte Qaben dhe thotë: “Sa e madhëruar je dhe sa e madhëruar është shenjtëria yte, mirëpo besimtari është më i shenjtë se ti!”¹

Në Haxhxin e lamtumirës, Pejgamberi a.s. mbajti një ligjëratë para masës së muslimanëve dhe tha:

*“Pasuria juaj, nderi juaj dhe gjaku juaj janë të shenjtë si shenjtëria e kësaj dite në këtë muaj dhe në këtë vend!”*²

Islami mbron nderin e njeriut edhe nga fjalët e gjetit që janë të vërteta e të mos flasim për fjalët e shpifura! Shpifja e tillë konsiderohet gabim i madh dhe mëkat i papërshtatshëm! Në një hadith thuhet:

*“Nese ndokush shpif diçka për ndokënd me qëllim që ta njollosë, Zoti do ta burgos në zjarrin e xhehennemit derisa t’i mohojë fjalët e thëna!”*³

Aisheja transmeton se Pejgamberi a.s. u ka thënë sahabëve të vet:

¹ Transmetim i Tirmidhiut.

² Transmetim i Muslimit.

³ Transmetim i Taberaniut.

“A e dini se cili lloj i kamatës është më i keq te Zoti?” Kur i thonë se jo, atëherë vazhdon: “Lloji më i keq i kamatës te Zoti është thumbimi i nderit të njeriut musliman!”¹ Pastaj ka lexuar ajetin:

“E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtare për atë që ata nuk janë fajtorë, ata e kanë ngarkuar veten me shpifje dhe me një mëkat shumë të madh.” (Ah'zâb, 58)

Forma më negative e fyerjes së nderit është shpifja e pamoralshme kundër besimtareve të ndershme, gjë që ndikon shumë në autoritetin e tyre, në autoritetin e familjes së tyre dhe në ardhmërinë e tyre, posaçërisht kur dihet se s'preferohet përhapja e shpifjeve amorale në shoqërinë islame. Për këtë shkak, Pejgamberi a.s. e konsideronte si njërin prej shtatë mëkateve të mëdha, kurse Kur'an i kërcënohet me dënim më të rreptë!

“Vërtet, ata që akuzojnë gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh. Në atë ditë kur dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë që ata kanë punuar. Atë ditë All-llahu ua plotëson shpërblimin e merituar, e ata e dinë se All-llahu është Ai i vërteti, i qarti në drejtësi. (Nûr, 23-25)

“Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, ata i pret dënimi i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk i dini.” (Nûr, 19)

Shenjtëria e jetës

9. Islami e shenjtëron jetën njerëzore, mbron shenjtërinë e shpirt-rave dhe sulmin kundër jetës e konsideron si krim më të madh te Zoti pas kufrit në Të. Në Kur'an thuhet:

“Kush mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit.” (Mâide, 32)

¹ Transmetim i Ibën Ebi Hatemit, Ibën Merdevejhut, Bejhakiut dhe Ebu Ja'liut.

E gjithë kjo është rezultat i faktit se Islami e trajton tërë gjininë njerëzore si një familje dhe armiqësia kundër një anëtar të saj, konsiderohet armiqësi kundër tërë gjinisë njerëzore. Krimi është edhe më serioz kur ka të bëjë me të vrarin që beson në Zotin:

“Kush mbyllet në besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehennemi në të cilin do të jetë përgjithmonë. All-llahu është hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh.” (Nisâ, 93)

Pejgamberi a.s. thotë:

“Përfundimi i botës është më i lehtë për Zotin se vrasja e një muslimani!”¹

Pejgamberi a.s. përsëri thotë:

“Besimtari vazhdon të jetë brenda sferës së fesë përderisa nuk derdh ndonjë gjak të ndaluar”²

Ai gjithashtu thotë:

“Zoti mund të falë çdo mëkat përveç njeriut që vdes idhujtar ose njeriut që e vret qëllimisht besimtarin!”³

Sipas këtyre ajeteve e haditheve, Ibn Abbasi konstaton se pendimi i vrasësit nuk pranohet. Meqë kushti i pendimit është kompensimi i të drejtave që i takojnë familjes ose janë në nivel të satisfikuar, atëherë si mund t'i kompensohet e drejta e të vrarit ose të jetë në nivel të satisfikuar?

Sipas disa të tjerëve, pendimi i sinqertë pranohet dhe e fshin shirkun, pra pse të mos fshijë edhe gjëratë tjera?

Zoti i Madhëruar thotë:

“Edhe ata që pos All-llahut nuk lusin ndonjë zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai e gjen ndëshkimin!

¹ Transmetim i Muslimit, Nesaiut dhe Tirmidhiut.

² Transmetim i Buhariut.

³ Transmetim i Ebu Davudit, Ibën Habbanit dhe Hakimit.

Atij i dyfishohet dënimi Ditën e Kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqijat ua shndërron në të mira. All-llahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë!” (Furkan, 68-70)

Vrasësi dhe i vrari në zjarr (xhehennem)

Sipas Pejgamberit a.s., vrasja e muslimanit është derë e kufrit dhe vepër e njerëzve paraislamë të cilët ndëznin luftëra dhe derdhnin gjaqe për një dele ose një kalë. Ai thotë:

*“Fyerja e muslimanit është mëkat kurse vrasja e tij, kufër.”*¹
Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

*“Mos u shndërroni pas meje në pabesimtarë e të vritni njëri-tjetrin!”*²
Ai po ashtu thotë:

“Nëse dy muslimanë (grinden) dhe njëri prej tyre përdor armën kundër tjetrit, atëherë që të dy janë në prag të xhehennemit, e nëse njëri prej tyre vret tjetrin, atëherë që të dy do të hyjnë në xhehennem.” Kur i është shtruar pyetja: “Kjo ka të bëjë me vrasësin, por ç’bëhet me të vradin?”, ai është përgjigjur. *“Edhe ai dëshironte vrasjen e shokut të vet.”*³

Për shkak të kësaj, Pejgamberi a.s. ka ndaluar çdo akt që shkakton vrasje ose luftë, bile edhe drejtimin e armës. Në këtë kontekst, ai ka thënë:

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim unanim.

³ Transmetim unanim.

لَا يُشِيرُ أَحَدُكُمْ إِلَى أَخِيهِ بِالسَّلَاحِ، فَإِنَّهُ لَا يَدْرِي لَعَلَّ الشَّيْطَانَ يَنْزِعُ فِي يَدِهِ فَيَقَعُ فِي حُفْرَةٍ مِنَ النَّارِ.

*“Askush prej jush s’duhet ta drejtojë armën drejt vëllait të vet, ngase djalli mund ta shtyjë dorën e të zhytet në greminën e xhehennemit (zjarrit)”.*¹

Ai gjithashtu thotë:

مَنْ أَسَارَ إِلَى أَخِيهِ بِحَدِيدَةٍ فَإِنَّ الْمَلَائِكَةَ تَلْعَنُهُ حَتَّى يَنْتَهِيَ، وَإِنْ كَانَ أَخَاهُ لِأَبِيهِ وَأُمِّهِ.

*“Kush i kërcënohet vëllait të vet me copë hekuri, engjëjt do ta mallkojnë derisa të ndalet, qoftë edhe vëlla i vërtetë!”*² Ai përsëri thotë:

*“Nuk i lejohet muslimanit ta frikësojë muslimanin!”*³

Mëkati nuk vlen vetëm për vrasësin por edhe për çdo pjesëmarrës në vrasje. Qoftë me fjalë ose me vepra, pjesëmarrësi dënohet nga Zoti sipas asaj se sa ka qenë aktiv në aktin e tillë, bile edhe ai që prezanton në vrasje merr një pjesë të mëkatit. Në një hadith thuhet:

*“Le të mos qëndrojnë ndokush prej jush në vendin ku vritet pa të drejtë ndonjë njeri. Mallkohet ai që prezanton e nuk e mbron!”*⁴

Shenjtëria e aleatëve dhe e banorëve jomuslimanë

Këto tekste që ndalojnë vrasjen dhe luftën kundër muslimanit janë ligje e udhëzime për muslimanët e shoqërisë islame, mirëpo kjo nuk do të thotë se gjaku i jomuslimanit është i lejuar. Zoti ndalon dhe mbron derdhjen e gjakut njerëzor përderisa jomuslimani nuk i sulmon muslimanët, ngase në këtë rast lejohet.

¹ Transmetim i Buharit.

² Transmetim i Muslimit.

³ Transmetim i Ebu Davudit dhe Taberaniut.

⁴ Transmetim i Taberaniut dhe Bejhakiut.

Muslimanit nuk i lejohet ta sulmojë aleatin ose rezidentin jomusliman. Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë:

“Kush vret aleatin, nuk do ta shijojë erën e xhennetit ngase do të jetë larg erës së tij në një largësi prej 40 vjetësh.”¹

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Ai që vret rezidentin jomusliman, nuk do ta shijojë erën e xhennetit!”²

Kur anulohet shenjtëria e jetës! (Dënimi me vdekje)

Zoti i Madhëruar thotë:

“Mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloj All-lahu, përpos kur është me vend!” (El-En'âm, 151)

Kushti “vetëm kur është me vend”, që theksohet në Kur'an, nënkupton dënimin për tre krime.

1. Vrasja e padrejtë (pa faj):

Për secilin që argumentohet krimi i vrasjes, obligohet shpagimi shpirt për shpirt dhe e keqja për të keqe, ngase iniciatori është shkaktar i këtij dëmi:

“Kjo masë e dënimit është jetë për ju!” (El-Bekare, 179)

2. Kurvëria (amoraliteti) publike e personit dhe e dëshmuar nga katër dëshmitarë të njerëzve të besueshëm. Dënimi me vdekje lejohet në qoftë se pushti e lavirja janë të martuar. Dëshmia individuale e katërfishtë para gjykatësit është e barabartë me dëshminë e katër dëshmitarëve.

3. Dalja nga Islami pas pranimet të tij me qëllim që t'i kërcënohet xhemaatit islam.

Islami nuk obligon askënd që me dhunë të hyjë në të, por në të njëjtën kohë refuzon manipulimin me fenë. Kështu vepronin hebrenjtë dhe thonin:

¹ Transmetim i Buhariut dhe i të tjerëve.

² Transmetim i Nesaiut.

“Besoni paradite në atë që u është shpallur atyre që besuan (muslimanëve), e pasdite mos e besoni, e ndoshta edhe ata (muslimanët), do të zbrapsen (nga besimi i tyre).” (Ali Imrân, 72)

Pejgamberi a.s. e përkufizon dënimin me vdekje në këto tre raste dhe thotë:

“Gjaku i muslimanit lejohet vetëm në tre raste: shpirt për shpirt, i martuari që bën prostitucion dhe ai që largohet nga feja e vet dhe e braktis xhemaatin!”¹

Dënimin me vdekje në këto tre raste duhet ta aplikojë njeriu autoritar e jo individ, sepse në të kundërtën mund të rrezikohet qetësia e të mbizotërojë kaosi, dhe çdo person do ta luajë rolin e gjykatësit dhe të ekzekutuesit. Vetëm në rastin e vrasjes së qëllimtë, që shpalluhet me marrjen e hakut, Islami lejon të afërmit të bëhen ekzekutues në praninë e personit autoritar, me qëllim që të qetësohen shpirtrat e tyre dhe të shuhet zjarri i hakmarrjes. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“E kush mbytet pa të drejtë (pa faj), kujdestarit të tij, Ne i kemi dhënë të drejtë (të kërkojë drejtësinë), e ai të mos e kalojë kufirin në mbytje derisa ai është i ndihmuar (prej Zotit).” (Isrâ, 33)

Vetëvrasja

Çdo gjë që theksohet rreth krimit të vrasjes, ka të bëjë edhe me vetëvrasjen meqë edhe ajo është privim i jetës së dikujt. Pa marrë parasysh se në çfarë mënyre bëhet vetëvrasja, aty merret jeta ku Zoti e ndalon dënimin e saj me vdekje pa të drejtë.

Jeta nuk është pronë e njeriut sepse ai nuk është krijues i saj; nuk është as organ i tij e as qelizë e tij. Zoti ia ka dhënë dhuratë atij dhe nuk i lejohet ta pakësojë atë, e si mund t'i lejohet ta sulmojë ose ta shkatërrojë atë? Zoti i Madhëruar thotë:

“Dhe mos mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, All-llahu është i mëshirueshëm për ju.” (Nisâ, 29)

¹ Transmetim unanim.

Islami kërkon prej muslimanit që me qëndrueshmëri e vendosmëri t'u përballojë vështirësive dhe asnjëherë nuk e lejon të ikë prej jetës e të dorëzohet para ndonjë problemi ose shprese të humbur. Besimtari është krijuar që të bëjë përpjekje e jo të përkulet, që të luftojë e jo të ikë. Besimi dhe morali i tij e ndalojnë të ikë nga fushëbeteja e jetës, pasi që në vete ka armën e pathyeshme dhe municionin e paharxhuar, gjegjësisht imanin e fortë dhe moralin e sigurt.

Pejgamberi a.s. ia tërheq vëmendjen atij që dëshiron të bëjë vetëvrasje duke i thënë se do të jetë larg mëshirës së Zotit në xhennet dhe do ta meritojë hidhërimin e Zotit në xhehennem. Në këtë kontekst, ai thotë:

“Para jush një njeri është plagosur dhe nga dhembjet e mëdha, ka marrë thikën dhe e ka prerë nyjen e dorës. Nga gjakderdhja e madhe edhe ka vdekur. Për këtë, Zoti i Madhëruar ka thënë: “Robi im shpejtoi me jetën e tij dhe për këtë shkak, i është ndaluar xhenneti!”¹

Nëse ndalohet xhenneti për një plagë të padurueshme, që është shkak i vetëvrasjes, atëherë ç'ndodh me atë që bën vetëvrasje për ndonjë kontratë që është faktor i humbjes së vogël apo të madhe, ose për provimin e padhënë apo për ndonjë femër që i ikë?!!!

Le ta dëgjojnë të dobët këtë hadith pejgamberik, i cili gjëmon si bubullima dhe vetëtima:

¹ Transmetim unanim.

“Ai që e gjuan veten nga kodra dhe bën vetëvrasje, do të hyjë në xhehennem, ku përherë do të digjet; ai që pi helm dhe bën vetëvrasje, do të hyjë në xhehennem, ku përherë do të digjet; kush bën vetëvrasje me copë hekuri, do të digjet gjithmonë në zjarr!”¹

Shenjtëria e pasurisë

10. Muslimanit i lejohet të grumbullojë pasuri aq sa dëshiron, përderisa e grumbullon në mënyrë të lejuar dhe e fiton me mjete ligjore.

Islami thotë:

“Sa e mirë është pasuria e mirë e njeriut të mirë,”² kurse fetë tjera thonë: “I pasuri nuk do të hyjë në perandoritë e qiejve derisa devet të mos hyjnë nëpër birë të gjilpërës.”

Meqë Islami e lejon pronën ligjore për muslimanin, atëherë atë e mbron me ligj dhe me udhëzim moral nga vjedhësit, uzurpuesit ose konfiskuesit.

Sipas Pejgamberit a.s., shenjtëria e pasurisë, e gjakut (jetës) dhe e nderit janë brenda një sfere të përbashkët, si dhe vjedhjen e konsideron kundërshtare të asaj që e obligon besimi:

“Vjedhësi kur vjedh nuk është besimtar!”³

Zoti i Madhëruar thotë:

¹ Transmetim unanim.

² Transmetim i Ahmedit.

³ Transmetim unanim.

“Vjedhësit dhe vjedhëses preni duart, si shpagim i veprës që bëjnë (kjo masë është) dënim nga All-llahu. All-llahu është i fuqishëm, ligdhënës i urtë!” (Mâide, 38)

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Muslimanit nuk i lejohet të marrë asnjë shkop pa lejen (e pronarit të tij).”*¹ Ai këtë e thotë nga rëndësia e madhe e mbrojtjes së pasurisë së muslimanit.

Zoti i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete.” (Nisâ, 29)

Ndalimi i mitës (ryshfetit)

Marrja e mitës është formë e ngrënies së pasurisë së njerëzve në mënyrë të palejuar. Ky nocion nënkupton dhënien mitë e ndonjë autoritari ose ndonjë funksionari të përgjithshëm për të gjykuar në favor të dhënësit e në dëm të kundërshtarit, të kryejë ndonjë punë ose të vonojë diçka që i përket kundërshtarit...

Islami ndalon muslimanin që të përdorë mitën ashtu siç i ndalon udhëheqësit dhe bashkëpunëtorët e tyre që të marrin mitën. Islami gjithashtu ua ndaloj të tjerëve që të ndërmjetësojnë midis dhënësve dhe marrësve të mitës.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Dhe mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, e as mos u paraqitni me të (me ryshfet) te gjykatësit për të grabitur në mënyrë të padrejtë një pjesë të pasurisë së njerëzve, kur ju e dini (se pa të drejtë po e hani atë.)” (El-Bekare, 188)

Pejgamberi a.s. thotë:

¹ Transmetim i Ibën Habbanit në *Sahihun* e tij.

“Mallkimi i Zotit është mbi mitëdhënësin dhe mbi mitëmarrësin në pushtet!”¹

Thevbani transmeton se Pejgamberi a.s.

e ka mallkuar “mitëdhënësin, mitëmarrësin dhe ndërmjetësin!”²

Krimi është edhe më i madh kur mita jepet për dëmtimin e ndonjërit. Drejtësia është e obligueshme dhe s’blehet me para!

Kur e dërgoi Pejgamberi a.s. Abdull-llah ibn Revahën te hebrenjtë që ta caktojë tatimin e palmave, ata i ofruan ryshfet, mirëpo ai refuzoi ta pranojë duke u thënë:

“Haram është ryshfeti që ma ofroni dhe për këtë ne nuk e pranojmë!”³

Nuk është për t’u habitur nga qëndrimi kategorik ndaj mitës dhe pjesëmarrësve në të, ngase përhapja e saj në shoqëri përhap korrupsionin dhe tiraninë; gjykohet në mënyrë të padrejtë dhe pengohet gjykimi i drejtë, vonohet ajo që duhet të shpejtohet dhe shpejtohet ajo që duhet të vonohet. Mita bën që në shoqëri të dominojë shpirti i interesit e jo ai i obligimit.

Dhurata për zyrtarët

Islami ndalon të gjitha format dhe të gjithë emrat e mundshëm të mitës. Trajtimi i mitës si “dhuratë” nuk e shndërron prej sferës së haramit në atë të hallallit.

Në një hadith thuhet:

¹ Transmetim i Ahmedit, Tirmidhiut dhe Ibën Habbanit.

² Transmetim i Ahmedit dhe i Hakemit.

³ Transmetim i Malikit.

“Kur e angazhojmë ndonjërin në ndonjë punë, kujdesemi edhe për furnizimin e tij, dhe çdo gjë që pranon pos kësaj, konsiderohet fitim ilegal.”¹

Kur i është dhuruar Umer ibn Abdulazizit një dhuratë gjatë halifatit të tij, ai e ka refuzuar, dhe kur i është thënë se Pejgamberi a.s. e ka pranuar dhuratën, ai ka reaguar: “Për të ka qenë dhuratë e për ne ryshfeti!”

بَعَثَ الرَّسُولُ ﷺ وَالْيَا يَجْمَعُ صَدَقَاتِ الْأَزْدِ (قَبِيلُهُ)
فَلَمَّا جَاءَ إِلَى الرَّسُولِ أَمْسَكَ بَعْضَ مَا مَعَهُ وَقَالَ: هَذَا لَكُمْ
وَهَذَا لِي هَدِيَّةٌ، فَغَضِبَ النَّبِيُّ وَقَالَ: أَلَا جَلَسْتَ فِي بَيْتِ
أَبِيكَ وَبَيْتِ أُمِّكَ حَتَّى تَأْتِيَكَ هَدِيَّتُكَ إِنْ كُنْتَ صَادِقًا؟!
ثُمَّ قَالَ: مَا لِي أَسْتَعْمِلَ الرَّجُلَ مِنْكُمْ فَيَقُولُ: هَذَا لَكُمْ
وَهَذَا لِي هَدِيَّةٌ؟ أَلَا جَلَسَ فِي بَيْتِ أُمِّهِ لِيُهْدَى لَهُ! وَالَّذِي
نَفْسِي بِيَدِهِ، لَا يَأْخُذُ أَحَدٌ مِنْكُمْ شَيْئًا بِغَيْرِ حَقٍّ إِلَّا أَتَى اللَّهَ
يَحْمِلُهُ – يَعْنِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ – فَلَا يَأْتِيَنَّ أَحَدُكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ
بِبَعِيرٍ لَهُ رُغَاءٌ، أَوْ بَقَرَةٍ لَهَا خَوَارٌ، أَوْ شَاةٍ تَيْعَرٌ! ثُمَّ رَفَعَ
يَدَيْهِ حَتَّى رُئِيَ بَيَاضُ إِبْطَيْهِ ثُمَّ قَالَ: اَللَّهُمَّ هَلْ بَلَغْتُ؟

Pejgamberi a.s. dërgoi një njeri për ta mbledhur zekatin e fisit Ezd dhe kur u kthye te Pejgamberi, mori diçka prej zekatit të mbledhur dhe tha: “Kjo është për ju, e kjo tjetra është dhuratë imja!” Në atë rast, Pejgamberi a.s. u hidhërua dhe tha: “Nëse ke të drejtë, a do të të arrinin këto dhurata sikur të qëndroje në shtëpinë e babait tënd dhe të nënës tënde!”

Pastaj vazhdoi e tha: “Ç’është me mua? E caktoj njërin prej jush e më thotë: Kjo është e juaja e kjo është dhuratë imja? Sikur të ishte në shtëpinë e babait të vet, a do të merrte dhuratë? Beto hem në Atë që ka shpirtin tim në dorën e Vet, askush prej jush nuk mund të ma-

¹ Transmetim i Ebu Davudit.

rrë diçka të padrejtë e t'i dalë Zotit me të Ditën e Kijametit. Le të mos dalë askush prej jush Ditën e Kijametit duke mbajtur deve që ulëron, lopë që pëllet ose dele që blegëron!" Pastaj i ngriti duart e ulut: *"O Zot, a e transmetova mesazhin!"*¹

Imam Gazaliu thotë: "Në bazë të këtyre qortimeve, gjykatësi, guvernatori ose ndokush tjetër që është autoritar, duhet të imagjinojë se është në shtëpinë e babait dhe të nënës së vet. Në qoftë se mendon se do të pranojë dhuratë edhe pas braktisjes së punës, atëherë mund ta pranojë dhuratën e ofruar. Në qoftë se mendon se nuk mund ta pranojë në shtëpinë e prindërve të vet por i dhurohet vetëm për shkak të postit, atëherë nuk duhet ta pranojë. Nëse e ka vështirë të vendosë, si p.sh. për dhuratat e shokëve të vet, të cilët mund t'i dhurojnë dhuratë edhe kur nuk është në post, atëherë bie në një pozitë të dyshimtë dhe i preferohet që të mos e pranojë dhuratën e tyre."²

Ryshfeti për largimin e shtypjes (zullumit)

Atij që i është humbur e drejta dhe s'ka mënyrë tjetër për ta fituar përveç me ryshfet ose është dëmtuar dhe s'mund të kompensojë dëmin përveç me ryshfet, i preferohet që të durojë derisa Zoti t'ia ofrojë mënyrën më të përshtatshme për mënjanimin e dëmit dhe rifitimim e të drejtës.

Në qoftë se obligohet të përdorë ryshfetin, atëherë mëkati i takon ryshfetmarrësit e jo atij që jep, ngase ky është rezultati i dështimit të të gjitha formave tjera dhe shpëton nga dëmi ose përfiton të drejtën (e të humbur) pa i sulmuar të drejtat e të tjerëve.

Disa dijetarë argumentojnë me hadithet e transmetuara rreth atyre që insistonin të merrnin sadaka prej Pejgamberit a.s. edhe pse nuk u takonte e ai ua jepte. Umeri r.a. transmeton se ai (a.s.) ka thënë:

¹ Transmetim unanim.

² *Ihjau ulûmid-dîn*, libri *El-halâlu vel-harâm*, f. 137.

إِنْ أَحَدُكُمْ لَيَخْرُجُ بِصَدَقَتِهِ مِنْ عِنْدِي مُتَابِعًا –
يَحْمِلُهَا تَحْتَ إِبْطِهِ – وَإِنَّمَا هِيَ لَهُ نَارٌ! قَالَ عُمَرُ: يَا رَسُولَ
اللَّهِ كَيْفَ تُعْطِيهِ وَقَدْ عَلِمْتَ أَنَّهَا لَهُ نَارٌ؟
قَالَ: فَمَا أَصْنَعُ؟ يَأْبُونَ إِلَّا مَسْأَلَتِي وَيَأْبَى اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ
لِي الْبُخْلُ.

“Ndonjëri prej jush del prej meje me sadaka nën sqetull, e cila është zjarr për të (për marrësin)”. Kur Umeri i thotë: “O Pejgamber i Zotit, pse i jep kur e di se është zjarr për të!”, e ai i përgjigjet: “Ç’të bëj, insistojnë lypjen prej meje, e Zoti i Madhëruar nuk ma lejon koprracinë.”¹

Kur insistimi e obligonte Pejgamberin a.s. t’i japë lypësit edhe pse e dinte se ajo dhënie ishte zjarr për të, atëherë si të veprohet në rastin e presionit nga nevoja për shpëtimin nga dëmi ose për rikthimin e të drejtës së humbur?!

Harxhimi i tepërt ndalohe

Përveç pasurisë së të tjerëve që është e shenjtë dhe që ndalohe të sulmohet haptazi ose fshehurazi, ekziston shenjtëria edhe në vetë pasurinë e njeriut, të cilit i ndalohe ta humbë, të bëjë harxhim të tepërt ose ta zhdukë duke e shkapërderdhur djathtas e majtas.

Edhe ummeti ka të drejtë në pasurinë e personave dhe ai është pronar i çdo pronari, kështu që ka të drejtë ta pengojë atë që harxhon tepër. Në këtë kontekst, Kur’ani thotë:

“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj që All-llahu e bëri për ju mëkëmbje, e ata ushqeni nga ajo, veshni dhe u thoni fjalë të mira.” (Nisâ, 5)

Këtu Zoti i drejtohet popullit dhe i thotë: *“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj”*, edhe pse pasuria është pronë e tyre, në realitet, pasuria e çdo personi është pasuri e tërë popullit. Islami është fe e drejtësisë dhe e modestisë, ummeti islam është ummet modest dhe muslimani është moderativ në çdo gjë, dhe ky

¹ Transmetim i Ebu Ja’liut me sened të mire, i Ahmedit. Transmetimet e këtij hadithi janë autentike.

është shkaku që Zoti ua ndalon besimtarëve harxhimin e tepërt ashtu siç ua ndalon edhe dorështërngimin. Zoti i Madhëruar thotë:

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz e lutje, hani dhe pini e mos e teproni, pse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).” (El-A'râf, 31)

Teprimi nënkupton harxhimin në atë që e ka ndaluar Zoti, si p.sh. në alkool, drogë, enë ari, enë argjendi etj., edhe atë pa marrë parasysh se a harxhohet pak apo shumë.

Teprimi gjithashtu nënkupton harxhimin e tepërt për vetveten e për të tjerët. Pejgamberi a.s. ndalon shkapërderdhjen e pasurisë.¹

Teprimi nuk lejohet edhe në harxhimin për gjërat e panevojshme e të mbetet njeriu pa asgjë në rast nevojë.

Në komentimin e ajetit: “*Të pyesin ty edhe se ç’do të japin*”. Thuaj: “*Tepricën!*”, imam Raziu thotë se Zoti i Madhëruar i mëson njerëzit si të japin dhe i thotë Pejgamberit r.a.:

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon, edhe të varfërit, edhe atij në kurbet, por mos shpenzo tepër e pa rrugë. Ata që shpenzojnë tepër (mastrafaxhinjtë) janë vëllezër të djajve, e djalli është përbuzës i madh i Zotit të tij!” (Isrâ, 26, 27)

Zoti i Madhëruar përsëri thotë:

“Dhe mos e bën dorën tënde të lidhur për qafe (mos u bëj koprrac), e as mos e shtrijë në tërësi e të mbetesh i qortuar dhe duarthatë (nga shpenzimi i tepërt!” (Isrâ, 29)

Zoti i Madhëruar gjithashtu thotë:

“Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e teprojnë e as nuk janë dorështërnguar, por mbajnë mesataren e janë të matur.” (Furkân, 67)

Pejgamberi a.s. thotë:

*“Nëse ndokush prej jush ka diçka, le të fillojë prej vetvetes, pastaj le të dalë te ata që i mirëmban e kështu me radhë.”*²

Pejgamberi a.s. gjithashtu thotë:

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Muslimit.

*“Sadakaja më e mirë është ajo që të lë të vetëmjaftueshëm.”*¹

Transmetohet se Xhabir Ibn Abdull-llahu ka thënë:

“Ishim duke ndjenjur te Pejgamberi a.s. dhe ja, erdhi një njeri me një copë ari që kishte formën e një veze dhe iu drejtua Pejgamberit a.s.: “O Pejgamber i Zotit, merre sadaka! Beto hem në Zotin se s’posedoj gjë përveç kësaj!” Pejgamberi a.s. refuzoi t’ia marrë, mirëpo ai e ndiqte ngado që të kthehej dhe pastaj i hidhëruar i tha: “*Ma jep!*” dhe pasi e mori ia gjuajti aq shumë sa që sikur ta godiste, do ta plagoste, dhe në atë rast tha: “*Ndokush prej jush më sjell pasurinë që e ka e pastaj ulet dhe kërkon lëmoshë prej njerëzve. Sadakaja është ajo që të le të vetëmjaftueshëm! Merre ngase s’kemi nevojë për të!*”²

Nga Pejgamberi transmetohet se zakonisht i siguronte familjes së vet ushqim njëvjektor!³

Të urtit thonë: “Virtyti është ndërmjet shtërngimit e teprimi; teprimi i shumë është shkapërderdhje kurse shtërngimi i tepërt koprraci, kurse mesatarja është virtyt.”

Kjo ishte domethënia e fjalës së Zotit: “*Thuaj: “Tepricën!”*”, ndërsa “mesatarja” është bazë e sheriatit të Muhammedit a.s.

Parimi i ligjit të hebrenjve është ashpërsia ekstreme, i ligjit të të krishterëve, shthurja ekstreme kurse ai i Muhammedit a.s., mesatar-

¹ Transmetim i Taberaniut me sened hasen.

² Transmetim i Ebu Davudit dhe Hakimit.

³ Transmetim i Buhariut

ja në çdo gjë, dhe për këtë shkak është edhe më i plotë se sistemet tjera!¹

¹ Tefsiri i Fahuiddin Raziut, vëll. 6. f. 51.

MARRËDHËNIET E MUSLIMANIT ME JOMUSLIMANIN

Nëse dëshirojmë t'i përmblehim mësimet islame për marrëdhëniet me jomuslimanët (të lejuara e të ndaluara), mjafton të cekim dy ajetë kur'anore që meritojnë të jenë rregulla gjithëpërfshirëse të kësaj çështjeje:

"All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë. All-llahu ju ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes." (Mumtehinë, 8-9)

Ajeti i parë nuk ka për qëllim vetëm drejtësinë ndaj jomuslimanëve që nuk i luftojnë muslimanët për shkak të fesë e që nuk i nxjerrin nga shtëpitë e tyre (gjegjësisht ata, me të cilët s'ka luftë e as armiqësi midis tyre e muslimanëve), por edhe mirësjelljen ndaj tyre. Termi *birr* nënkupton bamirësinë e gjerë që kapërcen drejtësinë. Këtë term e përdorin muslimanët për të drejtat e obligueshme, gjegjësisht për mirësjelljen ndaj prindërve.

Urdhri kuptohet nga fjala e Zotit: "*Zoti i do të drejtët*", e muslimani përpiket gjithmonë ta realizojë atë që e dëshiron Zoti. Nuk ka kundërshtim midis fjalës së Zotit "*Zoti nuk ua ndalon*" (60:80), e cila është më e butë se interpretimi ynë i "kërkimit" dhe "urgjencës" së drejtësisë. Nëpërmjet kësaj shprehjeje, Zoti i Madhëruar dëshiron t'i eliminojë botëkuptimet e gabuara nga mendjet e njerëzve, se të gjithë jomuslimanët janë të njëjtë dhe se nuk meritojnë trajtim të mirë dhe mirësjellje nga muslimanët. Këtu All-llahu xh.sh. qartëson se Ai nuk e ndalon mirësjelljen ndaj jomuslimanëve në përgjithësi, por vetëm ndaj atyre që janë në luftë dhe që i sulmojnë muslimanët.

Kjo shprehje i ngjan fjalës së Zotit rreth *Safasë* e *Merves*, kur disa njerëz nuk dëshironin të ecnin midis ngase ende ishin nën ndikimin e traditave paraislame:

“E kush e mësyen shtëpinë për haxhxxh (Qaben për haxhxxh) ose për Umre (vizitë jashtë kohës së haxhxxhit), nuk është mëkat për të t’i vizitojë që të dyja (të shkojë në ato dy vende).” (El-Bekare, 158)

Me këtë mohim të mëkatit për anulimin e iluzionit të tillë, *sa’ji* është obligativ dhe pjesë e haxhxxhit dhe e umres.

Trajtim i posaçëm ndaj ithtarëve të Librit (ehlul Kitâb)

Edhe pse Islami nuk ndalon mirësjelljen ndaj jomuslimanëve në përgjithësi, qofshin edhe idhujtarë, siç janë për shembull idhujtarët arabianë për të cilët zbritën edhe dy ajetet e lartpërmendura, ai ka trajtim të posaçëm ndaj ithtarëve të Librit, gjegjësisht ndaj hebrejve e të krishterëve, qofshin brenda ose jashtë territorit islam. Islami i thirrë “*O ithtarë të Librit!*” dhe “*O ju që u është zbritur Libri!*” me qëllim që të tregojë se në esencë ata janë ithtarë të fesë qiellore, se midis tyre e muslimanëve ka afërsi e lidhje të ngushta në bazë të parimeve të një feje, e cila u është shpallur të gjithë peygamberëve:

“Ai u caktoi juve për fe atë që i pat caktuar Nûhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrâhimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) të praktikoni fenë e drejtë e të mos përçaheni në të!” (Esh-Shûrâ, 13)

Muslimanët obligohen që të besojnë në të gjitha librat e Zotit, në të gjithë peygamberët, sepse ndryshe nuk mund ta realizojnë besimin e tyre:

“Ju (besimtarë) thuani: “Ne i besuam All-llahut, asaj që na u shpall neve, asaj që iu shpall Ibrâhimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakupit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), asaj që i është dhënë Musait, Isait dhe asaj që u është dhënë nga Zoti i tyre peygamberëve. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur!” (El-Bekare, 136)

Nëse ithtarët e Librit e lexojnë Kur’anin, do të vërejnë se ai i lavdëron librat, mesazhet dhe peygamberët e tyre!

Nëse muslimanët zhvillojnë dialog me ithtarët e Librit, duhet të largohen nga çdo gjë që shkakton hidhërim e armiqësi:

“Ithtarët e Librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: “Ne i besuam asaj që na zbriti neve dhe që ju zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij!” (Ankebût, 46)

Më parë vërejtëm se Islami lejon ngrënien e ushqimit të tyre dhe ndarjen e mishit të cilin ata e kanë prerë, ashtu siç lejon martesën me femrat e tyre, kur dihet se martesë nënkupton qetësi, dashuri e mëshirë. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Ushqimet (të therurat) e ithtarëve të Librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar). Gratë e ndershme besimtare, dhe (gratë) e ndershme nga ata të cilëve u është dhënë Libri para jush.” (Mâide, 5)

Kjo në përgjithësi ka të bëjë me ithtarët e Librit, e të krishterët në veçanti, Islami i afron afër zemrave të muslimanëve:

“Do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: “Ne jemi nesârâ-të krishterë”. Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneqë.” (Mâide, 82)

Banorët jomuslimanë në shtetin islam (ehludh-dhimme)

Të gjitha këshillat e lartpërmendura i përmbledhin të gjithë ithtarët e Librit kudo që janë, me përjashtim të rezidentëve në shtetin islam, që kanë trajtim të posaçëm dhe të cilët në terminologjinë e muslimanëve njihen me emrin *ehludh-dhimme*. *Dhimme* nënkupton mbrojtjen e tyre ngase gëzojnë kontratën nga Zoti, nga Pejgamberi a.s. dhe nga bashkësia islame se do të jetojnë të sigurt e të qetë në shtetin islam.

Sipas terminologjisë bashkëkohore, këta janë shtetas të shtetit islam. Të gjithë muslimanët, prej periudhave në të hershme e deri më sot, janë të mendimit unanimit se atyre u takon ajo që u takon muslimanëve dhe se të gjithë kanë përgjegjësi të barabartë, përveç çështjeve të fesë e besimit, ngase në këtë lëmë Islami u garanton liri të plotë fetare.

Porosia e Pejgamberit për kujdesin ndaj rezidentëve jomuslimanë ishte rigoroze dhe i kërcënohej me dënim nga Zoti çdonjërit që largohej nga porositë e tilla.

Në hadithet vijuese thuhet:

“Kush dëmton rezidentin jomusliman (dhimmiun) më dëmton mua, dhe kush më dëmton mua dëmton edhe Zotin!”¹

“Unë jam armik i atij që dëmton rezidentin jomusliman, e nëse jam armik i ndokujt, do ta sulmoj Ditën e gjykimit.”²

“Kush dëmton aleatin, ia merr të drejtën ose e obligon më tepër se sa ka mundësi, apo merr diçka pa lejen e tij, do ta sulmoj Ditën e gjykimit.”³

Pasardhësit e Pejgamberit a.s. kishin kujdes ndaj mbrojtjes së të drejtave dhe shenjtërive të shtetasve jomuslimanë. Edhe pse juristët kishin medhhebe të ndryshme, përsëri i shohim unanimitet në respektimin e të drejtave dhe shenjtërive të tyre.

Juristi malikit Shihabuddin Kurâfi thotë: “Përgjegjësia ndaj të drejtave të rezidentëve jomuslimanë është jona ngase jetojnë afër nesh, nën përgjegjësinë tonë dhe nën mbrojtjen tonë, nën mbrojtjen e Zotit të Madhëruar, nën mbrojtjen e Pejgamberit a.s. dhe nën mbrojtjen e Islamit. Kush i sulmon ose i ofendon me ndonjë fjalë të keqe, ose ofendon nderin e tyre me thashetheme apo i ofendon në ndonjë mënyrë tjetër, do ta humb garancinë e Zotit, garancinë e Pejgamberit a.s. dhe garancinë e Fesë islame.”⁴

¹ Transmetim i Taberaniut në librin *El-evsat* me sened hasen.

² Transmetim i Hatibit me sened hasen.

³ Transmetim i Ebu Davudit.

⁴ Shiko librin *El-Furûk* nga autori Kurafi.

Juristi ekzoterist Ibn Hazmi thotë: “Në qoftë se vijnë kundërshtarët t’i luftojnë rezidentët tanë jomuslimanë, obligohemi të dalim e të luftojmë me armë e t’i mbrojmë deri në vdekje ngase ata janë nën garancinë e Zotit të Madhëruar dhe të Pejgamberit të Tij. Në qoftë se i dorëzojmë pa kurrfarë rezistence, zhvlerësojnë kontratën e garancisë.”¹

Nocioni i shoqërimit të jomuslimanëve

Në mendjet dhe në gjuhët e disa njerëzve qarkullon pyetja: “Si mund të realizohet mirësjellja, respekti e shoqërimi me jomuslimanët kur në Kur’an theksohet largimi nga pabesimtarët dhe mospranimi i tyre si prijës:

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh se vrapojnë te ta (për miqësi) duke thënë: “Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe!” (Mâide, 51-52)

Ne përgjigjemi se këto ajete nuk janë të pakushtëzuara dhe nuk përfshijnë çdo hebre, të krishter ose pabesimtar. Sikur të kuptohej kështu, atëherë do të binte në kundërshtim me tekstet tjera të cilat urdhërojnë mirësjelljen ndaj mirësjellësve të çdo feje e të cilat lejojnë martesën me femrat, ithtare të Librit. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“Dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe midis jush krijoi dashuri e mëshirë.” (Er-Rûm, 21)

“Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: “Ne jemi nesârâ-të krishterë”. (Mâide, 82)

Ajetet e lartpërmendura kanë të bëjnë me ata që e sulmojnë Islamin e që i luftojnë muslimanët; dhe në këto raste, muslimanit nuk i lejohej t’u ndihmojë, t’i shoqërojë, t’ua zbulojë fshehtësirat ose të bëhet aleat me ta në dëm të shoqërisë e popullit të vet. Këtë e qartësojnë edhe ajetet vijuese kur’anore:

“O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm

¹ Libri *Meratibul-ixhma’i* i Ibën Hazmit.

tuajin, u dëshirojnë çka ju mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojët e tyre, por ajo që fshehin në gjokset e tyre është edhe më e madhe. Në pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni. Ja, ju (muslimanë) jeni që i doni ata, e ata nuk ju duan juve.” (Âli Imrân, 118-119)

Ky ajet na i tregon cilësitë e tyre dhe se ata fshehin armiqësinë e urrejtjen ndaj muslimanëve në zemrat e tyre, kurse ndikimi i tyre vërehet në gojët e tyre.

Zoti i Madhëruar thotë:

“Nuk gjen në popull që e beson All-llahun dhe Ditën e gjykimit, e ta dojë atë që kundërshton All-llahun dhe Të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, fëmijët e tyre, vëllezërit e tyre ose farefisi i tyre.” (Muxhâdele, 22)

Kundërshtimi i All-llahut dhe i Pejgamberit të Tij nuk nënkupton vetëm pabesimin por edhe armiqësinë kundër Islamit e muslimanëve.

Zoti i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, nëse keni dalur (prej vendlindjes) për hir të luftës në rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi juve. Ata dëbojnë Të dërguarin dhe juve, sepse i besoni All-llahut, Zotit tuaj.” (Mumteherine, 1)

Ky ajet ka të bëjë me idhujtarët e Mekkes, të cilën e kundërshtonin Zotin e Pejgamberin a.s. dhe i dëbuan muslimanët prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte vetëm pse thonin: “Zoti ynë është All-llahu.” Në asçfarë mënyre nuk lejohet shoqërimi me të këtillët.

Ajeti nuk i këput shpresat në tërësi nga gjendja e tillë por ua bën me dije muslimanëve se gjendja mund të ndryshojë e t'i pastrojë zemrat. Në të njëjtën sure, pas disa ajeteve, thuhet:

“Pritet që All-llahu të vendosë miqësi ndërmjet jush dhe atyre që kishit armiqësi, All-llahu është i fuqishëm, All-llahu falë mëkatet, është mëshirues.” (Mumteherine, 7)

Kjo vërejtje kur'anore mjafton që të zbutet armiqësia kategorike. Në një hadith gjithashtu thuhet:

“Urreje armikun tënd me masë, se ndoshta një ditë bëhet shok yti.”¹

¹ Transmetim i Tirmidhiut, i Bejhakiut në *Shu'bul-Iman* nga Ebu Hurejra, kurse Sujutiu e konsideron hadith hasen. Ajo që e transmeton Buhariu në *El-Edebul-mufred* nga Aliu, ka transmetim të këputur.

Konfirmohet ndalimi i shoqërimit të armiqve të fuqishëm ngase te ata shkojnë hipokritët e zemërsëmurit për të kërkuar ndihmë prej tyre, me shpresëse do t'u nevojiten në të ardhmen. Në këtë kontekst, Zoti i Madhëruar thotë:

“E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh se vrapojnë te ata (për miqësi) duke thënë: “Po frikësohemi se mos po na sillet ndonjë e keqe”. Po, All-llahu do të sjellë fitoren, ose diç tjetër nga ana e Tij, e atëherë do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre.” (Mâide, 52)

“Ti (Muhammed) lajmëroi munafikët se me të vërtetë ata kanë një dënim të dhembshëm. Janë ata që përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë fuqi te ta? S'ka dyshim, e tërë fuqia i takon All-llahut.” (Nisâ, 138-139)

Mbështetja në jomuslimanët

Nuk është mëkat për muslimanët që të kërkojnë ndihmë prej jomuslimanëve në çështjet që s'kanë të bëjnë me fenë, si p.sh. në medicinë, në industri, në bujqësi etj., edhe pse preferohet që muslimanët të mbështeten në vetveten.

Në biografinë e Pejgamberit vërejmë se ai a.s. e ka angazhuar idhujtarin Abdull-llah ibn Urejkitin që ta udhëheq në emigrim. Dijetarët thonë: “Të qenurit e tij idhujtar nuk nënkupton se në esencë është i pabesueshëm, ngase s'ka gjë më të rrezikshme se udhëzimi jo i drejtë në rrugë, veçanërisht në rrugën e emigrimit për në Medinë.”

Përveç kësaj, ata e lejojnë udhëheqësin musliman të kërkojë ndihmë prej jomuslimanëve (posaçërisht prej ithtarëve të Librit) në çështjet ushtarake dhe t'u japë nga plaçkat e luftës ashtu siç u jep edhe muslimanëve.

Zuhriu transmeton se Pejgamberi a.s. në një betejë ka kërkuar ndihmë prej hebrenjve dhe u ka ndarë pjesë prej plaçkave të luftës. Idhujtari Safvân ibn Umejje ka dalur me Pejgamberin a.s. në Betejën e Hunejnit.”¹

Mbështetja kushtëzohet me atë që jomuslimani i tillë të ketë mendim të mirë ndaj muslimanëve, e nëse jo, atëherë ndihma prej tij

¹ Transmetim i Se'idit.

ndalohet, ngase prej njeriut të pabesë ndaj muslimanëve dalin vetëm thashetheme dhe shqetësime.¹

Muslimanit i lejohet t'i dërgojë ose të marrë dhurata prej jomuslimanit. Mjafton të cekim këtu se Pejgamberi a.s. i pranonte dhuratat e mbretërve jomuslimanë.²

Dijetarët e Hadithit thonë se është i madh numri i haditheve që tregojnë pranimin e dhuratave nga pabesimtarët.

Nga gruaja e Pejgamberit, Ummu Seleme transmetohet se Pejgamberi a.s. i ka thënë:

*“Nexhashiut i kam dhuruar një mantel dhe mëndafsh.”*³

Islami e respekton njeriun si njeri, posaçërisht kur bëhet fjalë për ithtarin e Librin, aleatin dhe rezidentin jomusliman.

Kur ka kaluar një xhenaze pranë Pejgamberit a.s., ai është ngritur, dhe kur i është thënë:

“O Pejgamber i Zotit, ajo është kufoma e hebreut!”, ai ka thënë: “A nuk është shpirt?”⁴

Po, ai është shpirt, dhe çdo shpirt, sipas Islamit, ka shenjtëri e rëndësi.

Islami është mëshirë e përgjithshme edhe për kafshët

Si mund të lejojë Islami muslimanin që ta dëmtojë jomuslimanin, kur dihet se ai poroset mëshirë ndaj çdo qenieje të gjallë dhe ndalon sjelljen e ashpër ndaj kafshëve!

Islami qysh para trembëdhjetë shekujsh u parapriu shoqatave që i mbrojnë kafshët. Ai e konsideron mirësjelljen ndaj tyre si pjesë të imanit kurse dëmtimin e tyre e dënon me zjarr.

¹ *El-Mugni*, vëll. 8, f. 41.

² Transmetim i Ahmedit dhe i Tirmidhiut.

³ Transmetim i Ahmedit dhe Taberaniut.

⁴ Transmetim i Buhariut.

Pejgamberi a.s. u rrëfente shokëve të vet për një njeri që kishte gjetur një qen të etur, kishte zbritur në një pus për të marrë ujë me këpucën e tij dhe i kishte dhënë ujë qenit derisa e kishte shuar etjen. Pejgamberi as. për këtë njeri tha

“Zoti i është falënderuar dhe e ka mëshiruar!” Kur e pyetën sahabët se a kanë ndonjë shpërblim nga kafshët, ai u është përgjigjur: *“Shpërblim ka prej çdo gjallese!”*¹
Përveç mëshirës së Zotit dhe pëlqimit të Tij, Pejgamberi a.s. potencon edhe një formë tjetër që meriton dënimin dhe urrejtjen e Zotit! Në këtë kontekst, ai thotë:

*“Një grua ka hyrë në zjarr për shkak të një mace, të cilën e kishte mbyllur dhe as nuk e ushqente e as nuk e lironte të ushqehet me brejtësit e tokës”.*²

Për respektimin e kafshës si kafshë, transmetohet se Pejgamberi a.s. kur ka parë një gomar të damkosur në fytyrë, ka refuzuar një akt të tillë dhe ka thënë:

*“Për Zotin, nuk do ta damkosja kafshën në fytyrë veçse në pjesët tjera (të trupit)! ”*³

Në një hadith tjetër transmetohet se ka kaluar pranë një gomari të damkosur në fytyrë dhe ka thënë:

*“A nuk keni dëgjuar se e kam mallkuar atë që damkos fytyrën e kafshës ose e qëllon në fytyrë!?”*⁴

¹ Transmetim i Buhariut.

² Transmetim i Buhariut.

³ Transmetim i Muslimit.

⁴ Transmetim i Ebu Davudit.

Më parë cekëm se Umeri r.a. ka hasur në një grup që ushtronte har-këtarinë në një pulë të gjallë dhe u ka thënë:

“Pejgamberi a.s. ka mallkuar atë që e përdor gjallesën si shënjestër!”

Abdull-llah ibn Abbasi thotë:

نَهَى النَّبِيُّ ﷺ عَنِ التَّحْرِيشِ بَيْنَ الْبَهَائِمِ.

“Pejgamberi a.s. e ka ndaluar dyluftimin midis kafshëve!”¹ (Nxitjen e kafshëve në dyluftim deri në vdekje ose në plagosje të rëndë).

Ibn Abbasi po ashtu transmeton se Pejgamberi a.s.

نَهَى عَنْ إِخْصَاءِ الْبَهَائِمِ نَهْيًا شَدِيدًا.

kategorikisht ka ndaluar treshjen e kafshëve.²

Kur’ani i qortonte paraislamët sepse i çanin për së gjati veshët e kafshëve duke e konsideruar një akt të tillë si inspirim të djallit.³

Kur biseduam për therjen, pamë se si kujdesej Islami për prerje më të lehtë të kafshës dhe si urdhëronte që të mprehet thika e të fshehet nga ajo. Islami gjithashtu ndalon therjen e kafshës para kafshës tjetër.

Bota asnjëherë nuk ka parë kujdes kaq të madh ndaj kafshës!

¹ Transmetim i Ebu Davudit dhe Tirmidhiut.

² Transmetim i Bezzarit me sened sahih.

³ Kjo është theksuar në suren *Nisâ*, ajeti 119.

PËRFUNDIM

Qëllimi ynë në këtë libër ishte që të sqarojmë hallallin dhe haramin (të lejuarën e të ndaluarën) praktik e të dukshëm, kurse aspektet e brendshme, lëvizjet shpirtërore, ndjenjat dhe dëshirat që i lejon apo i ndalon Islami, ose që i ndalon rreptësisht si p.sh. urrejtja, zilia, xhelozia, mendjemadhësia, hipokrizia, dyfytësia, koprracia e arroganca etj., nuk ishin tema për të cilat u përpilua ky libër, edhe pse Islami insiston me koncentrim të plotë në luftimin e tyre, ia tërheq vëmendjen Pejgamberit a.s. nga sherri i tyre, i quan disa prej tyre “*sëmurje*” të popujve që jetuan para nesh, ashtu siç i quan edhe “*brisk*”, mirëpo jo për prerjen e flokëve, por për prerjen (shkatërrimin) e fesë.

Çdo studiues i Kur'anit dhe i Sunnetit të Pejgamberit a.s. vëren se zemra e shëndoshë është shpëtim i individit e i shoqërisë, në këtë botë dhe në botën tjetër:

“Zoti nuk ndryshon gjendjen e një populli përderisa ai nuk ndryshon veten!” (Ra’d, 11)

“Ditën kur s’ndihmon as pasuria e as fëmijët por vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë. (Esh-Shuarâ, 88)

Në këtë kontekst, Pejgamberi a.s. thotë: “*E lejuara është e qartë dhe e ndaluara është e qartë, e midis tyre ka gjëra të dyshimta, prej të cilave kush largohet, shpëton fenë dhe nderin e vet, e kush i praktikon, mund të zhytet në të ndaluarën. Çdo mbret ka zonën e vet të siguruar, e zona e siguruar e Zotit në tokë është në ndalimet e Tij!*”

Pastaj lavdëron vlerën e zemrës e cila është gjenerator i aspiratave, i animeve e dëshirave në sjelljet njerëzore:

“*Në trupin e njeriut ka një copë mishi, e cila nëse është e shëndoshë, e shëron tërë trupin, e nëse është e prishur, e prishë tërë trupin, e kjo është zemra.*”

Zemra pra është kryesuese e organeve të trupit, mbrojtëse e të gjitha gjymtyrëve dhe nëse është e shëndoshë, shëndoshet edhe tufa, e nëse prishet, prishet edhe tufa.

Zoti i peshon gjërat sipas zemrës e njetit e jo sipas formës e gjuhës: “Zoti nuk i shikon format tuaja por i shikon zemrat tuaja.” “Veprat shpërblehen sipas njetit dhe çdonjëri do të shpërblehet sipas qëllimit.”

Ky është statusi i veprave të zemrës dhe i çështjeve të shpirtit në Islam. Ne nuk i kemi theksuar këto gjëra ngase i përkasin etikës e jo hallallit e haramit, dhe për këtë shkak edhe i kanë studiuar dijetarët muslimanë të etikës e sufizmit dhe i kanë quajtur “Sëmurje të zemrës”, duke i analizuar shkaqet e shërimit në bazë të Kur’anit e Sunnetit të pastër. Të gjitha këto çështje shpirtërore, Imam Gazaliu i ka përmbledhur në një të katërtën e enciklopedisë së tij *Ihja ulûmid-dîn*, dhe i ka titulluar “Sëmurje fatale”, ngase janë faktorë të shkatërrimit në këtë botë dhe në botën tjetër.

Kur i theksuam të ndaluarat, patëm për qëllim vetëm mëkatet e kryera e jo edhe ato të lëna, ngase mëkatet janë dy lloje: praktikimi i asaj që është e ndaluar dhe mospraktikimi i asaj që është e urdhëruar. Lloji i dytë i mëkatit nuk ka qenë subjekt i këtij libri, edhe pse e kemi potencuar aty-këtu në formë të shkurtë. Sikur të dëshironim shqyrtimin e mëkateve të lëna, atëherë do të duhej të bisedonim për një subjekt tjetër, gjegjësisht do të duhej t’i shqyrtonim të gjitha obligimet e urdhëruara nga Zoti për muslimanët. Pa dyshim se mosaplikimi ose lënia pasdore e obligimeve të tilla është haram, p.sh. dituria është e obligueshme për çdo musliman e muslimane, e zhytja e muslimanit në errësirën e paditurisë konsiderohet haram. Gjithashtu muslimani obligohet me farzet e namazit, agjërimin, zekatin, haxhërit dhe parimet kryesore të Islamit. Nëse muslimani nuk i aplikon pa ndonjë pengesë ose arsye, bën mëkat prej mëkateve të mëdha, e kush tallet e i zhvlerëson, del prej Islamit.

Gjithashtu është obligim islam që ummeti të forcohet ushtarakisht për ta mbrojtur veten nga armiku i Zotit dhe nga armiku i vet. Këtë obligim ummeti e ka në përgjithësi e udhëheqësit në veçanti, dhe mosaplikimi i obligimit të tillë konsiderohet haram dhe turp i madh. Këtë trajtim e kanë edhe obligimet tjera në jetën individuale e kolektive.

Ne nuk pretendojmë se i kemi përfshirë të gjitha llojet e hallallit e haramit, por e kemi theksuar vetëm atë që duhet ta dijë çdo

musliman se çka i lejohet e çka i ndalohet në jetën individuale, familjare e shoqërore.

Këtë e kemi bërë ngase shumica e njerëzve nuk i dinë vendimet ose urtësinë e hallallit e haramit, ose i lënë pasdore e i zhvlerësojnë.

U orvatëm të tregojmë urtësinë e madhe të sheriatit islam në çështjet e hallallit e haramit, kështu që secili që posedon dy sy, të shohë se Zoti i Madhëruar nuk lejon me qëllim që të bëhet i butë ndaj njerëzve e as që ndalon për ta vështirësuar jetën, por cakton atë që është në favor të tyre, që mbron fenë, botën, shpirtin, mendjen, moralin, pasurinë dhe qenien e tyre njerëzore, qoftë për individin apo shoqërinë.

Të gjitha ligjet pozitive njerëzore janë defektive e të pakompletuara. Faktorët ligjdhënës, qofshin individë, qeveri ose parlamente, mbrojnë interesin material dhe i anulojnë vlerat e fesë e moralit, si dhe gjithmonë janë të mbyllur në rrethet e ngushta nacionaliste e territoriale pa u kujdesur fare për botën e madhe dhe për njerëzinë e gjerë. Këta miratojnë ligje për kohën e tashme e të caktuar, ndërsa e lënë pasdore të nesërmen e tyre dhe e injorojnë të ardhmen. Para së gjithash, këta janë njerëz që karakterizohen me dobësi, epshe e përkufizime:

“Vërtet ai (njeriu) i bëri padrejtësi vetes dhe është i padijshëm”. (Ah'zâb, 72)

Kështu, nuk duhet habitur fakti se legjislacionet pozitive janë shkurtpamëse, të cekta, materialiste e të përkohshme, ashtu siç nuk duhet habitur edhe nga njerëzit ligjdhënës që lejojnë apo ndalojnë sipas qejfeve të tyre e sipas dëshirës së mendimit publik, edhe pse ka njohuri rreth rrezikut dhe dëmit të madh që mund të pasojnë. Si shembull konkret mjafton të cekim lejimin e alkoolit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe anulimin e ndalimeve të mëparshme, edhe pse dihej dëmi individual, familjar e shoqëror prej tij.

Sheriati islam është i pastër krejtësisht nga mangësitë e tilla, ngase është Ligj nga Krijuesi që i di dhe që i njeh krijesat e veta, di se ç'është në favor e ç'është në dëm të tyre, për çka janë të aftë e për çka jo!

“All-llahu di të dallojë qëllimkeqin nga qëllimmiri.” (El-Bekare, 220)

Ai, si Krijues, di se ç'bën krijesa:

“A nuk e di Ai që ka krijuar kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë.” (Mulk, 14)

Ai është sheriat i Zotit të urtë, që ndalon mënyrën shkel e shko e që nuk lejon rastësisht, por çdo gjë krijon me masë dhe të gjitha ligjet e Tij janë harmonike.

Ai është sheriat i Zotit të mëshirshëm, që dëshiron të ofrojë lehtësim për robërit e vet e jo vështirësim. Si të mos veprojë kështu kur Ai është më i mëshirshëm se nëna ndaj fëmijës së vet?

Ai është sheriat i Sunduesit të fuqishëm që s'ka nevojë për (ndihmën) e robërve të vet, nuk anon nga ndonjë sekt, gjini apo gjeneratë ose ndokujt t'ia lejojë atë që ua ndalon të tjerëve. Si të veprojë kështu, kur Ai është Zot i të gjitha botëve?

Këtë bindje e ka muslimani ndaj Ligjit të caktuar nga Zoti rreth hallallit, haramit dhe çështjeve të tjera. Ai e pranon me bindje të plotë, me zemër të mbushur përplot pëlqim e zbatim dhe me dëshirë të flaktë për aplikim. Ai beson se lumturia e tij në këtë botë dhe shpëtimi i tij në botën tjetër varen nga respektimi i rregullave të Zotit, që urdhërojnë e ndalojnë dhe që kanë të bëjnë me hallallin e haramin.

Do të theksojmë dy shembuj nga jeta e muslimanëve gjatë periudhës së parë (islame), me qëllim që ta ilustrojmë atë se si kujdese-shin për respektimin e rregullave të Zotit rreth hallallit e haramit dhe si shpejtonin në aplikimin e tyre:

Shembulli i parë

Kur biseduam rreth ndalimit të verës, thamë se arabët shumë e përdornin dhe e pinin nëpër tubime. Meqë Zoti e dinte realitetin e tillë, filloi ta ndalojë në mënyrë graduale derisa u shpall edhe ajeti që e ndalon në mënyrë definitive dhe që e cilëson si vepër të ndytë nga shejtani. (Mâide, 90)

Kështu, Pejgamberi a.s. ndaloj konsumimin e verës, shitjen dhe dhurimin e saj jomuslimanëve, dhe në atë rast muslimanët iu përgjigjën pozitivisht dhe të gjitha sasi të alkoolit që i kishin të depoluara, i derdhën nëpër rrugët e Medines.

Edhe më shumë na habit fakti se kur e dëgjoi një grup ajetin ndalues, edhe pse i kishin gotat në dorë të mbushura e të papërfunduara, i gjuajtën duke iu përgjigjur fjalës së Zotit: *“Pra, a po i jepni fund!”*, *“O Zot, përfunduam!”*

Nëse e krahasojmë këtë fitore të dukshme kundër alkoolit në territorin islam me dështimin e hatashëm të SHBA-ve¹ kur dëshiruan ta pengojnë alkoolin me ligje e forcë, do të konkludojmë se njerëzve më tepër u konvenon ligji qiellor, i cili mbështetet në ndjenja e besim para se të mbështeten në fuqi e qeveri.

Shembulli i dytë

Ky shembull ka të bëjë me gratë e para muslimane të cilat iu përgjigjën pozitivisht ndalimit të zbukurimit sipas traditës paraislame pas vendimit të Zotit, dhe veshjes e mbulesës së urdhëruar.

Gruaja paraislame e kishte zakon të ecë me gjoks të hapur, fythapur, flokëlëshuar dhe vathhapur, mirëpo Islami ia ndaloi këtë mënyrë të xhahilijetit paraislam dhe i urdhëroi të dallohet nga gratë paraislame, të mbulohet e t'i mbulojë gjoksin, fythin dhe veshët së bashku me kokën.

Nëna e besimtarëve, zonja Aishe r.a. transmeton se si e pranuan këtë ligj hyjnor gratë e muhaxhirëve e të ensarëve në shoqërinë e hershme islame, kryesisht ligjin për ndryshimin e rëndësishëm të jetës së grave në formë, zbukurim e veshmbathje.

Aisheja thotë: “Zoti i mëshiroftë gratë e para muhaxhire... Kur Zoti e shpalli ajetin

“Le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre” (Nûr, 31),

i grisën teshat e tyre për t'u mbuluar.”²

Një grup grash u ulën një ditë afër saj dhe filluan t'i përmendin vlerat e grave kurejshite, e ajo u tha: “Gratë e Kurejshit kanë vlera mirëpo unë nuk kam parë më të vlefshme se gratë e ensarëve, më besnike ndaj Librit të Zotit e më të bindura në Kur'an. Kur zbriti sureja “Nûr”: “Le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre”, burrat e tyre shkuan dhe ua lexuan atë që e shpalli Zoti për to. Kur ia recitonin gruas, vajzës, motrës ose ndonjëres nga familja, menjëherë grisnin ndonjë teshë dhe e mbulonin trupin nga bindja në atë që ua shpalli Zoti xh.sh. në Kur'an. Kështu, kur shkonin të falin namazin pas Pejgamberit a.s., dukeshin sikur të kishin sorra në kokë.”³

¹ Shikoni më gjerësisht librin tim *El-akîdetu darûretun lil-hajâti*.

² Transmetim i Buhariut.

³ Këtë e cek Ibën Kethiri në tefsirin e tij të ajetit nga sureja *Nûr* prej Ibën Ebi Hatemit.

I tillë ishte qëndrimi i grave besimtare ndaj ligjeve të Zotit për to, shpejtimi i tyre në realizimin e urdhrave të Tij dhe largimi nga ndalimi i Tij pa hamendje, pa dyshim dhe pa pritje. Ato nuk pritnin të kalojnë një ose dy ditë derisa të blejnë diçka të përshtatshme për mbulimin e kokës ose për mbulimin e kraharorit, por përdornin çdo lloj teshe, pa marrë parasysh ngjyrën, e nëse nuk gjenin diçka, i shqyenin teshat që i kishin dhe e mbulonin kokën, pa menduar fare për pamjen e tyre që dukeshin sikur të kishin sorra në kokë (sipas përshtatshme të Aishesë r.a.).

Ne dëshirojmë të potencojmë se nuk mjafton vetëm njohja e qartë e hallallit dhe haramit. Edhe pse gjërat janë të qarta për çdo musliman përsëri vërejmë se shumë muslimanë zhyten në haram dhe hyjnë syhapur në zjarr. Pra, këtu obligohet edhe devotshmëria ndaj Zotit, e cila dirigjon çdo gjë, ose, sipas të shprehurit modern, obligohet ndjenja e gjallë e cila e udhëzon në hallall dhe e ndalon nga harami. Kjo ndjenjë zhvillohet vetëm në sferën e besimit në Zotin xh.sh. dhe në botën tjetër.

Nëse muslimani ka njohuri të mira për rregullat e fesë e të sheriatit të saj dhe vetëdije vigjilente, atëherë do t'i posedojë të gjitha të mirat. Të sakta janë fjalët e Pejgamberit a.s.: *“Nëse Zoti dëshiron të mirën e ndonjë individi, shpirtin e tij ia bën këshilltar!”*¹

Të përfundojmë me lutjen e njohur nga paraardhësit tanë:

“O Zoti im, me hallallin Tënd bë më të pavarur nga harami Yt, me respektin ndaj Teje bë më të pavarur nga gabimet ndaj Teje, ndërsa me begatitë tua bë më të pavarur nga çdokush tjetër përpos Teje!”

Falënderimi i takon All-llahut i cili na udhëzoi në këtë, meqë sikur të mos na udhëzonte, nuk do të ishim të udhëzuar!

¹ El-Irâkî thotë: “Këtë e ka transmetuar Dejlemi në *Musnedin* e Firdevsit me sened të mirë.

Recensor
Dr. Ismail Ahmedi

Redaktor gjuhësor - korrektor
Fatmire Ajdini - Hoxha

Përgatitja kompjuterike
Urim R. Poshka

P.H. "Logos-A"
II Mak. brigada TC "Treska" X/7
91000 Skopje - R. Macedonia
Tel./Fax: (091) 611-508

Shtypi "Focus" - Shkup

Spored misleweto na Ministerstvoto za kultura br. 08/1-6892/2 od 9.12.1997, za knjigata *Dozvolenoto i nedozvolenoto vo Islamot* se plaža povlastena dano~na stapka.

Sipas mendimit të Ministrisë për Kulturë nr. 08/1-6892/2 të datës 9.12.1997, për librin *Hallalli dhe harami në Islam* bëhet pagesa e lehtësuar tatimore.